

# Dituria



13

Imam Gazaliu

**Imam Ebu Hamid Muhammed  
eI- GAZALI  
(Rahmetullahi alejh)**

**IHJAU 'ULUMI'D - DIN**

**DITURI**

**Prishtinë 2017**

**Përgatiti dhe përktheu:**

Ia-hak Shala dhe Abdullah B. Ferizi

**Lektor:**

Artan Sadiku

**Përgatitja kompjuterike:**

İlhan Bölükbaşı

**BISMIL'LAHI'R-RAHMANI'R-RAHIM**  
**Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit!**

**PARATHËNIE**

Pikësëpari, siç falënderon (hamd) çdokush, edhe unë vazhdimisht dhe pafund falënderoj Allahun Teala, sadoqë karshi hakikatit të madhësisë së Tij, kjo është pak.

Së dyti, i dërgoj salat dhe selame peygamberit të fundit, Resulallahut s.a.v.s., dhe të gjithë peygamberëve.

Së treti, kërkoj ndihmë dhe hair prej Allahut Teala, në nijetin e bërë për shkrimin e librit **'Ihjau Ulumid-din'**.

E katërta, kjo vepër është për atë kritikues që pas shpine, nga mesi i kritikuesve, më së shumti shfaq ekstremizëm dhe që nga mesi i refuzuesëve të pavëmendshëm dhe të shpërqëndruar, kalon në mohim dhe qortim. Dëshiroj që sa më parë t'i jap fund shpërqëndrimit tënd.

Në të vertetë, ajo që më shtyu të zgjidh nyjën e heshtjes prej gjuhës dhe të vendos në qafë gjerdanin e të folurit, është të qortoj pëlqimin tënd për paditurinë, dhe këmbënguljen tënde në përkrahje të së pavërtetës duke refuzuar ta kuptosh të vërtetën e qartë, ku Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Në ditën e kiametit vuajtjen më të rëndë do ta shijojnë dijetarët që nuk kanë përfituar (për ahiretin e tyre) prej ditorisë së Allahut Teala.”<sup>1</sup>**

---

<sup>1</sup> Taberani në **'Sagir'** dhe Bejhaki në **'Shu'abu'l-Iman'** nga Ebu Hurejre.

Duhet të largohesh nga dijetarë të tillë, dhe sadoqë nuk është e mundur të kompenzohen plotësisht disa mangësi nga e kaluara e kotë - siç është përmirësimi i vetes dhe pastrimi i zemrës - duhet vepruar në përputhje me diturinë, duke u larguar nga ritualet popullore, me shpresën për ngritje në shkallën e adhuruesit ashtu siç urdhëron Allahu Teala.

Betohem në jetë se i vetmi shkaktar i qëndresës tënde në mohim është sëmundja që ka përfshirë shumicën; mosmendimi i fundit - ahiretit, mosnjohja e ardhmërisë së lumtur – kënaqësisë në ahiret.

Derisa kjo botë mbetet mbrapa, ahireti po afrohet, exheli po afrohet, udhëtimi është i gjatë e jeta e shkurtë, rruga me rreziqe të mëdha e dija dhe veprat tua nuk janë në përputhje me sheriat; ti nuk je duke e ditur që është shumë e vështirë të hysh në rrugën e ahiretit pa udhërrëfyes dhe bashkëudhëtar.

Udhërrëfyes të rrugës së drejtë janë dijetarët e vërtetë, që janë trashigimtarë të Pejgamberëve. Mirëpo, dijetarë të tillë në këtë kohë gati-gati nuk ka. Në të shumtën e rasteve mbeten vetëm imituesit. Edhe këta, nën ndikimin e shejtanit, azdisen (hynë në rrugë të gabuar) dhe secillin e mbërthen dashuria e përfitimit material. Nga ky shkak, mirësia (*ma'ruf*) u kuptua si keqësim (*munkër*): e keqësimi (*munkër*) u kuptua si mirësi (*ma'ruf*). Bile, duke e mbuluar hija dritën e hidajetit, shenjat e fesë u larguan nga sipërfaqja e tokës. Kështu, u munduan t'ua paraqesin njerëzve se dituria është e përbërë vetëm nga gjykimet mbi bazën e fesë (*fetva*) të gjykatësve (*kadi*) për dënimin e njerëzve që shkaktojnë kaos, ose që dituria është për ata që u hyn vetja në qejf për të heshtur kundërshtarët dhe që karshi tyre të shpallin epërsinë në debat, ose për predikuesit (*vaiz*) që të mashtrojnë shtresën e rëndomtë (*avam*) me fjalë të rimuara.

Sepse pos këtyre trijave, ata nuk gjetën tjetër zgjidhje për të kurdisur rrjetë që të kapin haramin.

Duke e larguar nga njerëzit diturinë e rrugës së ahiretit që e ndjekën **Selef-i salihin** (të mëdhenjtë e parë të Islamit) - dituri këto që Allahu Teala në Kur'ani Kerim i emërton si *hikmet, ilm, nur, hidajet* dhe *rusht* - kjo dituri krejtësisht u harrua.

Kur kjo gjendje, në emër të fesë, u bë një boshllëk i dëmshëm dhe rrezik i frikshëm që dërgon në errësi, e kuptova si detyrë të rëndësishme shkrimin e këtij libri, duke shpjeguar rrugën e imamëve të parë, si edhe dituritë e vlefshme të Pejgamberit dhe të mëdhenjëve të Islamit, për të mbajtur gjallë dituritë e fesë.

## RENDITJA E LIBRIT

Librin e ndava në katër vëllime:

Vëllimi i parë flet për **ibadet** (rit fetar), vëllimi i dytë për **adet** (zakon), vëllimi i tretë për **muhlikat** (veprimet e këqija që prishin mirësitë dhe sevapet) dhe i katërti për **munxhiat** (shpëtim).

Meqë dituria vjen e para, në fillim e vendosa **Kitabu'l-ilm** (Librin Për Diturinë).

Synimin e kisha të shpjegoj se cila dituri kërkohet nga ne sipas Resulit (të Dërguarit), e që llogaritet adhurim Allahun Teala. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Kërkimi i diturisë është farz për çdo mysliman.”<sup>2</sup>**

Synimi i dytë është të ndajë diturinë e dobishme nga dituria e dëmshme. Prap Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Tek Allahu strehohemi nga dituria e dëmshme.”<sup>3</sup>**

---

<sup>2</sup> Ibn Maxhe nga Enesi, gjithashtu Imam Ahmedi dhe Imam Bejhakui.

<sup>3</sup> Ibn Maxhe nga Xhabiri.

Dëshiroj të shpjegoj se si njerëzit e kohës së tashme e lanë esencën e diturisë dhe mjaftohen me lëvozhgë, e duke u mashtruar me shkëlqimin e rremë të vegimit, si u ndanë nga rruga e drejtë.

Vëllimi i parë [RUB'UL-IBADET] përfshinë 10 libra:

**1. Dituria (ilim); 2. Parimet themelore të besimit (akaid); 3. Fshehtësitë e pastrimit (sir); 4. Fshehtësitë e namazit; 5. Fshehtësitë e zeqatit; 6. Fshehtësitë e agjërit; 7. Fshehtësitë e haxhit; 8. Adabi i leximit të Kur'anit; 9. Dhikri dhe dua; 10. Leximi i Evradit në kohë të ndryshme.**

Vëllimi i dytë [RUB'U'L-ADAT] përfshinë 10 libra:

**1. Adabi i ushqimit; 2. Adabi martesor; 3. Rëndësia e fitimit; 4. Hallalli dhe harami; 5. Të jetuarit mirë me njerëz dhe adabi i të folurit; 6. Vetmia (uzlet); 7. Adabi i udhëtimit; 8. Sema dhe vexhd; 9. Emr-i ma'ruf, nehj-i munkur; 10. Edebet mbi të jetuarit dhe ahlaku i Pejgamberit.**

Vëllimi i tretë [RUB'U'L-MUHLIKAT] përfshinë këto 10 libra:

**1. Gjendjet e mahnitshme të zemrës; 2. Shërimi i zemrës, zburimi i ahlakut dhe edukimi i nefsit (rijâdhet); 3. Rreziku i pasionit të stomakut dhe të mardhënies; 4. Dëmtimet e gjuhës; 5. Zemërimi (gadhab), armiqësia (kin) dhe xhelozia (haset); 6. Qortimi i kësaj bote (dynja); 7. Qortimi i pasurisë dhe kopracisë. 8. Qortimi i pasionit për pozitë dhe i dyfytërisë; 9. Qortimi i mendjemadhësisë dhe vetë-lavdërimit; 10. Qortimi i arrogancës.**

Vëllimi i katërt [RUB'U'L- MUNXHIJAT] përfshinë këto 10 libra:

**1. Teube; 2. Durimi dhe falënderimi (sabr dhe shukur); 3. Frika dhe shpresa (havf dhe rexa); 4. Varfëria dhe zuhd-i. 5. Mbështetja Allahut dhe njëshmëria (tevekkul dhe tehvid); 6. Dashuria, dëshira e zjarrtë dhe afërsia (muhabbet, shvk dhe uns). 7. Qëllimi, drejtësia dhe sinqeriteti (nijet, sidk dhe ihlas); 8. Kontrollimi dhe llogaria (murakabe dhe muhasebe); 9. Mendimi (tefekkur); 10. Përkujtimi i vdekjes.**

Në librin 'RUB'U'L-IBADET' do të shpjegoj shpërfilljen në librat e fikh-ut, edebet e fshehta të ibadeteve, hollësitë dhe kuptimet e fshehta në sunnete. Ata që veprojnë me dituri kanë shumë nevojë për këto; ata që nuk i dinë, nuk llogariten dijetarë të ahiretit.

Në librin 'RUB'U'L-ADAT' do të shpjegoj detyrimet mes njerëzve, mënyrën e veprimit, thellësitë dhe fshehtesitë e hollësive të rrugëve dhe rreziqet në veprim që duhet shmangur; do t'i shpjegoj deri sa të arrij edhe te personi pa parime, në mënyrë që asnjë mysliman të mos jetë i panjohur me to.

Në librin 'RUB'U'L-MUHLIKAT', duke iu mbështetur ajeteve të Kur'anit, haditheve dhe gjendjeve të të mëdhenjve të Islamit, do të shpjegoj veset që janë ndaluar në Kur'an-i Kerim, pastrimin e zemrës nga këto dhe përshkrimin e secilit prej këtyre veseve veç-e-veç, pastaj sebetet e lindjes (së këtyre veseve), më pas shkatërrimet që veset shkaktojnë, identifikimin dhe shenjat, përmirësimin dhe zgjidhjet e shpëtimit.

Në librin 'RUB'U'L-MUNXHIJAT' do të shpjegoj, me dëshmi të sheriatit dhe me ato mendore se çka i afron njerëzit te Allahut Teala, arrijten në tiparet e të afërmëve (*mukarrebun*) dhe të sinqertëve (*sidk*), të gjitha tiparet e dëshirueshme, hakikatin dhe brendinë e çdo tipari, zgjidhjet e përfitimit të ahlakut të mirë, marrjen e përfundimt të mirë, njohja e shenjave dhe vlerat e larta.

## EPËRSIA E KËSAJ VEPRE NGA VEPRAT TJERA NË KËTË TEMË

Ky libër ndahet nga librat tjerë që janë shkruar rreth disa temave që janë përmendur këtu, në pesë çështje:

1- Shpjegimet e tyre është vështirë për t'i kuptuar dhe janë të shkurtuara; ky libër shpjegon në mënyrë të hollësishme;

2- Temat e ndërlikura në këtë libër janë thjeshtëzuar, duke u renditur.

3- Temat e gjata shpjegohen shkurt.

4- Duke i larguar përsëritjet, shkrimet janë sistematizuar.

5- Për çështje të thella, për të cilat nuk është shkruar në asnjë libër për shkak të vështirësisë për t'u kuptuar, është gjetur zgjidhje e drejtë.

Sadoqë të gjithë dijetarët ndjekin rrugën e njëjtë, disa nga ta dinë e disa nuk dinë, ose dinë - por nga harresa ose nga ndonjë pengesë nuk kanë shkruar. Edhe kjo nuk duhet të mohohet.

Këto që i përmenda përbëjnë temat e librit dhe përfshijnë të gjitha dituritë e cekura.

Janë dy sebepe që më drejtojnë që këtë vepër ta përgatis në katër vëllime:

**Sebepi i parë dhe kryesor:** Një renditje e tillë është bërë e domosdoshme për të vërtetuar hakikatin dhe për njohje. Sepse dituria që drejton në ahiret, ndahet në dy: në dituri *muamele*<sup>4</sup> dhe *mukashefe*<sup>5</sup>. Me dituritë mukashefe qëllim

---

<sup>4</sup> **Muamele:** praktikë; veprim; trajtim.

<sup>5</sup> **Mukashefe:** zbulim; hap; qelë; fshehtësitë shpirtërore; të dihet një gjë para se të ndodh; nxjerrja në shesh e një sekreti ose të fshehte; pamje/shikim me syrin e zemrës.

**Keshf:** hap; qelë; të dihet një gjë para se të ndodh; nxjerrja në shesh e një sekreti ose të fshehte; njoftim dhe dalja në shesh i një gjëje të

është vetëm tregimi i keshf-it të njohur, kurse me diturinë muamele, qëllimi është që, së bashku me keshf-in e njohur, të arrihet veprimi. Qëllim i këtij libri është vetëm shpjegimi i diturisë muamele (praktike), e jo dituria mukashefe, e cila nuk lejohet të shkruhet në libra. Sadoqë personi i devotshëm që mendon, gjykon e vepron në përputhje me të vërtetën – sheriatin, e ka lakmi, dhe kërkesë e veprimit të fundit të tij është dituria mukashefe, prapë është dituria muamele ajo që do t'i bëhet rrugë për në diturinë mukashefe. Pejgamberët u kanë folur njerëzve kryesisht për dituritë muamele, të cilat mund të bëhen rrugë për në dituritë mukashefe, sepse e kanë ditur që populli nuk mund të bartë atë ngarkesë, prandaj për dituritë mukashefe kanë folur me alegori dhe shumë shkurt. Edhe dijetarët, që janë trashëgimtarë të pejgamberëve, nuk mund të dalin jashtë rrugës që e kanë përcaktuar pejgamberët.

Edhe dituria muamele (praktike) ndahet në dy:

1- Dituria *zahir* (e jashtme); dituritë në lidhje me gjymtyrët.

2- Dituria *batin* (e brendshme); dituritë e zemrës.

Dituritë në lidhje me gjymtyrët janë **adet-et** ose **ibadet-et**. Edhe gjendjet e zemrës, të cilat Allahu Teala i ka fshehur nga shqisat e jashtme, ndahen në dy: në **mahmud** (të vlefshme) dhe **mezmum** (të qortueshme). Karshi kësaj gjendjeje, ka qenë e domosdoshme që edhe kjo dituri të ndahet në dy dituri: **zahir** dhe **batin**. Gjithashtu, duke u ndarë dituria zahir në lidhje me gjymtyrët në dy, ashtu siç është shpjeguar më lartë: në *adet* dhe *ibadet*, bëhet e qartë që të gjitha bashkë janë katër. Nga kjo pikëpamje, edhe kjo vepër (ihja) është ndarë në katër pjesë. Zaten, edhe dituria muamele është e përbërë nga këto katër pjesë.

---

fshehtë qysh më parë nga Allahu Teala me anë të dhënies së frymëzimit; vështrim me syrin e zemrës.

**Sebepi i dytë:** dituria e fikut është ndërtuar mbi këto katër pjesë:

- për ata që seriozisht kërkojnë diturinë;
- si kundërpërgjigje atyre që nuk frikësohen nga Allahu Teala (kundër pabesimtarve);
- për ata që krenohen me dituri; dhe
- për ata që kacafyten me nefis (veten) duke përcaktuar pozitën e shkallës së tij.

Çka hyn në formë të dashur, bëhet e dashur. Libri mori bukuri edhe me shkrimin e pjesës së fikut në renditje, prandaj shpresoj që kjo do të tërheq zemrat. Edhe ata që dëshirojnë të tërheqin zemrat e të rriturve në mjekësi, kanë shkruar vepra të mjekësisë të zbukuruara në lista, dhe e kanë emërtuar **‘Takvimu’s-Sihha’** (*Kalendari i shëndetit*), me qëllim që të tërheqin ata që janë mësuar të lexojnë këto lloj listash, të lexojnë edhe veprat e mjekësisë.

Kur dituritë e mjekësisë të cilat sigurojnë vetëm shëndetin e trupit zbukurohen ashtu për t’i bërë ato sa më tërheqëse, atëherë zbukurimi i kësaj diturie e cila siguron jetën e përjetshme, dhe sjellja e saj në një gjendje tërheqëse, padyshim që është më e rëndësishme. Fruti i kësaj diturie arrihet në jetën e përjetshme, që nuk ka fund; është mjekësia e shpirtit dhe zemrës. E dituria e mjekësisë vlen vetëm për shërimin e trupit, e ardhmja e të cilit është e detyruar në vdekje...

Prej Allahut Teala dëshirojmë të na drejtojë në rrugë të drejtë, Allahu është kerim (i xhymertë).

EBU HAMID MUHAMMED GAZALI  
Hixhri 495

**Ihjau Ulumid-din**

(Ringjallja e diturive fetare)

**KITABU'L – ILM**

**[vëllimi 1]**

**R u b ' u ' l – l b â d â t**

**Libri i parë**

**LIBRI PËR DITURINË**



## KAPITULLI I PARË

### VLERAT E LARTA (FAZILET) TË DITURISË

DËSHMI NGA KUR'ANI KERIM

**“Allahu dëshmon se nuk ka ilah tjetër përveç Tij, e dëshmuan edhe melaiket dhe dijetarët, dhe se Ai është zbatues i drejtësisë.” 3-Ali Imran:18**

Shiko! Allahu Teala fillon dëshminë me dhatin (qenien) e Tij, në shkallë të dytë janë melekët, e në shkallë të tretë renditen dijetarët!

Vetëm ky ajet është i mjaftueshëm për të kuptuar se sa vlerë i jep diturisë Allahu Teala:

**“Allahu lartëson ata që besuan prej jush, i lartëson në shkallë të lartë ata të cilëve u është dhënë dituri.”**

58-Muxhadele:11

Në komentimin e këtij ajeti, Ibn Abbasi r.a. thotë:  
*“Ekzistojnë shtatëqind shkallë diferencë në mes të dijetarëve dhe xhahilëve (të paditurve). Në mes të shkallëve ka sa pesëqind vite rrugë.”*

**“Thuaj: ‘A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?!’” 39-Zumer:9**

**“Po, Allahut ia kanë frikën nga robërit e Tij, vetëm dijetarët.” 35-Fatir:28**

**“Thuaj: ‘Mjafton që Allahu është dëshmitar midis meje dhe jush dhe (është dëshmitar) ai që ka njohuri të Librit (shpalljeve)’.” 13-Rra’d:43**

Ajeti poshtë sjell mësimin se si ka sukses një vepër e rëndësishme, në saje të diturisë:

**“Po, ai që ishte i pajisur me dijen e Librit, tha: ‘Unë do të ta sjell (fronin mbretëror të Belkisit) ty sa çel e mbyll sytë.’” 27-Neml:40**

Kurse ajeti në vazhdim na mëson që gradat e ahiretit mund të kuptohen vetëm me dituri:

**“Ndërsa njerëzit e dijshtëm thoshin: ‘Të mjerët ju! Shpërblimi i Allahut është më i mirë për atë që beson dhe bën vepra të mira’.” 28-Kasas:40**

**“Këta janë shembuj që Ne ua sjellim njerëzve, po këta nuk i kupton kush pos dijetarëve.” 29-Ankebutë:43**

Hak Teala e ka lënë që dijetarët të nxjerrin përfundime për të kuptuar vendimet dhe ngjarjet, e ata i ka ngritur (me dituri) në nivelin e pejgamberëve:

**“E sikur t’ia linin atë Pejgamberit dhe ulu’l emrit (dijetarëve) të tyre, ata do të dinin të nxjerrin përfundime.” 4-Nisa:83**

**“O bijtë e Ademit, Ne krijuam për ju petk që ju mbulon vendet e turpshme dhe petk zbukurues. Por petku i devotshmërisë, ai është më i mirë.” 7-A’rafë:26**

Për ajetin lartë, disa dijetarët kan thënë; me fjalën *‘petk që ju mbulon vendet e trupshme’* mendohet në diturinë sepse dituria e mbulon turpin e paditurisë. Ndërsa *‘petk zbukurues’*

gradën e bindjës (jakin), dhe me *‘petkun e devotshmërisë’* gradat në dynja.

**“Ne u sollëm atyre një libër që ua shkoqitëm në baza të diturisë, e që është udhërrefyes e mëshirë për ata që besojnë.” 7-A’rafë:52**

**“Dhe duke e ditur mirë Ne do t’u rrëfejmë atyre (për atë që punuan).” 7-A’rafë:7**

**“Përkundrazi! Ai (Kur’ani) është shpallje e qartë në zemrat e atyre të cilëve u është dhënë dija.” 29-Ankebut:49**

Përsëri Hak Teala urdhëron:

**“Ka krijuar njeriun dhe i ka mësuar atij të folurit e qartë”. 55-Rrahman:3-4**

## DËSHMITË NË HADITHE

Zotëria ynë, Muhammedi s.a.v.s. thotë:

**“Allahu Teala kujt i dëshiron mirësi, atë e bën dijetar (alim) të fesë dhe e njofton me gjëra që mund të dëmtojnë fenë – ia tregon të drejtën.”<sup>6</sup>**

**“Dijetarët janë trashëgimtarët e Pejgamberëve.”<sup>7</sup>**

Pasi që nuk ka gradë më të lartë se pejgamberllëku, nuk mund të mendohet për nder më të madh se sa ky trashëgim.

**“Banorët e qiellit dhe tokës kërkojnë falje për alimët.”<sup>8</sup>**

---

<sup>6</sup> Buhari dheMuslim, transmetuar nga Muaviu

<sup>7</sup> Ebu Davud, Tirmidhi, Ibnu Hibban

Padyshim që është nderi më i madh kur melaiket e qiellit dhe të tokës kërkojnë falje në emër të atij i cili është i zënë me veten.

**“Patjetër dituria ia shton nderin njeriut të ndershëm; dituria - edhe skllavin e ngrit në nivel të mbretit!”<sup>9</sup>**

Pejgamberi ynë a.s. me këtë hadith na tregoi rëndësinë e diturisë në këtë botë. Pasi që ahireti është i përjetshëm dhe më i hairit, natyrisht se dobia e diturisë atje bëhet edhe më lartë.

**“Janë dy veti që nuk gjenden te mynafiku: bukuria e botës së brendshme dhe ditura e fesë (fikhud-din) me ahlak (moral të bukur)”<sup>10</sup>**

Mos gabo që duke shikuar disa dijetarë të kësaj kohe, të dyshosh në saktësinë e këtij hadithi; e brendshmja duhet të përputhet me të jashtmen, fjala me punën. Kur Resulallahu s.a.v.s. thotë ‘dijetar’, nuk është fjala për dijetarin e fikhut, si mendon ti. Kjo dituri do të shpjegohet më vonë. Shkalla më e ultë e kësaj diturie është të dihet se ahireti është më i hairit se kjo botë. Ai që e njeh dhe plotësisht e beson këtë të vërtetë, largohet nga gjendjet e këqija si përçarja, dyfytërsia dhe të ngjashme.

Përsëri Pejgamberi ynë thotë:

**“Më i vlefshmi i njerëzve është mumini dijetar që, kur duhet ndihmon të tjerët dhe kur duhet mbetet me veten, i kënaqur.”<sup>11</sup>**

---

<sup>8</sup> Ebu’d-Derda

<sup>9</sup> Ebu Nuajn, transmeton në ‘Hilje’

<sup>10</sup> Timidhi, transmetuar nga Ebu Hurejre

<sup>11</sup> Bejhaki, transmeton në ‘Shu’abu’l-Iman’

**“Imani është i zhveshur, veshja e tij është devotshmëria, zbukurimi i tij është turpi kurse fryti i tij është dituria.”<sup>12</sup>**

**“Njerëzit më të afërt në gradën e peygamberllëkut janë dijetarët dhe muxhahidët. Dijetarët i udhëzojnë njerëzit në urdhrat e peygamberëve, kurse muxhahidët luftojnë me armën e tyre sipas urdhrit të peygamberëve.”<sup>13</sup>**

**“Vdekja e një brezi të tërë është më e mirë se vdekja e një dijetari.”<sup>14</sup>**

**“Njerëzit janë si minierë e dukatit a argjendit; secili veç e veç e ka vlerën e vet. Ata që janë respektuar pa u bërë myslimanë, duke u bërë myslimanë të ditur bëhen të respektuar edhe në Islamijet.”<sup>15</sup>**

**“Në ditën e kiametit, ngjyra e shkrimit të dijetarëve, peshohet me gjakun e shehidëve (dëshmorëve).”<sup>16</sup>**

**“Ai i cili mëson dyzet hadithe përmendësh, më qëllim që tua transmetojë ato ummetit tim, në ditën e gjykimit do të jem ndërmjetësues dhe dëshmitar i tij.”<sup>17</sup>**

**“Ai që është dijetar i fesë, Allahu e mbron dhe ia jep riskun nga ku nuk e pret.”<sup>18</sup>**

**“Allahu Teala urdhëroi Ibrahimin a.s.: ‘O Ibrahim! Unë jam dijetar, dhe secilin dijetar e dua’.”<sup>19</sup>**

---

<sup>12</sup> Hakimi, transmeton në ‘Tarih-i Nishabur’

<sup>13</sup> Ebu Nuajm, transmetuar nga Ibn Abbasi

<sup>14</sup> Taberani, transmetuar nga Ebu’d-Derda

<sup>15</sup> Buhari dhe Muslim, transmetuar nga Ebu Hurejre

<sup>16</sup> Ibn Abdullberr, transmetuar nga Ebu’d-Derda

<sup>17</sup> Ibn Abdullberr, transmetuar nga Ibn Umeri

<sup>18</sup> Hatib, transmetuar në ‘Tarih’

<sup>19</sup> Transmeton Ibn Abdullberr

**“Dijetari është i besueshmi i Allahut Teala në sipërfaqen e tokës.”<sup>20</sup>**

**“Janë dy kategori në ummetin tim që, nëse ata përmirësohen – përmirësohen të gjithë njerëzit, e nëse ata prishen – prishen të gjithë njerëzit. Këta janë udhëheqësit dhe dijetarët.”<sup>21</sup>**

**“Nuk ka dobi për mua prej lindjes së ditës në të cilën nuk përfitoj një dituri të re që më ofron edhe më shumë Allahut Teala.”<sup>22</sup>**

Për të treguar që dijetari është më i vlefshëm se ai që vetëm bën ibadet, është thënë:

**“Vlera e dijetarit ndaj abidit, është si vlera ime ndaj as’habit tim në shkallën më të ulët.”<sup>23</sup>**

Shikoni se si Resulallahu s.a.v.s. e ngrit diturinë në nivelin e peygamberllëkut.

Ibadeti nuk mund të bëhet pa dituri; ibadeti që bëhet vazhdimisht me një dituri të paktë, dhe i cili është i zhveshur nga dituria, i ulët grada:

**“Epërsia e dijetarit mbi ata që bejnë ibadet është si epërsia e hënës së plotë mbi yjet.”<sup>24</sup>**

**“Në ditën e kiametit, shefat (ndërmjetësim) do të bëjnë tri kategori njerëzish. Këta janë Pejgamberët, pastaj dijetarët dhe në fund dëshmorët.”<sup>25</sup>**

---

<sup>20</sup> Ibn Abdulberr, transmetuar nga Muadhi

<sup>21</sup> Ibn Abdulberr, transmetuar nga Ibn Abbasi

<sup>22</sup> Tirmidhi, transmetuar nga Ebu Uname

<sup>23</sup> Tirmidhi, nga Ebu Uname

<sup>24</sup> Ebu Davud, Tirmidhi, Nesei, Ibn Hibban

<sup>25</sup> Ibn Maxhe, nga Osman b. Affani

Është thënë shumë për vlerën e lartë të shefatit (ndërmjetësimit). Edhe në ndërmjetësim, grada më e lartë, menjëherë pas pejgamberllëkut, i është dhënë diturisë.

**“Dhe prej ibadeteve më të larta që i bëhen Allahut Teala - është të bërit dijetar i fikut. Bile, një dijetar (faki) i fesë, nga pikëvështrimi i shejtanit është më i keq se njëmijë abidë. Si çdo ndërtesë që ka shtylla, edhe shtylla e fesë Islame është dituria.”<sup>26</sup>**

**“Ana e dobisë në fenë tonë është lehtësimi. Ibadeti më i dobishëm është të bërit dijetar i fesë.”<sup>27</sup>**

**“Ju jeni me një botë dhe kohë ku dijetarët e fesë (fukaha) janë shumë, lexuesit dhe folësit janë të paktë, pyetjet e tyre janë të pakta, e përgjigjet që jepen janë shumë. Në këtë situatë, vepra (amel) është më e dobishme (se dituria). Shpejt do të vjen një kohë kur dijetarët do të pakësohen, folësit dhe ata që bëjnë pyetje do të shumohen, pak do të ketë të tillë që do të përgjigjen. Për këtë arsye në atë kohë dituria është më e dobishme se vepra (ameli).”<sup>28</sup>**

**“Mes dijetarit dhe atij që bën ibadet ka njëqind gradë diferencë. Mes çdo grade, distanca është sa shtatëdhjetë vite vrapim të kalit të ushqyer.”<sup>29</sup>**

---

<sup>26</sup> Taberani

<sup>27</sup> Ibn Abdulberr, nga Enesi

<sup>28</sup> Taberani

<sup>29</sup> Isfahani nga Et-Tergib ve't-Terhib

Është pyetur Resuli:

- *'O Resuli i Allahut, cila vepër është ma e lartë?'*

Resulallahu s.a.v.s. tha:

- **'Njohja e madhërisë së Allahut të dashur.'** Ata thanë:

- *'Për cilën njohje po mendoni?'* Resulallahu s.a.v.s. u përgjigj:

- **'Njohja e madhërisë së Allahut të dashur.'** Ata thanë:

- *'O Resuli i Allahut, ne po pyesim për vepra, ju po përgjigjeni për dituri.'* Resulallahu në këtë u përgjigj:

- **'Kuptoni (diturinë) mirë. Bërja e pak veprave duke njohur Allahun Teala, jep dobi. Por, veprat që bëhen pa njohuri, edhe nëse janë shumë – nuk japin dobi'.<sup>30</sup>**

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

**"Në ditën e kiametit, Allahu Teala ringjallë të gjithë robërit dhe dijetarët. Pastaj u thotë dijetarëve: 'O dijetarë, Unë ju dhashë dituri, duke ditur gjendjet e juaja. Këtë nuk ju dhashë për të ju dënuar juve. Ju fala mangësitë. Urdhëroni ne xhenet'."**<sup>31</sup>

---

<sup>30</sup> Ibn Abdulberr, nga Enesi

<sup>31</sup> Taberani, nga Ebu Musa

## FJALËT E TË MËDHENJVE TË ISLAMIT

Alia r.a., duke iu drejtuar Kumejlit, i thotë:

*- O Kumejl, dituria është më e hairit se pasuria. Sepse pasurinë duhet ta ruash ti, por dituria të ruan ty. Dituria është dominim, e pasuria është e dënuar. Pasuria pakësohet duke u shpenzuar, e dituria, me shpenzime shumohet.*

Përsëri Alia r.a., ka thënë:

*- Një dijetar është më i lartësuar se një abid muxhahid (luftëtar) i cili ditën, duke agjëruar lufton, dhe natën e kalon me ibadete. Zbrazëtinë që e lë në botën Islame vdekja e një dijetari, nuk mund ta mbush askush, përpos atij që lartësohet (në dijeni) si ai.*

Ja edhe disa shprehje të Alisë r.a. për dijetarët dhe diturinë:

*- Lavdërimi i përket vetëm poseduesve të diturisë. Sepse ata, siç janë vet në rrugë të drejtë, edhe atyre që dëshirojnë ua tregojnë rrugën e drejtë.*

*- Grada e çdokujt peshohet me diturinë e tij. Ndërsa xhahilët (të paditurit) janë armiq të dijetarëve.*

*- Bëhu dijetar që të mos vdesësh. Sepse njerëzit vdesin, por dijetarët janë të gjallë.*

Ebu el Esved ka thënë:

*- Nuk mund të ketë diçka më të vlefshme se dituria; sepse sulltanët i gjykojnë njerëzit, e dijetarët i gjykojnë sulltanët.*

Ibn Abbas r.a. thotë:

*- Sulejmani a.s., duke qenë i lirë të zgjidhte mes pasurisë, mbretërisë dhe diturisë, zgjodhi diturinë, dhe në saje të kësaj u bë posedues edhe i dy të tjerave.*

Ibn Mubarekin e pyetën:

- *Kush janë njerëzit e përsosur?* Ibn Mubareki tha:

- *Janë dijetarët.* Përsëri e pyetën:

- *Kush janë mbretërit?* Ibn Mubareki tha:

- *Zahidët* (që punojnë për Allahun, duke braktisur këtë botë). Kur e pyetën:

- *Kush janë njerëzit në nivelin e ulët?* Ibn Mubareki kështu u përgjigj:

- *Ata që në emër të fesë sigurojnë përfitime të kësaj bote. Dhe përveç dijetarit, askush nuk njihet si njeri i përsosur. Sepse njeriu dallon nga krijesat tjera në saje të diturisë. Me cilën veçori dallon njeriu prej krijesave tjera, edhe përsosmëria e tij është në saje të asaj veçorie. Padyshim se epërsia e njeriut ndaj krijesave tjera nuk është në forcë. Deveja është më e fortë se njeriu. Elefanti është më i fuqishëm se njeriu. As trimëria nuk është epërsi e njeriut - luani është më i guximshmi nga të gjithë. As në aftësi të ngrënies njeriu nuk ka epërsi - barku i kaut është shumë më i madh. Njëjtë, as me epshe (seks) njeriu nuk është në epërsi - një krijesë e vogël si zogu, është në atë aspekt më i fuqishëm se njerëzit. Njeriu është krijuar vetëm për dituri (njohje të Allahut).*

Njëri ka thënë:

- *Nuk kuptoj se çka është fitimi i xhahilëve e çka dëmi dëmi i dijetarëve.*

Feth-i Musili thotë:

- *Si shembulli i të sëmurit, që i prehet ushqimi, edhe zemra e varfër me dituri e mençuri është e detyruar në vdekje.*

Kjo fjalë e thotë të vërtetën; siç është të ngrënit dhe të pirit ushqim për trupin, ushqim i zemrës është dituria dhe mençuria. Zemra me to jeton. Pa dituri, zemra është e detyruar të vdes. Njëjtë si frika e tepërt që pengon

ndërprerjen e dhimbjes së plagës, edhe dashuria e tepërt e kësaj bote pengon dëshirën e diturisë. Kur vdekja i bartë shqetësimet e kësaj bote, ashtu siç e ndiejnë dhimbjen dhe lëndimin shpirtëror i dehuri kur vjen në vete, ose njeriu kur e shfaq frikën, edhe kjo gjendje me gjithë lakuriqësinë e saj del në shesh, njeriu e kupton që është shkatërruar, dhe pendohet shumë. Por, me çfarë dobie? Është urdhëruar që *“njerëzit janë në gjumë; pasi vdesin, zgjohen”*, por edhe është treguar se pendimi krejt në fund nuk jep përfitim. Tek Allahu strehohemi prej ditës së tmerrshme kur ngrihet perdja.

Hasan Basriu shprehet:

- *Ngjyra e shkrimit të dijetarëve peshohet me gjakun e dëshmorëve dhe vjen rëndë.*

Ibn Mesudi r.a. ka thënë:

- *Lexoni deri sa nuk zhduket ditura; dituria zhduket me vdekjen e dijetarëve. Beto hem në Allahun që ekzistenca ime është në fuqinë e Tij, se dëshmori i vërtetë, që vdes për hir të Allahut, kur i sheh gradat e larta që u janë dhënë dijetarëve, dëshiron të kthehet përsëri në këtë botë dhe të bëhet dijetar. E vërteta është që askush nuk lind dijetar. Dituria përfitohet duke punuar dhe mësuar.*

Ibn Abbasi r.a. thotë:

- *Për mua, më e dashur është pak kohë e natës e ndarë për dituri, se sa tërë nata të kalohet në ibadete.*

Hasan Basriu ka thënë:

- *Në ajetin: ‘O Rabbi ynë, na jep të mira në këtë botë, na jep të mira në botën tjetër’, (Bekare 2:201) me ‘të mirat në këtë botë’ shprehet dëshira për dituri dhe ibadete, e me ‘të mira në botën tjetër’ dëshirohet xheneti.*

Është pyetur një mendimtar:

- *Cilën pasuri ta marrim? Është përgjigjur:*

- *Zgjidhni pasurinë që mund të mbetet me ju kur anija fundoset. Fundosja e anijes interpretohet me vdekjen e njeriut, e pasuria që mbetet kuptohet të jetë dituria.*

Disa të tjerë kanë thënë:

- *Njerëzit i përshtaten dhe e pranojnë si udhërrëfyes atë i cili i përshtatet diturisë. Poseduesit e diturisë gjithmonë respektohen dhe nderohen.*

Imam Shafi rah., njofton:

- *Dituria ka veçori të tillë që, ai që merr pak nga ajo – gëzohet, e ai që nuk merr aspak, gjithmonë është në mërzë.*

Omeri r.a. na udhëzon:

- *O njerëz! Mësoni dituri; Ata që mësojnë me qëllim të mirë, Allahu Teala i vesh me veshje madhështie. Në qoftë se bëjnë gabim, për të mos ua zhveshë këtë veshje, Allahu ua fal gabimin tri herë, dhe kjo vlen deri në vdekje.*

Ahnef rah. thotë:

- *Dijetari është i denjë për tu bërë zotëri. Madhështia pa dituri përfundon si poshtërsi.*

Salim b. Xhad ka thënë:

- *Unë kam qenë skllav; një person më bleu për treqind derhemë dhe kur më liroi kërkova punë. Unë preferoja mësimin. Në sajë të diturisë ndodhi që për pak kohë të mos pranoja padishahun i cili erdhi të më vizitojë.*

Zubejr b. Ebu Bekir tregon:

- *Në një letër që më dërgoi nga Iraku, babai im shkruante: 'Mëso, sepse dituria në varfëri është pasuri, e në pasuri është stoli'.*

Edhe Llokmani këshillonte të birin duke i thënë:

- *O biri im! Vazhdo në mexhlise (tubime) të dijetarëve.*

*Allahu Teala, si e gjelbëron me shi tokën në pranverë, ashtu edhe zemrat e muminëve i ndriçon me nurin e diturisë.*

Disa kanë thënë:

- *Vdekjen e dijetarit e qajnë peshqit në det dhe çdo gjë tjetër, deri te shpendët në qiell. Fytyra e tij harrohet por ai nuk harrohet kurrë.*

Zuhriu ka thënë:

- *Dituria është burrëri, atë e duan trimat e vërtetë.*

## VLERAT E LARTA TË MËSIMIT

### DËSHMI NGA KUR'ANI KERIM

**“...një grup të mbetet mbrapa, që të thellohet në mësimin e fesë.” 9-Teube:122**

**“Pyetni pra dijetarët nëse ju nuk dini.” 16-Nahl:43**

### DËSHMITË NË HADITHE

**“Ai që mban rrugën e diturisë, Allahu ia qel rrugën e xhenetit.”<sup>32</sup>**

**“Melaiket zgjasin krahët mbi nxënësit me të cilët janë të kënaqur.”<sup>33</sup>**

---

<sup>32</sup> Muslim, nga Ebu Hurejre

**“Të mësosh diçka në një mëngjes është më mirë se falja e njëqind reqateve.”<sup>34</sup>**

**“Të mësosh një çështje nga dituria në një mëngjes, është më mirë se bota me tërë pasurinë e saj.”<sup>35</sup>**

**“Kërkoni diturinë, edhe po të jetë ajo në Kinë.”<sup>36</sup>**

**“Kërkimi i diturisë është farz për çdo mysliman.”**

**“Dituria është thesar, pyetja është qelës. Pyetni që të mësoni. Në sajë të një pyetje, katër vetë marrin sevap; ai që pyet, ai që përgjigjet, ai që ndëgjon dhe ai që këta i do.”<sup>37</sup>**

**“Nuk është e drejtë që i padituri të hesht paditurinë, dhe dijetari të fsheh dijen.”<sup>38</sup>**

Resulallahu s.a.v.s. një herë tha:

**“Të gjendesh në një mexhlis (tubim) të diturisë është më e vlefshme se falja e njëmijë reqateve namaz, vizita njëmijë të sëmureve dhe përcjellja e njëmijë kufomave.”**

Ata që dëgjuan, e pyetën: *“O Resuli i Allahut, a është kjo më e mirë edhe se leximi i Kur’anit?”* Resulallahu s.a.v.s., u përgjigj:

**“Kur’ani jep dobi me dituri. Mos-kuptimi nuk jep dobi.”<sup>39</sup>**

**“Ai që vdes duke lexuar për të ringjallur Islamin, në xhenet, mes tij dhe Pejgamberëve do të jetë vetëm një gradë.”<sup>40</sup>**

---

<sup>33</sup> Ahmed, Ibn Hibban dhe Hakim, nga Safvan b. Asal

<sup>34</sup> Ibn Abdullberr, nga Ebu Zeri

<sup>35</sup> Tabarani, nga Ebu Zeri

<sup>36</sup> Ibn Adijj dhe Bejhaki transmetojnë nga Enesi, Taberani nga Ibn Mesudi dhe Ibn Abbasi

<sup>37</sup> Ebu Nuajm, nga Alia. r.a.

<sup>38</sup> Tabarani, nga Ibn Marduje

<sup>39</sup> Ibn Xhevdhi, në librin el-Mevduat transmeton nga Omeri

<sup>40</sup> Darimi, nga Hasani

## FJALËT E TË MËDHENJVE TË ISLAMIT

Ibn Abbasi r.a., thoshte:

- *Durova vështirësitë dhe mësova, si përfundim arrita madhësinë.*

Bile, për Ibn Abbasin, Ibn Maliku ka thënë:

- *Nuk kam njohur të ngjashëm me Ibn Abbasin. Sepse, ai që shikon fytyrën e tij ka parë fytyrën më të bukur, ai që ka dëgjuar fjalët e tij ka dëgjuar fjalët më të ëmbla, dhe ai që analizon fetvatë e tij gjen diturinë e vërtetë.*

Ibn Mubarek ka thënë:

- *Çuditë me atë që kërkon madhësinë pa mësim.*

Disa dijetarë kanë thënë:

- *Për dy grupe njerëzish duhet ndjerë keqardhje: për ata që nuk kuptojnë asgjë e dëshirojnë të mësojnë, dhe për ata që çdo gjë kuptojnë por nuk dëshirojnë të mësojnë.*

Ebu Derda r.a. ka thënë:

- *Për mua më e dashur është të mësohet një çështje nga dituria se sa një natë ibadete.*

Gjithashtu ka thënë:

- *Dijetari dhe nxënësi janë bashkë në të mira. Të tjerët nuk mbajnë ndonjë vlerë. Bëhu ose dijetar, ose nxënës ose dëgjues; mos të mbesësh jashtë tyre, shkatërrohesh.*

A t a r.a. ka thënë:

- *Një tubim i dhikrit dhe diturisë i pastron shtatëdhjetë gjynahe të argëtimit.*

Omeri r.a. thotë:

- *Vdekja e njëmijë abidëve që kalojnë ditën në agjërim e natën pa gjumë, ka vlerë më të ulët se sa vdekja e një dijetari i cili e ndanë haramin dhe hallallin.*

Imam Shafiu rah. ka thënë:

- *Nga ibadetet nafile, mësimi i diturisë është më i pëlqyeshmi.*

Ibn Abdi'l-Hakem rah. transmeton:

- *Po mësoja nga Imam Maliku. Para drekës desha të fal namazin nafile dhe e mbylla librin. Kur e pa Hoxha këtë, më tha: 'Nëse lexon me qëllim të mirë, namazin që deshe ta falësh nuk ka vlerë më të lartë se leximi'.*

Ebu Derda r.a., ka thënë:

- *Të shkosh në mëngjes për të mësuar dituri, është e pamundur të mos konsiderohet si luftë.*

## VLERAT E LARTA TË MËSIMDHËNIES

DËSHMI NGA KUR'ANI KERIM:

**“...të thellohet në mësimin e fesë dhe kështu të këshillojë popullin e vet, mbasi të kthehet nga lufta, që t’i frikësohet Allahu.”** 9-Teube:122

Këtu, me fjalën *‘inzar’* është menduar mësimdhënia dhe udhëzimi (i popullit) - irshad.

**“Kujtoje kohën kur Allahu mori premtimin nga ata që u është dhënë Libri se do t’ua shpjegojnë atë njerëzve dhe nuk do të fshehin asgjë nga ai.”** 3-Al Imran:187

Ky ajet e bën mësimdhënien farz.

**“Por disa prej tyre e fshehin të vërtetën, duke e ditur mirë.”** 2-Bekare:146

Ky ajet na njofton se fshehja e diturisë së vërtetë është haram. Ndërsa rreth atyre që nuk dëshmojnë atë që e dinë kur është e novojshe:

**“Mos e fshihni dëshminë, se, kush e fsheh atë, zemra e tij është gjynahqare.”** 2-Bekare:283

Lidhur me këtë çështje, Pejgamberi ynë kështu urdhëron:

**“Allahu Teala, si mori premtim nga pejgamberët ashtu merr premtim edhe prej atyre që i jep dituri - prej dijetarëve, që tua shpjegojnë atë njerëzve dhe mos ta fshehin.”**<sup>41</sup>

---

<sup>41</sup> Ebu Nuajm, nga Ibn Mesudi

**“E kush flet më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira dhe thotë: ‘Unë, me të vërtetë jam mysliman’.” 4-Fussilet:33**

**“Thirr në rrugën e Rabbit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur.” 16-Nahl:125**

**(Allahu) do t’ia mësojë atij shkrimin, diturinë.”**

**3-Al Imran:48**

#### **DËSHMITË NË HADITHE**

Resulallahu s.a.v.s., duke përcjellë Muadh b. Xhebelin në Jemen iu drejtua:

**“Një person të udhëzosh te Allahu Teala është më e mirë për ty se sa bota me gjithë pasurinë.”<sup>42</sup>**

**“Ai që mëson një çështje prej diturisë për të ua mësuar të njëjtën njerëzve, i jepen shtatëdhjetë sevape të sidikëve.”<sup>43</sup>**

Isa s.a., ka thënë:

**- Kush mëson, dhe atë që ka mësuar ua mëson të tjerëve, përmendet me respekt në qiell.**

**“Allahu Teala në ditën e kiametit abidëve dhe muxhahidëve u thotë:**

**- Hyni në xhenet. Dijetarët thonë:**

**- Ata bënë ibadet dhe luftuan në sajë të mësimit tonë.**

**Allahu Teala urdhëron:**

**-Ju jeni pranë Meje si disa prej melekëve. Bëni shefat (ndërmjetësim), shefati i juaj është i pranueshëm. Dhe ata do të bëjnë shefatin dhe do të hynë në xhenet.”<sup>44</sup>**

---

<sup>42</sup> Imam Ahmed, nga Muadhi, gjithashtu Buhari dhe Muslim

<sup>43</sup> Ebu Mensur ed-Dejlemi, nga Ibn Mesudi

<sup>44</sup> Ebu’l-Abbas, Ez-Zehebi, nga Ibn Abbasi

E drejta e shefatit i përket vetëm atyre dijetarëve të cilët atë që dinë ua mësojnë të tjerëve, e nuk është për çdo dijetar.

**"Padyshim, Allahu nuk do ta zhdukë diturinë. Por, sigurisht që shkencat (dituritë) do të humbasin me humbjen e dijetarëve. E kur nuk do të ketë dijetarë, njerëzit do t'i zgjedhin për kryetarë të paditurit. Populli do t'i pyes, e ata do të japin shpjegime (fetva) pa ndonjë dituri. Kështu, ata edhe vetë do të bien në humbje, e edhe të tjerët do t'i largojnë nga rruga e drejtë."**<sup>45</sup>

**"Dijetarin që e fsheh diturinë, në ditën e kiametit Allahu Teala e dënon me zjarr."**<sup>46</sup>

**"Dhurata më e mirë është një dituri të cilën e kupton mirë, dhe atë ia tregon një vëllait mysliman. Për këtë ka shpërblim sikur të bëhet ibadet për një vit."**<sup>47</sup>

**"Çdo gjë që ekziston në këtë botë është e mallkuar, përpos atij që përkuqton (dhikrullah) dhe i afrohet Allahut, mësuesit dhe nxënësit."**<sup>48</sup>

**"Padyshim se për ata që njerëzve u mësojnë mirësinë, i luten Allahut Teala melekët, banorët e qiellit dhe tokës, bile edhe milingona në fole e peshqit në det."**<sup>49</sup>

**"Askush nuk mund të bëhet më i dobishëm se ai që dëgjon mirë një hadith dhe atë ia tregon një vëllait mysliman."**<sup>50</sup>

---

<sup>45</sup> Buhari dhe Muslim, nga Abdullah b. Amari

<sup>46</sup> Ebu Davud, Tirmidhi, Ibn Maxhe, Ibn Hibban dhe Hakim, nga Ebu Hurerje

<sup>47</sup> Taberani, nga Ibn Abbasi

<sup>48</sup> Tirmidhi, dhe Ibn Maxhe, nga Ebu Hurejre

<sup>49</sup> Tirmidhi, nga Ebu Uname

<sup>50</sup> Ibn Abdulberr, nga Muhammed b. El-Mukendiri

**“Kur myslimani mëson një fjalë të mirë, atë fjalë ua mëson të tjerëve dhe me atë fjalë vepron, kjo është më e mirë se një vit ibadet.”<sup>51</sup>**

“Një ditë, kur Pejgamberi ynë i pa dy grupe njerëzish, një grup i zënë me dua, e grupi tjetër mësonte, urdhëroi:

**- Këta (që bënin dua) po kërkojnë nga Allahu Teala. Allahu, nëse dëshiron jep, nëse dëshiron nuk jep. Ndërsa për ata që mësonin tha:**

**- Por këta po mësojnë. Zaten, edhe unë si mësues jam dërguar. Dhe u ul në tubimin e atyre që mësonin.”<sup>52</sup>**

**“Dituria dhe udhëzimi që Allahu Teala dërgoi me mua është si shiu i bollshëm. Kur shiu bie në tokë, një pjesë e tokës e merr ujin brenda, bari dhe prodhimet bujqësore rriten me bollëk. Një pjesë tjetër e tokës bëhet e fortë dhe e shkretë, nuk e thith ujin por e mban përmbi; që njerëzit ta shfrytëzojnë për pije dhe për të mbjella. Një pjesë tjetër e tokës është e pjerrtë dhe e rrëshqitshme. Ajo as nuk e thith ujin, as nuk e mban përmbi, shiu që bie mbi te rrëshqet e shkon. Në të asgjë nuk rritet e as që i sjell ndokujt dobi.”<sup>53</sup>**

Në hadithin lartë, me shembullin e parë është treguar për personin që vepron me atë që ka mësuar, me shembullin e dytë për atë që nuk vepron, por i mëson të tjerët, dhe me shembullin e tretë tregohet për atë që është i varfër nga të dyja këto gjendje.

---

<sup>51</sup> Ibn Mubarek, nga Zejd b. Eslemi

<sup>52</sup> Ibn Maxhe, nga Abdullah b. Omeri

<sup>53</sup> Buhari dhe Muslimi, nga Ebu Musa

**"Kur vdes biri i Ademit, libri i veprave të tij mbyllet. Përveçse nga tri gjëra i shkruhen sevape në libër, e njëra prej tyre është dituria që të tjerët e përfitojnë."**<sup>54</sup>

**"Treguesi i rrugës së mirësisë është sikur ai që e bën atë mirësi."**<sup>55</sup>

**"Janë dy persona që lakmohen: ai të cilit Allahu i ka dhënë pasuri dhe atë pasuri ai e shpenzon në rrugë të drejtë; dhe ai të cilit Allahu i ka dhënë dituri, e ai gjykon sipas saj dhe i mëson edhe të tjerët."**

Kur Resulallahu s.a.v.s. tha:

**"Rahmeti i Allahut Teala qoftë mbi trashëgimtarët e mi", e pyetën:**

- *Kush janë trashëgimtarët tuaj?* Resulallahu s.a.v.s., u përgjigj:

- **Janë ata të cilët ringjallin sunnetin tim (duke e jetuar) dhe ia mësojnë atë robërve të Allahut Teala.**<sup>56</sup>

## FJALËT E TË MËDHENJVE TË ISLAMIT

Omeri r.a., ka thënë:

- *Kush ia mëson një hadith një personi, dhe ai person vepron me atë hadith, e fiton sevapin si ai që vepron.*

Ibn Abbas r.a. ka thënë:

- *Për ata që njerëzve u mësojnë mirësinë, gjithçka, deri edhe peshqit në det kërkojnë falje.*

---

<sup>54</sup> Muslimi, nga Ebu Hurejre

<sup>55</sup> Tirmidhi, nga Enesi

<sup>56</sup> Ibn Abdulberr

Disa dijetarë kanë thënë:

- *Dijetari është mes Allahut dhe robit; këtë gjendje ta ketë në mendje; dhe: 'Dijetarët janë dritat e kohës. Çdo dijetar e ndriçon kohën e vet dhe njerëzit e asaj kohe ndriçohen prej dritës së dijetarit.'*

Sufijan es- Sevri shkoi në qytetin Askalan. Aty qëndroi një kohë, dhe pasi që askush nuk e pyeti asgjë, tha:

- *Në këtë vend dituria ka vdekur, tani nuk ka nevojë të pres. Më gjeni një mjet e të shkoj.*

Padyshim se një shprehje e këtillë vjen nga vlera e lartë e mësuesit, zelli për të mësuar dhe për të vazhduar traditën e diturisë.

A t a r.a. ka thënë:

- *E vizitova Said Ibn Musejjebin, dhe e pashë duke qarë. Kur e pyeta për shkakun, tha se po qanë sepse nuk është pyetur për asgjë.*

Hasan Basriu rah., thotë:

- *Po të mos kishte dijetarë, nuk do të kishte dallim mes njerëzve dhe krijesave tjera të gjalla. Sepse, me mësimet e dijetarëve njerëzit arrijnë në nivelin e njerëzores.*

Kur Ikrime tha:

- *Kjo dituri ka një vlerë, atyre që e pyetën se çka është ajo, u përgjigj:*

- *(Dituria) t'i jepet atij që ia di vlerën dhe që mund ta ruaj.*

Jahja b. Muadh ka thënë:

- *Dijetarët janë më të mëshirshëm për ummetin e Muhammedit alejhisselam se sa prindërit. Sepse prindërit e mbrojnë nga zjarri i botës, ndërsa dijetarët e mbrojnë nga zjarri i ahiretit.*

Është thënë:

*- Për të fituar dituri, duhet respektuar këto procedura: të dëgjosh në heshtje, të mësosh përmendësh, të zbatosh njohuritë dhe të mësosh të tjerët.*

Përsëri është thënë:

*- Mësoje atë që nuk di, mëso prej atij që di, ruaje atë që e di, dhe mësoja atij që nuk i di.*

Për ata që mësojnë dhe që i mësojnë të tjerët, Muadh b. Xhebel ka thënë:

*- Lexoni dhe mësoni, sepse fitimi i ditorisë për Allahun është nderim dhe ibadet ndaj Allahut. Shkëmbimi i mendimeve është lëvdatë, biseda është përpjekje. Të mësosh personin që nuk di, është sadaka, të mësosh të aftin edhe më shumë njohuri, është afërsi ndaj Allahut. Në vetmi, dituria është një mik që heq shqetësimet, është udhëzues në rrugë të drejtë, lehtësim dhe durim në vështirësi. Dituria afër shokëve vezirë është afërsi për të huajin. Dituria mbanë dritë në rrugë të xhenetit. Në saje të ditorisë, Allahu Teala i lartëson disa njerëz, i bën ata udhëzues dhe udhërrëfyes që ndiqen në punë të mirë. Atyre, mirësitë u kujtohen, veprat ju mbeshin. Melekët i donë ata dhe i shtrijnë krahët mbi ta. Çdo gjë që ekziston, në të lagur dhe në të thatë, peshqit në det, krijesat e gjalla në tokë, e deri te hëna dhe yjet, çdo gjë, kërkon falje për dijetarët prej Allahut Teala. Sepse dituria e çel syrin e zemrës, në terr i hedh dritë syve, në dobësi i jep forcë trupit, e ngritë njeriun në nivele të larta dhe e ngritë në gradën e sidikëve. Dituria është meditim, dituria është në baraspeshë me agjërimin dhe me falje namaz tërë natën. Me dituri, Allahu Teala adhurohet, Atij i nënshtrohet, me dituri kuptohet tehvidi (njëshmëria), me dituri mbrohem nga gjërat e dyshimta, dhe i vazhdojmë lidhjet me të afërmit. Me dituri dihet hallalli dhe harami.*

*Dituria është udhërrëfyes ndërsa veprat vijnë më pas. Të mirët frymëzohen me dituri, e të këqijtë mbesin të varfër prej diturisë.*

Prej Allahut Teala kërkojmë përshtatje në rrugë të drejtë.

## DËSHMITË MENDORE

Ajo që dëshirohet të shpjegohet në këtë temë është fazileti dhe mrekullia e diturisë. Ai që nuk e di se çka do të thotë fazileti dhe që nuk kupton se çka është qëllimi prej tij, nuk ka mundësi ta kuptojë se në dituri ose në gjëra jashtë diturisë gjendet një veti. Padyshim që, të thuhet se një person është dijetar ose jo, pa e ditur se çka do të thotë dituria, nuk është asgjë tjetër pos llogaritje. Andaj, edhe ne ta kuptojmë se çka është fazileti.

*Fazilet* vjen nga rrënja **“tepër”**; me kuptimet: shumë, rritje, shtesë dhe shumim - domethënë është një tepëri. Kur dy gjëra kanë vlerë të njëjtë, e më pas njëra ka një veçanti më tepër – kësaj i thuhet që ka fazilet ndaj tjetrës, dhe për më tepër – kjo bëhet përsosmëria e saj. Për shembull: Kur thuhet se kali posedon vlera më shumë se gomari, këta janë të barabartë në bartje të ngarkesës, por kali me bartje të ngarkesës më të madhe, pjesëmarrje në luftë, vrapim të shpejtë, me kërcim dhe bukuri - është më sipëror dhe më i përsosur se gomari. Edhe po të pranohet se ekziston një gomar që është më i madh se kali, përsëri gomari nuk e mban një vlerë më të madhe. Sepse kjo epërsi është nga pikëpamja e madhësisë së trupit, që nuk njihet si përsosmëri. Kafsha nuk

vlerësohet me trup por me cilësi. Në qoftë se e kuptove këtë shpjegim - se si është fazileti në kali në krahasim me kafshët tjera, padyshim se mund te kuptosh se si në krahasim me cilësitë tjera, dituria është një fazilet. Kali që vrapon shpejtë nuk është një përsosmëri; ndoshta kjo është veçori dhe epërsi e një kali ndaj kuajve tjerë. Por dituria është një fazilet absolut, pa u krahasuar me asgjë në esencën e vet. Sepse dituria është cilësi e përsosur e Allahut, është një nder dhe një fazilet i domosdoshëm i melekëve dhe pejgamberëve. Si gjendja e kalit më të zgjuar i cili është më i hairit se kali jo i zgjuar, e që kjo - pa i shtuar asgjë - është një fazilet i tij.

Kuptoje mirë - çdo gjë që dëshirohet dhe që është tërheqëse, dëshirohet dhe pëlqehet për njërën nga tri arsyet:

1. Për një qëllim tjetër;
2. Për vet qenien; dhe
3. Edhe për një qëllim tjetër edhe për vet qenien.

Padyshim ajo që dëshirohet për vet qenien është më e vlefshme dhe më e ndershme se sa ajo që kërkohet për qëllim tjetër.

Ajo që dëshirohet për një qëllim tjetër është si dukati dhe argjendi. Këto, me esencën e vet nuk plotësojnë asnjë nevojë të njeriut. Ato janë një copë metali. Po të mos ishin mjet tregtie, nuk do të dallonin nga guri.

Ajo që dëshirohet për vet qenien është arritja në lumturinë e ahiretit për ta shikuar me kënaqësi bukurinë e Allahut Teala.

Ajo që dëshirohet edhe për një qëllim tjetër edhe për vet qenien; si për shembull shëndeti i trupit. Njeriu dëshiron këmbë të shëndosha, pa dhimbje dhe sëmundje. E kjo është dëshirë për vet qenien, por këmbët e shëndosha pa dhimbje

dhe sëmundje është edhe për një qëllim tjetër, sepse me to njeriu ecë drejtë vendeve ku dëshiron.

Kur shikon diturinë në këtë lidhje, në esencën tënde gjen kënaqësi. Dituria dëshirohet për vet atë. Por, meqenëse dituria është një shkak për lumturinë në ahiret dhe një mjet që afron Allahut, kjo nënkupton që ajo dëshirohet edhe për tjetër qëllim (pos vet diturisë). Grada më e lartë e njeriut dhe dëshirë e tij është kjo lumturi, si edhe mjeti që arrinë këtë lumturi. E kjo lumturi është vet dituria dhe veprimet që mbështeten në dituri. Pasi që vepra nuk bëhet pa dituri, themel i lumturisë në botë dhe në ahiret është dituria, që është edhe më e vlefshmja nga të gjitha veprimet. Si të mos jetë, kur vlera e çdo gjëje peshohet me përfundimin e saj. Ndërsa përfundim i diturisë është arritja në gradat e larta, përngjasimi në melekë dhe afrimi Allahut Teala. Këto që treguam deri këtu janë përfitimet e diturisë që i takojnë ahiretit.

Ndërsa në këtë botë, dijetarët kanë një veti që me fjalë ndikojnë në mbretërit e dinjitetshëm dhe në njerëzit e zakonshëm, dhe tërheqin respektin e tyre. Bile edhe më i pamendi prej Turqve dhe më i paturpshmi prej Arabëve, e sheh të natyrshme respektin për dijetarët, sepse nga përvoja e kupton që ata janë më të dijshëm. Kjo veçori nuk është vetëm te njerëzit, por ekziston edhe te kafshët. Edhe kafsha pranon epërsinë e njeriut dhe i nënshtrohet atij.

Të gjitha këto që i përmendëm janë fazilet i diturisë absolute. Megjithatë, më vonë do të shpjegohet se edhe dituritë ndahen në pjesë dhe nga pikëpamja e faziletit të tyre, bartin vlera të ndryshme.

Me këtë shpjegimin tonë, është sqaruar fazileti i mësimi dhe mësimdhënies. Pasi që dituria është mbi të gjitha, edhe mundimi për të mësuar diturinë sigurisht që është dëshirë për diçka më të lartë, ndërsa mësimdhënia siguron përfitim edhe më të madh.

Shpjegimi i kësaj është kështu: Qëllimi i njerëzve lidhet me fenë dhe me këtë botë. Ndërsa rregulli i fesë është i lidhur me rregullin e botës. Sepse bota është arë e ahiretit. Bota nuk është atdhe i përhershëm, është një urë dhe një bujtinë, është një mjet që arrin Allahut. Ndërsa rregulli dhe zhvillimi i botës është i lidhur për punët e njerëzve.

Puna, mjeshtëria dhe profesioni i njerëzve mund të përmbliken në tri grupe:

**E para:** Punët që janë të domosdoshme për të jetuar, dhe këto janë katër:

1. Për sigurimin e ushqimit – bujqësia;
2. Për sigurimin e veshjes – endja;
3. Për sigurimin e strehimit – ndërtimi; dhe
4. Për sigurimin e bashkësisë - dashuria, respekti, ndihma reciproke dhe bashkëpunimi - pra politika (*sijaset*).

**E dyta:** Ndihmesat për punët në grupin e parë; punët që japin mundësinë për bërjen e punëve të domosdoshme. Edhe këto ndahen në dy grupe.

1. Për bujqësi dhe zejtarë – përgatitja e veglave të punës, profesioni i farkëtarit;
2. Për shërbimin e endjes – shpupurishja e pambukut dhe tjerja e leshit.

**E treta:** Punët që plotësojnë dhe zbukurojnë të gjitha këto, si bluarja, gatimi, pjekja, rrobaqepësia, ngjyrosja dhe pastrimi.

Të gjitha këto, në krahasimin me jetën e kësaj bote, janë si organet e një trupi, e edhe këto ndahen në tri pjesë:

1. Organet kryesore: zemra, mushkëria dhe truri;
2. Organet që iu bëjnë shërbim këtyre organeve kryesore: lukthi, venat, arteriet, nervi;
3. Organet që i plotësojnë dhe zbukurojnë organet kryesore: lëkura, thonjtë dhe vetullat.

Nga profesionet që përmendëm, më të nderuara janë kryesoret, e nga kryesoret më e nderuara është politika. Për këtë arsye domosdo kërkohet përsosmëria e këtij profesioni qysh në burimin e saj, por kjo nuk kërkohet edhe për profesione të tjera. Dhe për po këtë arsye, poseduesit e këtij profesioni (politikës) i bëjnë profesionet e tjera të jenë në shërbimin e profesionit të tyre.

Politika që tregon rrugën e drejtë të edukimit të njerëzimit për arritjen e lumturisë në botë dhe ahiret i ka katër grada:

**Grada e parë:** Politika e Pejgamberëve është grada më e lartë. Pejgamberët drejtojnë dhe qeverisin të gjithë njerëzit (*avam*) dhe të zgjedhurit (*havas*), në të jashtmen (*zahir*) dhe të brendshmen (*batin*) e tyre.

**Grada e dytë:** Politika e mbretërve dhe sulltanëve. Qeverisja e tyre është në çdo shtresë të njerëzve. Por ata qeverisin vetëm të jashtmen dhe nuk mund të ndikojnë në të brendshmen.

**Grada e tretë:** Politika e atyre që njohin fenë dhe Allahun Teala - dijetarët që janë trashëgimtarë të pejgamberëve. Këta nuk përzihen në punët e jashtme të asnjë

shtrese, pasi askënd nuk mund ta ndalojnë dhe ta pengojnë, por edhe, në përgjithësi, njerëzit nuk mund të përfitojnë nga ta. Ata mund t'i drejtohen vetëm të brendshmes së shtresës inteligjente.

**Grada e katërt:** Politika e vaizëve (ligjërues fetar). Edhe këta mund t'i drejtohen vetëm të brendshmes së një pjese të njerëzve të rëndomtë (*avam*).

Në të gjitha këto grada të politikës, pas pejgamberllëkut, më e ndershmeja është padyshim dituria që i tërheq njerëzit larg shkatërrimit, ua ndërron veset e këqija, i zbukuron me ahlak të mirë dhe i arrit në lumturi. Pra, ky edhe është qëllimi i mësimi të diturisë.

Treguam se dituria është më e lartë se profesionet tjera. Shpjegimi i saj është si vijon:

Vlera e profesionit dihet me tri gjëra:

**E para:** Shkaku që na bën të njohim atë profesion, e që duhet t'a kërkojmë në natyrën dhe esencën e saj. Si epërsia e diturisë së shkencave ekzakte ndaj diturisë së fjalorit. Sepse, mendja është ajo që na njofton dituritë shkencore, kurse fjalorin na mëson ndjenja e dëgjimit. Është e qartë që mendja është më e lartë se dëgjimi.

**E dyta:** Duke menduar dobitë e përgjithshme, si për shembull të menduarit e epërsisë së bujqësisë ndaj argjendarisë.

**E treta:** Të merret parasysh përpunimi i diçkaje, psh. epërsia e përpunimit të argjendit ndaj përpunimit të lëkurës. Njëra punohet mbi dukat, e tjera mbi lëkurën e shtazës së ngordhur.

Padyshim, dituritë e fesë që ndriçojnë rrugën e ahiretit përfitohen me mendje të mprehtë dhe me zgjuarsì të plotë.

Siç do të sqarohet më vonë, mendja është cilësia më e lartë e njeriut. Sepse amanetet e Allahut Teala pranohen në sajë të mendjes, dhe në sajë të mendjes njeriu arrin kënaqësinë (rizanë) e Allahut Teala.

Sa u përket përfitimeve të përgjithshme të diturisë, në to as nuk duhet dyshuar. Sepse përfundimi është lumturia e përjetshme.

Ndërsa nderi i mësuesit; as kjo nuk është e fshehtë. Si mund të jetë e fshehtë kur mësuesit ndikojnë në zemrat dhe mendjet e njerëzve. Krijesa më e përsosur në sipërfaqen e tokës është njeriu, kurse pjesa më e vlefshme e njeriut është zemra. Mësuesi merret me pjekurinë e zemrës, me pastrimin dhe lustrimin e saj, dhe me afim e kënaqësisë hyjnore. Prandaj, dituria është më e ndershme, në çdo drejtim.

Përmbledhje e shkurtër: mësimdhënia, nga një pikëpamje është ibadet për Allahun e nga një pikëpamje tjetër është përfaqësim i Allahut Teala. Bile, përfaqësim i madh. Sepse dituria është cilësia më e veçantë e Allahut Teala e vendosur në zemrën e dijetarit. Dijetari është drejtues i thesarit më të vlefshëm të Allahut Teala – diturisë së Tij, dhe atij i është lejuar që nga ky thesar t’u jap nevojtarëve, që të arrijnë në xhenet dhe t’i afrohen Allahut Teala. A mund të ketë gradë më të lartë se të qenit mjet në mes të robit dhe Allahut Teala? Allahu Teala, me mirësinë dhe pëlqimin e Tij, na bëftë edhe neve si këta robër të Tij.

Të dashurit të Tij, Resulallahut s.a.v.s. dhe të gjithë robërve të hairit, u qoftë salat dhe selam.

## KAPITULLI I DYTË

### DITURITË FARZI AJIN

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Të mësuarit dituri është farz për çdo mysliman.”<sup>57</sup>**

Dhe me një hadith tjetër:

**“Kërko diturinë, edhe po të jetë ajo në Kinë.”**

Njerëzit janë në mosmarrëveshje se cilat dituri janë farz që çdo mysliman duhet t’i dijë, dhe në këtë çështje janë thënë përmbi njëzet mendime. Pa hyrë në detaje, këtë mund ta përmbledhim si në vijim:

Secili grup ka pranuar si mësim *farzi ajin* tematikën e vet. Sipas kelimistëve (*mutekellimuni*), farzi ajin që duhet të dihet është **ilmi kelam** (dituria kelam). Sepse përmes kelimat njihet ekzistenca e Allahut, njëshmëria, dhati (qenia) dhe sifatet (cilësitë).

Sipas fakihut, farzi ajin është dituria e fikhut. Sepse me diturinë e fikhut mësohen ibadetet, veprimet, hallalli dhe harami. Qëllimi i këtyre diturive nuk janë çështjet e rralla dhe të ndjeshme – ndoshta janë çështjet e nevojshme ditore të njerëzve.

---

<sup>57</sup> Ibn Maxhe nga Enesi r.a.

Dijetarët e tefsirit dhe të hadithit thonë që dituri farz ajin janë Kur'ani dhe Hadithi. Sepse dituritë tjera përfitohen prej tyre.

Ndërsa sufite thonë që farzi ajin është dituria e tasavvufit, e edhe këta ndahen në dy degë. Njëra palë thotë që qëllimi i kësaj diturie është që njeriu të njohë gjendjen e vet dhe gradën tek Allahu, ndërsa të tjerët thonë që qëllimi është të përfitohet sinqeriteti (*ihlas*), të njihen shkatërrimet e nefsit dhe të ndahen vesveset e shejtanit nga frymëzimet e melekëve.

E sipas të tjerëve, dituri farzi ajin është dituria e brendshme (*ilmi batin*), dhe thonë që kjo dituri është farz për të zgjedhurit, e në këtë mënyrë heqin kuptimin e përgjithshëm të hadithit ("**...farz për çdo mysliman**").

Ebu Talib el Meki thotë se farzi ajin është dituria që e përmban hadidhi *Mebani-i Islam*:

**"Islami ndërtohet në pesë shtylla: dëshmia se nuk ka ilah tjetër përveç Allahut dhe se Muhammedi është Pejgamber i Tij; falja e namazit; dhënia e zekatit; haxhxi dhe agjërimi i Ramazanit."**<sup>58</sup>

Pra, farz janë këto pesë gjëra. Sigurisht që është farz të njihen këto farze me cilësitë dhe me mënyrën e zbatimit të tyre.

Jemi të mendimit se ne do të themi fjalën e fundit, e cila do të heq dyshimet në këtë çështje. Siç treguam në parathënie, dituria ndahet në **Muamele** (e veprimit) dhe **Mukashefe** (e zbulimit), dhe dituria që këtu kërkohet është dituria e veprimit.

---

<sup>58</sup> Buhari dhe Muslim, nga Ibn Omeri

Ata të cilët kanë mend dhe kanë arritur moshën e pubertetit janë të obliguar t'i bëjnë tri gjëra:

1. Të besojnë (*i'tikad*)
2. Të veprojnë sipas besimit (*fi'l*)
3. Të mos bëjnë gjërat e ndaluara (*terk*)

I mençuri që arrin në moshën e pjekurisë, ose që pas ejakulimit në ëndërr merr njohuri që ka arritur në pjekuri, fillimisht duhet shqiptuar farzin e shahadetit (dëshmisë), duke e kuptuar atë:

**“Eshhedu en la ilahe illallah ve eshhedu enne Muhammeden abdu-hu ve resuluh.”**

*“Dëshmoj se nuk ka ilah tjetër përveç Allahut, dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i dërguar i Allahut.”*

Ky shahadet është i mundur të bëhet edhe me imitim – duke dëgjuar dhe duke mësuar prej tjetrit. Për këtë nuk ka nevojë parapërgaditje dhe kërkim i dëshmisë, por padyshim që qëllimi është besimi i asaj që deklarohet. Nëse gjendet një besim i tillë, qëllimi është realizuar. Vetë Pejgamberi ynë (s.a.v.s.) e ka pranuar si të mjaftueshëm deklarin dhe shqiptimin nga Arabët e paditur. Për më tepër, atyre nuk u ka mësuar dëshminë. Prandaj, duke besuar dhe kuptuar, ai që bën shahadet e ka kryer detyrën dhe për atë kohë nuk i ka mbetur tjetër farz. Nëse në atë moment vdes – vdes si një mysliman që i është përshtatur urdhrave.

Obligimet që vijnë pas kësaj mbështeten në shkaqe të veçanta dhe nuk janë të domosdoshme për secilin person. Bile, shumëkush edhe lirohet nga disa obligime.

Shkaqet që i bëjnë këto obligime të domosdoshme janë të lidhura me veprim, me braktisjen e gjërave të ndaluara dhe me besim.

## OBLIGIMET QË LIDHEN ME VEPRIME

Në qoftë se myslimani që ka besuar jeton deri në drekë, atij i takon një farz i ri - falja e namazit të drekës, dhe me hyrjen e kohës së namazit të drekës, ai është i obliguar të dijë kushtet e pastrimit dhe të namazit. Nëse ka ndonjë të metë dhe pengesë, e mendon që nuk mund t'i mësojë të gjitha kushtet dhe ruknet e namazit deri sa të kalojë koha e drekës, ai e fal namazin - sepse ky namaz farz është i lidhur me kohë, dhe për të mos kaluar koha – falet, e pastaj vazhdon me mësim. Kjo vlen edhe për kohët e namazeve tjera.

Në qoftë se jeton deri në Ramazan, i takon edhe një farz – të agjërojë dhe të dijë urdhrat rreth agjërit: nijeti, që agjërohet prej imsakut deri në aksham, të mos ketë marrëdhënie seksuale, dhe që kjo vazhdon deri në muajin Sheval.

Pastaj, në qoftë se pasurohet ose trashëgon pasuri, edhe nje farz i takon, dhe duhet të dijë obligimet e zeqatit: sa duhet të japë nga pasuria që e posedon për një vit, për cilin lloj të pasurisë - sa duhet dhënë. Nëse posedon vetëm një deve, mjafton të dihet zeqati i devesë, e njëjtë është edhe me obligimet tjera.

Sa i përket haxhit, nuk është i obliguar që menjëherë ta kryejë këtë farz dhe të dijë obligimet e haxhit. Sepse kushtet e haxhit janë shëndeti dhe pasuria. Por, dijetarëve u takon që të tregojnë se kur i plotëson kushtet e haxhit dhe lënien për më vonë. Kur vendos të shkojë në haxh, atëherë është farz të mësojë kushtet dhe vaxhibet e haxhit. Mësimi i sunneteve nuk është farz, pasi që sunnetet janë ibadete nafile, e mësimi i ibadeteve nafile nuk është farz, është nafile. Fakihëve u

takon t'i tregojnë besimtarit kur bëhet farz haxhi për te, dhe udhëzimet rreth haramit (për atë person) – kjo nuk na takon neve. Edhe për farzet tjera ajin të cilat personi duhet t'i bëjë, udhëzimi është i këtillë.

Sa i përket mësimi farz në lidhje me braktisjen e gjërave të ndaluara, edhe këto duhet të mësohen sipas gjendjes, prandaj kjo ndërron sipas gjendjes së personit. Sepse nuk është farz të mësohet një memec duke i thënë *“është e ndaluar të thuash këtë”*, as një i verbër duke i thënë *“këtë të shikosh është haram”*, ose një beduini t'i thuhet *“është e ndaluar të ulesh këtu”*.

Atëherë, ajo që duhet të bëhet është të mësohet farzi në mënyrë individuale. Njeriu duhet të paralajmërohet për ato gjëra të ndaluara të cilat mund t'i bëjë, e jo për ato gjërat të ndaluara që nuk mund t'i bëjë. Për shembull: Nëse në një vend mysliman ka ndonjë që vesh mëndafsh, që e merr pasurinë e tjetrit me dhunë ose përdhunon, atij duhet t'i mësohet që këto janë haram. Njëjtë vlen edhe për atë që për momentin nuk i bën këto vepra, por që ka mundësi t'i bëjë më vonë. E nëse përdoret mishi i derrit dhe alkooli në atë vend ku gjendet myslimani, farz është të mësohet që këto janë haram. Farz është të mësohet çdo gjë që është farz.

Sa i përket besimit dhe veprimit të zemrës, farz është të mësohet dituri aq sa mund të hiqen dyshimet që mund të lindin në zemër. Në qoftë se dyshon në kuptimin e kelimeit shehadeit, farz është të mësohet aq sa duhet për të hequr këtë dyshim. Në qoftë se nuk lind një dyshim i tillë dhe vdes para se të mësojë që Allahu Teala është absolut, vetëm Ai është krijues, ekzistenca e Tij nuk është e lidhur për vend dhe kohë, Ai do të shihet në ahiret dhe çështje të ngjashme të

besimit, është konsensus i dijetarëve që ka vdekur si besimtar.

Dyshime të tilla që mund të lindin në zemër nganjëherë vijnë nga vetë natyra dhe mendimet e personit, e nganjëherë nga ato që dëgjon prej të tjerëve. Nëse një adoleshent gjendet në një shoqëri ku debatohej dyshime të tilla, ai duhet të ruhet nga këso filozofi dhe së pari duhet t'i mësohen të vërtetat. Sepse, nëse një zemër e pastër e të riut mbushet me gjëra që mund të zgjojnë dyshime, heqja e tyre bëhet farz. Ndërsa edhe kjo nganjëherë bëhet shumë e vështirë.

Siç është farz për një mysliman që gjendet në një shoqëri ku është shumë kamata, të mësojë rrugët e ligjshme të fitimit hallall dhe të mbrohet nga kamata, edhe për dituritë farzi ajin është gjendja e njëjtë. Kuptimi i kësaj është - të dihet esenca e veprimtë të caktuar. Kush i di dituritë farz dhe kohën për to, i di edhe dituritë që janë farzi ajin.

Mendimi i sufive kur thonë: “(farzi ajin është) *ndarja mes vesveseve të shejtanit dhe frymëzimit të melekëve*” është i drejtë. Por, kjo nuk është për çdokënd; kjo është posaçërisht për atë që ka nevojë, që në zemër i lind diçka e tillë. Në kohën kur njeriu nuk mundet të mbrojë veten nga dëshirat e këqija si xhelozia, urrejtja, kryengritja, demonstrimi dhe te ngjashme, është farz për atë person të fitojë dituri aq sa mundet që vet të mbrohet nga këto. Si mos të jetë kjo dituri farz për atë njeri! Sepse Resulallahu s.a.v.s me një hadith thotë:

**“Tri gjëra e shkatërrojnë njeriun: koprracia e tepërt, përshtatja e plotë dëshirave, dhe vetëpëlqimi.”<sup>59</sup>**

---

<sup>59</sup> Bezzar dhe Taberani nga Enesi r.a.

Ndërsa, askush nuk mund ta shpëtojë veten aq lehtë nga këto. Mendjemadhësia dhe sëmundjet e ngjashme të zemrës të cilat do t'i shpjegojmë më vonë, janë të lidhura me këto tri esenca që i tregojnë hadithi. Për ata që i kanë këto sëmundje është farzi ajin të shërohen nga to. Për t'u shëruar duhet të njihen cilësitë, burimi dhe shenjat e sëmundjes, dhe duke përcaktuar diagnozën – të kërkohet zgjidhje për shërim. Sepse ai që nuk e njeh të keqen, bie në të keqe. Ilaç do të thotë shërimi i sëmundjes me të kundërtën e saj. Pa përcaktuar diagnozën, pa e njohur ilaçin - padyshim që nuk ka shërim.

Duke qenë se farzi ajin është të njihen shumica e këtyre shkatërruesve që i përmendëm, sa keq që njerëzit në përgjithësi e harxhojnë kohën me gjëra të panevojshme, e këto i lënë pas dore.

Një fëmijë mysliman, për besim, pas kelimeit shehadetit (dëshmisë) duhet të mësojë për: ringjalljen pas vdekjes, llogarinë (*hesab*), peshoren (*mizan*), xhenetin dhe xhehenemin. Ky i ri, kur beson që Allahu ka dërguar Pejgamberin, duhet të kuptojë edhe domethënien e asaj shpallje, e ajo është të dijë që kush i nënshtrohet Allahut Teala dhe Resulallahut s.a.v.s., shkon në xhenet, e ai që nuk pranon dhe nuk beson shkon në xhehenem.

Nëse këto që thamë kuptohen mirë, padyshim që kjo është rruga e drejtë. Dhe kupton që njeriu çdo ditë dhe natë, në çdo gjendje, në ibadet dhe në veprimet e tij, do të jetë ballë-për-ballë me ngjarje që i interesojnë. Në çdo situatë kur përballet dhe do të përballet me ndodhi, ai duhet të pyes dhe të përfitojë dituri të re.

Në hadithin: **“Të mësuarit dituri është farz për çdo mysliman”**, është kuptuar që me **“të mësuarit dituri”** qëllimi është që çdo mysliman të mësojë farzet e veprimit me të cilat është i obliguar, e edhe me njoftimet tona është shpjeguar që këto janë farz. Vetëm Allahu Teala e di më së miri.

## DITURITË FARZI KIFAJE

Dije se, nuk është e mundur të ndahen dituritë të cilat janë farz nga ato që s’janë, pa u shpjeguar pjesët e diturisë. E në esencë, dituritë ndahen në dy:

1. **Dituritë e sheriatit**, që mësohen vetëm nga pejgamberët, të cilat nuk njihen me mend (si matematika), ose me përvojë (si mjekësia), ose me të dëgjuar (si fjalët).

2. **Dituritë që nuk janë të sheriatit**, të cilat përfitohen me mjete tjera. Ato ndahen në tri:

- Dituri e lavdëruar (*mahmud*);
- Diturie e papëlqyer (*mezmum*); dhe
- Dituri as e lavdëruar e as e papëlqyer (*mubah*).

Dituri e lavdëruar janë dituritë për të mirat e njerëzve në këtë botë, si mjekësia, matematika etj., e edhe këto ndahen në dy: në (1) *farzi kifaje* dhe (2) *fazilet* (vlerë e lartë).

Dituritë *farzi kifaje* nevojiten për rregullimin e punëve të dynjasë (kësaj bote). Për shembull mjekësia, që është e nevojshme që njeriu të mund të jetojë shëndosh. Ose

matematika, që është e nevojshme për tregti, trashëgimi dhe në të gjitha llogaritë. Nëse në një vend nuk gjindet dikush që i di këto dituri, populli përballet me vështirësi dhe të gjithë bëhen përgjegjës. Por nëse njëri, ose disa sipas nevojës, dinë - kjo është e mjaftueshme, dhe në këtë mënyrë të tjerët shpëtojnë nga ky obligim.

Nuk duhet të habiteni me pohimin tonë që mjekësia dhe matematika janë farzi kifaje. E vërteta është që edhe të gjitha profesionet tjera janë farzi kifaje, si bujqësia, endja, rrobaqepësia, politika, e të tjera.

Nëse në një vend nuk ka mjek, sëmundjet mund të përhapen, njerëzit i ekspozohen rrezikut, e humbin fuqinë, dhe në përfundim është vdekja. Ai që krijoi sëmundjen e krijoi edhe ilaçin. Robëve të Tij u dhuroi aftësi për të zbuluar ilaçin dhe i mësoi si ta përdorin. Nuk është e drejtë që njeriu të braktisë shërimin, dhe të rrezikojë veten.

Sa u përket diturive që njihen si *fazilet* (dituri me vlerë të lartë), këto janë dituri që hyjnë në detaje të diturive që tashmë i përmendëm. Sigurisht që është një vlerë e lartë (fazilet) lehtësimi i pjesëve që duhet të kuptohen.

Dituri e papëlqyer janë dituritë që nuk kanë vend në fe, ato janë dituri që nuk sjellin asnjë dobi, siç janë sihr-i, iluzionet dhe të ngjajshme.

Dituritë *mubah* (mësim që nuk është as i ndaluar as i obliguar) janë mësimi i poezisë, ose historitë e vjetra, me kusht që të mos teprohet.

Deshëm të tregojmë që të gjitha dituritë e sheriatit janë të vlefshme. Por, nëse përzihen dituritë që nuk janë në të vërtetë (hakikat) të sheriatit me dituritë e sheriatit, ato bëhen të papëlqyeshme. Prandaj, dituritë e fesë ndahen në dy: të lavdërueshme dhe të papëlqyeshme.

## PJESËT E DITURIVE TË SHERIATIT

Dituritë e lavdërueshme të sheriatit ndahen në katër pjesë: dituria burimore (*usul*), dituria e degëzuar (*furu*), dituria fillestare (*mukaddimat*) dhe dituria plotësuese (*mutemmimat*).

**Pjesa e parë** janë dituritë burimore (*usul*): Libri, sunneti, ixhma (konsenzusi) dhe rruga e as’habëve. Konsenzusi është në radhë të tretë, si shpjegues i sunnetit. As’habët janë dëshmitarët e shpalljes, prandaj kanë arritur shumë dituri, të cilat pasardhësit e tyre nuk i kanë arritur. Nganjëherë, pikëpamjet nuk mund të shpjegohen me shkrime. Për këtë arsye dijetarët e gjejnë të përshtatshme të pasojnë rrugën e as’habëve, dhe t’u përshtaten atyre. Edhe kjo i ka rrugët e përcaktuara dhe kushtet e veçanta, por nuk është e përshtatshme që këtu të mirremi me to.

**Pjesa e dytë:** quhet ‘*furu*’, dhe kjo është dituria që nxirret nga burimet. Por, kuptimi nuk nxirret nga burimi tekstualisht. Ndoshta është që, me zgjuarësinë e mendjes së mprehtë, nga zgjerimi i fjalës burimore të nxirren edhe kuptime tjera. Si shembull, në hadithin:

**“Gjykatësi, nuk gjykon kur është i zemëruar.”<sup>60</sup>**

nga kuptimi i fjalës zemërim, janë nxjerrë edhe kuptimet: i uritur, i frikësuar dhe i sëmurë.

---

<sup>60</sup> Buhariu dhe Muslimi nga Hz. Ebu Bekri r.a.

Dituria *furu* ndahet në dy:

1. Dituritë në lidhje me rregullimin e punëve të dynjasë: këto i shpjegojnë librat e fikhut dhe ata që merren me to quhen '*fakih*'. Këta janë dijetarë të dynjasë.

2. Dituritë në lidhje me ahiretin: këto janë dituritë që shpjegojnë gjendjet e zemrës, ahlakun e mirë dhe të keq, dhe gjendjet e pëlqyeshme dhe të papëlqyeshme tek Allahu Teala. Kjo është e përfshirë në pjesën e fundit të librit tonë, bashkë me përhapjen e gjendjeve në ibadet - nga zemra në gjymtyrë.

**Pjesa e tretë:** Duke qenë fillim i diturive (*mukaddimat*), është mjet që mundëson përfitimin e diturive tjera, siç janë gjuha dhe sintaksa: Këto nuk janë dituri të sheriatit në vetvete, por janë të nevojshme për kuptimin e diturive të Kur'anit dhe Hadithit. Meqë Kur'ani dhe Hadithi janë në gjuhën Arabe, ne kemi nevojë për këto dituri për të kuptuar fenë tonë (sheriatin). Edhe shkrimi duhet mësuar, por ai nuk është i domosdoshëm, siç është gjuha. Sepse edhe Pejgamberi a.s., nuk dinte të shkruajë e të lexojë. Po të ishte e mundshme që të mos harrohet çdo gjë që dëgjohet, edhe nevoja e shkrimit do të ishte zvogëluar. Por pasi kjo nuk është e mundur, edhe shkrimi është i domosdoshëm.

**Pjesa e katërt:** dituritë plotësuese (*mutemmimat*) janë dituritë që plotësojnë tri pjesët që i cekëm më lartë, e edhe këto ndahen në dy: (1) dituritë plotësuese në lidhje me Kur'anin; dhe (2) dituritë plotësuese në lidhje me Hadithet.

Në lidhje me Kur'anin, dituritë plotësuese ndahen në tri pjesë:

1. Dituria që njofton mënyrën se si lexohet Kur'ani, leximi i shkronjave dhe pikënisja (*Kiraet* dhe *Maharixhu'l-Huruf*).

2. Dituritë në lidhje me kuptimin e Kur'anit, siç është tefsiri (komentimi). Tefsiri mbështetet në shpjegime. Nuk mjafton vetëm njohja e gjuhës Arabe.

3. Dituritë në lidhje me urdhërat e Kur'anit. Këto janë dituri që njoftojnë gjendjen e urdhrave si '*nasih*' (anulimi i vendimit të vjetër për ajetin, me vendim të ri), '*mensuh*' (vendimi i anuluar), '*amm*' (shumë kuptime), '*has*' (vetëm një kuptim), '*nass*' (i prerë), '*zahir*' (kuptimi i jashtëm) dhe çështje të tilla. Me disa nga këto veprohet, e me të tjera jo.

Dituritë që plotësojnë mësimet e hadithit dhe tregimet e të parëve janë dituri që njoftojnë emrat dhe fisnikërinë e dijetarëve të hadithit, emrat dhe cilësitë e as'habëve, drejtësinë dhe cilësinë e transmetuesve për të ndarë të dobët nga të qëndrueshmit, gjendjet e transmetuesve, bile edhe moshën - për të ndarë hadithet *mursel* nga ato *musned*.

Të gjitha këto që i cekëm janë dituri të sheriatit, të gjitha janë të lavdërueshme dhe *farzi kifaje*.

Nëse thua: "*Pse 'fikhu' radhitet në dituri të dynjasë (kësaj bote), dhe fakihët në mesin e dijetarëve të dynjasë?*", dije se: Allahu Teala e krijoi Ademin prej dheut, krijoi pasardhësit e tij prej një pikë uji të hedhur nga kurri i babait në mitrën e nënës dhe prej aty në botë, pastaj në varr, dhe pastaj në llogari, dhe më pas ose në xhenet ose në xhehennem. Ja fillimi, përfundimi dhe vendi i arritjes. Dynjanë (këtë botë) e krijoi për të fituar ahiretin. Nëse njeriu në dynja përfiton ndershëm, thashethemet dhe armiqësia zhduken dhe dituria

e fikhut bie vetvetiu. Por, përqaftimi me pangopësi i kësaj bote, krijoi armiqësi dhe lindi nevojën për qeverisjen e njerëzve në shtet. Qeveritarit të shtetit i nevojiten ligjet për të drejtuar njerëzit. Fakihu është ai që i njeh këto ligje politike dhe është ndërmjetësues i cili e di rrugën e pengimit të grindjes mes njerëzve. Fakihët janë mësuesit e shtetit, të cilët drejtojnë njerëzit në rrugë të drejtë. Betohem në jetë që dituria e ‘fikhut’ (drejtësia) - sa është e lidhur me dynja, aq është e lidhur edhe me fe. Por lidhja me fe është nëpërmjet kësaj bote. Sepse **‘dynjaja është ara e ahiretit.’** Feja plotësohet me dynja. Feja me pushtetin janë vëllezër, binjakë. Feja është themel e pushteti mbrojtës. Siç është ajo që nuk ka themel e detyruar në rrëzim, edhe themeli që nuk ka mbrojtje rrëzohet, zhduket. Plotësimi i pasurisë dhe mbrojtja e saj me pushtet janë të mundshme. Mbrojtjen e pasurisë dhe rendit gjatë armiqësisë e rregullojnë fakihët.

Qeverisja e njerëzve me politikë nuk është nga vetë feja, por feja e ndihmon politikën në gjëra që mund të përmirësohen; edhe fakihu është si kjo, që njofton për rrugët e qeverisjes dhe rregullat.

Ata që nisen për haxh kanë nevojë për mbrojtës, për parandalimin e hajdutëve. Por, lidhja e mbrojtësit me haxhin është shumë larg, sepse haxhi është tjetër, hyrja në këtë rrugë diçka tjetër, personi që do të zbatojë haxhin është tjetër, njohja e rregullave dhe mashtrimeve në mbrojtje dhe parandalim në rrugë të haxhit është diçka tjetër. Edhe fakihët janë si personat që u mësojnë metodat e mbrojtjes njerëzve që kanë hyrë në rrugëtim të haxhit, për të realizuar rrugën në siguri. Sa është lidhja e atij mbrojtësi me haxhin, aq është lidhja e fakihëve me fenë, e që del të jetë pjesa e katërt

(dituritë plotësuese). Në këtë çështje, ky hadith i Resulallahut s.a.v.s., është dëshmi e qartë:

**“Vetëm tre persona mund t’u jepen fetva njerëzve: Emiri, me’muri dhe mutekellefi.”<sup>61</sup>**

Emiri është imam dhe kryetar i shtetit. Me’muri është përfaqësuesi i tij. Mutekellef është ai që pa iu kërkuar, merr detyrën për të dhënë fetva.

As’habët radiallahu anhum, janë përmbajtur nga dhënia e fetvasë dhe këtë punë ia kanë dorëzuar njëri-tjetrit. Vetëm kur janë pyetur rreth Kur’anit dhe ahiretit, janë përgjigjur menjëherë.

Në një transmetim tjetër të këtij hadithi, në vend të ‘mutekellef’ është shkruar ‘el-murai’ (dyfytirësh). Sepse: i tilli jep fetva pa u caktuar për diçka të tillë, vetëm për të fituar pasuri dhe post, e kjo është tamam dyfytirësi.

Nëse thua: “Këto sqarime tua, si në pjesët për rendin e kësaj bote, dënimet për pagimin e gjakut nga vrasësi (dijet), shpagimi (kësas) dhe ndarja e të drejtës nga e padrejta përmes padisë, janë të drejta. Por në çështjet e trajtimit për namaz dhe agjërim, që janë prej ibadeteve, si edhe sqarimi për hallallin dhe haramin nuk janë të drejta. Sepse këto janë plotësisht fe.”

Si përgjigje them: Tema të bisedës së një fakihu që janë më së afërti ahiretit, janë tri: Islami, namazi me zeqatin, si dhe hallalli e harami. Nëse mendon, do të kuptosh që

---

<sup>61</sup> Ibn Maxhe nga Amr b. Shuajbi.

mendimet e fakihëve nuk kalojnë përtej kësaj bote (dynjasë). Kur kupton që edhe këto veprime janë të lidhura për këtë botë, të tjerat do të jenë të qarta.

**Sa i përket Islamit**, fakihët flasin për drejtësinë e Islamit, kushtet dhe çrregullimet, por së pari shikojnë pohimet për gjendjen e personit dhe sipas saj japin gjykimin. Fakihët nuk gjykojnë për zemrën, për shkak që nga Resulallahu s.a.v.s, është ndaluar përzjerja në zemër. Resulallahu s.a.v.s., e pyeti personin që vrau tjetrin, pasi që ky kishte shqiptuar kelime-i shehadetin:

**- Pse e mbyte, kur e shqiptoi shehadetin?**

Duke u arsyetuar, personi tha:

- *“O Resulallah, nga frika e tha, por me zemër nuk besonte.”* Në këtë, Resulallahu s.a.v.s., tha:

**- Mos ia hape ti zemrën dhe shikove aty?**<sup>62</sup>

(pra, zemra nuk është detyrë e jotja, ti shikoje gjuhën).

Fakihu e pranon shqiptimin e shehadetit, gjykon drejtësinë e Islamit dhe shpëton personin nga shpata. Megjithatë, fakihu e di mirë që në zemër të atij personi nuk ka islam, pra, ai nuk e ka ngritur pengesën e paditurisë dhe konfuzionit, nuk e ka përmirësuar nijetin. Pra, shqiptimi vetëm me gjuhë ia shpëton personit jetën dhe pasurinë, e kjo është dynjallëk (i takon kësaj bote). Për këtë arsye Resulallahu s.a.v.s. thotë:

**“Më është urdhëruar që të luftoj kundër njerëzve derisa të thonë “Lailahe ilallah”. Kush e thotë këtë, e ruan nga unë pasurinë dhe jetën.”**<sup>63</sup>

---

<sup>62</sup> Muslimi nga Usame b. Zejdi.

<sup>63</sup> Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre r.a..

Resulallahu s.a.v.s., na njoftoi për dobinë e shehadetit - me deklarin e shehadetit mbrohet jeta dhe pasuria. Ndërsa dihet mirë që pasuria nuk jep dobi në ahiret. Por, në ahiret jep dobi vetëm singeriteti dhe drita (nur) e zemrës, e fikhu nuk merret me këtë. Nëse një dijetar i fikhut dëshiron të flasë për këto, kjo është njëjtë sikur të flasë për mjekësi dhe kelam, të cilat janë jashtë specializimit të tij.

**Sa i përket namazit;** Një fakih jap fetva për vlefshmërinë (në zbatim) të namazit të personit i cili merr tekbinin e parë për rizanë e Allahut, dhe që i përshtatet kushteve të jashtme të namazit, sadoqë në namaz me mendje bën tregti dhe gjëra tjera. Por, siç nuk ka vlerë te Allahu shehadeti që nuk hyn në zemër, edhe nga ky namaz nuk ka dobi në ahiret. Duke thënë: *“Po, ky namaz është i drejtë.”* fakihu dëshiron të thotë: *“Po, ai iu përshtat urdhrave të Allahut Teala, dhe kështu e shpëtoi veten nga rreziku.”*

Veprim i vërtetë i ahiretit është namazi me frikë-respekt të brendshëm dhe me zemër. Vetëm një veprim i tillë i jashtëm jep dobi; e fakihu në këtë nuk përzihet, sepse nuk është çështje e tij.

**Sa i përket zeqatit;** Nëse personi i pasur nuk jep sasinë e përcaktuar të zeqatit dhe sulltani ia merr me forcë, fakihu e miraton këtë zgjidhje.

Tregohet që Kadiu (gjykatësi) Imam Ebu Jusufi, për të mos dhënë zeqatin, para se të përfundonte viti ia transferonte pasurinë gruas, e kur kalonte viti, grua ia kthente pasurinë, kështu që pasuria nuk ishte në pronën e tij për një vit të plotë, dhe ai shmangej nga zeqati. Këtë ia tregojnë Imam Ebu Hanifes dhe Ebu Hanife thotë: *“Po, kjo është dituria e tij nga fikhu.”* Po, u vërtetua që kjo dituri është nga fikhu i kësaj bote. Por, dëmi i këtij dijetari në ahiret është

i madh (në çdo drejtim); sepse dituritë e tilla janë dituri shumë të dëmshme.

**Sa i përket hallallit dhe haramit;** Besimtari largohet nga harami. Por, edhe kjo ka katër gradë:

1. Largimi nga haramet e dukshme. Nëse nuk largohet nga kaq, e humb të drejtën e përfaqësimit dhe dëshmitarit në gjyq.

2. Largimi i personit të ndershëm edhe prej gjërave të dyshimta, të cilat kanë mundësi të jenë haram.

Në këtë çështje, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Braktisi ato që janë të dyshimta për ty, bëji ato që nuk janë dyshimta për ty”<sup>64</sup>,**  
e përveç kësaj:

**“Dridhja e zemrës është gjynah.”<sup>65</sup>**

(pra, zemra duhet të jetë e qetë në çdo veprim; nëse zemra dridhet, ai veprim nuk është i vlefshëm)

3. Largimi i personit të devotshëm edhe nga hallalli i cili ka mundësi të bëhet shkak për haramin. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Personi nuk mund të jetë i devotshëm deri sa nuk i braktis gjërat të cilat në dukje janë të padëmshme, me frikë që të mos bie në gjëra të dëmshme.”<sup>66</sup>**

Për shembull: Për të mos rënë në telendisje, nuk bisedon për gjendjet e njerëzve. Duke marrë parasysh dëshirat e epshit, për të mos hyrë në rrugë të gabuar, nuk ha çdo gjë që dëshiron shpirti, edhe nëse ato janë hallall.

---

<sup>64</sup> Tirmidhiu nga Hasan b. Alia.

<sup>65</sup> Bejhaki nga Ibn Mesudi.

<sup>66</sup> Tirmidhiu nga Atijje es-Sadi.

4. Largimi i sidikut (që mendon, gjykon e vepron në përputhje me të vërtetën – me sheriat). Sadoqë i tilli nuk bie në haram, nga frika se do të kalojë një çast të jetës bosh duke mos iu shtuar afrimi Allahut Teala, me tërë qenien e tij drejtohet kah Allahu Teala dhe largohet nga çdo gjë.

Nga këto katër gradë, vetëm e para është punë e fakihut. Ndërsa grada e parë është cilësia e pranimit ose mospranimit të dëshmisë në këtë botë (në jetën e materies), e kjo nuk e shpëton njeriun nga përgjegjësia në ahiret. Këtë e vërteton kjo fjalë e Resulallaut s.a.v.s., thënë Vabises:

**“Sadoqë të japin fetva, ti këshillohu me zemrën.”<sup>67</sup>**

Domethënë: Sadoqë të japin fetvanë e lejuar, ti shikoje zemrën, nëse zemra nuk gjenë qetësi dhe kënaqësi, lëre atë vepër, mos e bëj.

Ndërsa fakihët nuk flasin për dridhjen e zemrës dhe cilësitë e veprimit me zemër: mjaftohen me pjesën që kërkohet për drejtësi.

Është kuptuar që të gjitha gjykimet e fakihut janë në lidhje me këtë botë (dynjallëk), për të drejtuar besimtarin në rrugën e drejtë të ahiretit. Nëse ai flet diçka kur t’i jepet fjala në lidhje me cilësitë e zemrës, kjo fjalë e tij nuk është e plotëfuqishme, e ndoshta është e pafuqishme. Kështu që nganjëherë, mes temave të mjekësisë, matematikës, astronomisë dhe logjikës, fjalët përzihen. Njëjtë si ndërhyrja e sintaksës në poezi.

Sufjani Sevriu ka thënë:

*“Dituria e jashtme nuk ka ndonjë përfitim në ahiret.”*

---

<sup>67</sup> Imam Ahmed nga Vabise.

E si të ketë, kur të gjithë pajtohen që dituria më e ndershme është ajo në bazë të së cilës veprohet; atëherë si është e mundur të mendohet që përfitimin për ahiret e paraqet njohja e rregullave, si **zihar** (shkurorëzimi për shkak të krahasimit të gruas me nënën), **li'an** (mallkimi i ndërsjelltë për ziná mes burrit e gruas), **selem** (vendimet në tregti), **igjare** (vendimet për qira) dhe **sarf** (vendimet rreth parave). Kush i mëson këto dituri me qëllim për t'iu afruar Allahut, ai është naiv. Zbatimi i urdhrave të fesë bëhet me zemër dhe gjymtyrë; nderi aty është.

Nëse thua: *“Ti po i trajton mjekësinë dhe fikhun të barabarta, ndërkaq mjekësia, nga pikëpamja e nevojës për trup të shëndoshë është plotësisht e kësaj bote, por fikhu, ani pse është i kësaj bote, megjithatë rregullon fenë me urdhrat dhe ndalesat e Allahut - mes tyre është dallim i qartë. Konsiderimi i tyre si të barabarta nga ana jote është kundër mendimit unanim të myslimanëve”,* dije që:

Mes tyre ka dallim, dhe nga shpjegimet tona do të kuptohet që dallim duhet të ketë; fikhu është më i vlefshëm në tri pika:

1. Fikhu është dituri e sheriatit meqenëse na është mësuar nga Pejgamberi, por mjekësia nuk është.

2. Çdo udhëtar i ahiretit, edhe i shëndoshi dhe i sëmuri, kanë nevojë për fikh, por për mjekësi kanë nevojë vetëm ata që janë të sëmurë.

3. Dituria e fikhut është fqinje e diturisë së ahiretit, sepse shpjegon cilësitë e veprimeve me gjymtyrë, e që burim i tyre është zemra dhe gjendjet e zemrës. Veprimet e mira që janë të pranueshme në ahiret paraqiten prej ahlakut të mirë. E veprat e këqija paraqiten prej vesit të keq. Nuk është e

fshehtë lidhja mes zemrës dhe gjymtyrëve; verbëria, shëndeti, sëmundja - nuk janë nga cilësitë e zemrës, është nga prishja e natyrës së trupit, që nuk ka të bëjë me zemrën. Dituria e fikhut është më e vlefshme në krahasim me mjekësinë, dituria e ahiretit është më e vlefshme dhe më e lartë në krahasim me diturinë e fikhut.

## PJESËT E DITURISË SË RRUGËS SË AHIRETIT

Meqenëse një shpjegim i hollësishëm deri në shkallën e fundit i kësaj diturie nuk është i mundshëm, nëse dëshiron të dish një çikë hollësi të diturisë së ahiretit bëhu i zgjuar dhe dije që: Dituria që tregon rrugën e ahiretit ndahet në dy: **mukashefe** dhe **muamele**.

PJESA E PARË: mbanë emrin **dituria mukashefe**, e kësaj i thuhet edhe dituria e brendshme (**Ilmi batin**). **Dituria mukashefe** është qëllimi i diturive. Bile, disa arifë (evlia) kanë thënë: *“Ai që nuk ka hise nga kjo dituri, frikësohet nga fryma e fundit.”* E hisja më e vogël është të pranohet pa dyshim dituria batin, dhe t’i lihet ajo atyre që e meritojnë. Një arif tjetër ka thënë: *“Asgjë nga kjo dituri nuk i çelet personit me këto dy veti: bidat dhe mendjemadhësi.”* Përsëri është thënë: *“Nganjëherë kjo dituri realizohet edhe me dituri tjera, e nuk gjindet te ai që e do këtë botë dhe ndjek epshin.”* Dënimi më i vogël për atë që e mohon këtë dituri është privimi nga kënaqësia e tij. Siç ka thënë një poet:

***“Ti gëzohu kur diçka t’humbet,  
ke lanë mbrapa një vujtje t’dëbimit.”***

Dituria mukashefe është dituri e *sidikëve* (të sinqertëve), dhe *mukarrebunëve* (të afërmëve). Kjo dituri përbëhet nga një nur që shfaqet në zemër kur ajo pastrohet

nga veset e këqija. Falë këtij nuri, i tilli sheh shumë gjëra, i shfaqen emrat dhe nxjerr përmbajtjet e tyre, e duke u mbyllur në vete, mundohet të kuptojë, i çelet perceptimi i gjerë; bile bëhet posedues i vërtetë i marifetit rreth Qenies (dhat), cilësisë (sifat) dhe punës (ef'al) së Allahut Teala. Kupton mençurinë (hikmetin) e krijimit të dynjasë dhe ahiretit, dhe jetën në ahiret pas jetës në dynja. Kupton çka do të thotë Pejgamberllëku dhe Pejgamberi, shpallja (vahji), melekut dhe shejtani. Kupton mënyrën e arritjes së shpalljes pejgamberëve, paraqitjen e melekëve Pejgamberëve, mënyrën e armiqësisë së shejtanit ndaj njeriut, thesaret e tokës dhe qiellit. Pastaj zemrën, veprimin e melekut dhe sulmin e shejtanit në zemër, dallimin mes frymëzimit të melekut dhe vesesës së shejtanit, ahiretin, xhennetin, xhehenemin, vuajtjen në varr, siratin (ura e vendosur mbi xhehenem), mizanin (peshorja), hisabin (llogaria), si dhe e di kuptimin e ajeteve:

**“Lexoje librin tënd! Ti mjafton sot si llogaritar kundër vetvetes!”** 17-Israë: 14

**“E jetë e vërtetë, padyshim është ajo e botës së ardhme (Ahireti), sikur ta dinin.”** 29-Ankebutë: 64

Gjithashtu, kupton mënyrën e takimit dhe shikimit e bukurisë së përsosur të Allahut Teala, arritjen në afërsinë e Allahut, ngritjen në *mele-i a’la*, realizimin e lumturisë duke u bërë mik me melekët dhe pejgamberët, dallimin mes banorëve të xhennetit - shpjegimi i hollësishëm do të bëhej shumë i gjatë - pra, personi kupton edhe shumë gjëra të ngjashme këtyre. Por, ekziston dallim në kuptimin e këtyre që u përmendën, mes personave me besim të njejtë.

Disa njerëz menduan se të gjitha këto janë një simbol i hakikatit. Disa menduan ato që ka përgatitur Allahu në xhennet e që sytë nuk i kanë shikuar e as veshët nuk kanë dëgjuar, për gjërat që nuk mund t'i paramendojnë dhe imagjinojnë, është simbol, dhe sipas tyre njerëzit dinë vetëm emrat dhe cilësitë e xhenetit, e jo edhe hakikatin. Disa të tjerë pranuan që e vërteta (hakikat) është pikërisht në kuptimin e fjalës, e të tjerët thanë që fjalët janë simbolikë. Ngjashëm si kjo, disa supozuan se shkalla e fundit në njohjen e Allahut është pranimi i pafuqisë në njohjen e Tij. Të tjetër deklaruan shumëçka tjetër në temën e njohjes së Allahut. Disa të tjerë thanë se shkalla e fundit në njohjen e Allahut është ajo që çdo besimtar e kupton dhe njeh, e ajo përbën besimin që **Allahu ekziston dhe është Një** – është **Alim** (E di çdo gjë si është dhe si do të bëhet, dituria e Tij nuk ndërron), **Kadir** (I mjafton fuqia për çdo gjë), **Semi** (Dëgjon çdo gjë), **Basir** (Sheh çdo gjë), **Mutekellim** (Flet).

Pra, me diturinë mukashefe qëllimi ynë është të njoftojmë për gjendjen e shkëlqimit të zemrës, duke pastruar njollat dhe ndryshkun nga pasqyra e zemrës, të cilat pengojnë në njohje të qartë të cilësitë (sifat) dhe punës (ef'al) të Allahut Teala .

Pastrimi nga ky ndryshk është i mundshëm me braktisjen e dëshirave epshore dhe shtazore, dhe me përshtatje në të gjitha gjendjet Pejgamberit, i cili është shembull për ne. Me lustrimin e zemrës dhe varësisht nga drejtimi i Hakkut, drita (nur) e diturisë mukashefe fillon të shkëlqejë në zemër. E kjo arrihet vetëm përmes kundërshtimit të dëshirave të nefsit (ushtrimeve shpirtërore) dhe duke mësuar, që do ta shpjegojmë më vonë. Kjo është dituri që nuk është shkruar në fletë të librave dhe nuk është

folur me të tjerët, përveç zotëruesit të kësaj diturie. Edhe zotëruesi ka marrë pjesë në këtë fshehtas dhe përmes diskutimeve. Në këtë dituri të fshehtë (*ilm-i hafi*) aludohet edhe në këtë hadith të Pejgamberit tonë:

**“Ekzistojnë disa dituri, që mbahen të fshehta, e të cilat i kuptojnë vetëm ata që janë arif-i bi’llah. Kur ata flasin nga këto dituri, llogariten si xhemati që u ka hyrë vetja në qejf dhe si i padituri. Mos i poshtëroni dijetarët të cilëve Allahu u ka dhënë dituri (nga dituria e Tij). Sepse Allahu Teala nuk i poshtëroi ata duke u dhënë atë dituri.”<sup>68</sup>**

PJESA E DYTË është dituria praktike (muamele) që njofton për gjendjen e zemrës.

Gjendjet e lavdërueshme (*mahmud*) të zemrës janë: *sabr* (durimi), *shukur* (falënderimi), *havf* (frika), *rexha* (shpresa), *riza* (pëlqimi), *zuhd* (braktisja e kësaj bote me zemër), *takva* (devotshmëria), *kanaat* (mjaftueshmëria), *xhymert* (bujaria) dhe të dihet që të gjitha *nimetet* (mirësitë): bamirësia, mendimi për të mira, ahlaku i mirë, kalimi mirë me të tjerët, drejtësia dhe sinqeriteti, janë prej Allahut.

Dituri që vlen është të njihet kufiri dhe hakikati i këtyre gjendjeve, të njihen se bënë për t’i përfituar ato. Duke ua njohur frytin dhe shenjat, e pastaj duke i përforcuar ato që janë dobësuar e duke i kthyer ato që janë humbur, kjo është një dituri që vlen - dituri e ahiretit.

Gjendjet e papëlqyeshme të zemrës janë frika nga varfëria, zemërimi ndaj fatit (*kader*), armiqësia, urrejtja, hakmarrja, xhelozia, mendjemadhësia, vetëkënaqësia, kërkesa e jetës së gjatë për dynjallëk, dyfytirësia, zemërimi i

---

<sup>68</sup> Ebu Abdurrahman es-Sylemi në ‘*Erbain*’ nga Ebu Hurejre.

panevojshëm, pangopësia, koprracia, madhështia, padrejtësia, respekti ndaj të pasurit e tallja me të varfërit, egoizmi, vetëpëlqimi, vetëlavdërimi, mospranimi i të vërtetës, përpjekja/puna e kotë, dëshira për të folur shumë, stolisja për demonstrim, shkaktimi i përçarjeve, kërkimi i mangësive të të tjerëve duke mos i kërkuar mangësitë e veta, nxjerja nga zemra e frikës nga zjarri dhe nga mendimi për ahiretin, hakmarrja personale duke mos treguar kujdes për të vërtetën dhe drejtësinë, mos-frika nga dënimi i Allahut, besimi në vepra të veta, mashtrimi, tradhëtia, dredhia, dëshirat e pafundme, dalldisja dhe mendimi se nuk do të vdes kurrë, mizoria dhe zemra e ngurtë, gëzimi në pasuri dhe hidhërimi në varfëri, padrejtësia, mendimi i shkurtë, mosdurimi dhe paturpësia. Këto që i përmendëm dhe të ngjajshme, mbjellin farën e keqe dhe përfundojnë me vepra të këqija. Këto janë vese të këqija të zemrës.

Kundërveprim i këtyre janë virtytet, që janë burim i adhurimit dhe afërsi Allahut Teala.

Njohja e thelbit dhe kufirit të këtyre veseve, shkakun dhe shenjat, si dhe zgjidhjen e përmirësimit, është dituri e ahiretit. Sipas dijetarëve të ahiretit, është *farz-i ajn* për çdo mysliman t'i mësojë këto. Mos shpresoni vetëm për veprimet e jashtme (zahir); siç shkatërrohet (i pasuri që nuk jep zeqatin) nga shpata e sundimtarit në pajtim me fetvanë e fakihut, edhe ata që nuk i japin vlerë diturisë së ahiretit në ditën e kiametit do të shkatërrohen nga pronari i vërtetë, me dënimin e Allahut Teala.

Thëniet e fakihëve farz-i ajn janë për rregullimin e punëve të dynjasë. Thëniet tona janë përgatitje për ahiret.

Nëse pyet një fakih për njërën nga ato që i shpjeguam, për shembull për tevekkul, ihlas ose zgjidhjen për braktisjen e

dyftytyrësisë – ai do të ndalet dhe nuk do të mund të japë përgjigje. Ndërkaq, edhe këto të dihen është farz-i ajn; lënia e tyre pas dore është shkak i shkatërrimit në ahiret.

Nëse i pyet fakihët për **li' ân, zihâr, sebk, remj** dhe të ngjajshme, ata japin përgjigje me vëllime që asnjëra nuk do t'ju duhet, e nëse të duhen, ato përgjigje gjinden në çdo vend. Ata lexojnë ditë e natë këto dhe gjëra të ngjajshme, mundohen t'ua mësojnë të tjerëve, e ato më të rëndësishmet lihen pas dore. Nëse u thuhet se këtë që janë duke e bërë nuk është e drejtë, thonë '*jo, kjo është nga dituritë farz-i kifaje*', e me këtë hutojnë veten dhe të tjerët.

Njeriu i mençur e kupton menjëherë që nëse qëllimi i këtij fakihu është zbatimi i urdhërave farzi kifaje, ai duhet që pikësëpari të zbatojë farzin ajn.

Sa ka qytete ku mjekët ende janë *zimmi* (jomysliman), e dëshmia e tyre në lidhje me mjekësinë sipas fikhut, nuk është e vlefshme. Por, askush nga myslimanët nuk mirret me këtë. Ata mirren me kundërshtime rreth çështjeve më delikate të diturisë së fikhut. Shoqëritë janë mbushur përplot me fakihë që japin fetva për çështje të tilla.

Sikur ta dija se si bëhet që fakihët mirren me dituritë farz-i kifaje, të cilat shumica i di, e i lëjnë pas dore farz-i kifajet që nuk janë marrë në shqyrtim? Shkaku i vetëm i kësaj është: me diturinë e mjekësisë - të mirret udhëheqësia e fondacionit të bamirësisë, me ekzekutimin e testamentit të jetimit apo të njeriut të sëmurë - marrja e pasurisë së jetimit, mbajtja e anës gjyqtarit, epërsia ndaj kolegëve dhe heshtja e kundërshtarëve; e kjo nuk do të realizohet lehtë. Haram u qoftë, me fshehjen e të vërtetës, dijetarët e këqinj e shkatërrojnë diturinë e fesë. Ndihmësi ynë është vetëm Allahu

Teala. Strehohemi te Allahu nga ky mashtrim që të zemërojmë Rahmanin e të argëtojmë shejtanin.

Dijetarët e zahirit të cilët largohen nga harami dhe gjërat e dyshimta (vera), pranojnë epërsinë e dijetarëve batin dhe zotëruesve të basiretit (mendjemprehtësisë, largpamësisë).

Imam Shafiu, Allahu qoftë i kënaqur me të, qëndroi i gjunjëzuar si një fëmijë në shkollë para Shejban-i Rai-t, dhe e pyeti për punët që do t'i bënte. Kur e pyetën Imam Shafiun:

- *A merr dituri një dijetar si ti nga një beduin?*, Imam Shafiu tha:

- *Ky njeri i di ato që ne nuk i dimë.*

Ahmed b. Hanbel me Jahja b. Main e pyesnin Marufi Kerhin. E, si mos t'a pyesnin, sepse kur Resulallahut s.a.v.s., i thanë:

- *Çka të bëjmë, kur të përballemi me një situatë që nuk e gjejmë në Kur'an dhe sunnet?*, ai a. s., u tha:

- **Për atë pyetni personat salih<sup>69</sup> dhe përmbahuni udhëzimit të tyre.<sup>70</sup>**

Për këtë shkak është thënë: *'Dijetarët zahir janë stoli e sipërfaqes së tokës, kurse dijetarët batin janë stoli e qiellit dhe të botës së melekutit.'*

---

<sup>69</sup> **Salih**: i hairit; ndershëm dhe bamirës; ai që posedon drejtësi dhe veprime të drejta; ai që i zbaton urdhrat e fesë; i devotshëm; me virtyt; me dinjitet.

<sup>70</sup> Taberani nga Ibn Abbasi.

Xhunejd-i Bagdadi ka treguar: *‘Kur u largova nga mësuesi im Serij Sakati, ai më pyeti se me kë rri, e unë iu përgjigja që rri me Muhasibin. Serij Sakati më tha:*

*- Mirë, rri me atë, merr nga edebi dhe dituria e tij, por mos i’a dëgjo fjalët rreth kelamit - ato leji kelamistëve. Duke u larguar, e dëgjova që tha:*

*- Allahu të bëftë së pari dijetar të haditheve e pastaj sufi, e mos të bëftë së pari sufi e pastaj dijetar.*

Me këtë fjalë, ai tregoi se personi që mirret me tasavvuf pasi që mëson diturinë e hadithit, do të gjejë shpëtim, e ai që hyn në tasavvuf pa këtë dituri, do të shkatërrohet.

Nëse pyet se përse nuk shpjegova në klasifikimin e diturive përbërjen e kelamit dhe filozofisë, dhe se a janë ato të pëlqyeshme ose papëlqyeshme, dije se:

Dituria e kelamit që përfshin dëshmitë e vlefshme, ekziston në Kur’an dhe hadithe.

Ato dituri që janë jashtë këtyre, ose janë të qortueshme dhe të pëlqyeshme, që më vonë do të shpjegohen si **risi** (bidat) ose **mashtime** (myshagabe), të cilat përdoren për prishjen e një medh’hebi me një medh’heb tjetër, ndërrimin e fjalëve, dhe që sjellin çrregullime e konfuzion. Natyra e drejtë nuk e do shumicën e tyre, nuk do të dëgjojë llomotitje. E një pjesë bile janë gjëra që nuk kanë lidhje me fe. Në kohën e as’habëve dhe tabi’inëve nuk kishte asgjë nga kjo. Të merresh me këto ishte tërësisht bidat. Por, tani u ndërrua qëndrimi, sepse u shumuan bidatet dhe po pengojnë vendimet e nevojshme nga Kur’ani dhe hadithi. Duke shkruar vepra që nxisin dyshime, u shfaqën xhematet të shumta. Për t’u larguar nga këto bidate dhe mashtime, domosdo është lejuar kelami.

Bile, me kusht që mos të tejkalojë kufirin, është lejuar të mësohet dituria e kelamit aq sa është e nevojshme për të heshtur orvatjet të bidatxhinjve që hutojnë njerëzit, dhe kelami është hyrë në mes të diturive që janë fardh-i kifaje. Shkallën e kësaj, do të shpegojmë në kapitullin e ardhshëm, inshallah.

Sa i përket filozofisë, meqë ajo nuk është dituri e pavarur, ajo del në shesh nga katër pjesë:

1) Është **hendes** (gjeometri) dhe **hisab** (aritmetikë). Nga këto dituri ndalohen vetëm ata që, duke shkuar në ekstreme kalojnë në dituri të papëlqyshme, sepse disa nga ata që mirren me këto dituri kanë devijuar në bidate. Për këtë arsye duhet të mbrohen nga këto dituri ata që janë të dobët në besim, si fëmiu që shëtit buzë lumit e që duhet të mbrohet që të mos bjerë në lum, ose si fillestarët (pa përvojë) që kanë hyrë në islam nga provokimet e pabesimtarëve (qafirëve).

2) Është **logjikë**. Në këtë dituri flitet për dëshmitë me shpjegim dhe për kushtet e tyre, e që është brenda diturisë së kelamit.

3) Është **ilahijat** (teologji). Flet për Qenien (Dhat) e Allahut Teala, cilësitë (Sifat) e Tij dhe punën (Ef'al) e Tij që është brenda diturisë së kelamit. Sepse filozofia në këtë çështje nuk është ndarë nga kelamistët si një dituri tjetër. Ndoshta, disa ndarje janë në pikëpamje të kufrit dhe bidatit. Sikur mu'tezile (**i'tizâl**) që nuk është dituri e pavarur, por u ndanë nga kelami për shkak të besimit pa parim themelor, ani pse ishin anëtarë të kelamit, edhe filozofët kështu janë ndarë nga kelamisët.

4) Është **tabi'ijjat** (fizikë). Disa nga këto janë gjëra të kota që nuk i përshtaten fesë së vërtetë dhe kuptimit të shariatit. Ato nuk janë dituri dhe nuk llogariten si pjesë të diturisë. Disa

flasin për veçoritë, cilësitë dhe ndryshimet e materies, që në një mënyrë është e ngjajshme me mjekësinë; dallimi është që mjeku kujdeset për sëmundjen dhe shëndetin e trupit të njeriut, ndërsa fizikantët përcjellin ndryshimet dhe lëvizjet e tërë materies. Por, mjekësia është mbi fizikën, sepse nevoja për mjekësi është e domosdoshme, ndërsa për fizikë nuk është.

Nga ky shpjegim është kuptuar që edhe dituria e kelamit është bërë dituri farz-i kifaje për të mbrojtur zemrat nga mashtrimet, njerëzit e rëndomtë nga bidatxhinjtë. Domethënë, dituria e kelamit ka lindur me qëllim të nxjerrjes në pah të bidatit. Si vendosja në rrugën e haxhit e rojtarëve për të mbrojtur haxhinjtë nga dhuna dhe hajdutëria e arabëve. Nëse arabët do të braktisin këtë ves të keq, nuk do të kishte nevojë për mbrojtjen e haxhinjëve. Njëjtë edhe bidatqinjët - nëse braktisin fjalët boshe, nuk do të kishte nevojë për diturinë e kelamit, si në kohën e as'habëve; pra, kur njerëzit mbështeteshin në Kur'an dhe hadithe, nuk kishte nevojë për diturinë e kelamit.

Kelamisti duhet ta dijë që vendi i tij në fe është si mbrojtësi i haxhinjëve në rrugë. Nëse ky rojtar merret vetëm me ruajtje e nuk hyn në rrugë (obligimet) e haxhit, ai nuk do të llogaritet prej haxhinjëve; edhe kelamisti - nëse mirret vetëm me diskutim dhe mbrojtje, përderisa nuk hyn në rrugë të ahiretit dhe përderisa nuk përmirëson zemrën, kurrësi nuk mund të ketë vend në mesin e dijetarëve. Vendi i kelamistëve në fe është i njëjtë si besimi i shtresës së rëndomtë (avam). E kjo ka të bëjë me veprimet e jashtme (zahir), me gjuhën dhe zemrën. Dallimi nga shtresa e rendomtë është vetëm në përpjekje dhe në mbrojtje me dituri. Por, njohjet për Qenien (Dhat) e Allahut Teala, cilësitë (sifat) dhe punën (ef'al) e Tij që

i shpjeguar në diturinë mukashefe, nuk përfitohen përmes diturisë së kelamit. Ndoshta ekziston frika që dituria e kelamit bëhet pengesë për dituritë mukashefe. Posedimi i këtyre diturive (diturive mukashefe), është i mundshëm me luftë (*muxhâhede*) dhe me udhëzimin e Allahut Teala. Ndërsa në ajet është thënë:

**“Ata që luftojnë për çështjen Tonë, sigurisht, Ne do t’i udhëzojmë drejtë udhëve Tona. Vërtetë, Allahu është me punëmirët.”** 29-Ankebutë: 69

*Nëse thua: “A është e drejtë që me këtë shpjegimin tënd të ulen në nivelin e rojtarëve që ruajnë nga hajdutëria e arabëve, kelamistëve që mbrojnë besimin e njerëzve të rëndomtë (avam) nga dyshimet e bidatxhiut? Dhe ua ulë gradën fakihëve në mbrojtës të ligjit të sulltanëve që ruajnë të shtypurin (mazllum) nga tirani (zalim). Këto dy grada, në krahasim me diturinë e fesë janë grada shumë të ulta. Ndërsa fakihët dhe kelamistët janë dijetarë me vlera të larta që kanë përfituar reputacion në këtë ummet. Dhe janë krijesat më të vlefshme tek Allahu Teala. A është e drejtë ulja e tyre në grada më të ulta në lidhje me dituritë e fesë?”*

Dije se, ai që kërkon hakikatin të njerëzit, humbet në shkretëtirë. Nëse je udhëtar i hakikatit, njëje Hakkun që të njohësh zotëruesin e hakikatit. Nëse shikon vetëm reputacionin, gradat e vlefshme që ekzistojnë mes njerëzve, dhe me këtë mjaftohesh, mos harro as’habët dhe gradat e tyre të larta! Edhe këta persona që ne i përmendëm kanë pranuar unanimisht pozitën e lartë të as’habëve. Lëri gradat e as’habëve, se as të pluhuri i këmbëve të tyre nuk arrihet! Sipas kësaj, vlerat e larta të as’habëve nuk janë me kelam dhe fikih, por janë me dituri që tregojnë rrugën e ahiretit. Si

dëshmia e Resulallahut s.a.v.s., që vlera e lartë (fazilet) e Hazreti Ebu Bekrit r.a., nuk është në falje të shumtë të namazit, në shumë agjërim, në shumë fetva ose në kelam, por është në vendosjen në zemër të një sekreti (*sirr*). Edhe ti merrë këtë *sirr*. Sepse kjo është ajo që vlenë, është esencë e vlefshme. Largohu prej personave të cilët njerëzit i respektojnë, duke u mashtruar me dukje dhe me shpjegime të hollësishme për ndonjë temë. Resulallahu s.a.v.s., para se të ndërrojë jetë, ka lavdëruar me mijëra as’habë që njohën Allahun Teala. Kurse asnjëri prej tyre nuk e ka njohur mjeshtërinë e kelamit, dhe nuk janë më shumë se dhjetë prej tyre që kanë dhënë fetva.

Abdullah b. Omeri r.a., është njëri nga tyre. Kur kërkohej fetva prej tij, ai thoshte:

- *Shko dhe vendosja në qafë këtë sultanit që ka marrë përgjegjësinë për udhëzimin e njerëzve.*

Duke thënë kështu, ka treguar që puna e fetvasë u takon guvernatorëve dhe sultanëve.

Kur ndërroi jetë Hazreti Omeri r.a., Abdullah b. Mesudi, tha:

- *Shkuan nëntë nga dhjetë pjesë të diturisë. Në këtë, i thanë:*

- *Përse flet kështu kur në mesin tonë ka ende as’habë të mëdhenj?* Abdullah b. Mesudi u përgjigj:

- *Nuk po flas për diturinë e fetvasë (dhe vendimit), por për njohuritë hyjnore (ma’rifet-i ilahijje).*

E sheh, ai nuk ka biseduar fare për kelamin dhe grindjet. E çfarë ke ti që nuk dëshiron të mësosh ‘nëntë nga dhjetë’ pjesë të diturisë që shkuan me vdekjen e hazreti Omerit r.a.? Ndërsa Omeri r.a., ka mbyllur derën e kelamit dhe grindjes. Omeri r.a., ka ndaluar mospajtimin, prandaj e rrahu me

kërbaç dhe e internoi nga Medina Dabiun për shkak që ky e pyeti për ajetet që janë anuluar.

E për thënien *'Fakihët dhe kelamistët janë dijetarë të famshëm'*, dije se, janë dy gjëra të ndara të jesh tek Allahu me vlera të larta (fazilet) dhe të jesh i famshëm mes njerëzve. Shembull: fama e hazreti Ebu Bekrit r.a., në mesin e njerëzve është me halifetin e tij, kurse fazileti i tij është me vendosjen në zemër të sekretit (sirr) dhe me rritjen e këtij sekreti. Fama e hazreti Omerit r.a., mes njerëzve është me drejtësinë e tij, e fazileti i tij është me njohjen e Allahut; fakti që nëntë nga dhjetë pjesë të diturisë shkoi së bashku me Omerin r.a., nën kryesinë (udhëheqjen) e tij është sjellur me drejtësi dhe dashamirësi ndaj njerëzve, ka kërkuar vetëm rizanë e Allahut Teala. E kjo ishte një sirr i fshehtë brenda tij.

E kur bëhet fjalë për gjëra të tjera të dukshme, këtu bëhet fjalë për ata që dëshirojnë të përfitojnë famë dhe nam, e kjo mund të shihet kur ata bëjnë demonstrim për të përfituar pozitë. Prandaj, fama është e rrezikshme, ndërsa fazileti është fshehtësia që askush përveç Allahut Teala nuk mund ta di. Fakihët dhe kelamistët janë si halifet, kaditë dhe dijetarët e tjerë. Këta janë ndarë në disa grupe. Një grup, duke mos kërkuar demonstrim, me dituri dhe fetva dëshirojnë përshtatje sunnetit të Resulallahut s.a.v.s., dhe rizanë e Allahut Teala. Me këta Allahu Teala është razi (i kënaqur). E fazileti i tyre është në atë që kanë vepruar me dituri dhe kanë kërkuar rizanë e Allahut Teala me fetvanë e tyre. Çdo dituri është veprim, sepse me dituri përfitohet vepra bazuar në atë dituri. Por, çdo veprim nuk është dituri. Bile, edhe mjeku përmes diturisë së tij i afrohet Allahut dhe në saje të kësaj fiton sevap; kjo afërsi nuk është me dituri të fesë, por është me synimin për ta fituar rizanë e Allahut me

veprimin e ditorisë së profesionit të vet. Edhe sultani që për rizanë e Allahut angazhohet për ta qeverisur popullin, e arrinë rizanë e Allahut dhe fiton sevap. Kjo nuk është nga fakti që ai e merr këtë përgjegjësi sepse ka dituri të fesë, por për shkak që ai vepron në pajtim me diturinë që ka, për ta fituar rizanë e Allahut.

Për afrim Allahut Teala ekzistojnë tri rrugë:

1. Vetëm me dituri. Kjo është dituria mukashefe.
2. Vetëm me vepra. Kjo është qeverisja e popullit me drejtësi nga sultani.
3. Me dituri dhe me vepra. E ky është veprimi i bazuar në njohurinë për ditoritë e ahiretit. Sepse zotëruesi i kësaj është edhe dijetar edhe veprues.

Mendo se në cilin grup do të jesh ti në ditën e kiametit! A do të jesh në mesin e zotëruesëve të ditorisë mukashefe që janë alimi-bi'llah, apo mes atyre që veprojnë për Allahun, apo me të dytë? Mundohu që të përfitosh prej dy grupeve, sepse kjo është më e rëndësishme se sa të marrësh famë nga imitimi (*taklit*) i thatë.

Ndërsa poeti thotë:

***Njeriu të mirën le ta merrë,  
nga thashethëmet veten ta largojë,  
kur Dielli vet shkëlqen,  
nga Saturni çfarë mund të kërkojë?***

Tani do të të tregojmë ahlakun/virtytshmërinë e fakihëve (imamëve) nga koha e shkuar, do ta kuptosh se si u kanë bërë zullum këtyre imamëve ata që kanë imituar medh'hebet e tyre, dhe do të kuptosh se si ata do të bëhen armiq të më të mëdhenjë në ditën e kiametit.

Sepse ata imamë, me diturinë e tyre kanë synuar vetëm rizanë e Allahut Teala. Siç do ta shpjegojmë në kapitullin për shenjat e dijetarëve të ahiretit, nga gjendjet e tyre është e qartë që ata ishin dijetarë të ahiretit (botës së përtejme). Ata nuk ishin vetëm dijetarë të fikhut, ata janë marrë edhe me diturinë e zemrës, me përmirësimin dhe kontrollimin e saj. Por, ajo që i pengoi as’habët për të shkruar vepra në lidhje me fikhun, ani pse secili prej tyre ishte fakih, është bërë pengesë edhe për imamët për të shkruar vepra në lidhje me zemrën. Meqenëse këto pengesa janë të njohura, nuk ka nevojë të shpjegohen.

Tani do të shpjegojmë gjendjet e fakihëve të islamit. Por, siç do të kuptohet nga fjalët tona, synimi ynë nuk është të qortojmë, por të shpjegojmë gjendjen e atyre që në dukje imitojnë medh’hebin e tyre, e me veprim dhe ahlak e kundërshtojnë.

Fakihët që janë bërë kryesues në diturinë e fikhut e që kanë shumë pasues, dijetarë të medh’hebeve, janë pesë, e këta janë **Shafiu, Malikiu, Ahmed b. Hanbel, Ebu Hanife dhe Sufjani Sevri** (Allahu qoftë i kënaqur me ta). Secili prej tyre ishte abid, zahid, dijetar i ahiretit dhe dijetar i fikhut (për të cilët kanë nevojë njerëzit në këtë botë – në dynja). Ata me këtë dituri të fikhut, kanë kërkuar vetëm rizanë e Allahut Teala.

Fakihët e ditëve të sotme, nga këto katër veti, i përshtaten vetëm fikhut, duke u fokusuar në hollësira. Sipas tyre, vetitë tjera vlejnë vetëm për ahiret, ndërsa fikhu vlen edhe për këtë botë (dynja) edhe për ahiret. Por, nëse me një dituri synohet ahireti, atëherë pakësohet dobia që i takon kësaj bote. Pra, nga këto katër veti fakihët e sotëm mirren vetëm me hollësitat e fikhut dhe deklarojnë që janë të

ngjajshëm si imamët e mëdhenjë! Ku janë Imamët e ku këta dijetarë? Ja dallimi mes tyre.

Dituria në fikh e këtyre imamëve është krejtësisht e ditur, kurse ne do të shpegojmë shenjat e gjendjeve të tyre lidhur me tri vetitë tjera.

## IMAM SHAFI

Allahu qoftë i kënaqur me të

Shembull i devotshmërisë së tij: transmetohet se natën e ndante në tri pjesë: një për mësim, një për ibadet, një për gjumë. Rebiu tregon:

*- Imam Shafi'u do të lexonte Kur'anin gjashtëdhjetë herë gjatë namazeve në muajin e Ramazanit."*

Buvejti ishte nxënësi i Shafiut, e duke iu përshtatur mësuesit të tij, edhe ai për çdo ditë në Ramazan do të lexonte komplet Kur'anin.

Hasan el-Kerabisi thotë:

*- I kam kaluar disa netë me Shafiun. Rreth një të tretën e natës do ta kalonte në namaz, e nuk mendoj të ketë kënduar më shumë se pesëdhjetë ajete, më së shumti njëqind. Sa herë të arrinte te ajetet ku përmendet mëshira e Allahut, do të luste Allahun për vete dhe për të gjithë myslimanët. E sa herë të arrinte te ajetet ku përmendet dënimi i Allahut, do të lutej te Ai për shpëtim, për vete dhe për të gjithë myslimanët. Duket sikur te ai kanë qenë prezent, së bashku, edhe shpresa (rexha) edhe frika (havf).*

Dëgjo, kufizimi i këndimit në pesëdhjetë ajete tregon njohjen e Kur'anit nga ana e tij në detaje, dhe zhytjen e thellë në to. Imam Shafiu thoshte:

*- Nuk jam ngopur që kur i kisha gjashtëmbëdhjetë vjet, sepse ngopja rëndon trupin, forcon zemrën, mbrapsë mendjemprehtësinë, tërheq gjumin dhe dobëson personin në ibadete.” Shiko urtësinë e tij për dëmin që sjellë të ngopurit, pastaj dëshirën e këmbënguljen e tij në ibadet. Prandaj është thënë: “Koka e ibadetit është në të ushqyerit e pakët.”*

Gjithashtu ka thënë: *“Kurrë nuk jam betuar në Emër të Allahut Teala, as drejtë e as rrejshëm.”* Kjo është dëshmi e nderimit dhe njohjes së madhështisë dhe fuqisë së Allahut Teala nga ana e tij.

E pyetën Imam Shafiun për një problem. Ai heshti. I thanë: *“Përse heshte, a nuk do të përgjigjesh?”* Ai tha: *“E preferova heshtjen derisa ta kuptoj a është fazileti (vlera e lartë) në heshtje apo në përgjigje.”* Vetëm shiko se si ka qenë i kujdesshëm për gjuhën e vet, e ky është organi që fakihët më së vështiri e kontrollojnë, e zптоjnë dhe e ndalojnë. Nga kjo kuptohet që edhe heshtja edhe të folurit e Imam Shafiut ishte vetëm për të fituar sevap.

Ahmed ibn Jahja ibn el-Veziri transmeton:

*“Ishim duke shëtitur me Imam Shafiun në tregun e Kandilit (Egjipt). Aty ishte njëri që po i drejtonte fjalë të shëmtuara një dijetari. Imam Shafiu u kthye kah ne dhe tha: ‘Ruani veshët nga dëgjimi i fjalëve të shëmtuara ashtu siç e ruani gjuhën, sepse ai që dëgjon është i njëjtë me atë që flet. Njeriu i keq dëshiron të fusë në zemrat tuaja gjëra të këqija të brendësisë së vet. Ata që dëgjojnë fjalët e njeriut të keq bëhen gjynahqarë, ata që i nuk dëgjojnë dhe i kundërshtojnë - arrijnë në lumturi.”*

Imam Shafiu ka treguar:

*“Një dijetar i shkroi letër një dijetari tjetër: ‘Të është dhënë dije, prandaj mos e përlyej dijen tënde me terrin e gjynahut sepse do të mbetesh në terr, në ditën kur dijetarët do të shndërrisnin me dritën e dijes së tyre’.”*

Imam Shafiu ka thënë:

*- Kush thotë që ka në zemër dashuri edhe për këtë dynja edhe për Krijuesin, gënjen (sepse dy dashuri në një zemër nuk është e mundur).*

Humejdi transmeton:

*“Imam Shafiu me disa njerëz shkoi në Jemen e prej aty u drejtua për në Meke me dhjetë mijë dërhëmë. E ngriten një tendë për të, në dalje të Mekës, dhe njerëzit filluan ta vizitojnë. Imam Shafiu nuk u largua nga tenda derisa i shpërndau të gjitha paratë që i kishte.”*

Në një rast, duke dalë nga hamami (banjë popullore), Imam Shafiu i jep kujdestarit të hamamit shuma të mëdha parash. Në një rast tjetër, i bie shkopi nga dora, e kur dikush ia afroi, imam Shafiu i dha si shpërblim pesëdhjetë dinarë.

Të gjitha këto tregojnë bujarinë e Imam Shafiut, e ka edhe më shumë ngjarje që mund të tregohen, e bujaria është kulmi i zuhd-it<sup>71</sup>. Dikush që do diçka – atë edhe e ruan;

---

<sup>71</sup> **Zuhd:** mos të ketë dëshira për këtë botë; zuhd nuk është të braktisurit fizik të kësaj bote, por të braktisurit e kësaj bote me zemër; zuhd i vërtetë është që, duke iu mbështetur Allahut Teala, zemra dhe dora të largohen nga pasuritë e njerëzve; zuhd nuk është lidhja e zemrës me gjëra, por është mbështetja Allahut Teala dhe të besuarit vetëm Atij; zuhd është që zemra të mos lidhet për asgjë tjetër pos Allahut Teala, të besohet dhe të bëhet lidhja me Allahun, e jo me pasuri.

pasurinë e ndanë vetëm ai të cilit dynjaja i duket e pavlefshme. Ky edhe është kuptimi i zuhd-it.

Dëshmia e fuqisë së zuhdit së Imam Shafiut, frika e tij e madhe nga dënimi i Allahut dhe që i gjithë mundimi i tij ishte ahireti, bëhet e qartë nga ky transmetim: Një ditë Sufjan ibn Ujejne fliste për hollësitë e njohjes, në çka Imam Shafiu alivanoset, e të pranishmit thanë:

- *Vdiq! Ibn Ujejne tha:*

- *Nëse ka vdekur, ka vdekur njeriu me vlerat më të larta të kësaj kohe.*

Abdullah ibn Muhammed el-Belevi tregon:

- *Omer ibn Nubata dhe unë flisnim për të devotshmit dhe zahidët, e Omeri më tha:*

- *Nuk kam parë më të përmbajtur, por edhe më gojëmbël se Muhammed ibn Idris Shafiu, Allahu pastë rahmet mbi të.*

*E një ditë tjetër, shkuam unë, Shafiu dhe Haris Lebidi në Safa. Harisi ishte nxënës i Salih el-Murriut, dhe filloi të këndojë Kur'an – kishte zë të mrekullueshëm. Këndoi ajetin:*

***“Kjo është një ditë, kur ata nuk do të mund të flasin,***

***Dhe nuk do t'u jepet leje për t'u shfajësuar.”***

77-Murselat: 35, 36

*dhe unë e pashë Imam Shafiun, i ndërroi ngjyra e fytyrës, lëkura iu rrëqeth, e trupi iu dridh fuqishëm dhe ra i alivanosur, e kur erdh në vete, tha: ‘Ej Rabbi im, tek Ti kërkoj strehim nga gënjeshtari dhe gafili. Zemrat e atyre që përjetojnë të Vërtetën (arif) Ty të binden, e kokat e atyre që të duan, Ty të përkulen, më dhuro nga Mirësia Jote, mbuloi mangësitë e mia dhe m'i fal gabimet.’*

*Më pas ai mori rrugë, dhe u ndamë. Kur unë shkova në Bagdad, e dija që në atë kohë Imam Shafiu ishte në Irak. Një ditë u ula në breg të lumit (Tigër) për abdes, e pranë meje kaloi një njeri dhe më tha:*

*- Djalosh, zbukuroje abdesin tënd, e Allahu do të zbukurojë ty, në dynja dhe ahiret. U ktheva, dhe pashë një njeri të cilit disa tjerë i shkonin pas. U nguta në abdes dhe i shkova pas edhe unë. Ai u kthye kah unë dhe më pyeti:*

*- A të duhet gjë?*

*- Po, i thashë.*

*- Më mëso diçka prej asaj që Allahu të ka mësuar ty. Më tha:*

*- Dije që, ai që beson me të vërtetë Allahun, ka fituar. Kush ka iman, ka shpëtuar nga shkatërrimi. Kush druhet në këtë botë, e bëhet zahid, nesër do ti gëzohen sytë me shpërblime nga Allahu Teala. A dëshiron ende?*

*- Dua, i thashë.*

*- Kush posedon tri veti, ai ka plotësuar imanin e vet: ai që urdhëron të mirën por edhe vet e bën të mirën, ai që urdhëron largimin prej të keqes por edhe vet largohet prej të keqes, dhe ai që nuk i kalon kufijtë e Allahut. A do ende?*

*- Natyrisht!*

*-Ktheja fytyrën kësaj dynjasë, drejtohu ahiretit, vetëm Allahut mbështetju për çdo gjë – do të jesh i shpëtuar. Pas kësaj vazhdoi të ecë. Unë nuk e njoha dhe pyeta:*

*- Kush është ky?*

*- Është Shafiu, më thanë.*

*Vetëm shiko se si, fillimisht ra përtokë duke u alivanosur, e më pas shpalosë në këshillën e tij zuhdin dhe*

frikë-respektin e jashtëzakonshëm! Frikë nga dënimi i Allahut dhe zuhd të tillë arrin vetëm ai që e ka njohur Allahun Teala.

**“...Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët...”** 35-Fatir: 28

Imam Shafiu nuk e fitoi këtë frikë e as këtë zuhd nga librat me rrymë filozofike, ose librat për tregti, ose librat tjerë të fikhut. Jo, kjo është fryt i diturisë së ahiretit të cilat rrjedhin nga Kur’ani dhe sunneti, sepse të gjitha çështjet janë në Kur’an, dhe në të bazohen edhe dituritë e vjetra edhe këto të fundit.

Sa i përket njohurive të Imam Shafiut për fshehtësitë e zemrës dhe për dituritë e ahiretit, kjo kuptohet me lehtësi nga fjalët e urta që transmetohen nga ai. Imam Shafiu është pyetur për dyfyrësi (rija), në çka menjëherë përgjigjet: *“Rija është intrigë që ngulë dëshirën para syrit të zemrës së dijetarit. Nëse dijetari i nënshtrohet dëshirave të veta (nefs), veprat e tij shkatërrohen.”*

Imam Shafiu thotë:

*- Nëse ke frikë nga vetëpëlqimi (uxhb) në veprat tua, mendo – kënaqësinë e kujt je duke kërkuar? Nga kush po pret sevap? Nga dënimi i kujt po frikësohesh? Për mëshirën e kujt po falënderohesh? Gjykimin e kujt po e mendon? Nëse mendon vetëm për njërin nga këto, pëlqimi i veprës tënde në sytë e tu do të zvogëlohet.*

Shiko se si i përmend të vërtetat e dyfyrësisë dhe ilaçin për vetëpëlqim – sëmundje këto të zemrës, nga më të këqijat.

Imam Shafiu ka thënë:

- *Kush nuk e ruan veten, veprimi i tij nuk jep dobi.*

Dhe ka thënë:

-*Kush i nënshtrohet Allahut (në mënyrë) të vetëdijshme, e fshehta (sër) e tij zgjohet. (Pra, ndjenë kënaqësi shpirtërore në veprim-ibadet).*

Gjithashtu ka thënë:

- *Secili ka mik dhe armik. Atëherë bëhu nga ata që i nënshtrohen sheriatit. (pra, për lumturinë e mikut dhe për poshtërimin e armikut)*

Tregohet se Abdul-Kahir ibn Abdul-Aziz ka qenë një njeri i mirë dhe i vetëpërmbajtur. E kishte bërë zakon të pyeste Imam Shafiun për vetëpërmbajtjen, e Imam Shafiu gjithmonë i përgjigjej me kujdes, pikërisht për shkak të vetëpërmbajtjes së vet.

Një herë, Imam Shafiu është pyetur:

- *Cila gradë e ka vlerën më të lartë – durimi (sabr), prova (mihna) apo kompetenca (temkin)?*, e Imam Shafiu tha:

- *Fuqizimi është gradë e Pejgamberëve, e ajo vjen vetëm pas sprovës. Kur një Pejgamber do të sprovohej, ai do të bënte sabër, e kur të bënte sabër do të bëhëj kompetent (autoritet). A nuk e di ti që Allahu Teala e ka sprovuar Ibrahimin a.s., e më pas i ka dhënë autoritet? E ka sprovuar edhe Musanë a.s., e më pas e ka fuqizuar. Është sprovuar Ejubi a.s., e më pas është fuqizuar. Është sprovuar edhe Sylejmani a.s., e më pas i është dhënë mbretëria. Fuqizimi ka vlerën më të lartë. Allahu Teala thotë:*

**“E fuqizuam Jusufin në Tokë.”** 12-Jusuf: 56

Ejubi a.s., pas një sprove të madhe, u fuqizua, siç tregon Allahu:

**“...ia kthjem familjen të dyfishuar në numër...”**

21-Enbija: 84

Ky shpjegim i Imam Shafiut tregon hyrjen e tij të thellë në të fshehtat e Kur'anit, dhe njohjen e gradave të Pejgamberëve dhe evlijave. Të gjitha këto janë dituri të ahiretit.

E pyetën Imam Shafiun, Allahu e mëshiroftë:

- *Kur mund të bëhët njeriu dijetar?* Imam Shafiu u përgjigj:

- *Kur të zhytet në dituri fetare, t'i mësojë dhe kuptojë ato, e pastaj mëson dituritë tjera për të plotësuar mangësitë.*

E kanë pyetur mjekun grek, Galinus:

-*Përse për një sëmundje jep disa ilaçe përnjëherë?* Ai u përgjigj:

- *Në të vertetë, ilaçi i sëmundjes është një, por përzierja e tij me ilaçe tjera bëhet për të pakësuar dëmin e ilaçit. Sepse fuqia e një ilaçi nganjëherë mund të vrasë. Por ilaçet tjera e pakësojnë fuqinë e tij dhe mbetet vetëm cilësia e shërimit.*

Njëjtë, dituria vetëm nga një këndvështrim mund ta dërgojë njeriun në ekstremizëm; por me përzierjen e diturive tjera (me këtë dituri), njeriu kthehet në vetëpërmbajtje. Ja, këta, dhe shembuj tjerë të panumërt tregojnë për shkallë të lartë të njohjes që Imam Shafiu ka për Allahun Teala, dhe për dituritë e ahiretit.

Qëllimi i angazhimit të Imam Shafiut në fikh dhe diskutimet përbrenda fikhut, është vetëm rizaja e Allahut, e pët këtë dëshmon qartë ky transmetim: kur ishte sëmure Shafiu, u vizitua nga Rebiu, dhe Shafiu i tha:

*- Qëllimi im është që njerëzit të përfitojnë nga kjo dituri, e të mos më përshkruajnë asgjë nga kjo.*

Vetëm shiko se si e njeh shkatërrimin e kërkimit të diturisë për famë, dhe si e largon zemrën nga këto dëshira duke pasur nijetin e pastër – vetëm për rizanë e Allahut Teala.

Imam Shafiu ka thënë:

*- Kurrë nuk kam diskutuar me dikë, e të mos kem dashur që ai të ketë të drejtë. Kurrë nuk kam folur me dikë e të mos kem dashur që ai të jetë i udhëzuar, i shpërblyer dhe i ndihmuar, që Allahu ta sigurojë dhe ruaj. Kurrë nuk kam biseduar me dikë e të mos më ketë interesuar nëse Allahu Teala do të shfaqte të vërtetën përmes fjalëve të mia apo të tij. Kurrë nuk ia kam shprehur të vërtetën dhe dëshmitë dikujt, e të mos e kem respektuar dhe të kem besuar në qëllimin e mirë të tij. Kurrë nuk ka ndodhur që dikush të kundërshtojë me kokëfortësi të vërtetën dhe dëshmitë e unë të mos e vërej dhe refuzoj.*

Këto janë dëshmi që Imam Shafiu ka dëshiruar vetëm rizanë e Allahut, në të gjitha angazhimet e tij në fikh dhe në diskutimet rreth rregullave.

Dhe shih se si njerëzit nuk e pasojnë në të gjitha pesë vetitë të tij, por vetëm në njërën nga to – në fikh. E, edhe në këtë i kundërvihen. Prandaj Ebu Sevr ka thënë:

*- Kurrë nuk kam parë, as unë as dikush tjetër, dikë si Shafiu.*

Ahmed ibn Hanbel ka thënë:

*- Ka katërdhjetë vite që, sa herë fali namaz e lus Allahun Teala për Shafiun, Allahu e mëshiroftë.*

Shih se kush lutet për të, dhe gradën e atij për të cilin bëhet lutja, e më pas me të krahaso bashkëkohësit tu dhe dijetarët e ditëve të sotme, shiko lakminë e tyre të forcuar me koprraci dhe urrejtjen e tyre, që të kuptosh mangësitë e tyre në pasimin e këtij kolosi. Për shkak të lutjeve të shpeshta për Shafiun, i biri i Hanbeliut, e pyeti të atin:

*- Çfarë ishte Shafiu, kur kaq shumë lutje bën për të?*  
Imam Ahmedi u përgjigj:

*- Biri im, Shafiu, Allahu e mëshiroftë, ishte sikur Dielli për dynjanë dhe sikur shëndeti për njerëzit. E çka mund të zëvendësojë këto dyja?!*

Imam Ahmedi, Allahu e mëshiroftë, do të thoshte:

*- Çdokush që e prek penën, duhet t'i shprehë mirënjohje Imam Shafiut.*

Jahja ibn Seid el-Katan ka thënë:

*- Për katërdhjetë vite, sa herë që fal namazin, lutem për Shafiun, të cilit Allahu Teala ia hapi njohuritë dhe e udhëzoi në rrugë të drejtë.*

Do të kufizohemi në këto citate nga gjendjet e Imam Shafiut, dhe kjo mjafton. Shumicën e këtyre dëshmime i kemi gjetur në veprën “*Menakibët e Shafiut*” të shkruar nga Shejh Naser ibn Ibrahim el-Makdisi, Allahu e mëshiroftë, atë dhe të gjithë myslimanët.

## IMAM MALIK

Allahu qoftë i kënaqur me të

Edhe ai ishte i zbukuruar me pesë vetitë e përmendura.  
E kishin pyetur:

- *Çka thua ti për kërkimin e diturisë? U përgjigj:*
- *Shumë mirë. Vetëm se kërko atë që gjithsesi të duhet, që nga momenti kur i hapë sytë e deri në vdekje, dhe këtë ta bësh prioritet.*

Kishte respekt aq të madh për dijen sa që, kur donte të fliste për një hadith, së pari merrte abdes, pastaj ulej në divan, rregullonte mjekrën, parfumohej, qetësohej, koncentrohej, mbulohej me frikë-respekt, dhe vetëm atëherë do të tregonte hadithin. Dikush e pyeti për këtë, e ai tha: *“Për të shprehur respekt ndaj të folurit të Resulallahut s.a.v.s..”*

Imam Maliku ka thënë:

- *Dituria është dritë, Allahu e dhuron atë si të dojë, e ajo nuk varet nga numri i transmetimeve të hadithit.*

Ky tregim i respektit dhe vëmendjes së tij ndaj diturisë është dëshmi e njohjes së tij për madhërinë e Allahut Teala.

E dëshirën e tij për të arritur kënaqësinë (rizanë) e Allahut na e tregojnë vetë fjalët e tij:

- *Diskutimi për fetë nuk vlen gjë.*
- Këto fjalë të Imam Shafiut tregojnë virtytet e tij:
- *Isha me Malikun, dhe e pyetën për katërdhjetë e tetë probleme. Për tridhjetë e dy prej tyre tha: ‘nuk di’.*

Ai që me dituri dëshiron diçka tjetër e jo kënaqësinë e Allahut, nuk do t'i lejojë vetes të thotë disa herë *“nuk di.”* Prandaj Imam Shafiu thotë:

*- Kur flasim për ulemanë, Maliku është yll. Askujt s'i kam borxh më shumë se Imam Malikut.*

Transmetohet se Halifeja Ebu Xhafer el-Mensur ia ndaloi Imam Malikut të përmend hadithet që flasin për shkëputjen e dhunshme e të njëanshme të lidhjes martesore (talakul-mukrih), e më pas tinëz ia dërgoi dikë të pyes mu për këtë çështje. Imam Maliku, para një grupi njerëzish tha:

*- Talaku i dhunshëm nuk është i vlefshëm.*

Mensuri e dënoi, por Imam Maliku nuk ndaloi së përmenduri hadithin.

Imam Maliku ka thënë:

*- Nuk ka njeri që ka përcjellë besueshëm një hadith, e ta ketë goditur ndonjë sëmundje mendore apo të ketë qenë i hutuar.*

E sa i përket zuhdit të tij, transmetohet se Emiru'l-mu'minin Mehdiu e kishte pyetur:

*- A ke shtëpi?, e Imam Maliku ishte përgjigjur: “Nuk kam, por po të tregoj diçka – E kam dëgjuar Rebi ibn Ebu Abdurrahmanin të thotë:*

*- Shtëpi e njeriut është prejardhja e tij.*

Harunu'r Reshid e kishte pyetur:

*- A ke shtëpi?”, e Maliku i tregoi që nuk ka. Harunu'r Reshid i dha tremijë dinarë dhe i tha:*

*- Blej një shtëpi për vete. Imam Maliku i mori paratë por nuk bleu e as ndërtoi shtëpi.*

Kur Reshidi deshi të kthehet nga Hixhazi në Irak, i tha Imam Malikut:

- *Duhet të vish me ne, kam vendosur që njerëzit t'i urdhëroj të lexojnë veprën tënde 'Muvatta' (libri i haditheve) ashtu si hazreti Osmani r.a., i ka urdhëruar të pasojnë Kur'anin.* Imam Malik u përgjigj:

*"Nuk është e mundur që njerëzit të lexojnë librin Muvatta, sepse pas vdekjes së Resulallahut s.a.v.s. as'habët u shpërndanë në qytete të ndryshme dhe tregonin hadithet, kështu që secili banor i cilit do qytet e di (ndonjë) hadith. Sepse Resulallahu s.a.v.s. thotë:*

**Mosmarrëveshja e ummetit tim është rahmet<sup>72</sup>,**  
*e as nuk mund të vij me ty, sepse Resulallahu s.a.v.s. thotë:*

**Medina është më e mirë për ta, veç sikur ta dinin<sup>73</sup>,**  
*dhe gjithashtu ka thënë:*

**Medina shkatërron të këqijat ashtu si zjarri me gjyryk që largon ndryshkun.<sup>74</sup>**

*Ja ku janë dinarët e tu; nëse doni – merrni, e nëse doni – lërin. A do të thotë që më duhet të lëshoj Medinën vetëm pse mi dhatë këta dinarë? As për gjithë botën nuk do të kisha lëshuar qytetin e Resulallahut s.a.v.s!*

I tillë ishte zuhdi i Imam Malikut në këtë botë. Kur iu dha një pasuri e madhe mbledhur nga të gjitha anët e botës, për shkak të zgjerimit të diturisë dhe shokëve të tij, ai e shpërndau në bamirësi. Një xhymertllëk (bujari) kaq i madh i tij është dëshmi e qartë e zuhdit dhe mos-dashurisë së tij për këtë botë (dynja). Në esencë zuhdi nuk do të thotë varfëri,

---

<sup>72</sup> Bejheki nga Ibn Abassi.

<sup>73</sup> Buhariu dhe Muslimi nga Sufjan ibn Ebi Zubejr.

<sup>74</sup> Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre.

por mos-dashuri e zemrës për pasurinë. Edhe me gjithë atë pasuri, Sylejmani a.s. ishte zahid.

E për përbuzjen e dynjallëkut nga ana e Imam Malikut na tregon Imam Shafi'u:

*- Pashë para derës së Malikut kuaj nga Horasani dhe mushkë nga Egjipti, kurrë më të bukur nuk kisha parë, dhe i thashë Malikut:*

*- Sa të bukur që janë, më tha:*

*- I ke dhuratë nga unë, Ebu Abdullah', i thashë:*

*- Mbaje së paku një, për vete, e ai ma ktheu:*

*- Turpërohem nga Allahu Teala që me thundrën e ndonjë kafshe të shkel tokën ku gjendet trupi i Resulallahut s.a.v.s.'.*

Shiko bujarinë e tij që shfaqet në atë se si i jep të gjitha përnjëherë Shafiut, dhe se si ecë me këmbë në Medinë e nuk hip në kalë, duke respektuar Resulallaun s.a.v.s.!

Në dëshirën e tij për arritjen e kënaqësisë së Allahut Teala me përbuzjen e dynjallëkut tregon ngjarja të cilën vet ai e tregon:

*- Shkova te Harunu'r Reshidi, e ai më tha:*

*- Ebu Abdullah, duhet të vish më shpesh, që fëmijëve tanë t'u mësohet hadithet nga libri Muvatta. I thashë:*

*- Allahu e lartësoi Pejgamberin tonë. Kjo dituri (hadithi) ka dalë nga ju (nga Kurejshët). Nëse e respektoni – do të jetë e respektuar, e nëse e nënçmoni – do të jetë e nënçmuar. Dituria nuk i shkon askujt, por ne shkojmë te dituria.'Harunu'r Reshidi tha:*

*- Të vërtetën thua. Shkoni fëmijë në xhami dhe dëgjoni (Muvattanë), si të tjerët.*

IMAM EBU HANIFE  
Allahu qoftë i kënaqur me të

Ishte gjithashtu i devotshëm, zahid, kishte frikë nga dënimi i Allahut, dhe dëshironte të arrinte kënaqësinë e Tij.

Sa i përket devotshmërisë së tij, nga Ibn Mubarek transmetohet: *“Ebu Hanife, Allahu e mëshiroftë, ishte zemërgjerë dhe falte shumë namaz natën.”*

Hammad ibn Ebu Sylejmani ka thënë:

- *Imam Ebu Hanife tërë natën ka falë namaz.*

Kjo ishte nga fundi i jetës së tij. Në një transmetim tjetër thuhet se gjysmën e natës falet, e kjo ishte në fillim të jetës së tij.

Një ditë, Ebu Hanife po ecte rrugës, e dikush bëri me gisht kah ai dhe i tha shokut:

- *Ky është ai që gjithë natën bën ibadet.* Pasi dëgjoi këtë, Ebu Hanife filloi që tërë natën të bënte ibadet, duke thënë:

- *Më vije turp nga Allahu Teala të më përshkruajnë një ibadet që nuk e bëj.*

Sa i përket zuhdit të tij, er-Rebi ibn Asim transmeton:

- *Më ftoi Jezid ibn Omer ibn Hubejre (guvernatori i qytetit Kufa) të shkoj te ai me Ebu Hanifen. Dëshironte që Imam Ebu Hanife të jetë drejtues i thesarit të shtetit (Bejtul-mal), por Ebu Hanife refuzoi. Jezidi e dënoi me njëzet goditje.*

E sheh se si refuzoi punën e drejtuesit, e më me dëshirë ka pranuar dënimin!

Hakem ibn Hisham es-Sakafi ka thënë:

*- Tregoja në Sham për Imam Ebu Hanifen, që ishte njëri nga njerëzit më të besueshëm, dhe që sulltani donte që ky t'i merrte çelësat e thesarit të tij ose do ta godiste. Imam Ebu Hanife zgjodhi dënimin e tyre në vend të dënimit të Allahut.*

Transmetohet se Imam Ebu Hanife u përgojua para Ibn Mubarekut, e ky tha:

*- Vallë, ju e përgojoni njeriun të cilit iu dha gjithë dynjallëku, e ai nga kjo iku?!*

Muhammed ibn Shuxha transmeton nga njëri prej miqve të vet që Halifi Ebu Xhafer Mensur donte t'ia dhurojë dhjetëmijë dërhëmë Imam Ebu Hanifes. Por, Ebu Hanife nuk iu gëzua kësaj. Kur erdhi dita për të dorëzuar dhuratën, Ebu Hanife e fali namazin e sabahut, pastaj u mbulua me rroba dhe nuk fliste me askënd. Erdh i dërguari (Hasan ibn Kahtab) me dhuratë, iu afrua Ebu Hanifes e ky nuk i foli. Dikush nga të pranishmit i tha Hasanit që i tillë ishte zakoni i Ebu Hanifes – që të mos flasë, pos ndonjë fjalë aty-këtu. Hasani tha:

*- Lëreni këtë çantë me dhuratë diku në shtëpi.*

Pas kësaj, Imam Ebu Hanife i tha të birit:

*- Kur të vdes dhe të më keni varrosur, këtë çantë t'ia dërgosh Hasan ibn Kahtabit dhe t'i thuash: 'Merr amanetin që ia ke besuar Ebu Hanifes!'*

Djali i Imam Ebu Hanifes tregon: *“Ashtu kam vepruar, e Hasani më tha:*

*- Allahu e mëshiroftë babanë tënd, ishte i përpiktë në besimin e tij.*

Tregohet se Imam Ebu Hanifes i është ofruar të jetë kadi (gjykatës) i Bagdadit, në çka ai është përgjigjur:

*- Nuk jam i denjë për atë punë.*

*- Pse? e pyetën, e ai tha:*

*- Nëse jam i sinqertë në këtë që po them, atëherë vërtetë nuk jam i denjë për atë punë. E nëse gënjej – gënjeshtari nuk është i denjë për të gjykuar.*

Sa i përket njohjes së rrugës së ahiretit dhe besimit nga ana e tij, si edhe njohjes së Allahut Teala, këtë na e dëshmon frika e tij nga Allahu Teala dhe zuhdi i tij në këtë botë. Ibn Xhurejh ka thënë:

*- Më është transmetuar nga banorët të Kufes që Numan ibn Sabiti (Ebu Hanife) shumë i frikësohet Allahut.”*

Sherik Nehai ka thënë:

*- Imam Ebu Hanife shpesh do të heshte, vazhdimisht ishte në mendime, dhe njerëzve u fliste pak.”*

Këto janë disa nga dëshmitë më të qarta të njohjes së brendshme dhe angazhimit në gjërat e rëndësishme të besimit, e kujt i është dhënë heshtja dhe zuhd-i, i është dhënë e gjithë dituria.

Kjo është vetëm një pjesë e përshkrimit të gjendjeve të tre Imamëve të parë.

IMAM AHMED IBN HANBEL DHE SUFJAN ES-SEVRI,  
Allahu qoftë i kënaqur me ta

Numri i pasuesve të tyre është më i vogël se i tre të parëve, e Sufjani ka më pak pasues se Ahmedi. Por, vetëpërmbajtja, largimi nga harami dhe zuhdi i tyre është i njohur. Pjesa më e madhe e këtij libri përmban shumë tregime për veprat dhe thëniet e këtyre të dyve, prandaj nuk ka nevojë këtu të thellohemi në detaje. Ti shiko tre Imamët tjerë dhe mendo për gjendjet, të folurit dhe veprat me të cilat e kanë refuzuar dynjallëkun dhe e kanë dëshiruar vetëm rizanë e Allahut Teala; a janë këto rezultat vetëm i angazhimit të tyre në disciplina të ndryshme të fikhut: si marrëveshjes për pagesë të menjëhershme të mallit të pranuar (selem), qiraja (ixhara), rregullave për lëshimin e gruas pasi që me fjalë e barazon gruan e vet me nënën (zihar), shkurorëzimit në bazë të betimit të bashkëshortit që nuk ka pasur marrëdhënie seksuale me gruan për së paku katër muaj (ila), mallkim (lian), apo janë fryt i ndonjë diturie tjetër, më të lartë dhe më të ndershme? Shikoj dijetarët që pohojnë se pasojnë Imamët e parë të fesë – a nuk gënjejnë kur thonë kështu?

## KAPITULLI I TRETË

### PËR DITURITË QË KONSIDEROHEN SI TË DOBISHME, E NUK JANË

Në këtë kapitull gjenden shpjegimet rreth disa diturive që konsiderohen si të dobishme nga njerëzit e rëndomtë (avam), e që në esencë janë të pa dobishme. Gjithashtu, këtu gjendet shpjegimi se janë të pa dobishme këto dituri dhe shpjegimi si u ndërruan kuptimet e emrave të disa diturive si fikih, hadith, tehvid, teologji dhe vaz, si edhe shpjegimi për atë se sa ka dituri të dobishme e sa të pa dobishme në mesin e diturive të shariatit.

### SHKAKU I QORTIMIT TË DITURIVE TË PA DOBISHME

Ndoshta do të thuash: *“Dituri është njohja e diçkaje në esencën e saj, e që është edhe një nga cilësitë e Allahut Teala, atëherë si mundet të jetë dituria e pa dobishme?”*, dije se, dituria nuk është e pa dobishme në vetvete, por bëhet e pa dobishme për njerëzit, nga njëri prej tri sebepeve:

1. Bëhet e pa dobishme kur e dëmton zotëruesin e saj ose dikë tjetër, siç është dituria e magjisë (*sihr*). Magjia është e vërtetë sepse Kur’ani dëshmon që përmes magjisë mund të ndahen burri e gruaja. Bile edhe Resulallahut s.a.v.s., i është bërë magji, dhe është sëmurë. Xhebraili a.s., e njoftoi për këtë dhe ata e nxorën magjinë, që ishte e vendosur nën një gur në fund të bunarit.<sup>75</sup>

---

<sup>75</sup> Buhariu dhe Muslimi, nga Aisha.

Magjia (sihr) bazohet në njohjen e veçorive të gurëve të çmueshëm e përmes llogaritjes së lëvizjes së yjeve. Nga ata gurë formohet forma e ngjashme me pamjen e personit që dëshirohet t'i bëhet magji, në të shikohet në kohë të caktuar të shndritjes së yjeve me shqiptim të fjalëve të mosbesimit (*kufr*) dhe fjalëve të ulëta (*fahsh*) dhe në përgjithësi fjalëve në kundërshtim me sheriatin, me çka fitohet ndihma nga shejtani, e, në përputhje me ligjin hyjnor, personi të cilit i bëhet magji hyn në gjendje të çuditshme. Edhe nëse nuk është keq të mësohen këto, për shkak që janë dituri, ato nuk vlejnë asgjë, përveç të dëmtojnë njerëzit. Çdo gjë që çel rrugën për të keqen është e keqe, prandaj kjo dituri është e pa dobishme. Bile, nëse një zullumqar pyet për vendin e sigurt ku është fshehur një njeri i mirë të cilin zullumqari dëshiron ta vret; në esencë njohuria për vend-ndodhjen, udhëzimi për atje, dhënia e informatave, janë dituri për çështjen, por, meqë nga kjo lind dëm, atëherë kjo është dituri e dëmshme. Gënjeshtria në këtë rast është obligim (*vaxhib*).

2. Është e dëmshme kur në të shumtën e rasteve e dëmton zotëruesin, siç është dituria e astronomisë (*ilmun-nuxhxhum*). As kjo dituri nuk është e dëmshme vetvetiu. Ajo i ka dy pjesë:

**Pjesa e parë** është matematikore (*hisabi*). Kur'ani na tregon se lëvizjet e diellit dhe hënës janë të llogaritura:

**“Dielli dhe hëna janë të llogaritura në mënyrë të përkryer.”** 55-Rahman: 5

Allahu Teala gjithashtu thotë:

**“Edhe hënës i kemi caktuar fazat (pozicionet) derisa të kthehet në trajtën e harkut (rrem i hurmës së tharë).”**

36-Jasin: 39

**Pjesa e dytë** është ligji (el-Ahkam), e përmbledhja e kësaj është: gjetja e dëshmive për ndodhitë nëpërmjet sebepeve (shkaqeve). Kjo është ngjajshëm sikur mjeku kur gjen dëshmi për sëmundjen përmes kontrollimit të pulsit, që do të thotë, është njohja e ligjit të Allahut mbi krijesat e Tij. Por sheriati edhe këtë e ka qortuar. Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

**“Kur të përmendet caktimi (*kader*) heshtni, kur të përmenden yjet heshtni, dhe kur të përmenden as’habët e mi, heshtni.”**<sup>76</sup>

Si edhe:

**“Frikësohem për ummetin tim pas meje, për tri gjëra: padrejtësisë së liderëve, besimit në yje dhe parashikimit të kaderit.”**<sup>77</sup>

Hazreti Omeri r.a., ka thënë:

**“Mësoni për yjet ato që do t’ju udhëheqin në det dhe tokë, e më shumë jo.”**

Ai ndaloi mësimin për yjet për tri shkaqe:

1- Dituria për yjet dëmton shumicën e njerëzve. Nëse u thuhet se gjërat zhvillohen përshtatshëm lëvizjes së yjeve, ata do të mendojnë që yjet vendosin fatet, që janë hyjni të cilat udhëheqin sepse janë xhevahirë fisnikë qiellorë, e në zemrat e njerëzve mund të marrin pozitë të lartë, ta mbushin plotësisht. E mira dhe e keqja, e ndaluara dhe e urdhëruara, mund të shihen si dhuratë nga yjet, e përmendja e Allahut Teala mund të humbet plotësisht nga zemra. Personi i dobët në besim kufizohet në atë që e sheh, kurse njohuria e thellë

---

<sup>76</sup> Taberani nga Ibn Mesudi.

<sup>77</sup> Ibn Abdulberr nga Ebu Mihxhen.

tregon se dielli, hëna dhe yjet i janë nënshtruar urdhrave të Allahut Teala. Kuptimi i personit të dobët në besim që rrezja e dritës është pasojë e rrezatimit të diellit, është baras me kuptimin e buburrecit - po t'i jepej këtij mendja - i cili gjendet në një copë letre, dhe vazhdimisht shikon gjurmën e lapsit që krijohet me të shkruar, dhe mendon që ajo është vepër e lapsit, e nuk është në gjendje të ngritët mbi atë perspektivë dhe t'i shohë gishtat, dorën, fuqinë, aftësitë dhe vullnetin që e lëviz lapsin – personin, e që gjithë këto janë krijuar nga një Krijues. Konkluzionet e shumicës së njerëzve janë të kufizuara me shikim shkurt-pamës të kësaj dynjaje lidhur me shkaqet, me pamundësinë e ngritjes drejt Shkaktarit të shkaqeve (*Musebbibul-esbab*). Kjo është një arsye pse astrologjia është e ndaluar.

2- Horoskopi (*ahkamun-nuxhixhum*) është tërësisht parashikim, dhe askush nuk e llogarit si mjet për njohje, as të besueshëm. Marrja e vendimeve bazuar në horoskop është vendimmarrje pa dituri, prandaj në këtë rast nuk është e qortueshme dituria por pa dituria.

Kjo dituri ishte muxhize e Idrisit a.s., e pas vdekjes së tij edhe kjo dituri hyri në amulli dhe u zhduk. E nëse edhe ndodh që astrologu t'ia qëllojë, kjo është rastësi; sepse ai mund të kuptojë disa shkaktarë, por të kuptohet fshehtësia e të brendshmes është jashtë mundësive të njeriut, sepse sa e sa kushte janë të lidhura me punët që do të ndodhin si pasojë e këtyre shkaqeve. Nëse Allahu Teala ka miratuar edhe shkaqet e tjera, astrologu do të qëllojë dhe çka thotë ai – ashtu ndodh. E nëse Allahu Teala nuk ka miratuar, astrologu do të gabojë.

Kjo është si rasti kur njeriu parashikon se a do të bjerë shi apo jo pasi t'i ketë parë retë të mbledhjen dhe ngritjen përmbi kodra. Mund të ndodhë që dita të jetë me diell, që retë do të shpërndahen, por mund të ndodh edhe e kundërta. Vetëm mbledhja e reve nuk mjafton për shi, duhet njohur edhe kushtet tjera. Por ne ato nuk mund t'i kuptojmë.

Rasti i njëjtë është edhe me detarin, kur hamend që barka e tij do të lundrojë qetë, bazuar në sjelljen e zakonshme të erërave. Ato erëra kanë shkaktarë të fshehur të cilat detari nuk i njeh. Kështu, herë ia qëllon me hamendje, e herë gabon. Për këtë arsye, edhe për ata me besim (*iman*) të fortë është e ndaluar nganjëherë të mësojnë për yjet.

3- Nuk ka dobi të rëndësishme në diturinë për yjet. Nëse posedon këtë dituri, as që mundesh gjë të korrigjosh e as që mundesh të ndërrosh fatin (kaderin). Kjo është harxhim i kotë i jetës - pasurisë më të vlefshme të njeriut, e ky është dëmi më i madh.

Resulallahu s.a.v.s., po kalonte pranë një personi të cilin e kishin rrethuar njerëzit, dhe tha:

- **Çfarë është kjo?**

- *Një i ditur*, i thanë.

- **Në çka?**, pyeti Resulallahu s.a.v.s.

- *Në poezi dhe gjenealogji të arabëve*", thanë, e Resulallahu s.a.v.s., tha:

- **Pra, në dituri, njohja e të cilave nuk jep dobi, kurse mosnjohja e tyre nuk dëmton.**"<sup>78</sup>

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

**"Dituri është ajeti që kuptohet, ose sunneti që praktikohet, ose puna e drejtë."**<sup>79</sup>

---

<sup>78</sup> Ibn Abdulberr, nga Ebu Hurejre.

Po kuptohet se dalldisja në dituritë e yjeve dhe të ngjashme nuk është e dobishme, është dalldisje në xhahiliet dhe angazhim i rrezikshëm. Sepse ajo që është përcaktuar do të ndodhë, nuk ka mundësi t'i iket. Mjekësia është e kundërta e kësaj; për mjekësinë ekziston nevoja dhe shumë argumente udhëzojnë në këtë, bile edhe interpretimi i ëndrrave, sado që interpretimi është parashikim, sepse ëndrrat janë pjesa e dyzet e gjashtë e pejgamberllëkut, në këtë nuk ka kurrfarë dyshimi.

4- Angazhimi me dituritë që nuk sjellin dobi për dijen e personit që angazhohet. Dituria e tillë është e dëmshme për personin, siç është për shembull marrja me dituri dytësore para atyre parësore, me të fshehtën para të dukshmes, siç është studimi i fshehtësive hyjnore - me çka janë marrë filozofët dhe kelamistët, por nuk mundën të kuptojnë gjë; as fshehtësitë hyjnore, e as ndonjë nga segmentet e tyre. Ato (fshehtësitë hyjnore) nuk mund t'i njohë askush pos pejgamberëve dhe evliave. Prandaj njerëzit duhet të përmbahen nga studimi i tyre, e të drejtohen në qëndrimet e shariatit për to, e kjo mjafton për të udhëzuarit. Sa e sa njerëz merren me këso dituri, e dëmtohen. Po të mos merreshin me këto dituri, gjendja e besimit të tyre do të ishte më e mirë nga ajo çfarë e kanë. Padyshim që ekzistojnë dituri të cilat dëmtojnë disa njerëz, siç i bën dëm foshnjës që është në gji mishi i zogut ose ndonjë ëmbëlsirë. Bile, për disa njerëz mos-dituria është më e dobishme në disa situata. Transmetohet se një njeri i ishte ankuar mjekut në shterpësinë e gruas së vet.

---

<sup>79</sup> Ebu Davud dhe Ibn Maxhxhe nga Abdullah ibn Amr.

Mjeku ia mati pulsin gruas, dhe i tha:

- *Nuk të duhet ilaç kundër shterpësisë, sepse do të vdesësh për katërdhjetë ditë. Gruaja u frikësua shumë, u shqetësua, e shpërndau tërë pasurinë e saj, dhe shkroi testamentin. As nuk hante e as nuk pinte, duke pritur afatin të kalojë. Pas katërdhjetë ditësh, burri erdhi prapë te mjeku, dhe i tha:*

- *Gruaja nuk më vdiq.*

- *E kam ditur, tha mjeku.*

- *Tash, të kesh marrëdhënie intime me të, dhe do të mbetet shtatzënë.*

- *Si ashtu?, pyeti burri.*

- *E pashë që është e plotë, e yndyra ia kishte mbuluar vrimën e mitrës. E dija që nuk do të dobësohej, përpos me frikë nga vdekja. Prandaj e frikësova, e ajo u dobësua, dhe u largua pengesa për shtatzëni, u përgjigj mjeku.*

Kjo do të të paralajmërojë për rreziqet e marrjes me disa degë të diturive, dhe do të të shpjegojë kuptimin e fjalëve të Resulallahut s.a.v.s.:

**“Kërkojmë strehim te Allahu nga dituria prej të cilës nuk ka dobi.”<sup>80</sup>**

Mëso nga ky transmetim, s'ia vlen mudi për dituritë e ndaluara me shariat dhe mjaftohu me përshatje sunnetit dhe as'habëve, Allahu qoftë i kënaqur me ta; selameti është aty. Ndërsa rreziku është në mundimin krejt të pabazuar të parashikimit të ngjarjeve të së ardhmes. Mos u bëj mburracak duke u bazuar në mendimin tënd, kuptimin tënd,

---

<sup>80</sup> Ibn Abdulberr nga Xhabiri.

dëshmitë dhe vendimet tua, e duke thënë: “Unë po përpiqem të kuptoj esencën e gjërave, çfarë dëmi ka në këtë?” Kujto mirë sa e sa gjëra i ke kuptuar, e ai kuptim vetëm të ka dëmtuar deri në atë masë sa do të dërgonte në shkatërrim në botën tjetër (ahiret), nëse nuk do të arrinte mirësia e Allahut Teala. Dije se, sikur mjeku i aftë i cili i njeh fshehtësitë e shërimit të cilat të tjerëve mund t’ju duken të pabesueshme, ashtu janë edhe pejgamberët - mjekë të zemrës, e edhe dijetarët të cilët kanë dituri për shkaqet e ahiretit. Prandaj mos gjyko për metodat e tyre në saje të kuptimit tënd, kjo mund të të dërgojë në shkatërrim. Sa e sa herë e kemi parë kur paraqitet një çiban në gisht; sipas mendjes mjekimi duhet të bëhet në gisht, por mjeku me përvojë këshillon të mjekohet nga ana e kundërt, e mendja këtë assesi nuk e pranon. Sepse nuk kupton vendin e mbledhjes dhe lëvizjes së damarëve, rrënjët e tyre në trup dhe degët. Njëjtë është edhe në hollësitat e rrugës së ahiretit, shariatit, sunnetit, edebet<sup>81</sup> dhe në besimin me të cilin njerëzit janë obliguar - ekzistojnë hollësira të tilla që, fuqia e mendjes nuk mjafton për t’i kuptuar tërësisht këto. Njëjtë është edhe me mineralet që kanë aq shumë veti të çuditshme, të cilat as ekspertët nuk i kuptojnë, siç është shembulli i magnetit: askush nuk e ka zbuluar arsyen pse ai e tërheq hekurin. Kurse veçoritë në vendimet e shariatit dhe në besim e ibadete, në pastrimin e zemrës dhe arritjen në ahlak të bukur në mënyrë që ajo t’i afrohet Allahut Teala, janë veçori më madhështore se sa veçoritë e ilaçeve dhe bimëve mjekuese. Siç nuk munden mendjet të njohin në tërësi veçoritë e ilaçeve edhe pse

---

<sup>81</sup> **Adab [sh. Edeb]:** metodë; rregullat e sjelljes; edukim; ahlak i bukur; urtësi.

përvoja na i zbulon ato, ashtu nuk mund të kuptojnë as veçoritë e botës tjetër, bile, këtë as përvoja nuk na e zbulon. Përvoja do të na zbulonte këtë sikur dikush të kthehej pas vdekjes dhe të na tregonte për veprat që i janë pranuar, që janë treguar të dobishme dhe e kanë afruar atë person Allahu Teala, ose për veprat që e kanë larguar atë person nga Allahu, dhe se cili besim është i pëlqyeshëm. Por, kjo nuk është e mundur, nuk do të ndodhë kurrë. Nga përfitimi i mendjes, për ty është e mjaftueshme nëse arrin të kuptosh drejtësinë dhe shenjat e Resulallahut s.a.v.s.; mos e lodh mendjen me gjëra të panevojshme. Hyr në rrugën që Resulallahu s.a.v.s., e tregoi, vetëm aty është shpëtimi. Për këtë arsye Resulallahu ka thënë:

**“Vërtetë, në ndonjë dituri ka injorancë, dhe në ndonjë fjalë ka lodhje.”**

Me një transmetim tjetër thuhet **“rëndim”**.<sup>82</sup>

Padyshim, dituria nuk bëhet injorancë, por nganjëherë bëhet e dëmshme si padituria.

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

**“Pak sukses është më i hairit se shumë dituri.”**<sup>83</sup>

Edhe Isa a.s., ka thënë:

*“Drunj ka shumë por jo të gjithë japin frute, frute ka shumë por jo të gjithë janë të ëmbël, dituri ka shumë por jo të gjitha janë të dobishme.”*

---

<sup>82</sup> Ebu Davudi nga Burejde.

<sup>83</sup> E shënon autori i veprës **el-Firdevs**, nga Ebu Derda.

## SHPJEGIM SE CILAT EMËRTIME TË DITURIVE JANË NDËRRUAR

Dije se burimi i përzierjes së diturive të dëmshme me ato të shariatit është me qëllim të keq, duke ndryshuar emrat e tyre të lavdërueshëm, transmetuan gabimisht kuptimet e tyre, ndryshe nga ajo si janë kuptuar ato nga gjenerata e parë e myslimanëve të mirë (*selefus-salih*), dhe të shekullit të parë hixhri në përgjithësi, e krejt kjo me qëllime të këqija. Fjala është për pesë emërtime: *fikh*, *ilm*, *tevhid*, *tezkir* dhe *hikmet*. Këto janë emërtime të diturive të lavdërueshme. Ata që janë marrë me këto dituri kanë qenë në pozitë kyçe fetare. Fatkeqësisht, sot është ndryshuar kuptimi i këtyre emërtimeve dhe sot zemrat ndjejnë refuzim ndaj atyre që merren me këto dituri, si pasojë e thashethemeve që qarkullojnë për ta.

Emërtimi i parë, *fikh*, nuk është transformuar dhe ndërruar në një kuptim tjetër. Vetëm se, duke e ndarë në degë, dhe duke i dhënë emërtimin '*furu fikh*', e specifikuan në njohjen e çështjeve të çuditshme në fushën e marrjes së vendimeve ligjore (*fetva*), fokusim në detajizimin e prejardhjes së problemit, fjalimet e stërzgjatura për të dhe mësimin përmendësh të elementeve të tij. Për atë i cili më së thelli hyn në këto çështje dhe i cili merret më së shumti me to thuhet se është fakihu më i madh.

Por, në shekullin e parë, emërtimi "*fakih*" është përdorur vetëm për diturinë në rrugën e ahiretit, për njohjen e të metave të nefsit (vetes), për veprat të këqija, për moslidhjen për këtë botë, lidhjen për mirësitë e ahiretit dhe

dominimin në zemër të frikës nga dënimi i Allahut. Në këtë udhëzojnë fjalët e Allahut Teala:

**“...që të thellohet në mësimin e fesë dhe kështu të paralajmërojnë popullin e vet, mbasi të kthehet...”**

9-Teube: 122

Rruga deri te paralajmërimi dhe frika është një fikh i tillë, pa detajizime lidhur me shkëputjen e njëanshme të martesës (*talak*), lirimin e robit (*itak*), ndarjes si pasojë e akuzave për shkelje të kurorës përcjellë me mallkim për partnerin bashkëshortor i cili gënjen (*lian*), marrëveshjes për pagesë të menjëhershme të mallit të pranuar (*selem*) dhe qiraja (*ixhara*). Me këtë nuk arrihet te paralajmërimi e as te frika, bile atyre u forcohen zemrat edhe më shumë, dhe frika zhduket plotësisht, siç e shohim sot te ata të cilët janë dhënë pas këtyre diturive. Allahu Teala thotë:

**“...ata kanë zemra, por nuk kuptojnë...”** 7-A’raf: 179

Këtu qëllimi nga **“nuk kuptojnë”** është se nuk kuptojnë çka do të thotë imani (besimi) e jo se nuk i kuptojnë fetvatë. Betohem në jetë që fjalët **fikh** dhe **fehm** janë të njëjta në kuptim gjuhësor. Edhe në dialektin e vjetër dhe në atë të sotëm mes Arabëve, të dy termet përdoren në të njëjtin kuptim. Allahu Teala thotë:

**“...ata kanë më shumë frikë nga ju sesa nga Allahu, ngaqë ata janë njerëz që nuk kuptojnë.”** 59-Hashr: 13

Për frikë të vogël nga Allahu e frikë të madhe nga njerëzit, thuhet që përgjegjës është kuptimi i dobët i tyre për fikhun. E ti vet na thuaj se a është kjo pasojë e mësimin të

detajeve të lidhura me zgjidhjet ligjore ose është pasojë e mungesës së diturisë të cilën e përmendëm?!

Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

**“Dijetarët (ulema), të mençurit (hukama), janë fakih (fukaha)”**,<sup>84</sup>

Kur e pyetën Sad ibn Ibrahim nga fisi Zuhri se cilët janë fakihët më të mirë, ai u përgjigj:

*“Ata që më së shumti i frikësohen Allahut Teala”*; sikur ka dashur të theksojë frytin e fikhut - frikën nga Allahu (takva), frytin e diturisë së brendshme, e jo fetvatë dhe gjykimet.

Me një hadith Resulallah s.a.v.s., ka thënë:

**- A dëshironi të ju tregoj kush është fakih i vërtetë?**

**- Natyrisht, i thanë.**

**- Ai i cili nuk i bën njerëzit të humbin shpresën në Rahmetin e Allahut, e as nuk i bën të jenë të sigurt nga dënimi i Tij, dhe që nuk hedh poshtë Kur’anin për diçka tjetër.**<sup>85</sup>

Enes ibn Malik tregon se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

**“Të jem me ata që përmendin Allahun nga fillimi i mëngjesit deri në lindjen e diellit, më është më e dashur se sa të liroj katër skllav.”**<sup>86</sup> Më pas, Enesi u kthye kah Zejd Rekashi dhe Zijad Numejri dhe tha:

*“Mexhliset e dhikrit nuk ishin si këto tuajat – ku njëri flet, iu mban vaz të tjerëve dhe përmend hadithe. Ne do të uleshim, do të bisedonim për imanin, do të thelloheshim në Kur’an për të kuptuar begatitë e Allahut ndaj neve,*

---

<sup>84</sup> Ebu Nuajm në veprën **‘Hilje’** nga Suvejd ibn Haris.

<sup>85</sup> Ebu Bekr ibn Lal në **‘Mekarim-i Ahlak’**.

<sup>86</sup> Ebu Davudi, me zingjir të mirë të transmetuesve (hasen).

*mundoheshim të bëhemi fakihë dhe llogarisnim si fikh meditim e kuptimeve të Kur'anit Kerim.*" Të parët, e emërtonin 'fikh' të menduarit për kuptimet e Kur'anit dhe thellimin në Kur'an për të kuptuar begatitë e Allahut.

Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

**"Personi nuk mund të bëhet fakih në kuptimin e plotë deri sa nuk përbuzë njerëzit për Allahun dhe deri sa nuk pranon kuptimet e shumta të Kur'anit, ashtu siç janë."**<sup>87</sup>

Ky hadith gjithashtu transmetohet edhe si *mevkuf* nga Ebu Derda, Allahu qoftë i kënaqur me të, ku shtohet edhe:

**"...e më pas kthehet kah vetja dhe veten edhe më shumë e përbuzë."**

Ferkad es-Senxhiu e pyeti Hasan Basriun diçka, e ky iu përgjigj. Ferkadi më pas i tha:

*"Përse fakihët kundërshtojnë fetvatë tua? Ata thonë të kundërtën e kësaj që thua ti."* Hasani, Allahu e mëshiroftë, në këtë tha:

*"Ej Ferkad! A ke parë me sytë e tu ndonjë fakih? Fakihu është zahid në këtë botë, e dëshiron ahiretin, besimin e shikon me syrin e zemrës, pandërprerë është në ibadet, është i përmbajtur, rreptësisht e ruan nderin e myslimanit, nuk lakmon pronat e tyre, i këshillon."*

Duke treguar të gjitha këto, askund nuk e ka përmendur atë që jep fetva në degën e fikhut (*furu fikh*). Megjithëkëtë, nuk e thashë që dituria e fikhut nuk ka lidhje në vendimet të jashtme e fikhut. Ekziston lidhja edhe me fetvanë, por kjo

---

<sup>87</sup> Ibn Abdulberr, nga Shedad ibn Evs.

lidhje është e përbashkët dhe përfshirëse, ose e nënshtruar diturisë së ahiretit. Bile të parët, këtë dituri të fikhut e kanë quajtur më shumë si *dituri të ahiretit*. Me përcaktimin e kësaj diturie vetëm për fetva u shkaktua huti, u la anash dituria e ahiretit dhe gjendjet e zemrës. Aq më shumë, natyra e njeriut anon në këtë. Por dituria e brendshme (*batin*) është e fshehur; të kuptohet ajo është e vështirë dhe veprimi i bazuar në këtë dituri është i vështirë. Me diturinë *batin* është vështirë të arrihet pasuri dhe në pozitat e kësaj bote si gjyqtar a kryetar. Nëpërmes emërimit “*fikh*”, emërtim ky që është i vlefshëm në shariat, edhe shejtani gjeti rrugë për t’ia paraqitur këtë dituri si të mirë atyre.

*Emërtimi i dytë, është ilm (dituri).* Në esencë, *ilm* i thuhet njohjes së Qenies (Dhat) së Allahut Teala, njohjes së ajeteve të Tij dhe ligjin e Allahut ndaj krijesave të Tij. Kur vdiq hazreti Omeri r.a., hazreti Ibn Mesud r.a., tha:

- *Vdiqën nëntë të dhjetat e diturisë (el-ilm).*

Për diturinë e ka përdorë parashtesën “*e*” (trajta e shquar, njëjës – Dituria), e më pas këtë dituri e interpretoi si njohje Allahun Teala. Por, ata e ndërruan edhe këtë emërtim, duke e përdorë në kuptim të ndarë, në të shumtën e rasteve në kuptimin e fikhut dhe për debatim rreth çështjeve tjera. Të tillët thonë: “*Kjo është dituria e vërtetë*”, e kush nuk merret me një *ilm* të tillë llogaritet si i dobët, dhe nuk mund të quhet dijetar. Pra ky është ndryshimi në emërtimin ***dituri***, dhe përdorimi i tij në kuptim të ndarë. Mirëpo në shpjegimet e Kur’anit dhe haditheve për vlerat e larta të diturisë dhe të dijetarit - aty është dituria e dobishme dhe shpjegimi për dijetarët që njohin Allahun Teala, ligjet e Tij, veprimet dhe cilësitë. Sot ky emërtim u është dhënë atyre që nuk e kanë

kuptuar si duhet diturinë e sheriatit, që hynë me anë të logjikës në debatim për ta heshtur kundërshtarin. Me këtë ata llogariten si *‘dijetarë të mëdhenj’*, me gjithë mosnjohjen e tyre për tefsirin, hadithet, dituritë e medh’hebeve dhe të ngjashme; e kjo gjendje u bë shkak i shkatërrimit për disa kërkues të diturisë.

*Emërtimi i tretë, tevhid*, me të cilin sot nënkuptohet njohja e diturisë së kelamit dhe rrugët e përpjekjes për të arritur atë që dëshiron, njohja e mënyrës së debatimit për ta mposhtë tezën e kundërshtarit, aftësia e të folurit për t’iu përgjigjur shumë pyetjeve të dyshimta dhe përgatitje e dëshmive për ta heshtur kundërshtarin. Bile, një grup që merren me këto (mu’tezile) e quajten veten *‘njerëzit e të drejtës dhe tevhidit’* (Ehlul-adli vet-tevhid), e kelamistët u quajten *‘dijetarët e tevhid-it’* (el-ulemau bit-tevhid), por asgjë që lidhet me diturinë e kelamit nuk ka qenë e njohur në shekullin e parë hixhri (shekulli i as’habëve dhe taibinëve). Aq më shumë, as’habët maksimalisht ndalonin atë që mund të hapë dyert e debatimit dhe dyshimit. Por, dëshmitë që shprehen në Kur’an për njëshmërinë e Allahut Teala të cilat mendja i pranon sapo t’i dëgjojë për herë të parë, ishin të njohura për të gjithë.

Njohja e Kur’anit do të thotë njohja e të gjitha diturive. Shumica e kelamistëve nuk e kanë kuptuar tevhid-in siç e kanë kuptuar as’habët dhe taibinët, e edhe nëse do ta kuptonte ndokush prej tyre, nuk do të vepronte në bazë të atij kuptimi; e kjo është njohja që gjithçka është prej Allahut Teala pa iu drejtuar mjetit dhe shkaktarit; edhe e mira edhe e keqja janë prej Tij. Kjo është një shkallë e lartë, e njëri nga frutat e kësaj është *‘tevekkul’* (mbështetja në Allahun), të cilin

do ta shpjegojmë në kapitullin “*Tevekkul*”, inshallah. Fryt i kësaj është edhe mos ankimi nga njerëzit, largimi nga urrejtja për krijesat, kënaqësia (*riza*) dhe dorëzimi i plotë urdhrave të Allahut Teala.

Njëri nga frutat e këtij kuptimi u tregua me fjalët e Ebu Bekr es-Siddik, Allahu qoftë i kënaqur me të, kur i thanë gjatë kohës sa ishte i sëmurë:

- *A ta thërrasim mjekun?*, e ai u përgjigj:

- *Mjeku më ka sëmurë.*

Edhe në transmetimin tjetër thuhet që, kur është sëmurë Ebu Bekr es-Siddik r.a., e pyetën:

- *Çfarë të tha mjeku për sëmundjen tënde?*, e hazreti Ebu Bekr r.a., u përgjigj:

- *Më tha: ‘Unë bëj çfarë Unë dua.’*<sup>88</sup>

Dëshmitë për këto do t’i përmendim në librat ‘**Tevekkul**’ dhe ‘**Tevhid**’. Tevhid-i është një xhevahir me dy lëvohga. Njerëzit janë fokusuar në lëvohga dhe në mbrojtjen e lëvohgës e kësaj i dhanë emrin *tevhid*, dhe plotësisht e harruan thelbin.

Lëvohga e parë është të thuash me gjuhë: **La ilahe ilallah**, dhe kjo quhet *tevhid*, që është e kundërta e *trinisë*, të cilën e thonë të krishterët. Por, ky dëshmim mund të dëgjohet edhe te hipokriti, mendimet e fshehta të së cilit janë të kundërta me fjalët e shqiptuara.

Lëvohga e dytë është që në zemër të mos kesh kundërshtim dhe mohim ndaj kësaj dëshmie, pra, duhet të besohet dhe vërtetohet me zemër dhe pa dyshim. Ky është besimi në njëshmërinë e Allahut, besim që është prezent te

---

<sup>88</sup> “Bërës i çfarëdo që Ai do.” 85-El-Buruxh: 16

njerëzit e zakonshëm. Kelamistët, siç e thash më herët, e ruajnë këtë lëvzhgë nga ngatërresat që mund të vijnë prej atyre që fusin risi (*bidat*) në besim.

E treta është thelbi; njohja se të gjitha vijnë nga Allahu, pa u bazuar në mjetin dhe shkakun, dhe të mos i nënshtrohesh askujt pos Atij. Në këtë kuptim të tevhidit nuk hyn edhe ndjekja e dëshirave sepse ai që ndjek dëshirat e veta i karakterizon dëshirat e veta si zot. Allahu Teala thotë:

**“...atë njeri, që dëshirat e veta i ka bërë zot;”**

45-Xhathije: 23

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Nga adhurimet e idhujve, ajo që Allahu Teala më shumti urren në sipërfaqen e tokës është adhurimi që njeriu ka për dëshirat veta.”<sup>89</sup>**

Në fakt, kush mendon mirë e kupton që, ai që i nënshtrohet një idhulli, i është nënshtuar dëshirës së vet. Sepse zemra anon kah besimi i të parëve të vet (babai, gjyshërit), e personi ndjek atë besim. Zaten, një nga kuptimet e fjalës dëshirë (*hava*) është animi i nefsit kah gjërat me të cilat është mësuar.

Në këtë kuptim të tevhidit nuk bën pjesë ankimi te njerëzit dhe kthimi kah ta, sepse, si mundet dikush që beson se gjithçka vjen prej Allahut Teala, t'i ankohet dikujt tjetër? Pra, tevhidi përfshinë këtë gradë. Kjo është grada e të sinqertëve (*makamus-siddikin*), e ti shih se me çka është ndërruar, dhe me cilën ‘lëvzhgë’ mjaftohet. Shih se si e kanë

---

<sup>89</sup> Taberani, nga Ebu Uname, me zingjir të dobët të transmetuesve.

marrë interpretimin e tanishëm të këtij termi të lavdërueshëm si strehim për vetëlavdërim dhe mburrje, duke lënë anash atë me çka ky term edhe ka merituar vërtetë lavdërimin. Janë të ngjashëm me humbësin i cili zgjohet në mëngjes dhe drejton fytyrën kah Kibla duke thënë:

**“Unë e kthej fytyrën time nga Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë”** 6-En’amë: 79,

e kjo, nëse fytyra e zemrës nuk i është kthyer kah Allahu, është gënjeshtër e pastër ndaj Allahut, të cilën e thotë për çdo ditë. Nëse ai, me termin ‘fytyrë’ nënkupton fytyrën e të jashtmes, kthimi i fytyrës së tij është vetëm kthim fizik kah Qabeja. Por, nuk është Qabeja ana e Atij që krijoi qiejt dhe tokën, e që në atë rast, kthimi kah Qabeja do të nënkuptonte kthimin kah Ai, i Lartësuar qoftë, e që do të nënkuptonte që Allahu është i limituar me anë dhe dimensione. E nëse me termin ‘fytyrë’ nënkuptohet në fytyrën e zemrës, siç edhe duhet të jetë, me të cilën i nënshtrohet Allahut, si mundet atëherë deklarimi i tij të jetë i drejtë kur zemra i sillet andej-këndeje mes dëshirave dhe nevojave të kësaj bote, e preokupuar me hile me të cilat dëshiron të fitojë pasuri dhe reputacion dhe kah kjo është plotësisht i drejtuar? Kur e ktheu ky fytyrën kah Ai i cili krijoi qiejt dhe tokën? Fjalja në vazhdim flet për të vërtetën e tevhidit: personi që beson në njëshmërinë e Allahut (*muvehhid*), është ai person që nuk sheh askënd përpos Të Vetmit (el-Vahid), që fytyrën e vet nuk e kthen kah askush pos kah Ai, që i përshtatet urdhrit të Allahut:

**“Thuaj: Allahu. Mandej lëri ata të luajnë në atë kotësinë e tyre.”** 6-En’amë: 91

Nuk mendohet që kjo të thuhet me gjuhë, gjuha nganjëherë e thotë të vërtetën, e nganjëherë jo. Këtu po flitet për shikimin e Allahut Teala drejtuar robit, e kjo ndodh në zemër, aty është rrënja dhe burimi i tevhidit.

*Emërtimi i katërt, dhikr dhe tezkir.* Allahu Teala thotë:

**“Dhe ua kujto, se kujtesa u bën dobi besimtarëve”.**

51-Dhariat: 55

Ka shumë hadithe që lavdërojnë tubimet (*mexhliset*) e dhikrit. Kështu, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**- Kur kaloni pranë bahçeve të xhenetit, shfrytëzoni nga aty sa më shumë: hyni brenda, hani, pini.** Kur as’habët pyetën:

**- Ku janë këto bahçe të xhenetit?** Pejgamberi s.a.v.s. tha:

**- Janë tubimet e dhikrit.<sup>90</sup>**

E në një hadith tjetër thuhet:

**“Allahu Teala ka melekë që sillen rreth tokës, afër atyre që janë përgjegjës për njerëzit, e që kur i shohin tubimet e dhikrit, fillojnë t’i thërrasin njëri-tjetrit: “*ejani, këtu është ajo që kërkuam!*” Këta vijnë në tubim, i përqafojnë besimtarët me krahë, dhe dëgjojnë. Prandaj bëni dhikër Allahut, dhe kujtoni për këtë njëri-tjetrin.”<sup>91</sup>**

Pra, këtë gjendje të dhikrit, shumica e vaizëve që i shihni sot, e ndërruan me katër gjëra: me tregime, vjersha, fjalë të pamatura dhe fjalime pa kuptim e diskredituese.

Tregime gjithfarë nënkuptojnë futjen e risive në fe. Gjenerata e parë e myslimanëve ndalonte dëgjimin e çfarëdo

---

<sup>90</sup> Tirmidhiu nga Enesi.

<sup>91</sup> Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre.

tregimi. Do të thoshin: *“Këso nuk ka pasur në kohën e Resulallahut s.a.v.s.”*<sup>92</sup> Aso gjëra nuk ka pasur as në kohën e hazreti Ebu Bekrit dhe hazreti Omerit, Allahu qoftë i kënaqur me ta. Ashtu ishte deri sa nuk u lajmëruan intrigat, e atëherë nisën të lajmërohen edhe çfarëdolloj tregimesh. Transmetohet se hazreti Ibn Omeri r.a., një herë kishte dalë nga xhamia dhe kishte thënë: *“Ky tregimtar është shkaku që unë u largova nga mexhlisi. Nëse ai nuk do të ishte, as unë nuk do të isha larguar”*.

Damra ka thënë: *‘Një ditë e pyeta Sufjan Sevrinë:*

*- A t’i dëgjojmë tregimtarët?, e ai mu përgjigj:*

*- Largohu nga futja e risive në fe.*

Ibn Avn thotë: *‘Hyra te Ibn Sirin, e ai më pyeti se çfarë ka të re. I thashë:*

*- Udhëheqësi ua ka ndaluar tregimtarëve të flasin çfarëdo tregime, e më tha:*

*- Drejtë ka vepruar.*

Gjithashtu tregohet se një herë, Amesh-i hyri në një xhami në Basra, dhe dëgjoi folësin të thotë:

*- Kështu na ka treguar Amesh-i. Ky shkoi në mes të xhamisë, dhe filloi t’i largojë qimet nga nën-sqetulla. Folësi i bërtiti i nervozuar:*

*- O plak, si nuk ke turp?! Amesh-i iu përgjigj:*

*- Pse të kem turp?! Këtë që po bëj është pastrim sipas sunnetit, kurse ajo që po flet ti nuk është tjetër pos gënjeshtëri! Unë jam Amesh-i dhe unë ty asgjë nuk të kam treguar!*

---

<sup>92</sup> Shënon Ibn Maxhe, nga hazreti Omeri, me zingjir të mirë të transmetuesve (hasen).

Ahmed b. Hanbeli ka thënë:

- *Gënjeshhtarët më të mëdhenj në mesin e njerëzve janë tregimtarët e gjithfarë tregimeve dhe ata që vazhdimisht pyesin.*

Hazreti Alia r.a., një herë e përzuri një tregimtar nga xhamia e Basras, por kur e dëgjoi të folurit e Hasani Basriut, e lejoi të vazhdojë dhe nuk e ndoqi, sepse Hasani Basriu fliste për diturinë e ahiretit, mendimin për vdekjen, fliste për përmirësimin e mangësive, për dëmtimin e veprave, shpjegonte për vesveset e shejtanit dhe mbrojtjen nga to, do të përkujtonte dëgjuesit në bereqetet dhe dhuratat e Allahut Teala, si dhe mos-falënderimin e njeriut për to. Gjithashtu do të theksonte sa e ulët është kjo botë, turpin e saj, fundin e paevituar, mashtrimet, si edhe rreziqet dhe dënimet e botës tjetër. Një paralajmërim i tillë është i lavdërueshëm me sheriat, dhe të përkrahura me transmetimin që e përcjellë Ebu Dherr, me fjalët e Resulallahut s.a.v.s.:

- **Të gjendesh në një mexhlis (tubim) të diturisë është më vlefshme se falja e njëmijë reqateve namaz, vizita njëmijë të sëmurëve dhe përcjellja e njëmijë kufomave.**

Ata që dëgjuan, e pyetën:

- *O Resuli i Allahut, a është kjo më e mirë edhe se leximi i Kur'anit?* Resulallahu s.a.v.s., u përgjigj:

- **Kur'ani jep dobi me dituri. Mos-kuptimi nuk jep dobi.**<sup>93</sup>

A t a ka thënë:

- *Një tubim i dhikrit dhe diturisë i pastron shtatëdhjetë gjynahe të argëtimit.*

---

<sup>93</sup> Ibn Xhevdhi, në librin *el-Mevduat* transmeton nga Omeri.

Për fat të keq, ata që kanë zakon të zbukurojnë tregimet e veta me gënjeshtër i kanë marrë këto tradita si metoda për të arsyetuar veten, dhe kanë përvetësuar termin “tezkir” (paralajmërim) për tregimet e veta boshe, duke lënë anash rrugën e lavdërueshme të dhikrit, e duke kaluar kohën me tregime pa dobi, të mbushura me devijime, teprime dhe mungesa, e të cilat i shtrembërojnë tregimet e cekura në Kur’an. Disa tregime është mirë të dëgjohen, derisa të tjerat janë të dëmshme, përkundër faktit që ato mund të jenë edhe të sakta. Kujt i bëhet e zakonshme dëgjimi i tregimeve të tilla, ai nuk do të mund të dallojë të vërtetën nga gënjeshtër, të dobishmen nga e dëmshmja, e për këtë arsye kjo edhe është e ndaluar. Prandaj Ahmed b. Hanbeli ka thënë:

*- Nuk ka nevojë për tregimtarin, edhe nëse fol drejtë.*

Nëse tregimet e ndonjë tregimtari kanë të bëjnë me ndonjërin prej pejgamberëve, për çështjet e fesë, e tregimtari është i besueshëm, atëherë në këtë nuk shoh kurrfarë dëmi. Por tregimtarët duhet të kenë kujdes nga gënjeshtër dhe tregimet të cilat udhëzojnë në të parëndësishmen dhe nga gjërat të cilat populli (avam) nuk i merr vesh, ose ta kuptojnë se ato tregime nuk janë gjë tjetër pos informata të pazakonta dhe të pavërteta, qofshin ato edhe në përputhje me gjërat e mira për të cilat ato tregime edhe sajohen. Njeriu i zakonshëm i pranon ato sepse i ofrojnë lehtësim në lidhje me gjynahet e veta të vogla, duke gjetur në to arsyetim për vete. Kurse gënjeshtari, me qëllim që të gjejë justifikim për vete, thirret në autoritetin e ndonjë shejhu ose të ngrituri, duke shtuar se, pasi të gjithë ne kemi prirje për gjynahe, nuk është çudi nëse edhe ai refuzon nënshtrimin Allahut, sepse edhe para tij kanë gabuar edhe njerëz më të mëdhenj se ai. Kjo

gjithashtu te personi e ngjallë guximin për të bërë gjynahe karshi Allahut. Por nëse dikush ruan veten nga këto dy rrezeqe (që gjinden në tregime çfarëdo), ato nuk do të jenë të dëmshme, sepse personi do t'i kthehet Kur'anit dhe transmetimeve të besueshme nga hadithet. Disa, megjithatë, marrin lirinë të shpikin tregime të cilat do të ngjallnin te njeriu dëshirën për nënshtrim Allahut Teala, dhe pohojnë se qëllim i tyre është të thërrasin njerëzit të kthehen kah Allahu. Por, kjo është një nga kurthet e shejtanit. Nga gënjeshtra shpëtohet përmes të vërtetës. Pos kësaj, tregimet që janë thënë nga Allahu Teala në Kur'an dhe Resulullahu s.a.v.s., mjaftojnë për t'i ikur trillimeve në tregimet e vazëve. E si nuk mjafton kur është e ndaluar të përdoren fjalët shpifëse, të ndërlikuara e të rimuara? Sa'd ibn Vekkas, duke dëgjuar të birin se si përdorte fjalë të rimuara, e i cili kishte një kërkesë nga i ati, i tha:

*- Mënyra se si flet ti më zemëron. Deri sa nuk bën teube nuk do të plotësoj asnjë kërkesë.*

Kur Abdullah ibn Revahiu i rimoi tri fjali, Resulallahu s.a.v.s., i tha:

**“Ruaju nga citimi i rimuar, o Ibn Revaha.”<sup>94</sup>**

Më shumë se dy fjali të rimuara konsiderohet si diçka nga e cila duhet pasur kujdes. Kur një njeri (Haml b. Nabiga), lidhur me gjakun që duhet paguar për fëmijën që ka vdekur në barkun e nënës, tha:

---

<sup>94</sup> Ahmedi, Ibn Ja'la, Ibn es-Sunni dhe Ibn en-Nuajm, në veprën e tyre **‘Kitabur-rijada’** përcjellin nga Ajsha r.anha, me zingjir të besueshëm të transmetuesve, t'i ketë thënë es-Saibit: *“Ruaju nga të rimuarit. Resulallahu s.a.v.s. dhe as'habët nuk kanë rimuar.”* Te Ibn Hibbani thuhet: *“Largohu nga të rimuarit, e verzion i njëjtë është edhe te Buhariu, i cili këtë hadith e transmeton nga Ibn Abbas.*

- Si të paguajmë gjakun për vdekje, për dikë që as nuk ka ngrënë, as nuk ka pirë, as nuk ka qarë e as që ka lëshuar lot; vallë, gjaku për këtë kompensohet? Resulallahu s.a.v.s., tha:

**- A nuk është kjo si të folurit e rimuar arab?<sup>95</sup>**

Sa i përket poezisë, nuk është e pëlqyer që ajo të përdoret tepër në ligjërime. Allahu Teala thotë:

**“Poetët ndiqen nga njerëzit e humbur.**

**Vallë, a nuk e sheh ti, që ata bredhin në çdo luginë (të fjalës së kotë)”** 26-Esh-Shu’ara: 224, 225

Gjithashtu thotë:

**“Ne nuk ia kemi mësuar atij (Muhamedit) poezinë e ajo as që është për të...”** 36-Ja Sin: 69

Tutje, shumica e poezive që vaizët i përsërisin në ligjëratat e tyre kanë të bëjnë me të dashuruarit, me bukurinë e personit të dashur, gëzimin e takimit me të, dhe me dhimbjen e ndarjes, me çka dëgjuesit i bëjnë t’i kenë mendimet me epshe, e zemrat t’ju kthehen kah fytyrat e bukura. Në zemrat e tyre poezia nuk ngjallë gjë tjetër pos asaj që tashmë është aty, e që rindezë zjarrin e epshit. Logjikshëm, ata fillojnë të flasin dhe ta shprehin dashurinë e tyre. Shumica e kësaj, nëse jo e gjitha, është pasojë e një lloj sëmundjeje. Prandaj, kurrfarë poezie nuk do të duhej të përdorej, përpos nëse përmban këshillë ose urtësi, e me qëllim që diçka të vërtetohet ose të ilustruhet.

Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

**“Vërtetë, disa poezi janë urtësi.”<sup>96</sup>**

---

<sup>95</sup> Shënon Muslimi, nga el-Mugira.

Nëse vetëm të veçantit (havas), zemrat e të cilëve janë të mbushura me dashuri për Allahun, do të merrnin pjesë, e aty të mos ketë kush tjetër pos tyre, aty nuk do të kishte dëm nga poezia e cila me kuptimin e vet të jashtëm drejton kah njerëzit, sepse, siç do të shohim në librin **‘Dëgjimi’**, personi do të interpretojë atë që dëgjon varësisht dritës që dominon në zemrën e tij.

Xhunejd Bagdadi do të organizonte tubime ku do të merrnin pjesë rreth dhjetë njerëz, e nëse numri i dëgjuesve do të ishte më i madh, Bagdadi do të ndalonte ligjëratën. Prandaj tubimi i tij kurrë nuk ka qenë më i madh se njëzet njerëz.

Njëherë, kur një grup njerëzish u tubuan para dyerve të shtëpisë së Ibn Selimit, dikush i tha: *“Fol, se kanë ardhur pasuesit tuaj”*, e Ibn Selimi tha:

*“Jo! Këta nuk janë pasuesit e mi! Këta janë pasuesit e tubimit. Pasuesit e mi janë të veçantit (havas).”*

Sa i përket dashurisë në ekstazë, janë dy lloje të të folurit, të cilat i përdorin disa sufi:

1. Deklarimi i fjalëve të panevojshme dhe pretencioze për dashurinë ndaj Allahut Teala dhe pohimi i ribashkimit (*vuslat*), i cili nënkupton lirim nga detyrimi për kryerjen e veprave të jashtme. Bile, disa shkojnë aq larg sa pohojnë se kanë arritur bashkimin (*ittihad*) me Allahun, ngritjen e perdes (nga mesi), të pamit me syrin e zemrës (*mushaheda*) dhe bisedë hyjnore. Shprehen se u është thënë kjo-e-ajo, që ata vet kanë deklaruar kështu-e-ashtu, duke imituar Husejn Mensur Hallaxhin, të cilit i është prerë koka sepse ka lejuar që

---

<sup>96</sup> Shënon Buhariu, përcjellë nga Ubejj ibn Ka'b.

nga goja t'i rrëshqasin disa shprehje të asaj natyre, e si shembull përdoret thënia e tij: *Enel-Hakk* (Unë jam e Vërteta).

Njëjtë, transmetohet se Bejazid Bistamiu një herë të ketë thënë: *'Subhani, subhani' (Lavdi mua! Lavdi mua!)* Kjo në fakt është lloj i të folurit që i bën shumë dëm njerëzve të rëndomtë (*avam*), deri në atë masë sa që edhe disa fshatarë braktisën xhematin dhe arat e veta, dhe filluan të flisnin gjëra të ngjashme. Sepse natyra e njeriut merr kënaqësi nga fjalët e këtilla. Ata flasin për ngritje në grada të larta e që, me kalimin nëpër disa gjendje, pastrohet vetja (nefsi) prej ndyrësirave (ves).

Si pasojë e kësaj, edhe të paditurit njëjtë shprehen për vete, duke përdorë fjali të tilla, e në këtë përkrahen. Edhe kur refuzohen këto shprehje të tyre, ata nuk ngurrojnë të thonë: *"Shkaku i refuzimit tuaj (ndaj neve) është padituria dhe grindja; padituria është perde e grindja është egoizëm. Ndërsa fjalët tona dalin nga zemra, lindin me dritën e Allahut."*

Këso fjalë dhe të ngjashme janë shpërndarë si zjarri nëpër botë, e dëmi i tyre për njerëzit është shumë i madh. Bile, të mbytet personi që deklaron këso gjëra është më mirë se sa shpëtimi i dhjetë personave në fenë e Allahut.

Sa i përket Bejazid Bistamiut, fjalët e cituara nuk mund t'i përshkruhen atij. Edhe nëse dikush e ka dëgjuar të thotë këtë, ai ka qenë duke përsëritur fjalët e Allahut, e nuk i ka thënë si fjalët të tij. Ato fjalë duhet kuptuar vetëm si citat, e assesi ndryshe. Si shembull:

***"Me të vërtetë, Unë jam Allahu, s'ka zot tjetër përveç Meje, prandaj, vetëm Mua më adhuro."*** 20-Ta-Ha: 14

Nëse e dëgjojmë këtë ajet nga ndonjë person, nuk është e drejtë të thuhet se këto janë fjalët e tij.

2. Llojin e dytë e të folurit për dashuri në ekstazë, si personi i marrë që sillet e flet pa arsye të shëndoshë, e përbëjnë fjalët e pakuptueshme por që tingëllojnë këndshëm, e prej të cilave disa janë të padobishme, ani pse tingëllojnë bukur. Ato fjalë mund të jenë të pakuptueshme për vet personin që i flet, si pasojë e hutisë në mendjen dhe imagjinatën e tij, e që kjo huti shkaktohet nga mosnjohja nga ana e tij e fjalëve që i ka dëgjuar. Ky lloj është më i shpeshti. Mund të jenë edhe fjalë të cilat personi që i flet i kupton, por për shkak të edukimit të mangët ose mungesës së retorikës, nuk mund t’ua përcjellë të tjerëve me gjuhën me të cilën i shprehë mendimet e veta. Aso fjalë nuk shërbejnë për gjë tjetër pos për të hutuar zemrat, për t’i bërë përshtypje mendjes dhe për të komplikuar kuptimin. Gjithashtu, është e mundur që në ato fjalë të gjenden edhe kuptime tjera, prandaj secili në to mund të gjejë kuptime sipas aftësisë së tij. Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

**“Nëse dikush nga ju përcjellë një thënie të cilën njerëzit nuk mund ta kuptojnë, ajo thënie bëhet shkaktar i intrigave mes tyre.”<sup>97</sup>**

Gjithashtu, ka thënë:

**“Tregoni popullit atë që e kupton! A dëshironi të përgënjeshtrohet Allahu dhe Pejgamberi i Tij?”<sup>98</sup>**

Pra, kjo është gjendja e personit i cili kupton, por nuk mund t’ua tregojë kuptimin të tjerëve. Ndërsa, pa kuptuar është e ndaluar të flitet.

---

<sup>97</sup> Ukajli në veprën **‘Zuafa’**

<sup>98</sup> Buhariu nga hazreti Alia r.a.

Isa a.s. thotë:

*- Mos ua jepni urtësinë atyre që nuk janë të denjë, e t'i bëni padrejtësi urtësisë; e as mos ua privoni atyre që janë të denjë nëse nuk dëshironi t'u bëni padrejtësi. Bëhuni si mjeku i dijshtëm, i cili jep ilaçin e duhur për vendin e duhur.*

Kurse në një transmetim tjetër:

*- Kush ia beson urtësinë atij që nuk është i denjë për urtësi, do të shfaqë mos-diturinë e vet, e kush ia ndalon urtësinë atij që është i denjë për të, do të bëjë padrejtësi. Urtësia i ka të drejtat e veta, njëjtë si njerëzit të cilët janë të denjë për të. Prandaj, jepni secilit të drejtën e vet.*

Sa i përket të folurit të pa kuptimtë e të panevojshëm (*tamma*), krahas asaj që e thamë paraprakisht, gjithashtu ka edhe një kuptim specifik, e që është interpretimi i kuptimit të jashtëm (zahir) të fjalës së shariatit në një kuptim të brendshëm (batin) absurd dhe pa kurrfarë dobie. Si adeti i *batinive* në interpretime, i cili është haram dhe shumë i dëmshëm. Sepse, për të ndërruar kuptimin e fjalëve pa ekzistimin e kurrfarë dëshmie nga Resulallahu s.a.v.s, pa u mbështetur në ndonjë autoritet dhe pa ekzistimin e një domosdoshmërie logjike, natyrisht që humbet besueshmëria në fjalë dhe humbet rëndësia e fjalëve të Allahut Teala dhe të Resulit të Tij s.a.v.s.. Sipas pohimeve të tyre, nuk është e nevojshme të besohet në ato kuptime që janë të qarta. Kurse për kuptimin e brendshëm (batin) nuk ekziston ndonjë parim. Çdokush mund të shpjegojë kuptimin sipas zbulimit të vet. Edhe kjo është nga bidatet që i kanë bërë fesë (Islamit) shumë dëm. Për shkak se natyra e njeriut e pëlqen të çuditshmen dhe të pazakontën dhe atë e kënaq gjithçka që është e pazakontë, ata me qëllim kanë futur këto risi (*bidat*) në fe për

ta prishur sheriatin dhe për ta ndërruar besimin e njerëzve në besimin e tyre ‘batini’ e të pa themel. Për shkak të kësaj, në veprën **“Mustazharije”**, e kemi shpjeguar refuzimin e batinive.

Ja disa shembuj të interpretimit të ajeteve Kur’anore që këta i përdorin si kuptime abstrakte (*tamma*):

**“Shko te Faraoni, se ai, me të vërtetë, ka kaluar çdo kufi”** 79-en-Nazi’at: 17,

me termin *‘faraon’* mendohet në zemrën, sepse zemra është ajo që e dërgon njeriun në ekstremizëm.

Prapë, kur Allahu Teala i thotë Musasë a.s.:

**“Hidhe shkopin tënd!”** 28-El-Kasas: 31,

interpretimi i tyre është: *‘Braktis çdo gjë në të cilën mbështetesh përveç Allahut Teala.’*

Interpretim i njëjtë përdoret edhe për fjalët e Resulallahut s.a.v.s.:

**“Hani para agimit (*syfyr*) sepse në syfyr ka bereqet.”**<sup>99</sup>, që sipas tyre e ka kuptimin: *‘bëni teube para agimit.’*

Ka shumë interpretime të këtilla. Bile kanë interpretuar Kur’anin prej fillimit deri në fund, duke ndryshuar kuptimet e Kur’anit të cilat deri tek ne kanë arritur nga Ibn Abbasi r.a., dhe dijetarët e tjerë. Disa nga këto interpretime kuptohet që janë plotësisht pa themel, siç është për shembull interpretimi i fjalës *‘faraon’* si *‘zemër’*. Faraoni ka qenë person që mund të shihet, është një realitet që e dëshmon historia, dhe Musa a.s. e ftoi atë. Edhe Ebu Xhehli, Ebu Leheb dhe pabesimtarët tjerë, kanë qenë ngjashëm si Faraoni. Këta nuk kanë qenë shejtanë ose melekë të cilët nuk mund të shihen me sy, e që

---

<sup>99</sup> Burahiu dhe Muslimi nga hazreti Enesi r.a..

të kërkohet interpretim. Ngjashëm kësaj, të interpretohet syfyri si kohë e kërkimit të faljes nga Allahu është e pa bazë. Për shkak se Resulallahu s.a.v.s., vetë hante syfyryn, dhe do të thoshte: **“Hani syfyryn në kohë të syfyrit”**<sup>100</sup>, dhe:

**“Mbldhuni, rreth ushqimit të bekuar.”**<sup>101</sup>

Interpretime të këtilla që janë të pa bazë kuptohen me sunnet edhe me ndjenja. E disa gabime tjera kuptohen me mendje; këto janë çështje që nuk kanë lidhje me ndjenja. Të gjitha interpretimet e tilla janë haram dhe anormale, dhe janë duke e prishur fenë e njerëzve. Interpretimet e pabaza si këto nuk janë interpretuar as nga ndonjë as’hab ose taibin, e as nga Hasani Basriu, përkundër ligjërimit të tij të gjatë, mësimi dhe këshillat nga ai. Po të ishin të lejueshme interpretimet e tilla, atëherë nuk ka kurrfarë kuptimi ky hadith i Resulallahut s.a.v.s.:

**“Kush interpreton Kur’anin sipas dëshirës së vet, le t’i përgatisë vetes një vend në xhehenem.”**<sup>102</sup>

Nga ky hadith nuk është e drejtë të kuptohet që Kur’ani nuk mund të interpretohet me zgjuarsia dhe *ixhtihad*<sup>103</sup>. Sepse ka ajete të tilla që rreth tyre janë transmetuar nga pesë gjashtë, bile edhe shtatë kuptime prej as’habëve dhe mufessirëve, dhe është një realitet i njohur që të gjitha këto kuptime nuk janë transmetuar nga Resulallahu s.a.v.s.. Bile, këto kuptime mund të jenë në një mënyrë të papajtueshme

---

<sup>100</sup> Buhariu nga hazreti Enesi r.a.

<sup>101</sup> Ebu Davud, en-Nesai dhe Ibn Hibban, nga el-Irbada ibn Sari.

<sup>102</sup> Tirmidhiu nga Ibn Abbasi.

<sup>103</sup> Vendim që i përket çështjeve që nuk prek esencat e Sheriatit dhe që nxirret nga Kurani dhe Suneti, duke u përputhur me metodën e muxhtehidëve Islam dhe duke bërë përpjekje të plotë; atyre burrave që në këtë mënyrë kanë bërë ixhtihad ju thuhet “Muxhtehid”; opinion juridiko-fetar.

me njëri-tjetrin. Padyshim, këto janë rezultat i zgjuarsisë dhe mendimit të gjatë. Kjo është shkaku që Resulallahu s.a.v.s., iu lut Allahut për Ibn Abbasin:

**“Ja Allah, Bëj që (Ibn Abbasi) të kuptojë fenë dhe mësoja interpretimin.”<sup>104</sup>**

Prandaj, kushdo që ia aprovon pabesimtarit një interpretim të tillë, përkundër dijës se fjalët nuk e kanë atë kuptim, duke deklaruar se kështu vetëm dëshiron të thërret (davat) njerëzit te Krijuesi, i përngjanë personit i cili lejon gënjeshtren dhe shpifjen e thënieve të cilat do t'i përshkruhen Resulallahut s.a.v.s., të cilat në esencë janë fjalë të sakta, ose i përngjanë atij që shpik hadithe me qëllim për të përkrahur ndonjë deklaratë të veten, për të cilën është i bindur se është e vërtetë. Kjo është dhunë dhe anomali, si edhe gjynah që thërret kërcënimin të cilin na e tregoi Resulallahu s.a.v.s.:

**“Kush me qëllim gënjen për mua, le t'i përgatisë vetes vend në xhehenem.”<sup>105</sup>**

Vërtetë, interpretimi i këtyre fjalëve në atë mënyrë është një shkelje më e madhe e më e keqe, sepse interpretime të tilla dëmtojnë besimin në fjalët e sakta dhe e shkatërrojnë rrugën e kuptimit dhe dobisë nga Kur'ani Kerim.

Nga ky shpjegim e kuptove se si shejtani pengon njeriun në kërkimin e diturisë së lavdëruar, dhe e drejton kah dituritë e qortuara. Të gjitha këto janë nga ngatërimi i çështjes prej dijetarëve të këqij, që ua ndryshuan emërtimet diturive sipas kërkesës së vet. Pa kërkuar dhe kuptuar se cilat dituri synohen me këto emërtime në shekullin e parë hixhri, do të

---

<sup>104</sup> Buhariu nga Ibn Abbasi.

<sup>105</sup> Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre.

ishte sikur të kërkohet respekt përmes diturisë duke ndjekur secilin që e quan veten dijetar, term ky me të cilin sot, quhen edhe mjekët, poetët dhe astrologët, e krejt kjo është si pasojë e pakujdesit ndaj emërimit të gabuar të diturive.

*Emërtimi i pestë, është urtësi (hikma). Siç e kemi parë, sot është e zakonshme të përdoret ky emërtim për mjekun, poetin, astrologun, bile edhe për dikë që hedh fall fshatarëve të grumbulluar qosheve të rrugës. E urtësia është ajo që Allahu Teala e ka lavdëruar, duke thënë:*

**“Ai ia dhuron urtësinë atij që do, e kujt i është dhënë urtësia, atij pra i është dhuruar mirësi e madhe.**

2-Bekare: 269

Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

**“Një fjalë të urtë që e mëson njeriu, i është më e dobishme se gjithë dynjallëku, dhe krejt çka ka në të.”<sup>106</sup>**

Shiko atëherë se çka është urtësia me të vërtetë, dhe në çka ky term sot ka degjeneruar, dhe njëjtë shih edhe termet tjera. Ruaje veten nga ngatërresat e dijetarëve të këqij. Ndikimi i tyre i keq në fe është më i madh se sa i shejtanit, sepse me ndërmjetësimin e tyre shejtani largon besimin nga zemrat e njerëzve. Për këtë shkak, kur është pyetur Resulallahu s.a.v.s., *‘kush janë njerëzit më të këqij’*, nuk është përgjigjur menjëherë, por vetëm ka thënë:

**“Ja Allah, falja...”** Kur ata insistuan në pyetje, Resulallahu s.a.v.s., tha:

**“Ata janë dijetarët e këqij.”<sup>107</sup>**

---

<sup>106</sup> Hadithin tashmë e kemi përmendur.

<sup>107</sup> Darimi nga Ahves ibn Hakim dhe Bezzar në veprën e tij *‘Musned’*.

Pra, i kuptove dituritë e pëlqyera dhe ato të qortuara, si edhe shkaqet e ndërhyrjes së tyre te njëra-tjetra. Ti je i lirë; nëse do – u përshtatësh as’habëve dhe taibinëve, e nëse do ndjek të tillë që janë mbështjellur në vetëlavdërim dhe mendjemadhësi.

Shumë dituri të cilat gjeneratat e para i kanë pranuar, janë humbur. Ndërsa shumica e atyre diturive me të cilat njerëzit sot merren, janë shpikur më vonë. Drejtë ka thënë Resulallahu s.a.v.s.:

**“Islami ka filluar me të vetmuarit, dhe ashtu do të përfundojë. Prandaj, lum të vetmuarit!”**

E kur është pyetur se kush janë të vetmuarit, Resulullahu s.a.v.s., ka thënë:

**“Të vetmuarit janë ata që përmirësojnë sunnetin tim, që njerëzit e kanë prishur, dhe ata që ngjallin pjesë të sunnetit, që njerëzit i kanë braktisur.”<sup>108</sup>**

Në një transmetim tjetër thuhet:

**“Të vetmuarit janë ata që i mbahen rrugës që e mbani ju tani.”<sup>109</sup>**

Ka edhe një transmetim:

**“Të vetmuarit janë disa të drejtë në mesin e shumë të padrejtëve, e numri i atyre që i urrejnë është më i madh se numri i atyre që i donë.”<sup>110</sup>**

Dituritë e lavdëruara janë bërë të vetmuara mes njerëzve deri në atë masë sa që përçmohen ata që i përmendin. Për këtë arsye, Sufjan Sevri ka thënë:

---

<sup>108</sup> Muslimi nga Ebu Hurejre.

<sup>109</sup> Transmetimin nuk e kam gjetur

<sup>110</sup> Ahmed i nga Abdullah ibn Amr.

*“Nëse sheh një dijetar të ketë shumë miq, ta dish sigurt që ai është i përzier me hipokrizi, sepse po të fliste të vërtetën, do ta urrenin.”*

## PËR DITURITË E DOBISHME DHE GRADAT E TYRE

Dije se, sa i përket dobisë së tyre, dituritë ndahen në tri pjesë.

1. Janë të pa dobishme pak, ose shumë;
2. Janë të dobishme pak, ose shumë;
3. Janë të dobishme aq sa është e nevojshme, e teprica është e pa dobishme.

Kjo më së miri shpjegohet me shembullin e trupit të njeriut:

Ajo që është e pa dobishme, qoftë pak ose shumë, janë shëmtia dhe ahlaku (vesi) i keq.

Ajo që është e dobishme, qoftë pak ose shumë, janë shëndeti dhe bukuria.

Ndërsa, e dobishme aq sa mjafton por teprica e pavlefshme është si harxhimi i pasurisë dhe trimëria. Harxhimi i një pjese të pasurisë në vende të mira është e dobishme, por harxhimi i tërë pasurisë në vende të këqija është e qortueshme; trimëria është e dobishme aq sa duhet për të mbrojtur veten, por nëse sulmon dhe ofendon të tjerët padrejtë është e pa dobishme.

Njëjtë është edhe me diturinë:

1. Dituritë të cilat janë të pa dobishme, qoftë pak ose shumë, janë njohuritë që nuk kanë dobi – as fetare as për jetën, kurse dëmet nga to janë më të mëdha se sa dobia, siç

është dituria për magjinë (*sihr*), shkrimi i hajmalive dhe astrologjia. Disa nga to nuk kanë kurrfarë dobie, e të kalohet jeta - dhurata më e shtrenjtë që njeriu e posedon, duke u angazhuar me to, do të ishte një humbje e pastër; e të humbet diçka e vlefshme është e qortueshme. Të tjerat shkaktojnë më shumë dëm se sa që plotësojnë nevojat e kësaj bote, e që, kur t'i bashkohen dëmit të shkaktuar nga ato dituri, aspak nuk dalin si ajo çka është pritur.

2. Ndërsa dituritë të cilat janë të dobishme, qoftë pak ose shumë, janë njohja për Qenien (Dhat) të Allahut Teala, cilësitë (*sifat*) dhe punën (*ef'al*) e Tij, për ligjin e Tij me të cilin udhëheq me krijesat e Veta, urtësinë e Tij, dhe për epërsinë e ahiretit ndaj kësaj bote.

Kjo dituri kërkohet për vetë atë dituri, por edhe për arritjen e lumturisë në botën tjetër. Të merresh me të, edhe nëse jep maksimumin, prapë nuk është aq e mjaftueshme sa do të duhej, sepse ajo është e gjerë, si det. Thellësitë e saj nuk mund të arrihen, e njeriu mund t'i afrohet brigeve të saj vetëm aq sa e i lejohet, sepse askush nuk i ka njohur fundet e saj. Vetëm Pejgamberët, evliatë dhe ata që kanë kuptuar thellësitë e diturisë kanë njohuri të vërtetë, përshtatshëm gradave të tyre, dhe sipas përcaktimit të Allahut për secilin prej tyre. Kjo është dituri e fshehtë, e pa-shënuar në libra. Kjo dituri mund të përfitohet me ndihmën e personit që posedon këtë dituri dhe duke studiuar gjendjet e dijetarëve të ahiretit, për çka do të flasim më vonë. E kjo është gjendja e parë e *salikut*.<sup>111</sup> Më vonë, në përfitimin e kësaj diturie ndihmon

---

<sup>111</sup> **Salik:** ai që shkon një rrugë të ditur/të njohur/të qartë; ai që është në rrugën e një tarikati.

përpyekja, ushtrimi shpirtëror, pastrimi i zemrës, çlirimi i zemrës nga kjo botë dhe ndjekja e rrugës së pejgamberëve dhe evliave. Së bashku me këtë, suksesi është vetëm atë që ka përcaktuar Allahu Teala. Por, angazhimi është i obligueshëm. Sepse angazhimi është çelësi i rrugës së drejtë, nuk ka qelës tjetër.

3. Sa i përket diturive që janë të dobishme për atë që ka nevojiten e teprica është e pa dobishme: janë dituritë *farzi-kifaje*, të cilat tashmë i kemi përmendur në grupin e diturive. Edhe nëse angazhohesh gjithë jetën në dituritë *farzi-kifaje*, ato prapë kanë pjesë që nuk do t'i arrish.

Prandaj bëhu njëri nga këta të dy: ose ai që merret me përmirësimin e vetes, ose ai që merret me të tjerët pasi që është përmirësuar vet. Kurrë mos u mundo të ndryshosh të tjerët nëse nuk ke ndryshuar veten. Nëse merresh me veten, merri vetëm ato degë të diturisë të cilat i ke të obliguara, përshtatshëm gjendjes tënde, si edhe ato që kanë të bëjnë me obligime të jashtme, siç është mësimi për namazin, pastrimin dhe agjërimin. Edhe më e rëndësishme është dituria të cilën të gjithë e kanë lënë pas dore - dituria për cilësitë e zemrës, njohja e anës së dobishme dhe të pa dobishme të kësaj diturie. Sepse askush nuk ka shpëtuar nga cilësitë e këqija të zemrës, siç janë lakmia, zilia, vetë-lavdërimi, mendjemadhësia, vetëpëlqimi e të tjera, e secila prej tyre është një sëmundje shkatërruese. Të merresh me veprimet e jashtme duke i lënë këto pas dore është sikur të lyhet trupi nga jashtë kur është i mbuluar me plagë dhe ciste, pa larguar qelbin, qoftë me pastrim a me prerje. Njëjtë si ndonjë mjek i pakujdesshëm që përshkruan krem për përdorim të jashtëm, edhe dijetarët imitues rekomandojnë

obligimet e jashtme duke braktisur pastrimin e zemrës. Ndërsa për të shëruar plagën në rrënjë, dijetarët e ahiretit rekomandojnë pastrimin e brendshëm, dhe dëshirojnë ta largojnë të keqen nga rrënja. Shumica e njerëzve merren vetëm me veprimet e jashtme, për shkak të lehtësisë dhe për shkak të natyrës së vështirë të pastrimit të zemrës, si rasti i personit i cili është i sëmurë në mushkëri e nuk dëshiron të pijë ilaçin e hidhët, prandaj kthehet kah lyerja e jashtme e trupit, ani pse duke lyer vazhdimisht, sëmundja vetëm shtohet.

Nëse e dëshiron ahiretin duke kërkuar shpëtim dhe duke ikur nga fatkeqësia e pafund, merru me dituritë për sëmundjet e brendshme dhe shërimin e tyre, siç i kemi shpjeguar ato në vëllimin e tretë (**Rub’u’l-muhlikat - Gjërat që shkatërrojnë**), e në vëllimin e katërt (**Rub’u’l-munxhijat - Gjërat që shpëtojnë**) kemi shpjeguar se si është e mundur ngritja në gradat e lavdërueshme.

Njëjtë si bahçja që lulëzon e jep erë të këndshme pasi të pastrohet nga shkurret e thata dhe gjembat, nuk ka dyshim që edhe zemra kur pastrohet prej veseve dhe adeteve të këqija, mbushet me virtyte. Ashtu siç nuk mund të marrësh fruta prej tokës së thatë pa e punuar, as pa e pastruar zemrën mos u merr me dituritë farzi-kifaje, sidomos nëse këtë dikush tjetër tashmë e ka marrë përsipër. Sepse budalla është ai që mundohet të ndryshojë të tjerët dhe e harron veten, është si njeriu i cili derisa akrepi dhe gjarpri i futen nën rroba, ai kërkon shtagë që të largojë mizat nga njerëzit tjerë, veprim ky që as do ta kursejë e as ta shpëtojë nga sulmi i gjarprit dhe akrepit që i janë sulur.

Që të merresh me dituritë farzi-kifaje, së pari duhet të pastrohet zemra, të braktisen gjynahet e dukshme (të jashtme) dhe të fshehta (të brendshme). Kur i realizon këto me sukses, atëherë mund të merresh me farzi-kifaje. Por duhet të respektohen rregullat e mësimi, duke filluar me Kra'nin Kerim, pastaj me sunnetin e Resulallahut s.a.v.s., pastaj me tefsirin, dhe me dituritë tjera të Kur'anit, siç është dituria për *nasih dhe mensuh, mefsul dhe mevsul, muhkem dhe muteshabih*. Metoda e njëjtë duhet të ndiqet edhe për studimin e sunnetit të Resulallahut s.a.v.s., më pas merru me studimin *furu* (dituria e degëzuar, degë e fikhut), do të thotë me dituritë e veprimit të medh'hebit. Pastaj merru me *usuli-fikh* (bazat e fikhut) dhe dituritë tjera, aq sa ke ymër. Mos e kalo gjithë jetën në vetëm një prej këtyre disiplinave, duke provuar ta kuptosh në tërë detajet, sepse dituria ka shumë pjesë, e jeta është e shkurtër. Këto dituri që shpjegoam janë vetëm mjet dhe hyrje që kërkohet për një qëllim tjetër, e njeriu duke u marrë me mjetin nuk guxon të harrojë qëllimin. Edhe nga dituria e gjuhës mjaftohu me aq sa do të të mundësojë të kuptosh Kur'anin dhe hadithet dhe të flasësh gjuhën arabe. Sa i përket sintaksës, gjithashtu kufizohu në atë që është në Kur'an dhe sunnet, sepse në çdo dituri ka tri shkallë: angazhim i kufizuar (njohuri të pakta), angazhim i matur (njohuri të mesme) dhe angazhim i plotë (njohuri e plotë). Që të mund të ofrojmë ngjashmëri me dituritë tjera, ne do t'i përshkruajmë këto shkallë në hadith, tefsir, fikh dhe kelam.

*Angazhimi i kufizuar* në tefsir (komentimin e Kur'anit) është rreth dy vëllime të Kur'anit, ngjashëm me tefsirin '*el-Vexhi*', të shkruar nga Ali el-Vahidi en-Nisaburi. *Angazhimi i matur* është rreth tri vëllime të Kur'anit, ngjashëm me veprën

*'el-Vasit'*, nga autori i njëjtë. Pos këtyre, ekziston edhe *angazhimi i plotë*, që mund të kalohet tërë jeta duke u marrë me të.

*Angazhimi i kufizuar* me hadithe ka të bëjë me përmbajtjen e haditheve të Buhariut dhe Muslimit, të cilat i ka kontrolluar ndonjë ekspert i mirë i tekstit të hadithit. Sa i përket mësimin të emrave të transmetuesve përmendësh, ata para teje të kanë kursyer nga mundimet, prandaj mund të mbështetesh në librat e tyre. Nuk ke nevojë të mbash në mend as tekstet e Buhariut dhe Muslimit, por me ta njoftohu aq sa të mundesh t'i përdorësh kur ke nevojë. *Angazhimi i matur* me hadithe, përpos Buhariut dhe Muslimit nënkupton edhe hadithet *'musned'* të Ahmed ibn. Hanbeli dhe të tjerëve. Gjithçka jashtë kësaj paraqet *angazhim të plotë*, i cili kërkon njohje të detajuar të të gjithë haditheve, përfshirë edhe hadithet e dobëta (*daif*), hadithet e forta (*kavi*), hadithet autentikë (*sahih*), të pasaktë (*sekim*), si edhe njohjen e disa rrugëve të transmetimit, bashkë me njohjen e besueshmërisë të secilit transmetues, emrat dhe cilësitë e tyre.

Sa i përket *angazhimit të kufizuar* në fikh, kjo i përshtatet përmbajtjes së veprës *'El-Musnar'* të autorit Muzeni, të cilën e kemi rregulluar dhe përfshirë në librin tonë **'Hulasetul-Muhtesar'**.

*Angazhimi i matur* është tri herë më i gjatë dhe i përshtatet materialit të cilin e kemi përfshirë në librin tonë **'El-Vesit minel-mez'heb'**, derisa *angazhimi i plotë* është paraqitur në veprën tonë **'El-Besit'** dhe vepra tjera të ngjashme.<sup>112</sup>

---

<sup>112</sup> Medh'hebi i Imam Gazalit është Shafi; për këtë arsye edhe ka dhënë shembuj nga librat e fikhut Shafi.

Sa i përket *kelamit*, qëllim i tij duhet të jetë ruajtja e parimeve themelore të besimit të cilat na kanë dorëzuar pasuesit e sunnetit të Resulallahut, s.a.v.s. (*ehlus-sunna*) dhe të parët e drejtë (*es-selefus-salih*), asgjë më shumë. Gjithçka përtej kësaj është tentim për të zbuluar të vërtetën me rrugë tjera prej rrugës së tyre. Ruajtja e sunnetit në një shkallë të kufizuar është e mundur me leximin e një libri të shkurtë të kelamit. E kjo pjesë gjendet në veprën '*Libri për themelet e besimit*' (**Kitabu kava'idil-'aka'id**). *Aspekti i mesëm* është leximi i librit të kelamit me rreth qindra fletë, siç është vepra jonë '**El-Iktisad fil i'tikad**'.

Për shkallën e mesme në dituri të kelamit ka nevojë për diskutime lidhur me personat që fusin risi në fe (bidatçinjtë) dhe për t'u ruajtur nga ndikimi i tyre në zemrat e njerëzve të rëndomtë. E ky veprim do të jetë i dobishëm për njerëzit e zakonshëm vetëm para ndikimit të fanatizmit të tyre, ngase kurrfarë fjalësh nuk do ta ndikojnë bidatçiun pasi ai të ketë fituar pak dituri për argumentimin. Bile edhe nëse e heshtni në diskutim, ai nuk do t'i braktisë idetë e tij, por do të theksojë pafuqinë e tij në diskutim, duke theksuar se si argumentet tua mund të rrëzohen, ani pse ai vet nuk është në gjendje t'i rrëzojë, sepse është i hutuar me mënyrën tuaj të diskutimit.

Por, kur dikush nga njerëzit e zakonshëm, me ndihmën e ndonjë argumenti është larguar nga e vërteta, është e mundur të kthehet, me argumente të ngjashme, sepse fanatizmi i bidatçinjëve që drejtojnë në huti ende nuk ka marrë hov. Por, nëse fanatizmi i tyre lëshon rrënjë në zemër, nuk do të jetë e mundur të kthehen të humburit, sepse mësimi i fanatizmit ngulitet thellë në mendjet e njerëzve. E kjo është një fatkeqësi nga dijetarët e këqij, të cilët mësimet e

veta të çuditshme i prezantojnë si të vërteta, dhe akuzojnë e qortojnë secilin që nuk i pranon mësimet e tyre. Mësimet e tyre shpërndahen me dhurata dhe punë të përbashkët, si dhe i kushtohen gjetjes së përkrahjes për paqartësitë e tyre në të padrejtën. Dëshira që edhe më tutje të mbahet pozita është më e fortë. E sikur këta fanatikë, individualisht t'u afroheshin kundërshtarëve të tyre, me të mirë, me simpati, dhe të këshilloheshin me ta, në vend që t'i sulmojnë me paragjykime dhe dyshime, do të arrinin sukses në qëllimet e veta. Por, meqenëse pozita kërkon pasim të verbër, e pasimi i verbër nuk prodhon gjë tjetër pos paragjykime, mallkim dhe ofendim të kundërshtarit, pikërisht atë fanatizëm e pranojnë si mënyrë të sjelljes dhe afrimit tjetrit. Më në fund, ata këtë e thërrasin 'mbrojtje të fesë' dhe 'mbrojtje të myslimanit', derisa kjo në fakt rezulton me shkatërrim të njerëzve dhe me forcim të bidateve në mendjet e tyre.

Ruaju nga kundërshtitë që janë shfaqur në kohët tona, dhe për të cilat tashmë janë shkruar plot libra, vepra dhe argumentime të cilat kurrë nuk kanë ekzistuar në kohën e gjeneratës së parë. Largohu nga to ashtu siç largohesh nga helmi vdekjeprurës, sepse janë si epidemi të rënda të cilat nuk shërohen. Pikërisht këto kundërshti i kanë drejtuar fakihët në gara, për çka do të flasim më vonë.

Për të shpëtuar veten, ata mund të thonë edhe fjalën e urtë: *"Njerëzit janë armiq të asaj që nuk e njohin"*, por mos të të mashtrojë kjo. Ke hasur në personin që di. Prandaj prano këshillën e atij i cili ka kaluar jetën në kundërshti dhe i ka tejkaluar ato në shkrime, hulumtime, argumentime dhe paraqitje, deri sa Allahu Teala nuk e frymëzoi me drejtësinë e Tij, dhe ia tregoi të metat e veta. Prandaj i braktisi ato kundërshti dhe iu kthye vetes. Mos të të mashtrojnë fjalët e

atyre që thonë se fetvatë janë shtylla të fesë, e që principet e tyre mund të kuptohen vetëm përmes debatimit. Principet e medh'hebeve gjenden në librat e medh'hebeve, dhe çkado që i shtojmë, është vetëm pengesë, të cilën nuk e kanë pasur as'habët, të cilët i kanë njohur fetvatë më mirë. Ato pengesa, jo vetëm që janë të padobishme për fenë, por janë edhe dituri të dëmshme për shijen e fikhut.

Prandaj myftiu që njeh mirë të drejtën, në shumicën e rasteve e ka të pamundur të merr vendim, e që ai vendim t'i përshtatet kushteve të debatimit. Ai të cilit debatimi i është bërë veçori gjithmonë e përdor zgjuarsinë në këtë rrugë dhe nuk mundohet të arrijë shijen e fikhut. Në fakt, me kundërshti merren ata që kanë arritur reputacion dhe dëshirojnë pozitë. E si pretekst të kësaj paraqesin kërkimin dhe shpjegimin e mesazhit të medh'hebeve. Por, me kundërshti kalojnë gjithë jetën e tyre, e nuk mundohen të kalojnë as edhe një moment duke u marrë me dituritë e fikhut. Prandaj mos u frikëso nga shejtanët xhinë, sepse ti ke qëndrim ndaj tyre, ata janë armiq haptas, por ruaje veten nga shejtanët njerëz, sepse ata kanë shkuar aq larg në mashtrim dhe në drejtim të njerëzve në errësirë, sa që dëmtojnë më shumë se sa shejtanët xhinë.

Ajo çka të urtit propozojnë është të paramendosh se je vet me Allahun në univers; para teje është vdekja, ringjallja pas vdekjes, tubimi për llogaritje para Allahut Teala, xheneti dhe xhehenemi. Shih çka nga gjithë kjo dituri të nevojitet, të tjerat refuzoi, dhe shpëto.

Një shejh kishte parë në ëndërr një dijetar, dhe i thotë:

- *Çfarë ndodhi me ato dituri për të cilat debatoje dhe argumentoje; a fitove ndonjë dobi prej tyre?* Dijetari hapi shuplakën e vet, fryu në të, dhe tha:

- *Të gjitha u zhdukën, si pluhur. Dobi pata vetëm nga dy reقاتet që i kam falë në mes të natës.*

Sipas një transmetimi, Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

**“Njerëzit që janë të udhëzuar nuk do të devijojnë, deri sa nuk grinden.”<sup>113</sup>**

Më pas, lexoi ajetin:

**“Ata ta paraqesin këtë shembull vetëm për shkak se duan të grinden, sepse janë popull grindavec”**

43-ez-Zuhruf: 58

Sipas një transmetimi, në ajetin e Kur’anit:

**“Ata, zemrat e të cilëve priren nga e pavërteta...”**

(3-Al Imran: 7),

do të thotë që këta janë njerëzit që debatojnë, e për të cilët Allahu ka thënë: **“...ruajuni prej tyre!”** (5-el-Ma’ide: 49 dhe 63-el-Munafikun: 4)<sup>114</sup>

Njëri nga gjenerata e parë e myslimanëve ka thënë:

- *Kur të vie fundi i kohës, do të ketë njerëz të cilëve do t’u mbyllën dyert e veprimit e do t’u hapen dyert e debatimit.*

Në një transmetim tjetër, thuhet:

**“Takohuni në kohën në të cilën jeni të bekuar me punë, por do të lajmërohen njerëz, të cilët duan të debatojnë.”<sup>115</sup>**

---

<sup>113</sup> Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe nga Ebu Uname.

<sup>114</sup> Hadithi është muttefekun alejhi, përcjellë hasreti Ajsha r.anha.

Kurse në hadithin e mirënjohur, thuhet:

**“Allahu më së shumti i urren ata që debatojnë shumë.”<sup>116</sup>**

Transmetimi tjetër thotë:

**“Një popull që mëson debatimin largohet nga veprimi.”<sup>117</sup>**

E Allahu Teala, natyrisht, e di më së miri.

---

<sup>115</sup> Nuk e kam gjetur hadithin

<sup>116</sup> Buhariu dhe Muslimi nga hasreti Ajsha r.anha.

<sup>117</sup> Nuk e kam gjetur hadithin.

## KAPITULLI I KATËRT

### **PËR SHKAQET PSE NJERËZIT U DREJTOHEN DITURIVE TË PA DOBISHME, SHPJEGIM I DETAJUAR I TË KËQIJAVE TË POLEMIKËS DHE DEBATIMIT SI DHE KUSHTET KUR ATO JANË TË LEJUARA**

Dije se, pas vdekjes së Resulallahut s.a.v.s., detyra e hilafetit kaloi në halifet e drejtë, (Hulefai Rashidin – Ebu Bekir, Omeri, Osmani dhe Aliu, r.a.) në ata që ishin dijetarë të vërtetë në njohjen e Allahut Teala, gjykimet e tyre bazoheshin në ligjin e Allahut, dhe ishin të pavarur në dhënien e mendimeve juridike (*fetva*). Nuk kërkonin këshillim përpos në raste të rralla e specifike. Në atë kohë, dijetarët ishin dhënë pas ditorisë së ahiretit, plotësisht të përkushtuar në të. Megjithatë, marrjen e vendimeve juridike dhe vendimeve për këtë botë ia kalonin njëri-tjetrit. Në secilin veprim, ktheheshin kah Allahu Teala, siç transmetohet në biografitë e tyre.

E kur hilafeti i tyre përfundoi, udhëheqja u ra në duar atyre që nuk e merituan, që nuk ishin të pavarur në dhënien e mendimeve juridike (*fetva*), prandaj detyroheshin të kërkonin ndihmë nga juristët (*fakih*), dhe shoqëroheshin me ta gjithë kohën, në mënyrë që këta t'u japnin *fetva* për vendimet e tyre.

Në atë kohë ende ishin gjallë disa dijetarë nga tabiinët, të cilët vazhduan me traditën e gjeneratës së parë të myslimanëve, duke theksuar pastërtinë e besimit dhe duke i qëndruar besnik asaj që ishte transmetuar nga as'habët. Kur u kërkonin fetva, tabiinët do të largoheshin, do ta refuzonin këtë. Prandaj halifet detyroheshin të insistonin në këtë, në mënyrë që tabiinët të gjykonin dhe të jepnin mendime ligjore (fetva) për ta. Kështu, bashkëkohësit e tyre e panë famën e dijetarëve, dhe se si paria dhe udhëheqësit i kërkonin. Nerëzit u nisën në kërkim të diturisë, por me qëllim që me të të arrijnë reputacion dhe famë të udhëheqësit. Plotësisht iu përkushtuan diturisë për dhënie të fetvasë, duke ia prezentuar veten qeveritarëve kërkuar prej tyre detyra, përkrarje, pozitë dhe dhurata. Disa nga ta u shkatërruan, e disa patën sukses. Ata që patën sukses nuk shpëtuan nga poshtërimet, kështu që fakihët, që dikur ishin të kërkuar, tani u bënë ata që kërkojnë. Por dijetarët e vërtetë të fesë të cilët Allahu Teala i udhëzon, gjithëherë janë të veçantë.

Në atë kohë, shumica kërkonte pozitë duke u marrë me fetva dhe gjykime, sepse udhëheqësisë kjo gjithësi i duhej.

Më vonë u lajmëruan disa kryetarë dhe udhëheqës, të cilët dëgjonin ligjëratat për parimet e besimit, dhe filloi t'ju pëlqejë të dëgjojnë dëshmitë. Ata që e kuptuan këtë interesimin të udhëheqëve u dalldisën në dituri të 'kelamit', dhe duke shkruar disa libra në këtë temë, i përcaktuan metodat e debatimit, e me artikujt e tyre hapën rrugën e kundërshtimit. Duke vepru kështu, menduan dhe deklaruan se qëllim e kanë mbrojtjen e fesë, mbrojtjen e sunnetit dhe refuzimin e atyre që sjellin risi (bidat) në fe, njëjtë siç kanë menduar ata para tyre se qëllim i angazhimit të tyre me

fetvatë është mbrojtja e fesë, kujdesi për nevojat e myslimanëve është dashuri vëllazërore dhe është këshillim.

Pas kësaj u lajmëruan disa personalitete të njohura, të cilët nuk aprovonin angazhim më të thellë në kelam dhe fillimin e debatimeve, sepse ajo çka debatimet sollën në jetë ishin fanatizmi, fëlliqësitë dhe përleshjet e mbushura me urrejtje, të cilat shkaktuan derdhje të gjakut dhe shkatërrim të qyteteve. Prandaj u kthyen kah debatimet për fikh-un dhe shpjegimin e prioriteteve të medh'hebeve, e sidomos të shkollave juridike të Shafiut dhe Ebu Hanifes, r.a.. Kështu njerëzit e lanë diturinë e kelamit (*ilmul-kelam*) dhe u kthyen kah fikhu, duke debatuar për çështjet për të cilat dijetarët, posaçërisht Shafiu dhe Ebu Hanife, kishin dallime. I arsyetonin ndarjet mes Imam Malikiut, Sufjan Sevriut, Ahmed b. Hanbelit, e të tjerë, Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata. Duke bërë kështu, mendonin se qëllimin e kanë të sqarojnë hollësisht e sheriatit dhe justifikimin e shkollave juridike (*medh'heb*), si edhe lehtësimin e bazave për marrjen e vendimeve ligjore (fetva). Shumë u shkrua dhe u fol për këtë, prandaj u përcaktuan mënyrat (metodat) e debatimit dhe të shkrimit, që ka mbetur deri në ditët e sotme, e nuk e dimë se çka është në caktimin e Allahut Teala dhe çka do të ndodhë në të ardhmen.

Pra, animi i dijetarëve në këto dituri është vetëm nga interesimi i udhëheqësve për to. E sikur udhëheqësit e kësaj bote të ktheheshin kah medh'hebet ose dituritë tjera, njëjtë do të ndodhte; edhe ata (dijetarët) do të drejtohen kah ato dituri dhe do të arsyetoheshin se ajo me çka merren është dituri fetare dhe që ata nuk dëshirojnë asgjë tjetër pos afrimit Allahut Teala.

SHPJEGIM SE SI PËRNGJAJNË DHE PËRZIHEN  
DEBATIMET ME KËSHILLIMIN E AS'HABËVE DHE BISEDAT MES  
SELEFËVE

Dije se ata që vazhdimisht i udhëzojnë njerëzit në këtë rrugë thonë: *“qëllim i debatimeve tona është kërkimi i të vërtetës, që ajo të jetë e qartë; e vërteta është qëllimi, kurse përkrahja e ndërsjellë në debatimet për dituritë dhe shkëmbimi i mendimeve personale është e dobishme dhe e ka efektin e vet. Ky ishte zakoni i as'habëve r.a., në marrëveshjet e tyre, si për shembull në debatimet e tyre për gjyshërit dhe vëllezërit, dënimin për konsumim të alkoolit dhe obligimet e dënimit me të holla për imamin kur ai të gabojë, siç na është transmetuar kur një gruaje i dështoi shtatzënia sepse ishte frikësuar nga hazreti Omeri r.a., ose siç transmetohet për çështje të ndryshme nga e drejta e trashëgimisë, dhe disiplinat tjera, si edhe siç transmetohet nga Shafiu, Ahmedi, Muhammed ibn Hasani, Malikiu, Ebu Jusufi dhe dijetarët tjerë, Allahu i mëshiroftë.”*

Me këtë që do ta shpjegoj, përzierjen e tyre do ta kuptosh me lehtësi. Ndhima e ndërsjellë në kërkim të së vërtetës është pjesë e fesë. Por, kjo ka tetë kushte dhe shenja:

*E para*, që personi të mos merret me këto çështje që janë farzi-kifaje, nëse nuk e ka përmbushur farzin ajn, ose personi i cili duhet të kryej farzin ajn, merret me farzin kifaje, duke paramenduar se qëllim i punës së tij është arritja e të vërtetës, e në fakt, ai del gënjeshtar i madh. Shembull për këtë është ai që e lë namazin e merret me qepjen e rrobave duke thënë se me këtë dëshiron të mbuloj avret-in e atij që falet pa rroba. Kjo edhe ndoshta do të mund të ndodhte,

ashtu siç mendon fakihu se disa gjëra të rralla mund të ndodhin përbrenda ndasive ligjore. Megjithatë, ata që merren me debatim, plotësisht e lënë anash farzin ajn. Ai nga i cili kërkohet kthim i menjëhershëm i borxhit, e në vend të kësaj ai fillon të falë namazin, që është vepra më e mirë që afron Allahut Teala, në fakt, në këtë rast, është duke gabuar. Në mënyrë që njeriu t'i jetë i nënshtruar Allahut Teala, nuk mjafton vetëm të bëhen vepra të nënshtrimit, nëse nuk i kushtohet rëndësi edhe kohës, kushteve dhe renditjes.

*E dyta*, që farzi-kifaje të mos shihet si më i rëndësishëm se debatimi. Nëse njeriu konsideron diçka si të rëndësishme, por bën diçka tjetër, me atë veprim ai gabon. I ngjashëm me këtë person është ai që e sheh një grup njerëzish të etur për vdekje, e personi në fjalë mund t'i kthejë ata në jetë duke pasur ende mundësi për të gjetur ujë, por ky vendos t'i mësojë njerëzit se si lëshohet gjaku (*hixham*), duke menduar se ky është farzi-kifaje dhe se si njerëzit do të shkatërroheshin sikur në qytet të mos kishte të tillë që dinë për *hixham*. E sikur t'i thuhej se në qytet ka mjaftueshëm njerëz që merren me *hixham*, ai prap do të thoshte se veprimi i tij nuk është jashtë farzi-kifajes. Shembulli i atij që vepron kështu, duke lënë anash marrjen me problemin e myslimanëve të etur, është si shembulli i atij që merret me debatim, e në qytetin e tij ka aq shumë farze-kifaje të cilat janë lënë pas dore, dhe për të cilat askush nuk kujdeset.

Sa i përket dhënies së fetvasë, me këtë veç se merret një grup i caktuar, kurse në secilin qytet ka ndonjë obligim të lënë pas dore, në të cilën juristët aspak nuk fokusohen, e shembulli më i mirë është medicina. Në shumicën e krahinave nuk ka mjek mysliman, në fjalën e të cilit, sipas sheriatit, do të

mund të besohej. Asnjëri prej atyre juristëve (fakihëve) nuk është i interesuar të merret me këto çështje.

Njëjtë është me urdhërimin e të mirës dhe me largim nga e keqja (emri ma'ruf, nehji munkur), që është farzi-kifaje. Mund të ndodh që personi i cili debaton të gjendet në një fshat ku sheh se vishet e përdoret mëndafshi (nga meshkujt), e ky hesht për këtë, por debaton për ndonjë problem i cili as nuk do të ndodhë, e nëse ndodh, ndonjë grup fakihësh tashmë do të merrej me këtë, e bile edhe mendon se si kështu është duke iu afruar Allahut Teala me farzi-kifaje.

Nga Enesi r.a., transmetohet se e kanë pyetur Resulallahun s.a.v.s.:

- *Ja Resulallah, kur braktiset urdhërimi i të mirës dhe largimi nga e keqja?* Resulallahu s.a.v.s., u përgjigj:

**- Kur të lajmërohet mos-intersimi për mbrojtje nga personat e hairit mes jush, kur shumëzohet zinjat në mesin tuaj nga njerëzit e këqij, kur qeverisja i kalon shtresës së ulët dhe dituria e fikhut të kalojë në duart e të pandershmëve.**

E treta, që ai i cili hyn në debatim duhet të jetë muxhtehid, dhe i cili jep fetva sipas mendimit të vet, e jo sipas medh'hebit të Shafiut, Hanefisë, e të tjerëve. Kështu që kur të hyjë në debatim për një çështje nuk duhet të merr dëshmi prej Imam Hanefisë, kur dëshmia është e nevojshme prej Imam Shafiut. Duhet të veprojë ashtu siç kanë vepruar as'habët dhe imamët.

Nëse gjen dobësi në ixhtihadin e imamet të tij, nuk i lejohet që atë dobësi ta lë anash. Çfarë dobie ka në debatim nëse ai nuk është në gjendje që vet të sjell fetva, e medh'hebi i personit është i njohur. Kur diçka e ka të paqartë duhet të thotë:

- *Ndoshta themeluesi i shkollës time (Imami i madh'hebit tim) ka përgjigje në këtë, por unë nuk jam në gjendje që vet të gjykoj sepse nuk jam muxtehidi.*

Nëse për çështjen që debatohet ekzistojnë dy mendime të themeluesve të medh'hebit të tij, nganjëherë duke anuar në një drejtim mund të thotë: *'nga këndvështrimi im kjo është më e përshtatshme.'* Por debatuesit e sotëm nuk afrohen asesi për çështjet e ngjashme, aq më shumë, qëndrojnë në çështjet që janë kategorikisht të ndara.

E katërta, që të mos debatohet, përpos për problemin i cili është shfaqur ose është e mundur të shfaqet. Sepse as'habët r.a. nuk bënëin këshillim, përpos kur do të ndodhte diçka e re, siç është rasti me të drejtën trashëguese (*feraiz*), ose për një problem që mund të ndodhë së shpejti. Kurse debatuesi i sotëm nuk merret me problemet që njerëzit i kanë, e debaton mbarë-e-mbrapsht për problemet që mund të ndodhin, me ç'rast shkaktohen telashe, por ai dëshiron spektakël duke krijuar hapësira për debatim për çështjet të panevojshme, e anashkalon diçka që haset shpesh, duke thënë se kjo është njoftim; domethënë *'filani ka transmetuar, në filan libër shkruan, këto janë çështje që s'bien në sy. Në një shoqëri të tilla nuk janë çështjet që kanë vlerë për diskutim.'* Nëse nga debatimi qëllim është të kërkohet e vërteta, e për gjetje të së vërtetës mbështetet në njofimet të cila vijnë nga gjenerata e parë (selef), atëherë të thuhet: *'kjo çështje është njoftim'* ose *'kjo është çështje që s'bie në sy, nuk ka vlerë të diskutohet në këtë tubim'*, e të anashkalohet diçka që haset shpesh, vërtetë është e çuditshme.

*E pesta*, që debatimi të bëhet në vend të izoluar, që është më e dëshiruar dhe më e rëndësishme, se sa para udhëheqësve dhe popullit. Sepse vendi i izoluar është më i

përshtatshëm për mendje të kthjellët, për të menduar dhe për njohjen e të vërtetës. Debatimi mes popullit lind rrezikun për t'u dukur në sytë e të tjerëve dhe synimin për të dalë me çdo kusht mbi të tjerët në përpjekjet për të arritur qëllimin, qoftë fjala për drejtësi, ose jo. Por ti e di që dëshira e tyre për debatim në tubime dhe para udhëheqësve nuk është për rizanë e Allahut Teala. Secili prej tyre rri vetëm me shokun e tij për një kohë të gjatë e nuk flet me të, ndoshta edhe e pyet diçka, por ky tjetri nuk përgjigjet. Por, nëse vjen njëri nga udhëheqësit ose ndodhë ndonjë tubim, ai nuk do të ngurrojë të flasë lloj-lloj mashtrimi, deri në atë masë që të dominojë gjithë debatimin.

*E gjashta*, që personi i cili debaton, në kërkimin e së vërtetës duhet të jetë njëjtë sikur personi që kërkon diçka që ka humbur – nuk e ka me rendësi a do ta gjej vet apo do t'i ndihmojë dikush; kolegun e konsideron si ndihmës, e jo si kundërshtar, dhe falënderon çdo herë kur i tregohet për ndonjë gabim ose i zbulohet e vërteta. Kështu, nëse vazhdon të kërkojë sendin e humbur, e kolegu i tregon drejtimin, nuk duhet ta kritikojë, por duhet ta falënderojë, duke i shprehur nderim dhe duke qenë i kënaqur me të.

Kështu kanë vepruar as'habët r.a.. Me një rast, derisa hazreti Omeri r.a. ishte në hutbe, e ndërpreu një grua dhe ia tregoi gabimin që Omeri r.a. e kishte bërë. Në këtë, Omeri r.a. tha:

- *Gruaja ka të drejtë, burri gaboi*, duke shprehur kënaqësinë.

Në një rast tjetër, një person e pyeti diçka hazreti Alinë r.a., e kur hazreti Alia iu përgjigj, ky i tha:

- *Nuk është ashtu, o udhëheqës i besimtarëve, por kështu është. Në këtë, hazreti Alia r.a., tha:*

- *Ti ke të drejtë, unë gabova. Për secilin dijetar ka tjetër dijetar edhe më të dijsëm.*

Hazreti Ibn Mesud r.a., e përmirësoi një herë hazreti Ebu Musa el-Esh'shariun r.a. Tregohet se Ebu Musa el-Esh'sharin e kishin pyetur për fatin e atij që ka vdekur në rrugën e Allahut, e ky ishte përgjigjur:

- *Do të hyjë në xhenet.* Në atë kohë Ebu Musa el-Esh'shariu ka qenë në pozitën e drejtuesit të Kufës. Hazreti Ibn Mesud u ngrit, dhe tha:

- *Përsëriteni pyetjen për udhëheqësin. Ndoshta nuk e ka kuptuar.* Kur ia përsëritën pyetjen, hazreti Musa dha përgjigjen e njëjtë. Në këtë, Ibn Mesud tha:

- *Sipas mendimit tim, personi shkon në xhenet nëse në momentin e vdekjes ka qenë plotësisht i sinqertë.* Hazreti Ebu Musa tha:

- *E vërtetë është kjo. Mos kërkon mendimin tim, kur me ju është një autoritet i këtillë.*

E tillë duhet të jetë drejtësia e atij që kërkon të vërtetën. Nëse diçka e këtillë do t'i përmendej sot ndonjë juristi, qoftë edhe jo aq të njohur, do të refuzonte dhe do të thoshte se kjo është e pahijshme. Gjithashtu do të thoshte se aspak nuk ka nevojë që ai rast të kushtëzohet me sinqeritet sepse secili e di që kjo gjithsesi nënkuptohet.

Prandaj ti krahaso debatuesit e sotëm, se si u skuqet fytyra sa herë që kundërshtari i tyre të ketë gjetur të vërtetën, dhe se si japin gjithçka nga vetja duke dashur që të diskreditojnë kundërshtarin në debatim, dhe në fund nuk kanë turp që të krahasojnë veten me as'habët në kërkimin e së vërtetës.

*E shtata*, personi që debaton nuk duhet të pengojë kundërshtarin të kalojë prej një dëshmie në një dëshmi tjetër, prej një problemi në një problem tjetër, me qëllim që diskutimi të ngjasojë me diskutimet e të parëve të ndershëm. Sepse debatimet e të parëve të ndershëm ishin në këtë mënyrë. Personi që debaton do të duhej gjithashtu që nga argumentet e veta të largojë fjalët risi (bidat) që nuk janë në përputhje me fenë, qoftë kjo fjalë në favor ose kundër tij. Kështu për shembull, nuk do të duhej të thotë; *‘kjo fjalë nuk më obligon mua, por ti je në kundërshti.’* Sepse kthimi te e vërteta gjithmonë anulon fjalën boshe. Por në tubimet e sotme rrjedha e debatimeve gjithmonë kalon në fjalim dhe në përplasje mendimesh. Bile, nëse personi që debaton mendon se ka sjell një dëshmi, ai menjëherë deklaron se sipas mendimit të tij është dëmtuar një parim themelor i fesë. E kur të pyetet (nga kundërshtari) për dëshmi me të cilën arsyeton se është dëmtuar parimi me atë shkaktar, do të thotë që kjo është diçka që ai vet e ka zbuluar dhe do të thotë: *“Nëse ti zbulon diçka më të qartë a më të mirë, shpalose këtu që unë të mund ta shqyrtoj atë.”* Edhe duke thënë: *“Unë e di që ka aty edhe shumëçka tjetër, përpos kësaj por, unë nuk do t’i përmend ato, dhe asgjë nuk më obligon për këtë.”* E kundërshtari do të thotë: *“Është obligim i juaj që të përmendësh shkaktarin për të cilin flet.”* E ai edhe më tutje do të insistojë që nuk ka obligim dhe debati përfundon me fjalë të tilla boshe.

E i gori nuk është i vetëdijshëm që fjalët e tij: *“Unë di, por nuk jam i obliguar ta përmend.”* janë gënjeshtër në sheriat. Pra, sikur ai të mos e dinte kuptimin (e asaj që nuk dëshiron ta përmend) por atë e thotë vetëm me qëllim që ta heshtë kundërshtarin, ai është gjynahqar, gënjeshtar i

vërtetë, është kryengritës ndaj Allahut Teala, dhe meriton hidhërimin e Tij me atë që pohon se di diçka, për të cilën në fakt nuk di. Edhe sikur ta dijë, prap do të ishte gjynahqar, sepse fshehë atë që është e njohur në shariat, e vëllai mysliman e kishte pyetur me qëllim që të kuptojë, dhe të ketë pasqyrë më të mirë të situatës, dhe po të ishte argumenti i fortë, do të vepronte bazuar në të - e po të ishte i dobët, do t'i tregonte këtij dobësinë, dhe do ta nxirrte nga terri i paditurisë në dritën e njohjes. Kur shtrohet pyetja për një çështje fetare, është mendim unanim se duhet treguar. Kurse me fjalët e tij *“Nuk jam i obliguar”*, dëshiron të thotë: *“debatimi të cilin nisëm me fuqinë e pasionit dhe dëshirës, me anë të mashtrimeve dhe kacafytjes, nuk më obligon, përndryshe do të isha i obliguar me shariat”*, e duke mos treguar, ai ose është gënjeshtar ose gjynahqar.

Shih vetëm debatimet e as'habëve r.a. dhe të të parëve, Allahu qoftë i kënaqur me ta, a ke parë ndonjëherë që ata të sillen kështu dhe a i ka ndërhyrë ndonjëri nga ta atij që kalon nga një argument në tjetrin, ose nga logjika në traditë, ose nga hadithi në ajet? Ndoshta të gjitha debatimet e tyre ishin të kësaj natyre. Sepse në të gjitha debatimet i kanë përmendur të gjitha që i kanë ditur dhe kan bërë analizën e asaj qështjeje.

*E teta*, të hyjë në debatim me atë person nga i cili mund të pritet dobi, me atë që mirret me dituri. E në të shumtën e rasteve njerëzit hezitojnë të futen në debatim me më të vjetrit dhe me njerëzit e mëdhenj, duke u frikësuar që përmes gjuhëve të tyre të mos shfaqet e vërteta, prandaj nxitojnë në debate me atë që është nën ta, me dëshirë të zjarhtë për të plasuar të pavërtetën.

Përpos këtyre, ekzistojnë edhe shumë kushte më delikate. Megjithatë, këto tetë kushte mjaftojnë të të drejtojnë, të tregojnë se kush futet në diskutim për rizanë e Allahut, e kush për ndonjë qëllim tjetër.

Me një fjalë, ai që nuk futet në debatim me shejtanin, me armikun më të ashpër, i cili ka mbuluar zemrën e tij, dhe pandërprerë e fton në humbje, e më pas angazhohet në debatim për probleme për të cilat muxhtehidi tashmë ka sjellë zgjidhje të drejtë, edhe nëse ka hise në shpërblim për angazhim në debatim për problemin, të tillit shejtani i qeshet, e kjo gjithashtu është edhe mësim për të sinqertët. Shejtani i gëzohet fatkeqësisë së tij – se si është zhytur në errësirën e të këqijave, të cilat do t'i përmendim dhe do ti shtjellojmë në detaje.

E lusim Allahun Teala për ndihmë dhe udhëzim në rrugë të drejtë.

SHPJEGIM PËR TË KËQIJAT E DEBATIMIT  
DHE TË ASAJ ÇFARË LIND NGA DEBATIMI, E QË E PRISH  
AHLAKUN

Kupto mirë që - debatimi me qëllim për të mbizotëruar, për të heshtur tjetrin, për shfaqjen e vlerave dhe nderit tënd, fjalimit të zbukuruar para njerëzve, me qëllim të vetë-lavdërimit si dhe të tërheqjes së vëmendjes së njerëzve, është burim i të gjithë parimeve të këqija morale - edukatës së keqe, që te Allahu Teala është e urryer, e te armiku i Tij, Iblisi – e lavdëruar.

Marrëdhënia e debatimit krahas mendjemadhësisë, lakmisë, konkurrencës, vetë-arsyetimit, dashurisë për pozitë, etj, është si marrëdhënia e pirjes së venës krahas shëmtisë së jashtme, siç janë shkelja e kurorës (zina), shpifje të poshtra ndaj gruas së moralshme (kazf), vrasja dhe hajnia. Njëjtë si ai të cilit i është dhënë zgjedhja në mes të pijes, shfrenimit dhe fëlliqësive tjera, pijen e merr si e keqe më e vogël, fillon të pijë alkool, e në gjendje të dehur – alkooli e shtyen drejt bërjes edhe të fëlliqësive tjera. Njëjtë është edhe me atë të i cili dominon dashuria ndaj famës, ndaj mbizotërimit në debatim, kërkimit të pozitës dhe lavdërimit, që e drejtojnë kah ndyrësitat tjera dhe i ndezin atij të gjitha sjelljet tjera të shëmtuara. Dëshmitë e mospëlqimit të këtyre sjelljeve do t'i sjellim përmes haditheve dhe ajeteve, kurse në tërësi në kapitullin *“Gjërat që qojnë në humbje”* (el-Muhlikat).

Por ne tani do të tregojmë se çka lind nga debatimi, e njëra nga to është edhe xhelozia (*hased*). Resulallahu s.a.v.s. ka thënë:

**“ Si djeg zjarri drunin, edhe xhelozia djeg veprat e mira.”**

1. Personi që debaton assesi nuk mund të çlirohet nga xhelozia, sepse nganjëherë fiton ai e nganjëherë kundërshtari, nganjëherë lavdërohen fjalët e tij, e nganjëherë fjalët e kundërshtarit. Deri sa në këtë botë ekziston dikush që përmendet për fuqinë e diturisë, ose mendon se tjetri është më i mirë në të folur dhe më i fortë në debatim, xhelozon, dëshiron të mirat që tjetri i ka, dëshiron që fytyrat dhe zemrat e njerëzve të kthehen prej tjetrit kah ky. Xhelozia është zjarr që djeg, prandaj kush preket nga sëmundja e xhelozisë, edhe në këtë botë është në vuajtje, kurse vuajtja në ahiret është edhe më e fortë e më e madhe. Prandaj kush sprovohet me të, ai i është ekspozuar dënimit në këtë botë, kurse dënimi i ahiretit është edhe më i fortë e më i madh. Prandaj Ibn Abbas ka thënë:

*- Merrni diturinë, kudo që të gjendet, kurse mos pranoni të folurit e fakihëve për njëri-tjetrin, sepse ata kanë xhelozin ndaj njëri-tjetrit, njëjtë siç ka xhelozin cjapi ndaj cjapit në livadh.”*

2. E keqe e debatimit është edhe mbivlerësimi i vetes, mendjemadhësia (*tekebbur*), dhe vetëlavdërimi. Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

**“Kush mbivlerëson veten, Allahu Teala do ta poshtërojë, e kush është i përulur, Allahu Teala do ta lartësojë.”**

Në hadith-kudsij thuhet:

**“Madhështia është këmisha Ime, e Lartësimi është xhybeja Ime; kush garon me Mua në këtë – do Ta shkatërroj.”**

Personi që debaton nuk mund ta frenojë veten karshi mendjemadhësisë së moshatarit të tij dhe atij të ngjashëm me të, e as nga ngritja më lartë se vlerat e tij. Debatuesit garojnë në lartësim të vetes dhe poshtërim të tjetrit, bile deri në atë masë sa që në tubime garojnë mes vete se kush është ulur më lartë e kush më poshtë. Ata garojnë bile edhe për atë se cili do të kalojë i pari në rrugicë të ngushtë. Lavdërohen kur kalojnë përpara, e mërzen nëse ngelin mbrapa, gjithmonë dëshirojnë të jenë përpara. Për këtë shfajësohen me atë se vetëm po tentojnë të ruajnë nderin e diturisë dhe se, siç thotë hadithi:

**“Muminit i është ndaluar të përulë veten.”**

Pra, modestinë të cilën Allahu Teala dhe pejgamberët e Tij e kanë lavdëruar, i tilli e prezanton si të ulët, kurse mendjemadhësinë të cilën Allahu Teala e urren, e prezanton si vlerë të fesë, duke e shtrembëruar kuptimin bazë, duke mashtruar kështu njerëzit, siç ka ndodhur me termet *hikmet* (urtësi), *ilm* (dituri), dhe terme tjera.

3. E keqe e debatimit është edhe urrejtja (*hikd*). Ai që debaton, gati që nuk mund t’i shpëtojë urrejtjes. Muhammedi s.a.v.s., ka thënë:

**“Besimtari nuk është dashakeq.”**

Aq shumë është thënë për mospëlqimin e urrejtjes, sa që nuk mund të numërohen. Ai që debaton nuk mund të fshehë xhelozinë në fytyrën e tij kur dikush pohon me kokë derisa kundërshtari i këtij flet, dhe kur kundërshtari ndalet, kjo i pëlqen dhe e gëzon. Bile, detyrohet të fshehë urrejtjen e tij dhe ta shtrydhë atë brenda vetes, e rezultat i kësaj fshehjeje është edhe fshehja e dyfytyrësisë, por kjo, në të shumtën e rasteve, del në shesh. Si është e mundur të shpëtojë dikush nga kjo, kur nuk është e mundur të paramendohet unanimiteti i të gjithë dëgjuesve në përkrahje të fjalës së tij dhe të pëlqehen nga dëgjuesit të gjitha gjendjet e tij? Aq më shumë, sikur nga kundërshtari i tij të vinte edhe arsyeja më e vogël me të cilën zhvlerësohet të folurit e tij, menjëherë në zemër do t'i lajmërohej fara e të urrejtjes, të cilën nuk do ta shrrënjosë për jetë e mot.

4. Të këqija janë edhe thashethemet (*gijbet*), të cilën Allahu Teala e krahasoi me të ngrënit e mishit të cofëtinës, e ai që debaton pandërprerë ha cofëtinë sepse nuk ndalon vetën nga citimi i fjalëve të kundërshtarit, duke folur keq për të. Kulmi i një fanatizmi të tillë është që beson në gjithçka të keqe - edhe në gënjeshtër - që thuhet për kundërshtarin e tij, dhe asgjë prej kësaj nuk e merr me rezervë, por patjetër flet për mangësitë në deklaratimet e tij, për paaftësinë dhe vlerën e ulët të personalitetit të tij, zaten kjo është thashetheme (*gijbet*). Nëse gënjen, atëherë ka shpifë. Kështu personi nuk mund të ruajë gjuhën nga sulmi në nderin e secilit që e kundërshton, e i drejtohet kundërshtarit duke i përshkuar atij edhe paditurinë, budallakinë, kuptimin e dobët dhe mendjengurtësinë.

5. E keqe e debatimit është edhe lavdërimi i vetes. Allahu Teala thotë:

**“Pra mos lavdëroni veten, se Ai e di kush është më i ruajtur.”** 53-en-Nexhm: 32

E pyetën një të urtë se çka është sinqeritet i mospëlqyer, e ai u përgjigj: *“Lavdërimi i vetes”,* e ai që debaton nuk mundet e të mos e lavdërojë veten duke thënë: *“Unë kam dituri më shumë, mund të mposhti kundërshtarin”,* dhe gjatë debatimit nuk mundet e të mos thotë: *“Nuk është që gjëra të këtilla më janë të panjohura, unë jam specializuar për këto dituri dhe për hadithe”,* si edhe fjalë tjera me të cilat lavdërohet, nganjëherë prej dëshirës për vetë-lavdërim, e nganjëherë nga nevoja, e krejt kjo me qëllim që ta bëjë të folurit e tij më të popullarizuar. Është e ditur që mendjemadhësia dhe vetëlavdërimi janë të urreyera, edhe me shariat edhe me logjikë.

6. E keqe e debatimit është edhe spiunimi (*texhessus*) dhe hulumtimi i të metave të njerëzve. Allahu Teala urdhëron:

**“Mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njëritjetrit.”** 49-el-Huxhurat: 12

Personi që debaton, nuk mund të kursehet nga kërkimi i gabimeve të bashkëkohësve të tij, dhe hulumton privatësinë e kundërshtarit, deri në atë masë që, kur dikush e lajmëron për ardhjen e kundërshtarit të tij në qytet, do ta kërkojë dikë që ta njoftojë me të metat e fshehta të atij kundërshtari, duke e konsideruar si pasuri personale turpërimin dhe poshtërimin e kundërshtarit, sapo t’i jepet mundësia. Kjo shkon aq larg sa që

hulumton edhe fëmijërinë e hershme të kundërshtarit, të metat e mundshme trupore, mos rastësisht po gjen ndonjë detaj ose do të vërtetojë ndonjë mangësi, si humbja e flokëve ose çfarëdo qoftë. Më pas, nëse heton edhe tentimin më të vogël për dominim nga ana e kundërshtarit, do ti tregojë mangësitë e tij, që do t'ju pëlqejë të tjerëve, dhe do ta marrin si njohuri e shkëlqyeshme e debatuesit. Asgjë nuk e ndalon që edhe më tutje të nënçmojë, duke u krenuar me budallakinë e tij dhe me nënçmimin e kundërshtarit. Kështu flitet për debatuesit që njihen si më të mirët në profesionin e tyre.

7. E keqe e debatimit është edhe gëzimi kur pikëllohen të tjerët dhe dëshpërimi kur të tjerët janë të lumtur. Ndërsa ai që nuk ia do vëllait mysliman atë që e dëshiron për vete, ai është larg nga ahlaku i besimtarit. Secili që anon kah vetëlavdërimi me theksimin e vlerave të veta, pa dyshim se do ta gëzojë kundërshtarin e tij dhe atë të ngjashëm me të. Ata që garojnë në arritjen e famës, urrejtja mes tyre bëhet si urrejta mes shemrave. (ortakeve, grave të një burri) - kur njëra e sheh tjetrën nga largësia, i ngritën flokët në kokë dhe zverdhet e tëra. Ashtu edhe personi që debaton, ndërron ngjyrë kur e sheh kundërshtarin, gjithfarë mendime i kalojnë nëpër kokë, sikur të kishte parë shejtanin e mallkuar ose ndonjë bishë gjakatare.

Ku janë këtu miqësia dhe lehtësimi që ishte prezente mes dijetarëve të fesë kur takoheshin, dhe ajo që na transmetohet për vëllazërinë e tyre, ndihmën e ndërsjellë dhe ndarjen e të mirës dhe të keqes? Bile Imam Shafiu r.a. ka thënë: *“Dituria është mjet i afrimit dhe miqësisë mes atyre që kuptojnë”*. Si mundën disa të thonë se ndjekin medh’hebin e Imam Shafiut, kurse dituria mes atyre të të njëjtit medh’heb

është si një armiqësi e egër? A mundet fare të paramendohet që të tillëve të ju shfaqet afërsia (*uns*) krahas dëshirës së zjarhtë të tyre për mbizotërim dhe vet-lavdërim? Ah, sa larg është kjo! Sa shumë njerëz ka në përshtatje ahlakut të dyfytirëshit, dhe në privim nga ahlaku i pejgamberëve dhe i atyre që i frikësohen Allahut Teala.

8. E keqe e debatimit është edhe dyfytirësia. Nuk ka nevojë të dëgjohet dëshmi për të kuptuar të keqen e dyfytirësisë, e ata që debatojnë gjithsesi se bëhen dyfytirësh. Ngase kur debatuesi takohet me kundërshtarët, simpatizerët dhe përkrahësit e kundërshtarit, me gjuhë shfaq nderim, sinqeritet e miqësi ndaj tyre dhe lavdëron pozitat dhe gjendjet të tyre. Kurse, edhe folësi edhe bashkëfolësi, si edhe të gjithë që dëgjojnë e dinë që kjo është gënjeshtër, mashtrim, dyfytirësi dhe dredhi. Me fjalë joshen, e me zemër urrehen, Allahu Teala na mbrojtë nga kjo! Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Kur njerëzit fitojnë dituri dhe braktisin veprat, me fjalë shprehin lavdërime për njëri-tjetrin e me zemra urrehen mes vete, ndërpresin lidhjet farefisnore, atëherë Allahu Teala do t’i mallkojë, e do t’i bëjë të shurdhër e të verbër.”**

E gjitha kjo është vërtetuar me dëshmi në gjendjen tonë të tanishme.

9. E keqe e debatimit është edhe refuzimi i të vërtetës, mosdashja e të vërtetës dhe dëshira për pengesa, deri në atë masë që më e urryera për debatuesin është tregimi i të vërtetës nga gjuha e kundërshtarit të tij. Për ta rrëzuar tezën e kundërshtarit kërkon çdo lloj mashtrimi dhe çfarëdo

zgjidhje, deri sa kjo i bëhet adet i tij. Atëherë nuk dëgjon kurfarë fjalimi e që brenda tij të mos ngjallet impulsi i kundërshtimit, deri sa që fillon edhe me zemër të kundërshtojë dëshmitë e Kur'anit dhe rregullat e sheriatit, dhe të kundërshtojë ato mes vete. Grindja karshi gënjeshtërsë është gjithashtu e urryer, sepse Resulallahu s.a.v.s., ka rekomanduar evitimin e grindjes, qoftë edhe kur është në pyetje e vërteta karshi gënjeshtërsë, duke thënë:

**“Kush i ikë grindjes, e ka faj, Allahu Teala ia ndërton shtëpinë në pjesën e ulët të xhenetit, e kush i ikë grindjes kur ka të drejtë, Allahu Teala ia ndërton shtëpinë në pjesën më të lartë të xhenetit.”**

Allahu Teala i ka barazuar ata që gënjejnë për Allahun dhe ata që e mohojnë të vërtetën:

**“Kush është keqbërës më i madh se ai që trillon gënjeshtër kundër Allahut ose mohon të vërtetën që i ka ardhur?!”** 29-Ankebut: 68

Gjithashtu thotë:

**“Kush është më i keq se ai që trillon gënjeshtër për Allahun dhe hedh poshtë të Vërtetën (Kur'anin), kur ajo i vjen atij?!”** 39 ez-Zumer: 32

10. E keqe e debatimit është edhe *rija*. Rijallëku është dëshira që bota të të sheh, si dhe angazhimi në tërheqjen e zemrave të njerëzve e duke harruar rizanë e Allahut Teala. Rijallëku është helm i keq që dërgon në gjynahet më të mëdha, për çka posaçërisht do të flasim në *Librin për Rija*. Ai që debaton qëllim të vetëm ka që të tregohet para të tjerëve dhe të lavdërohet nga ata.

Këto dhjetë gjëra të këqija që i cekëm janë nga sëmundjet e mëdha të brendshme (të ahlakut) të debatuesve, duke përjashtuar të tjerët që nuk kanë vlerë mes njerëzve, e kjo shkon deri te përleshjet fizike, dëmtimi, shuplakat, grisja e rrobave, tërheqja për mjekër, sharja e prindërve dhe mësuesit, dhe përdorimi i shprehjeve të këqija. Njerëzit e tillë nuk meritojnë respekt, bile edhe paria e tyre, të kuptueshmit në mesin e tyre, nuk janë të kursyer nga këto dhjetë sëmundje. Dorën në zemër, disa nga ta nganjëherë kanë shpëtuar nga disa prej këtyre sëmundjeve kur janë para atij që qartas është nën ta, ose qartas mbi ta; ose larg nga qyteti i tyre. Por ata që kanë pozita të njëjta assesi nuk mund të vetëpërmbahen nga këto të këqija.

Tutje, nga secila prej këtyre dhjetë gjërave të këqija lindin dhjetë vese tjera të këqija, në të cilat nuk do të thellohem dhe nuk do t'i shpjegojmë në detaje, por vetëm t'i përmendim, si ashpërsia, zemërimi, urrejtja, lakmia, dëshira për pasuri dhe pozitë, mendjemadhësia, koprracia, kotësia, lavdërimi i të pasurve dhe udhëheqësve bashkë me vizitën atyre dhe me marrjen nga harami i tyre, zbukurimi i mjeteve të transportit, veshja e rrobave të mospëlqyera, nënçmimi i të tjerëve me vetë-lavdërim e vetë-lartësim, marrja me atë që nuk i përket, llafazanëria, zhdukja e pendimit, frikës dhe mëshirës nga zemra, pakujdesi deri në atë masë që ai që falet e nuk e di as çka është duke falur, as çka po lexon, as kujt po i drejtohet, duke mos ndjerë pendim në zemër edhe nëse gjithë jetën e ka kaluar në marrjen e diturisë që i ndihmojnë në debatim, edhe pse nuk i sjellin kurfarë dobie në ahiret. Ata që debatojnë ndahen në këto vese të këqija, përshtatshëm gjendjeve të tyre që janë të lloj-llojshme, kurse as ai me fenë më të fortë dhe me kuptimin më të mirë mes tyre nuk është i kursyer nga grupi i veseve të përmendura. Arritja më e madhe e tij është t'i fshehë ato, dhe lufta me neftin e vet.

Dije se këto gjëra të këqija ndodhen gjithsesi edhe te ai i cili merret me vaz, sepse qëllimi i tij është që të jetë i pranuar, të fitojë reputacion, pasuri dhe nder. Bile edhe te ai që merret me diturinë e medh'hebeve dhe me fetva, sepse ka për qëllim të gjykojë dhe të uzurpojë vakëfet, e kështu të udhëheqë me bashkëkohësit e tij. Me një fjalë, këto dhjetë vese të këqija janë gjithsesi te secili që me dituri kërkon diçka tjetër, e jo shpërblimin e Allahut Teala në ahiret. Dituria nuk e lë dijetarin të lirë, ose e sjellë në shkatërrim të përrjetshëm ose në lumturi të përrjetshme. Prandaj Resulallahu s.a.v.s. thotë:

**“Dënimin më të ashpër në ditën e Gjykimit do ta marrë dijetari i cili nuk ka përfituar nga dituria e Allahut.”**

Po kuptohet që veprimi pa dituri (hyjnore) sjell dëm. Inshallah besimtarët shlirohen plotësisht nga to. Por, kjo është larg, shumë larg, sepse rreziqet që dituria i bartë me vete janë të shumta. Kërkuesi i diturisë, kërkon pronë të përrjetshme dhe mirëqenie të përrjetshme. Prandaj ose e arrin këtë pronë ose shkatërrimin. Personi i tillë është si ai që kërkon pasuri në dynjallëk; nëse nuk arrin të perfitojë pasurinë, humb shpresën që do të shpëtojë nga shkatërrimi, e ndoshta në atë ditë të tmerrshme i zbulohen tërë gjendjet e fshehta dhe poshtërohet.

Nëse thua: *“Po të mos kishte dashuri ndaj pozitës, do të zhdukej dituria. Prandaj nga pikëpamja e inkurajimit të njerëzve në dituri, ekziston një dobi në debatim”*, ia ke qëlluar nga njëra anë, por, në anën tjetër, një arsyetim i tillë nuk ka vlerë. Pra, po të mos kishte premtim për lojë me top, me shkop dhe lojëra të tjera, djemtë e rinj nuk do të shkonin në shkollë, por kjo nuk dëshmon që vet premtimi është i lavdëruar. E *“po të mos kishte dashuri ndaj pozitës, do të zhdukej dituria”*, gjithashtu nuk dëshmon që personi që

dëshiron pozitë është i shpëtuar, aq më shumë, ai bën pjesë në ata për të cilët Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

**“Vërtetë Allahu Teala e ndihmon këtë fe përmes njerëzve të pavlerë që nuk kanë lidhje me këtë fe.”**

Gjithashtu, Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

**“Vërtetë Allahu Teala do të bëjë që këtë fe ta përkrahë edhe gjynahqari.”**

Personi që kërkon udhëheqësinë është i shkatërruar. Nëse fsheh dëshirën për udhëheqje, në pamjen e dukshme (zahir) është si paraardhësit e ndershëm. Nëse fton në braktisjen e dynjallëkut, rasti i tij është si qiriri që digjet vet, por edhe ndriçon për të tjerët, ku dobia e tjetrit qëndron mbi shkatërrimin e të parit. Nga ana tjetër, sikur ta ftonte që të lidhet për dynjallëk, shembulli i tij do të ishte sikur i flakës, e cila shkatërron edhe veten edhe të tjerët.

Kështu dijetarët mund të ndahen në tri kategori:

1. Ata që shkatërrojnë edhe veten edhe të tjerët: të tillët haptas kërkojnë dynjallëkun dhe i dorëzohen atij.

2. Ata që gëzojnë veten, dhe të tjerët; thërrasin Allahun Teala, haptas dhe fshehtas.

3. Ata që veten e shkatërrojnë e të tjerët i gëzojnë; thërrasin kah ahireti, me të jashtmen e tyre e përbuzin këtë botë, por qëllim të brendshëm kanë që t'i pranojnë njerëzit dhe të fitojnë pozitë.

Shih prandaj, në cilën nga këto kategori ti bën pjesë dhe për çka je duke u pregatitur. Kurrresi mos mendo që Allahu Teala pranon diçka tjetër përpos diturisë dhe veprimit të bërë ekskluzivisht për kënaqësinë (rizan) e Tij, i Lartësuar qoftë Ai.

Në librin '**Kitabur-rija**' do të flasim më shumë për këtë, respektivisht në vëllimin e tretë: "*Gjërat që dërgojnë në shkatërrim*" (**Rub'u'l-Muhlikat**), që do të largojë secilin dyshim nga ti, inshallah

## KAPITULLI I PESTË

### RREGULLAT E SJELLJES (ADAB) SË NXËNËSIT DHE MËSUESIT

Sa i përket nxënësit, ai ka shumë rregulla të sjelljes që duhet t'i respektojë dhe detyra të qarta, por të gjitha mund të përmbledhen në dhjetë pjesë:

1- Para se gjithash, duhet pastruar zemrën nga gjendjet e këqija dhe nga vetitë e këqija. Sepse dituria është ibadet i zemrës, namaz i fshehtësisë (sirr) dhe afrim i tipareve tona Allahut Teala. Ashtu si namazi, që është detyrë trupore dhe nuk pranohet pa pastrimin e pjesëve të caktuara të trupit, ashtu as ibadeti i të brendshmes dhe pasurimi i zemrës me dituri nuk janë të dobishme pa pastrim nga cilësitë e këqija dhe nga veset e këqija. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Feja është ndërtuar mbi pastërti.”<sup>118</sup>**

e mendohet në pastërti të jashtme dhe të brendshme.

Kurse Allahu Teala thotë:

**“...idhujtarët janë të papastër...”** 9-Teube: 28

duke ia tërhequr vëmendjen mendjes se pastërtia dhe ndyrësira nuk janë të kufizuara vetëm në organet e jashtme, por është edhe me të brendshme. Idhujtari mund të ketë trup dhe rroba të pastra, por zemra e tij mbetet e ndyrë, pra e brendshmja e tij është e përlyer. *Nexhaset* (papastëria) është term për diçka që duhet larguar, ndërsa largimi i papastërtisë së të brendshmes (batin) tonë është edhe më me rëndësi. Sepse, përderisa në këtë botë papastëria e brendshme është ndyrësirë, në botën tjetër (ahiret), ajo e dërgon njeriun në shkatërrim.

---

<sup>118</sup> Me kuptim të ngjashëm e shënon Ibn Hibbani nga Ajshja r.anhum dhe Taberani nga Ibn Mesud, si hadith daif.

Prandaj Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Melekët nuk hyjnë në shtëpinë ku gjendet qeni.”<sup>119</sup>**

e, edhe zemra është shtëpi ku melekët hyjnë, ku mbesin gjurmët e tyre, ku ata vendosen. Pikërisht vetitë e këqija, siç janë inati, epshet, ligësia, lakmia, mendjemadhësia, arroganca etj, janë ata qenë që lehin, e si atëherë të hyjnë melekët në zemrën e mbushur me ‘qenë’?! Kurse dritën e diturisë Allahu Teala e fut në zemra vetëm përmes melekëve:

**“Nuk ka asnjë njeri që t'i ketë folur Allahu ndryshe, vetëm se me anë të frymëzimit, ose pas ndonjë perdeje, ose t'i dërgojë të dërguar (melek), e ai t'i shpallë me lejen e Tij atë që do Ai.”** 42-esh-Shura: 51

Melekët janë të obliguar me mirësitë e diturisë të cilat Allahu Teala i dërgon në zemrat e njerëzve. Melekët janë të pastër, nuk kanë asnjë lidhje me cilësitë e këqija dhe janë të shenjtë. Ata zbresin vetëm në vende të mira, me atë që pranojnë në vete nga të mirat e Allahut, përmirësojnë vetëm vendet e mira dhe të pastra. Nuk po them që në hadith me ‘shtëpi’ mendohet në zemër, e me ‘qen’ në inatin dhe cilësitë e këqija, por them se ky është një paralajmërim dhe se në hadith ka shenjë. Dallimi në përkthimin e të jashtmes si të brendshme, dhe tëheqja e vërejtjes për të brendshmen duke përmendur të jashtmen, është që e jashtmeja edhe më tutje vlerësohet. Kjo është finesa që e dallon grupin e batinive, të cilët marrin kutimin e fjalës origjinale dhe e përdorin në një kuptim tjetër. Shpjegimi ynë është rruga e konsideratës (*i'tibar*) që dijetarët e mirë e kanë pranuar. Konsideratë do të thotë nxjerrje mësim (*ibret*); pra duke pranuar kuptimin origjinal, të nxirret edhe një kuptim tjetër. Kështu, për shembull, njeriu i kuptueshëm nxjerr mësim (*ibret*) nga fatkeqësia që i ndodh tjetrit, me atë që ia përkujton vetes që edhe atë mund ta godet fatkeqësia. Edhe vetë natyra e dynjallëkut është e ndryshueshme, prandaj kalimi nga tjetri te vetja, dhe nga vetja në thelbin e dynjallëkut, është një mësim

---

<sup>119</sup> Muteffekun alejhi (sahih).

i pëlqyer (*ibret*). Prandaj edhe ti nga fjala *shtëpi* –që është krijim i njeriut, nxjerr kuptimin *zemër* –që është krijim i Allahut Teala, dhe nga kuptimi i fjalës ‘*qen*’, që nuk është i qortuar për shkak të pamjes, por për shkak të egërsisë dhe fëlliqësisë së tij, nxjerr kuptimin e një shpirti me këto cilësi.

Dije se zemra, nëse është e mbushur me inat, me lakmi për dynjallëk dhe e lidhur për të, me mall për njollosjen e nderit të njeriut, në kuptim është qen, e në formë zemër, sepse drita e shikimit shpirtëror (*basiret*) i shikon kuptimet, e jo format. Në këtë botë (materije), format dominojnë mbi kuptimet, e kuptimet janë brenda formës, derisa në ahiret është e kundërta, format janë të nënshtruara kuptimit dhe kuptimet dominojnë. Pikërisht për këtë arsye, secili person do të ngjallet në formën (e vet) shpirtërore/morale (*manevijet*). Kështu, ai që ka njollosur nderin e tjetrit do të ngjallet në formën e qenit, hajni në formën e ujkut, arrogantët në formën e leopardit, pushtet-kërkuesi në formën e luanit. Gjithë këtë e vërtetojnë transmetimet dhe përvojat personale të atyre që posedojnë fuqinë e *basiret*-it.

Nëse thua: “*Sa shumë ka nxënës me moral të lig, që kanë arritur të përfitojnë dituri të shumta!*”; ah, sa larg janë ata nga dituria e vërtetë, që në ahiret sjell dobi dhe jep lumturi! Fillimet e një diturie të tillë janë që gjynahet të tregohen si vdekjeprurëse, si helme shkatërruese. A ke parë dikë të marr helmin, duke e ditur që helmi është vdekjeprurës?! Ajo që ti dëgjon nga të ashtuquajturit ‘*ulema*’ (dijetarë) janë fjalime që thuhën me gjuhë e refuzohen me zemër. Kjo nuk ka kurfarë lidhje me diturinë e vërtetë. Ibn Mesud r.a., ka thënë:

- *Dituria nuk përbëhet nga transmetimet e shumta; por është dritë që vendoset në zemër. Gjithashtu është thënë:*

- *Dituria është frikë dhe pendim, përshtatshëm fjalëve të Allahut Teala:*

**“Po, Allahut ia kanë frikën nga robërit e Tij vetëm dijetarët.”** 35–Fatir: 28

sikur me këtë të jepet shenjë për frytet më të veçanta të diturisë. Për këtë arsye disa dijetarë të vërtetë kanë thënë:

*- Kur dikush thotë 'ne kemi mësuar diturinë për një qëllim tjetër, por dituria refuzoi të jetë për një qëllim tjetër dhe pranoi të jetë vetëm për Allahun', mendohet në atë se si dituria kaloi para nesh, e thelbi i saj as që na është zbuluar, por kemi fituar vetëm fjalime të zakonshme dhe kuptimin e jashtëm."*

Nëse thua: *'Shoh plot dijetarë të fikhut që në usul dhe furu fikh llogariten si elitë, kurse nuk janë pastruar nga ahlaku i keq'*, do të të përgjigjem që, nëse i ke njohur shtyllat e diturisë, dhe i ke njohur dituritë e ahiretit, atëherë e ke të qartë që nga ajo me çka këta merren nuk ka ndonjë dobi, por dobia e vërtetë është vetëm me veprim për rizanë e Allahut Teala, me të cilat përpiqemi për afrim Allahut. Për këtë tashmë kemi folur, e më vonë do ta shpjegojmë më hollësisht, inshallah.

2- Nxënësi të pakësojë lidhjet e tij me punët e dynjasë, dhe të largohet nga familja dhe vendlindja. Sepse këto janë lidhje që preokupojnë dhe tërheqin në anën tjetër. Allahu askujt nuk ia ka dhënë dy zemra, dhe kur mendja përhapet në disa drejtime, (automatikisht) pengon për ta kuptuar të vërtetën. Prandaj është thënë: *'Dituria nuk të jep as një pjesë të veten, përderisa ti nuk ia jep diturisë veten plotësisht.'* Edhe kur ia dhuron diturisë veten plotësisht, prap është dyshim që mund të marrësh një pjesë prej diturisë. Mendimi që është përhapur në gjëra të lloj-llojshme është si përroska, uji i të cilës është shpërndarë; një pjesë të saj e thithë toka e një pjesë avullohet në ajër; kështu nga vet përroska në fund nuk mbetet gjë.

3- Për shkak të diturisë të mos i rritet mendja, e as të jetë mospërfillës ndaj mësuesit, por t'ia japë plotësisht vemendjen (vetën) në drejtimin e tij, në çdo çështje; t'i

pranojë këshillat e tij ashtu si i sëmuri i padijshëm që pranon ilaçin nga mjeku me përvojë dhe i dijshtëm. Para mësuesit duhet qenë i përlur, duke vlerësuar hyzmetin për mësuesin si një nder. Sha'bi tregon: *"Njëherë, Zejd ibn Sabit-it, pasi e fali një xhenaze, ia afruan mushkën për të hipur. Iu afrua Ibn Abbasi dhe e mbajti mushkën për fre. Zejd i tha: 'Lëshoi, o i biri i axhës së Resulallahut s.a.v.s.!' Në këtë, Ibn Abbasi tha: 'Na është urdhëruar që kështu të sillemi me dijetarët dhe të mëdhenjtë!' Zejd-i ia puthi dorën, dhe i tha: 'E kështu na është urdhëruar të sillemi me Ehli-bejtin e Resulallahut s.a.v.s.'"*<sup>120</sup> Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**"Nuk është ahlak i besimtarit të ulë veten, përpos në kërkim të diturisë."**<sup>121</sup>

Për këtë, nxënësi nuk guxon të shprehë mendjemadhësi ndaj mësuesit. Njëra nga shenjat e mendjemadhësisë ndaj mësuesit është që këshilla të marrë vetëm nga dijetarët e njohur. Kjo do të ishte çmenduri, sepse dituria është sebeb (shkaktar) i shpëtimit dhe lumturisë së tij. Kush ikë nga një bishë gjakatare, ai nuk shikon se a do ta shpëtojë dikush i njohur a i panjohur. Ndërsa sulmi i zjarrit të xhehnemit dhe paditurisë për Allahun Teala është më i ashpër se sa sulmi i cilës do bishë. Urtësia (*hikmet*) është pronë e humbur e besimtarit. Kur e gjen, e merr. Prandaj është i mirësjellshëm ndaj atij që ia sjell, kushdo qoftë ai. Për këtë shkak edhe thuhet:

*'Si është armik vërshimi i lumit për lartësi (vende të larta) edhe dituria është armik i nxënësit mendjemadh.'*

Prandaj dituria arrihet vetëm me përlulje dhe me dëgjim të kujdesshëm. Allahu Teala thotë:

**"Në të gjitha këto, për atë që ka zemër dhe që i ka vënë veshin me vëmendje, ka argumente."** 50-Kaf: 37

---

<sup>120</sup> Shënojnë Taberani, Hakimi dhe Bejkehiu. Sipas Hakimit, zingjiri i transmetuesve është i besueshëm, me kushtet e Muslimit.

<sup>121</sup> Ibn Adij nga Muadhi.

Të kesh zemër (*kalb*) nënkupton të jesh nga krijimi i kuptueshëm por edhe i aftë për ta pranuar diturinë, e nuk mjafton të jesh vetëm i kuptueshëm deri sa nuk pregaditësh nga brenda, në mënyrë që atë çka të jepet, ta pranosh me përulje, falënderim dhe kënaqësi dhe të dëgjosh me vëmendje. Nxënësi karshi mësuesit, le të jetë si dheu i butë i cili, kur bije shumë shi, gjithë ujin e thithë, dhe plotësisht i pranon këshillat e tij. Sido që të sillet mësuesi duke e mësuar nxënësin, ky duhet t'i shkojë pas dhe të mos përfillë mendimet e veta. Edhe gabimi në dukje i mësuesit do t'i jetë më i dobishëm se sa mendimet e veta të drejta. Përvoja u sjell njerëzve disa hollësira të jetës të cilat për dëgjuesin mund të jenë të çuditshme. Sa shumë ka të sëmurë me temperaturë të lartë, që mjeku nganjëherë i shëron me më shumë temperaturë, në mënyrë që t'ju rrisë fuqinë deri në atë masë që pacienti mund të pranojë tretmanin. Ai që nuk ka përvojë, habitet me këtë. Allahu Teala na tregon për këtë në pjesën për Hidrin a.s. dhe Musanë a.s., kur Hidri thotë:

**Ai i tha (Musait): “Ti nuk mund të durosh (në shoqëri) me mua; e si do të durosh për atë, për të cilën nuk di asgjë?”** 18-el-Kehf: 67, 68

Ai më pas i urdhëron heshtjen, dhe dorëzimin e plotë:

**I tha (Musait): “Nëse shkon pas meje, mos më pyet për asgjë, përderisa të mos ta shpjegoj unë!”**

18-el-Kehf: 70

Musai a.s. nuk u durua, dhe gjithnjë e pyeste, që në fund u bë arsye e ndarjes së tyre. Në përgjithësi, cili do nxënës që i mbahet mendimit dhe zgjedhjes së vet, duke mos u mbështetur në zgjedhjen e mësuesit, të tillit mundesh menjëherë t'i parashikosh humbje dhe shkatërrim. Nëse thua: “Allahu Teala thotë: **“Pyetni njerëzit e dijshtëm, nëse ju nuk dini!”** (21- Enbija: 7), prandaj, parashtrimi i pyetjeve është urdhëruar”;

Dije se, kjo është ashtu, por vetëm kur mësuesi jep leje. Pyetja për diçka që nuk është e nivelit tënd të kuptimit, vërtetë nuk është mirë. Për këtë arsye Hidri a.s., edhe ia ndaloi Musasë a.s. t'i parashtrojë pyetje.

Prandaj, lëri pyetjet deri sa të vijë koha për to. Mësuesi është ai që e di se për çka je i aftë ti, dhe mësuesi di kur duhet të të shpjegojë ato, e deri atëherë duhet pasur kujdes me pyetje. Hazreti Alia r.a. thotë:

*- Në të drejta të dijetarit llogaritet edhe ajo që të mos i parashtrohen shumë pyetje, as të mos lodhet me përgjigje, as të mos mërzhitet kur të është i lodhur, as të mos i tregohen fjalët që fliten pas shpine, as të mos i hulumtohen të metat, e nëse të ka bërë ndonjë gabim, diçka të keqe, të pranohet kërkim-falja e tij. Duhet ta respektosh dhe vlerësosh për rizanë e Allahut Teala, deri sa ai të ruaj urdhërin e Allahut. Dhe mos u ul para tij, e nëse i duhet diçka, të gjithë të gjinden menjëherë në shërbim të tij."*

4- Ai i cili është në fillim të kërimit të diturisë të ketë kujdes të mos futet në mospajtime me njerëzit, qoftë për dituri të dynjallëkut apo të ahiretit. Kjo vetëm mund t'ia turbullojë mendjen, t'i krijojë dyshime, t'i ndahen mendimet dhe shkakton pavendosmëri në kërkimin e diturisë. Ai në fillim duhet që para mësuesit t'i përmbahet një rruge të vetme e të lavdërueshme, dhe vetëm pas një kohe të fillojë të studiojë edhe drejtimit tjera. Nëse mësuesin nuk e ka të pavarur në mendime, por zakon e ka që gjithmonë të kalojë nga një mendim në tjetrin, nga një mësues i tillë duhet pasur kujdes. Ai më shumë mashtron se sa që udhëzon në rrugë të drejtë. I verbri nuk mund të udhëheqë të verbrit. Kush është i këtillë, gjendja e tij llogaritet si verbëri nga hutia dhe pengesë nga budallakia. Ndalesa për nxënësin fillestar në këto çështje është si ndalesa për dikë i cili sapo ka pranuar islamin të përzihet me pabesimtarët.

Gjithashtu, lavdërimi për shqyrtimin e mendimeve tjera për nxënësin që është forcuar është sikur inkurajimi i trimit për të hyrë në mesin e pabesimtarëve. Prandaj qyqarit as nuk i takon që t'i vërsulet radhëve të pabesimtarëve, deri sa kjo për njeriun trim është e rekomanduar. *Gaflet* (mosdituri) llogaritet edhe mendimi i disa të dobëtëve se përshtatja të fortëve në lehtësime (në disa gjëra që ata ia lejojnë vetes) është e lejuar, e nuk e dinë se detyrat e të fortit dallojnë nga detyrat e të dobët. Në këtë kuptim, disa thonë: *“Kush më sheh në fillim, bëhet besimtar i sinqertë (siddik), e kush më sheh në fund, bëhet jobesimtar (zindik)”*, sepse në fund, veprat, përpos farzeve, kalojnë prej të jashtmes (zahir) në të brendshmen (batin), prandaj vëzhguesit krejt kjo i duket si arrogancë, dembelizëm dhe braktisje. Ndërsa kjo gradë është lidhja e zemrës me thelbin e dëshmisë, dhe është vazhdueshmëri në zikër, që përgjithmonë është vepra më e mirë. I dobëti mendon që, kur dikush të hedh pak papastërti në një gotë, e në det hudhen edhe më shumë papastërti, e prap deti është i pastër dhe ajo papastërti nuk i pengon detit, atëherë gjithsesi se kjo nuk mund t'i pengojë as ujit në gotë. I gjori nuk e di që deti ka atë fuqi që papastërtinë e vet e kthen në pastërti, deri sa edhe pak papastërti në gotë, e ndotë gjithë ujin aty dhe e bën të papastër. Sipas këtij shembulli edhe Resulallahut s.a.v.s., i është lejuar diçka që të tjerëve nuk u është lejuar, dhe kështu i është lejuar të ketë nëntë bashkëshorte. Ai kishte fuqinë të ishte i drejtë me secilën prej tyre, deri sa të tjerët nuk janë në gjendje ta bëjnë këtë; duke u mundur të kënaqin secilën prej tyre, bëjnë padrejtësi mes tyre dhe kështu nuk i zbatojnë urdhrat e Allahut. I humbur është ai që krahason melekët me kovaçin.

5- Kërkuesi i diturisë të mos lë anash asnjë disiplinë nga dituritë e lavdërueshme, e as ndonjë nën-lloj të tyre, deri sa të depërtojë në thelbin dhe qëllimin e saj. E nëse edhe ka jetë të gjatë, le të futet thellë në to. Në të kundërtën, fillimisht le t'i përmbahet asaj më të rëndësishmes, e gjërat

dytësore le t'i anashkalojë. Ngase dituritë janë të lidhura mes vete dhe ndihmojnë njëra-tjetrën. Njëra nga dobitë që do t'i ketë atëherë është që më nuk do të jetë dushman i diturisë. Ai që nuk di, është dushman i diturisë; e të padijshmit, në fakt janë dushmanë. Allahu Teala thotë:

**“E, ngase ata nuk u udhëzuan me te në rrugën e drejtë, me siguri do të thonë: “Ky është trillim i lashtë”**

46-Ahkaf: 11

Në këtë kuptim, edhe poeti thotë:

*‘Atij që në buzë helm i hidhët i flen,  
Atij edhe uji i ëmbël, i hidhët i vjen.’*

Dituritë, duke marrë parasysh llojllojshmërinë e tyre, ose e afrojnë robin Allahut Teala, ose i ndihmojnë në atë rrugë. Secila nga to ka gradë të veçantë në afrim ose largim nga qëllimi. Ata që merren me to janë si rojet e kufijve në periferitë e mbretërisë. Secili nga ta ka një gradë të caktuar, dhe përshtatshëm gradës së tyre i pret shpërblimi në ahiret, nëse me diturinë e tyre kanë synuar kënaqësinë e Allahut Teala.

6- Të mos zhytet në ndonjërin nga disiplinat e diturisë plotësisht, por të ketë kujdes në renditje. Të fillojë me ato më të rëndësishmet, sepse nëse jeta, siç edhe ndodh në të shumtën e rasteve, të jetë shumë e shkurtër, me vendosmëri duhet marrë nga të gjithat atë më të mirën dhe të kënaqet qoftë edhe vetëm me aromën e saj. Tërë fuqinë duhet drejtuar kah specializimi i diturisë më të ndershme, që është dituria e ahiretit. Me këtë mendoj në dituritë muamele (praktike), dhe në dituritë mukashefe<sup>122</sup>. Rezultat i diturisë *muamele* është dituria *mukashefe*, e qëllim i diturisë mukashefe është njohja e Allahut Teala. Me *‘njohjen e Allahut*

---

<sup>122</sup> **Mukashefe:** zbulim; hap; qelë; fshehtësitë shpirtërore; të dihet një gjë para se të ndodh; nxjerrja në shesh e një sekreti ose të fshehte; pamje/shikim me syrin e zemrës.

*Teala'* nuk nënkuptoj besimin, të cilën njeriu i zakonshëm e merr nga të parët e tij ose nga dikush tjetër, ose përmes *kelam*-it dhe diskutimit të thatë, kah e cila anojnë kelamistët, por kjo është një lloj bindjeje (*jekin*), fryt i dritës të cilën Allahu Teala e lëshon në zemrën e robit i cili me fuqinë e ushtrimeve shpirtërore e ka pastruar të brendshmen e tij nga ndyrësitat, deri sa nuk arrin gradën e besimit (*iman*) të Ebu Bekrit r.a., për të cilin Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Sikur imani i gjithë botës të vendosej në njërën anë të peshores, e në tjetrën imani i Ebu Bekrit, ana e Ebu Bekrit do të ishte më e rëndë.”<sup>123</sup>**

Në esencë, besimi i njeriut të thjeshtë nuk ndryshon nga besimi i cilit do kelamist, i cili vetëm se me shkathtësi përdor fjalët, për çka edhe mësimi i tij është quajtur *‘e folur’* (kelam). Nga ajo dituri janë ndrojtur hazreti Omeri, hazreti Osmani, hazreti Alia dhe as’habët e tjerë, e ndër ta edhe më shumë veçohej hazreti Ebu Bekr, r.a., i cili në gjoks kishte një fshehtësi të veçantë. Është e çuditshme se si dikush që dëgjon fjalë të këtilla të Resulallahut s.a.v.s., t’i hedhë poshtë ato, bile edhe të thotë se këto janë trillime të sufive. Për këtë arsye, para të këtillit duhet pasur kujdes, sepse ai ka humbur pasurinë. Prandaj mëso me kujdes që të njohësh atë fshehtësi (fshehtësinë e Ebu Bekrit e cila llogaritet e lartë), e cila nuk gjendet në librat e juristit (*fukaha*) dhe të kelamistëve (*mutekellimun*), e në atë të udhëzon vetëm qëndrueshmëria në kërkim.

Me një fjalë, dituria më e ndershme dhe qëllimi i saj është njohja e Allahut Teala. Kjo dituri është një det me fund të paarrtshëm, ndërsa gradat më të larta në këtë dituri në mesin e njerëzve janë ato të peygamberëve, pastaj evliave (shokëve të mirë të Allahut), e më pas të të tjerëve që vijnë pas tyre.

---

<sup>123</sup> Hadithin e shënon Ibn Adijj, me zingjir të dobët të transmetuesve, si edhe Bejhekiu, me zingjir të besueshëm të transmetuesve.

Tregohet se si në një faltore më të hershme ishin dy statuja të udhëheqësve. Në dorën e njërit ishte një kartë, ku shkruante: *“Nëse je i drejtë në çdo punë, mos mendo se je duke bërë diçka drejtë, përderisa nuk e njeh Allahun Teala, e ta dish se Ai është krijuesi i çdo gjëje.”* Në dorën e tjetrit gjithashtu ishte një kartë, ku shkruante: *“Deri sa nuk e njoha Allahun, pija e prap isha i etur, e kur e Njoha, po pi, me etje të shuar.”*

7- Mos të kalojë në disiplinë tjetër të diturisë, deri sa nuk ka zotëruar të parën, sepse të gjitha dituritë kanë një renditje dhe njëra drejton te tjetra. I suksesshëm është ai që ka kujdes për këtë renditje. Allahu Teala thotë:

***“Atyre, të cilëve ua dhamë librin dhe të cilët e lexojnë drejt ashtu si është.”*** 2-Bekare: 121

pra, nuk kalojnë disiplinat deri sa t’i zotërojnë, në teori dhe në praktikë.

Dhe në secilën ditori, qëllim le ta ketë që të shkojë më tutje, dhe le të mos gjykojë për mosvlerën e ndonjë diturie në rast se sheh ndonjë ndasi, ose gabimin e ndonjë individi, ose nëse dituria nuk përcjellet me vepra. Mund të shohim shumë njerëz se si i kanë braktisur disiplinat teorike, bile edhe ato të natyrës juridike, sepse nuk ka të tillë që vërtetë i përdorin. Për këtë dyshim tashmë kemi folur në librin për kriteret e diturisë.

Gjithashtu, shohim njerëz se si mohojnë vlerën e mjekësisë, sepse kanë parë ndonjë gabim të ndonjë mjeku, si dhe ata që besojnë në astrologji, sepse te dikush parashikimi ka dalë i saktë, deri sa të tjerët në të nuk besojnë sepse te dikush parashikimi është treguar i pasaktë, e në fakt, të gjithë gabojnë. Gjërat duhet shikuar në esencën e tyre. Prandaj edhe hazreti Alia r.a., thotë:

*- Nuk mund ta njohësh të vërtetën përmes njerëzve! Njih të vërtetën, e do të njohësh edhe bartësit e saj.*

8- Të njohë shkakun përmes së cilit arrihet në dituritë më të vlefshme. Me këtë mendohet në dy gjëra: nderi i frytit, si edhe besueshmëria dhe fuqia e dëshmisë. Këto të dyja janë si dituritë fetare dhe mjekësia. Fryt i të parës është jeta e përherëshme, derisa fryt i të dytës është jeta e përkohshme. Prandaj dituritë fetare janë më të vlefshme. Si shembull mund të marrim matematikën dhe astronominë, dhe këtu matematika është më e vlefshme, duke pasur parasysh saktësinë e dëshmive të saj, e nëse e krahasojmë me mjekësinë, atëherë mjekësia është më e vlefshme për shkak të frytit të saj. Matematika është e vlefshme për shkak të dëshmive të saj, por të mendohet fryti është gjithmonë më mirë. Prandaj mjekësia është më e vlefshme se matematika, ani pse në të ka më shumë spekulime.

Në bazë të kësaj del që dituria më e vlefshme është ajo për Allahun Teala, melekët e Tij, librat e Tij, pejgamberët e Tij dhe për njohjen e rrugës drejt këtyre diturive. Prandaj të kesh kujdes që vetëm këto dituri t'i synosh sinqerisht dhe me vendosmëri.

9- Qëllimi i nxënësit nga mësimi (i tanishëm) duhet të jetë pastrimi i zemrës nga veset e këqija, zbukurimi me vlera të larta (fazilet), ndërsa (në të ardhmen) të ngritet pranë melekëve më të afërt të Allahut (mukarebun) dhe pranë njerëzve afër Allahut. Nuk duhet që me dituri të synohet pushtet, pasuri, diskutim me të padijshmin dhe shfaqje para të tjerëve. Nëse ka qëllim rizanë e Allahut, atëherë pa dyshim do të kërkojë mjetin më të afërt që do ta dërgojë te e dëshiruara, e që është dituria e ahiretit.

Së bashku me këtë, nuk duhet të nënçmojë dituritë tjera, siç është fetvaja (dhënia e zgjedhjeve juridike), gramatika dhe sintaksa, të cilat kanë lidhje me Kur'an dhe sunnet, si edhe dituritë tjera të cilat i kemi përmendur në fillim, e të cilat bëjnë pjesë në farzi-kifaje.

Assesi mos mendo që në theksimin tonë të shumtë të diturive të ahiretit, kundërshtojmë dituritë tjera. Ata që mbi vete marrin detyrën e ruajtjes së diturive janë si ata që mbrojnë kufijtë e shtetit dhe si luftëtarët në rrugën e Allahut. Dikush është luftëtar, dikush ndihmës, dikush jep ujë, e dikush kujdeset për kafshët, dhe i përgatit ato për luftë. Dhe asnjëri nuk do të privohet nga shpërblimi nëse qëllim e ka ngritjen e Fjalës së Allahut Teala, e jo fitimin e luftës. Të tillë janë edhe dijetarët. Allahu Teala thotë:

**“Allahu i lartëson ata që besuan prej jush, i lartëson në shkallë të lartë ata të cilëve u është dhënë dituri.”**

58-Muxhadile: 11

**“Tek Allahu ata kanë shkallë të ndryshme;”**

3-Ali Imran: 163

Vlera e lartë mes tyre është relative. Nëse i përçmojmë bankerët duke i krahasuar me mbretërit, nuk do të jetë nënçmim kur i krahasojmë me pastruesit. Prandaj mos mendo që ai që ka rënë nga grada më e lartë është pa vlerë. Grada më e lartë është e rezervuar për pejgamberët, më pas evliatë, më pas dijetarët e vërtetë, më pas të mirët, secili sipas gradës së tij. Me një fjalë:

**“Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë,**

**e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë”** 99-ez-Zelzele: 7, 8

Ai që me dituri ka për qëllim Allahun Teala, çfarëdo diturie që ta fitojë, ajo do ti shërbejë dhe do ta lartësojë, pa kurfare dyshimi.

10- Ta dijë lidhjen e diturisë ndaj qëllimit, dhe sipas saj ta zgjedh atë që do të mësojë. Njëjtë si ai që është afër dhe i ngritur mbi atë që është larg, ose sikur preferimi i

shumë të rëndësishmes mbi të rëndësishmen. Kuptimi i shumë të rëndësishmes këtu është ajo që të preokupon dhe intereson, e nuk të preokupon asgjë tjetër pos fitimit tënd, në këtë dhe në botën tjetër. E meqenëse nuk je në gjendje t'i bashkosh ëmbëlsitë e kësaj bote dhe kënaqësitë e botës tjetër, siç flet Kur'ani për këtë, e drita e shikimit të zemrës (nuri i basiretit) e dëshmon, atëherë është më me rëndësi t'i përmbahesh përjetësisë që nuk kalon. Atëherë dynjallëku bëhet vetëm një stacion, trupi mjet udhëtimit, e veprat bëhen vegla që na dërgojnë në qëllim, e qëllim nuk është gjë tjetër pos takimi me Allahun Teala. Këtu qëndron gjithë kënaqësia, ani pse vlerën e kësaj diturie e dinë vetëm të paktët. Duke marrë parasysh lumturinë e takimit me Allahun Teala, dhe shikimit të fytyrës së Tij, me çka po mendoj në shikimin për të cilin flasin pejgamberët e jo ashtu siç e kuptojnë njerëzit e zakonshëm dhe teologët, dituritë ndahen në tri kategori të cilat mund t'i kuptosh përmes shembujve. Nëse skllavit të cilit i është ofruar liria, i thuhet: *“Nëse e kryen haxhin sipas rregullave, bëhesh i lirë, e me këtë edhe i pasur. Por nëse përgatitesh e nisesht për rrugë, e diku rrugës ndonjë nevojë të pamundëson të vazhdosh, edhe atëherë do të jesh i liruar nga prangat e skllavërisë, por nuk do të fitosh pasuri.”* Në atë rast, skllavi duhet ti kryej tri lloje të punëve:

- 1- Të përgatitet për rrugë me blerjen e devesë, shishes për ujë, ushqimit etj;
- 2- Të niset për rrugë drejt Qabesë, stacion pas stacioni;
- 3- T'i kryejë obligimet e haxhit.

Vetëm pasi t'i kryejë të gjitha këto, të dalë nga ihrami dhe të bëjë tavaf-in lamtumurës, mund ta fitojë lirinë dhe pasurinë. Në secilën prej gradave e presin stacione të veçanta, që nga fillimi i përgatitjes për punë deri te përfundimi i saj, nga hapi i parë në rrugë deri te fundi i saj, nga obligimi i parë i haxhit deri te i fundit. Dhe nuk është me

fat të njëjtë ai që ka nisur me kryerjen e obligimit të haxhit si ai që ende merret me përgatitjet për shkuarje në haxh, ose sikur ai që sapo është nisur për rrugë. I pari është më së afërti lumturisë.

Njëjtë, edhe dituritë i ndajmë në tri tërësi:

1. Ato që i përshtaten përgatitjes për rrugë, e këto janë mjekësia, drejtësia dhe të gjitha ato dituri që i përkasin trupit të njeriut dhe dynjallëkut.

2. Ato dituri që i përshtaten nisjes për rrugë dhe tejkalimit të vështirësive, e që është pastrimi i zemrës nga veset e këqija, dhe me ndihmën e Allahut - arritja në gradat e larta, që të tjerët nuk kanë mundur t'i arrijnë. Të mësohet dituria për pastrimin e zemrës është si të mësohen drejtimitet dhe stacionet e saj, sepse stacionet dhe rrugët e dynjasë nuk mund të njihen deri sa nuk nisesh për rrugë. Njëjtë, as dituria për përmirësimin e ahlakut (moralit) nuk do të sjell dobi nëse nuk përdoret menjëherë. Vetëm të njihen dituritë e ahlakut nuk ka vlerë, e asnjë punë nuk ka mundësi të fillohet pa dituri.

3. Ajo që i përgjigjet kryerjes së obligimeve të haxhit, e kjo është njohja e Dhatit (Qenia), cilësitë dhe veprat e Allahut Teala, melekëve dhe të gjitha diturive që tashmë i kemi përmendur në lidhje me diturinë mukashefe. Vetëm këtu qëndron shpëtimi i vërtetë dhe lumturia. Shpëtimin do ta arrijë secili udhëtar (*salik*) që qëllim të singertë e ka të vërtetën, që nuk është asgjë tjetër pos selamet. Lumturinë e arrijnë vetëm ata të cilët e njohën Allahun Teala, e këta janë ata të afërtit, të mbushur me bereqet, në afërsi të Allahut Teala, në rehati dhe në të mira, në xhennet të begatshëm (*Xhennetun-ne'im*). E atyre që u është ndaluar qasja në majat e përsosjes, megjithatë kanë shpëtim e selamet, ashtu siç thotë Allahu Teala:

**“E nëse ai (i vdekuri) është prej të afërmeve (të Allahut).**

**Ai ka kënaqësi, furnizim të mirë dhe xhennet të begatshëm.**

Edhe ky ajet dëshmon për ata që do të shpëtonjë, e të cilët janë në shkallën e dytë:

**Po në qoftë se është nga të djathtët?**

**Pra, ty të qoftë selam prej të djathtëve (i thuhet).”**

56-el-Vaki’a: 88 deri 91

Secili që nuk drejtohet kah qëllimi i duhur dhe nuk i kushtohet atij, ose i kushtohet por jo për nënshtrim, por për ndonjë interes të ulët, ai është nga njerëzit e të majtës, nga të humburit. Të tillin e pret zjarri i nxehtë dhe djegia në xhehenem.

Dije se për dijetarët e vërtetë kjo është bindja e vërtetë (*hak-kul-jekin*), sepse ata e shohin këtë qartë me syrin e zemrës së tyre, e një shikim i tillë është shumë më i fuqishëm e më i pastër se shikimi me sytë e ballit. Ata janë ngritur në këtë gradë vetëm duke iu përshtatur sheriatit. Gjendja e tyre (*hal*) i ngjason gjendjes së atij, i cili pasi vërteton atë për çka informohet, të njëjtën e realizon përmes sositjes shpirtërore (*mushahede*). Ndërsa të tjerët, e vërtetojnë informatën dhe e pranojnë me besim, por nuk e përjetojnë me sositje. Lumturia vjen pas diturisë mukashefe, e dituria mukashefe pas diturisë muamele, e cila përbën hapat në rrugën e ahiretit.

Kalimi nëpër fazat e cilësive dhe hyrja në rrugën e braktisjes së cilësive të qortuara vjen pas njohjes së diturive rreth cilësive. Njohja e rrugës së shërimit të këtyre veseve të këqija dhe hyrja në këtë rrugë, vjen pas diturisë për selametin e trupit. Ajo që e ndihmon shëndetin dhe selametin e trupit arrihet në bashkësi dhe me ndihmesë të ndërsjellë, me çka sigurohen rrobat, ushqimi dhe vendbanimi, e krejt kjo varet

nga sundimtari. Ligji i tij në shërbim të drejtësisë dhe politikës është në duart e juristit. E sa i përket shëndetit (mjekësisë), është detyrë e mjekëve ta sigurojnë. Dikush thotë: *“Janë dy dituri: dituria e trupit dhe dituria e fesë.”* Ai me këtë drejton kah fikh-u (e drejta), me çka nënkupton dituritë e jashtme, e jo dituritë e brendshme.

Nëse pyet: *‘Përse diturinë e mjekësisë dhe fikhut i ngjason me mjetin transportues, me furnizimin e ushqimit dhe me gjëra të duhura për udhëtarin?’*

Dije se; zemra është ajo që punon për afrim Allahut Teala, e jo trupi. Kur themi zemër (*kalb*), nuk kemi qëllim këtë zemër që është veç një copë mishi, por tema jonë është zemra të cilën ndjenjat nuk mund ta njohin, një fshehtësi nga të fshehtat e Allahut dhe një letaif hyjnor. Nganjëherë quhet shpirt (*ruh*), e nganjëherë *‘shpirt i qetësuar’* (nefsi mutme’inne). Ndërsa në sheriat kësaj i thuhet *‘kalb’* – zemër. Sepse zemra është më së afërti kësaj fshehtësie. Me anë të saj, i gjithë trupi i nënshtrohet atij letaif-i hyjnor. Ngritja e perdes nga kjo fshetësi i takon diturisë mukashefe, ndërsa për diturinë mukashefe nuk është e lejuar të flitet. Krejt çka lejohet të thuhet është se kjo është një ekzistencë e lartësuar, një xhevahir i madhërishtëm dhe është nga urdhrat (*emr*) e Allahut Teala, siç thotë vet Ai:

***“Do të të pyesin ty për shpirtin. Thuaj: ‘Shpirti është nën urdhrin e Rabbit tim’.”*** 17-el-Isra: 85

Secila krijesë ka lidhje me Allahun Teala, por lidhja e këtij shpirti është më e nderuar se cila do lidhje e organeve tjera. Allahut i takon edhe krijimi (*halk*) edhe urdhri (*emr*) së bashku, e urdhri është më i lartësuar se krijimi.

Ky xhevahir i vlefshëm është bartës i amanetit të Allahut Teala nga bota e urdhrat (*alemi emr*), prandaj është në gradë më të lartë se sa toka dhe planetet, sepse ato refuzuan ta bartin amanetin. Por, kjo nuk nënkupton që shpirti është i

përjetshëm. Ai që flet për përjetësinë e shpirtit, është i hutuar, krejt i padijshëm dhe nuk di çka flet. Për të mos shkuar larg, t'i kthehemi temës tonë. Ajo çka duam të themi: meqë ky letaif është nga urdhri i Rabbit, synon t'i shkojë Rabbit të vet, nga Ai erdhi, Atij i kthehet. Ndërsa trupi është bartësi dhe mjeti i tij. Për shpirtin, në rrugën e Allahut Teala trupi është si deveja për trupin tonë në rrugë për haxh, ose sikur shishja; siç e bartë shishja ujin, edhe trupi bartë shpirtin. Kështu, secila dituri që ka për qëllim ruajtjen e shëndetit të trupit, ajo dituri i'a siguron nevojat bartësit të vet. Nuk ka dyshim që me mjekësinë është kështu, sepse për shëndetin e trupit nevojitet dituria e mjekësisë. Mjekësia nevojitet, qoftë edhe vetëm për një njeri. Por fikhu dallon nga mjekësia, dhe nëse është vetëm një njeri, për shumë çështje të fikhut ai nuk do të ketë nevojë. Por, njeriu është i krijuar si qenie shoqërore. Ai nuk mund të jetë i pavarur në fitimin e ushqimit, në punim të tokës, mbjellje, përgatitjen e bukës dhe pjekjen e saj. Njëjtë është edhe me rrobat e tij dhe vendbanimin. Për të gjitha këto nevojiten mjete, prandaj ai është i detyruar të jetojë bashkë me të tjerët dhe të ndihmohet nga ata, e sa më shumë që njerëzit të përzihen, epshet e tyre fillojnë të ndezen, prandaj futen në debatetime dhe grindje. Me prishjen e natyrës së brenshme, sëmundja e trupit u bë sebeb i shkatërrimit të tyre, dhe me ndikimin e thashethemeve nga jashtë, filluan me mbytjen e njëri-tjetrit. Siç rregullon mjekësia çrregullimin e brenshëm, edhe çrregullimet e jashtme i rregullon drejtësia dhe politika (*sijasat*). Dituria e cila njofton për shëndetin e njeriut quhet mjekësi dhe dituria e cila siguron rregullin në veprimet dhe punët e njerëzve quhet fikh, e të dyja janë në shërbim të ruajtjes së trupit, që është bartësi i shpirtit. Ai që fillon të merret vetëm me fikh ose mjekësi, por pa pastruar zemrën, pa përmirësuar ahlakun, është si ai që blen deve, ushqim për të, enë për ujë, dhe mirret me këto, por nuk niset në rrugë për në Qabe.

Ai që gjithë jetën e kalon në analizimin e fjalëve të cilat qarkullojnë në diskutimet e fikhut, është si ai që gjithë jetën e harxhon në analizim të materialit me të cilin do të mund të ndërtohej një bartëse e ujit për rrugën e haxhit.

Dallimi mes fakihut të tillë me atë që ka arritë diturinë mukashefe dhe merret me pastrimin e zemrës, është si dallimi mes atij që ende merret me blerjen e deve, ushqim për të dhe enë për ujë, me atë i cili tashmë ka hyrë në rrugë të haxhit, bile edhe ka filluar të kryejë ruknet e haxhit. Prandaj mendo mirë për gjithë këtë dhe prano këshillën falas nga ai i cili tashmë e ka kaluar këtë rrugë, dhe me gjithë kundërshtimet e njerëzve të rëndomtë (avam) dhe të zgjedhurve (havas), ka arritur në këtë gradë me mund të madh. Falë kësaj, u largua nga ndjekja e të tjerëve, që bazohet në epshe.

Kjo do të ishte e mjaftueshme rreth detyrave të nxënësit.

## DETYRAT E MËSUESIT UDHËZUES

Dije se në njohuritë e njeriut ekzistojnë katër grada, njëjtë si në rastin e fitimit të pasurisë: Ekziston gjendja e shfytëzimit, me këtë gjendje fitohet pasuria. Ekziston gjendja e kursimit, me këtë shpëton veten nga varfëria. Ekziston gjendja kur kujdeset për veten, e nga fitimi i tij hargjohet për vete; dhe gjendja kur pasuria hargjohet për të tjerët, përmes dhurimit dhe më këtë ai bëhet i xhymertë, e kjo gjendje është më e ndershmja. Edhe dituria fitohet njëjtë si pasuria, fillimisht gjendja kur e kërkojmë, më pas gjendja kur fitojmë dituri dhe nuk kemi nevojë të pyesim më, pastaj gjendja e studimit të kujdesshëm; mendojmë për atë që dimë dhe prej kësaj përfitojmë, dhe në fund gjendja e mësimdhënies që është edhe gjendja më e vlefshme nga të gjitha gjendjet e mëparshme.

Ai që di, vepron me atë që di dhe i mëson të tjerët, ai me respekt përmendet në botën e melekut (alem-i melekut). Ai është si dielli, që i ndriçon të tjerët, e edhe në vetvete është ndriçues, ose sikur aroma, që u jep aromë të tjerëve, por edhe vet është aromatik. Ai që di, por nuk punon sipas diturisë që ka është si fletorja, të cilën të tjerët e përdorin, e ajo vet është e zbrazët nga dija, ose si guri që mbrehë, e mbrehë thikën por vet nuk prenë, ose si gjilpëra, që të tjerët i vesh (me të qepur), e vet është lakuriq, ose si vaji i kandilit, që të tjerëve u dhuron dritë, kurse vet vetëm digjet, bash ashtu siç thuhet:

***“Ai nuk është tjetër pos vaj që digjet,  
Të tjerët i ndriçon, e veten e harxhon.”***

E kurdo që dikush fillon të merret me mësimin e të tjerëve, ka marrë mbi vete diçka të rëndë, dhe duhet ta dijë që ka filluar një punë të ndershme dhe për këtë arsye duhet të respektojë rregullat e sjelljes që i takojnë mësuesit. Ekzistojnë shtatë detyra që mësuesi duhet t'i respektojë:

*Detyra e parë:* dhembshuria për nxënësin, domethënë që ndaj tyre të sillet si ndaj fëmijëve të vet. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

***“Unë për ju jam si prindi për fëmijën e vet.”***<sup>124</sup>

Mësuesi duhet të fokusohet në mbrojtjen e nxënësit nga zjarri i ahiretit, e kjo është më e rëndësishme se sa kujdesi i prindit ndaj fëmijës që të mos bjerë në zjarrin e dynjasë. Prandaj e drejta e mësuesit është më e madhe se e drejta e prindit. Prindi është shkak i ekzistencës dhe i jetës së kalueshme, kurse mësuesi përgatit për jetë të përhershme. Po të mos ishte mësuesi, ajo çka vjen nga babai mund ta dërgojë fëmijën në shkatërrim të përhershëm, deri sa mësuesi është ai që sjell dobi për ahiret, për jetën e përtejme. Me këtë

---

<sup>124</sup> Ebu Davudi, Nesai dhe Ibn Maxhe nga Ebu Hurejre.

mendoj në mësuesin e diturive të ahiretit, ose të diturive të dynjasë por me qëllim ahiretin, jo dynjanë. E sa i përket mësimit kryekëput për interesa të dynjasë, ajo është *helaq* dhe dërgon në shkatërrim, Allahu na ruajtë!

Ashtu siç do të përparojnë drejt qëllimit fëmijët e një familje në siguri, dashuri dhe respekt të ndërsjellë, edhe nxënësit e një mësuesi duhet të jenë kështu - në siguri, dashuri dhe respekt të ndërsjellë. Ndryshe edhe nuk mund të jetë, nëse qëllim e kanë ahiretin, deri sa ata që për qëllim e kanë dynjanë mund të posedojnë vetëm lakmi dhe urrejtje. Vërtetë mësuesit dhe fëmijët e ahiretit janë udhëtarë drejt Allahut Teala, që nisen tek Ai nga shtigjet e dynjasë, vitet dhe muajt e të cilës janë vetëm stacione përgjatë rrugës. Kujdesi dhe dashuria e ndërsjellë gjatë rrugës mund të jetë vetëm si mjet për arritje më të shpejtë deri te qëllimi. E si duhet të jetë atëherë rruga drejt Firdeusit më të lartë (grada më e lartë e xhenetit), sa më shumë ndihmesë nevojitet në atë rrugë? Në lumturinë e asaj bote nuk ka vështirësi. Prandaj mes udhëtarëve të ahiretit nuk mund të ketë grindje. Kurse në lumturinë e kësaj bote nuk ka shtrirje të gjerë, prandaj njeriu mbetet në luftë dhe konkurrencë të përhershme. Prandaj as nuk mund t'i iket vështirësive, kurse ata që me dituri synojnë pushtet nuk janë të përfshirë në ajetin ku Allahu Teala thotë:

**“Me të vërtetë, besimtarët janë vëllezër.”**

49-Huxhurat: 10

por janë të përfshirë në ajetin:

**“Atë Ditë miqtë do të bëhen armiq të njëri-tjetrit, përveç të drejtëve, që e kanë pasur frikë Allahun.”**

43-ez-Zuhruf: 67

*Detyra e dytë*: në mësim dhe shpjegime t'i përshtatet Resulallahut s.a.v.s., dhe për ofrim të diturisë të mos kërkojë pagesë, bile as falënderim, por t'i mësojë të tjerët për rizanë e Allahut Teala dhe me dëshirë për t'iu afruar Atij. Sado që

nxënësit duhen të jenë mirënjohës, ai nuk duhet ta pranojë një të drejtë të tillë. Ndoshta me mbjellje të farës së diturisë në zemrat të tyre, duhet në ta të njohë vlerat, sepse ata i kanë pregatitur zemrat e veta për afrim Allahut Teala. Kjo gjendje e tyre është si personi që të jep (huazon) tokën e vet për të mbjellur në të dhe për korrje, ku më shumë ke dobi ti se sa pronari i tokës. Edhe ata që shartojnë dituritë në zemrat e nxënësve janë më fitimtarë. E si mundesh pra ta konsiderosh veten të privilegjuar (me kërkim të kompensimit material), kurse sevapi yt për mësim, te Allahu Teala është më i madh se sa sevapi i nxënësit. Po të mos ishte nxënësi, ti atë sevap nuk do ta fitoje! Prandaj shpërblim mos kërko nga kush tjetër, pos nga Allahu Teala, siç thotë Ai vet:

**“Unë për këtë nuk kërkoj nga ju kurrfarë pasurie. Mua më shpërblen vetëm Allahu.” 11-Hud: 29**

Pasuria materiale, si edhe gjithçka në dynja i shërbejnë vetëm trupit, e trupi është bartës i shpirtit (nefsit), deri sa dituria është ajo të cilës i shërbehet sepse vetëm përmes diturisë nefsi fiton kuptimin e vërtetë. Ai që me dituri synon paratë është si ai që me nallane e fërkon fytyrën për ta pastruar, e kështu atë që shërbehet e bën shërbëtor, e shërbëtorin e bën të shërbehet. Një sjellje e tillë është rrotullim kokë-poshtë. Pikërisht kështu ai që me dituri synon paratë, në Ditën e Gjykimit ngjallet para Allahut Teala me kokë përkulur bashkë me gjynahqarët.

Me një fjalë, nderi dhe përfitimet i takojnë mësuesit. E tani shiko si kaloi puna e fesë te njerëzit të cilët për të siguruar përfitime materiale dhe për të fituar ndonjë pozitë, vrapojnë në hyzmet pushtetarëve (sulltanëve). Ata humbasin në para dhe durojnë lloj-lloj nënçmimesh nga pushtetarët e vet. E duke bërë këtë, mendojnë se qëllim i tyre është afrimi Allahu Teala. E sikur të mos ishte kjo mundësi, as që do t'i vizitonin pushtetarët. Një mësues i tillë pret nga nxënësi që t'i

jetë në shërbim gjithmonë, të kujdeset për miqtë e tij e t'i urrejë armiqtë e tij, të jetë i dobishëm për nevojat e tij dhe para tij të jetë i butë si qingj, e nëse rastësisht nuk është i tillë, ai e qorton ashpër dhe i bëhet armiku më i egër. Një mësues të këtillë, që është i pajtuar me sjellje të tilla, bile edhe gëzohet për to, e as që turpërohet të thotë: *“Qëllim i mësimdhënies time është shtrirja e diturisë dhe afrimi Allahut Teala, si edhe ndihmesë fesë së Tij!”*, konsiderojë të ulët. Prandaj mendo dhe mëso nga këto shenja që tregojnë rrugën e qëllimit të keq të atyre që janë mashtruar.

*Detyra e tretë:* mësuesi duhet shumë mirë ta këshillojë nxënësin dhe t'i shpjegojë çdo gjë ashtu siç është, deri në detaje, në atë mënyrë që të mos ngritët në ndonjë pozitë para se ta meritojë dhe të mos merret me të fshehtën para se ta kompletojë diturinë e jashtme. Mësuesi duhet t'ia tërheqë vërejtjen nxënësit se qëllim i mësimit të diturive është afrimi Allahut Teala, e jo dëshira për pasuri, mendjemadhësi dhe konkurrencë. Ai, gjithë këtë fillimisht duhet ta bëjë sa më të qartë brenda kokës së nxënësit. Ngase mësuesi gjynahqar sjell më shumë dëm se dobi. E nëse mësuesi vëren se dituria e nxënësit është vetëm për dynjallëk dhe nëse nxënësi kërkon dituri për vetëlëvdim, për çështjet kundërthënëse në furu-fikh, debatimet e kelamit, fetvatë që trajtojnë lloj-lloj mosmarrëveshje e rregulla, duhet ta ndalojë në këtë, sepse ato nuk janë dituri të ahiretit, as dituri për të cilat thuhet: *‘ne kemi mësuar diturinë për një qëllim tjetër, por dituria refuzoi të jetë për një qëllim tjetër dhe pranoi të jetë vetëm për Allahun’*. Dituri të tilla janë *tefsiri* (interpretimi i Kur'anit), dituria e haditheve dhe të gjitha ato dituri të ahiretit dhe dituri që njoftojnë për ahlakun dhe edukimin e nefsit, me të cilat janë marrë të parët tanë. Nëse edhe me ato nxënësi merret për dynjallëk, atëherë nuk e ka gjynah nëse edhe e lejon, sepse mund t'i lind dëshira për vaz, e që me këtë njerëzit t'i shkojnë pas.

Prandaj, gjatë mësimit për këto dituri, ose kah përfundimi, ka gjasa për përmirësim, sepse në to ka edhe diçka që shkakton frikën nga Allahu Teala, jep përbuzje ndaj dynjallëkut, dhe madhëron ahiretin. Bile, rasti kur duke këshilluar njerëzit mund edhe vet të merr mësim dhe dashuri për të fituar pozitë, është si rasti i kokrrave të vendosura para kurthit për zogun, e zogu duke u munduar të marrë kokrrat, bie në kurth. Njëjtë edhe me vaz – duke i treguar këto hakikate të tjerëve, në fund edhe vetë mund të ndërgjegjësohet, të vij në vete dhe të përfitojë. Kështu vepron edhe Allahu Teala me robët e Tij. Ai u jep epshin për të siguruar brezat e ardhshëm, jep edhe dashurinë dhe titujt, që të bëhen shkak për të jetuar dituritë.

Pra, këto rregulla vlejné për dituritë që i përmendëm.

Angazhimi vetëm me debatimet e kelamit e me hollësitë e çështjeve të fikhut nuk sjell asgjë tjetër përveç pakujdesit, lodhjes shpirtërore, vazhdimit në devijim dhe dëshirës për pozitë, përpos atyre të cilët i arrin rahmeti i Allahut Teala, ose së paku nëse atyre diturive ju shton edhe disa dituri të besimit. Dëshmi për këtë nuk ka, përpos përvojës dhe dëshmisë personale. Vëzhgo dhe studio dijetarët e sotëm dhe me lehtësi e kupton këtë; na ndimofte Allahu.

E kishin parë Sufjan Sevrinë, Allahu e mëshiroftë, të mërztur, dhe e kishin pyetur për arsyen, e ai u tha:

*- U bëmë mjet i tregtisë për fëmijët e dynjallëkut. Njëri pas tjetrit, secili erdhi tek ne, mësoi dhe shkoi, e pastaj u bënë kadi, zyrtarë a pushtetarë.*

*Detyra e katërt:* bëhet fjalë për një veçori, që ka të bëjë me aftësinë për të mësuar tjetrin. Me këtë, mësuesi e largon nxënësin nga ahlaku i keq sa më shumë që të mundet përmes aluzionit, indirekt e jo haptas, me dhembshuri e jo qortim. Sepse të tregohet haptas gabimi, kjo e gris perden e

turpit, shkakton guxim për kundërshtim dhe ngjallë vullnetin për kryeneçësi. Resulallahu s.a.v.s., udhërrëfyeni i të gjithë mësuesve, thotë:

***“Sikur njerëzve t’u ndalohet të thyejnë gungën e deves, çdokush do të tentonte ta thejë, duke thënë: ‘na është ndaluar sepse me siguri në të ka diçka të mirë’.”***<sup>125</sup>

Këtë na e paralajmëron edhe tregimi për Ademin dhe Havën a.s., e tregimet nuk ekzistojnë që vetëm të fliten nëpër mbledhi, por që njerëzit të marrin mësim nga to. Gjithashtu, indirekt, ftohen personat me ndërgjegje të lartë dhe mendjet inteligjente që nga to të nxjerrin kuptime. Me këtë, inteligjenca e tillë ushtrohet edhe më, dhe e dëshiron diturinë, duke e ditur që është e aftë të depërtojë deri te kuptimi i dëshiruar.

*Detyra e pestë:* ai që i mëson nxënësit dituri të caktuara, në sytë e nxënësit të mos nënvlerësojë dituritë tjera, të cilat nxënësi i studion. Kështu për shembull, gjuhëtarët kanë zakon të nënvlerësojnë fikh-un, kurse dijetarët e fikhut minimizojnë dituritë e hadithit dhe tefsirit duke thënë se ato janë transmetime të zakonshme me të cilat mirren ata që nuk janë mjaft inteligjentë dhe se në to nuk ka të menduar për Krijuesin. Njëjtë edhe dijetari i kelamit qorton fikhun, duke thënë se ajo është dituri dytësore, është bisedim për menstruacionet, që nuk mund të krahasohet me bisedën për cilësitë e Allahut Teala. Krejt kjo bën pjesë në ahlak të mospëlqyer nga i cili mësuesi duhet larguar. Në fakt, mësuesi i një disipline, i një diturie, duhet që të nxënësi të zgjojë dashuri edhe për dituritë tjera, e nëse njëkohësisht i mëson disa dituri, atëherë duhet të ketë kujdes në përparimin gradual të nxënësit nga një gradë në tjetrën.

---

<sup>125</sup> Nuk dihet burimi i hadithit.

*Detyra e gjashtë:* që nxënësin të mos e ngarkojë më shumë se sa që ai ka aftësi, duke mos i dhënë dituri të cilat mendja e tij nuk do të mund t'i kuptojë, e me këtë t'i krijojë refuzim ndaj diturisë ose t'ia mjugullojë mendjen. Duhet përshtatur parimit të Resulallahut s.a.v.s., kur thotë:

**“Neve Pejgamberëve na është urdhëruar që me njerëzit të komunikojmë sipas gjendjeve të tyre, dhe t'u drejtohem sipas aftësisë së tyre për të kuptuar.”<sup>126</sup>**

Nëse mësuesi e sheh që nxënësi është në gjendje që edhe vet të kuptojë disa gjëra, atëherë duhet t'ia shpjegojë çdo të vërtetë (*hakikat*). Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“T'u tregohet njerëzve ajo që nuk mund ta kuptojnë, bëhet intrigë për disa.”**

Njëherë, hazreti Alia r.a., duke shikuar gjoksin e tij, tha:

*- Këtu ka dituri të madhe. Sikur të gjeja dikë që mund ta bartë! Të vërtetën e ka folur, Allahu e mëshiroftë.*

Zemrat e të mirëve (*ebrar*) janë varre të fshehtësive, prandaj dijetari nuk duhet që të shpjegojë të gjitha dituritë që i di - secilit, dhe këtë edhe kur nxënësi është në gjendje të kuptojë, por nuk është i aftë për të përdorur ato dituri. E si është puna e atij që as nuk mund të kuptojë?! Isa a.s., thotë: *“Mos vendosni xhevahirë në qafë të derrit.”*, e dituria është gjithsesi më e vlefshme se xhevahirët, e ai që nuk ia di vlerën diturisë është më i keq se derri. Prandaj edhe thuhet: *‘Për secilin, kanar le të bëhet mendja e tij dhe peshoje sipas kuptimit të tij, që të jesh i mbrojtur nga ai, e edhe ai të ketë dobi prej teje. Në të kundërtën, do të vijë deri te refuzimi, për shkak të pabarazisë mes kritereve.’*

---

<sup>126</sup> Ebu Davudi nga Ajsha r. anha.

E kishin pyetur diçka një dijetar, e ai nuk kishte dhënë kurfarë përgjigje. Ai që shtroi pyetjen, i tha:

- *A nuk ke dëgjuar që Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:*

**'Kush fshehë diturinë e dobishme, në Ditën e Gjykimit do të ngjallet me gojëz të zjarrit.'**<sup>127</sup> Dijetari ia ktheu:

- *Lëre gojëzën dhe shko! Nëse më vije dikush që kupton, e unë fshehi diturinë nga ai, atëherë më vë gojëzën e zjarrit! Allahu Teala thotë: 'Mendjelehtëve (të papjekurve) mos u jepni pasurinë tuaj...' (4—Nisa: 5)", duke tërhequr kështu vërejtjen që më e rëndësishme është ruajtja e diturisë nga ai që do ta prishte, dhe që vet atij do t'i sillte dëm. Sa zullum është dhënia dikujt që nuk meriton, po aq zullum është mos-dhënia atij që meriton. E poeti thotë:*

***Vallë perlat në ruajtje çobanëve t'ju japë?***

***Atë vlerë të madhe, çobani ta kapë?***

***Ata as vlerën nuk do t'ia dinë***

***E kjo kah egërsimi ata mund t'i prijë.***

***Nëse më jep Allahu nga të mirat e Tij,***

***E unë të takoj të denjin për dituri,***

***Të mirën me të e ndaj, dashuria shihet,***

***deri atëherë dituria në zemër do të fshihet.***

***Kush xhahilit dituri i jep***

***— diturinë e ka helmuar,***

***E ai që diturinë nga i miri fsheh***

***— zullumin e ka gatuar.***

*Detyra e shtatë:* që nxënësit të pa-aftë t'i shpjegohen vetëm ato dituri që ai mund t'i kuptojë dhe nuk duhet t'i thuhet se ekzistojnë disa çështje që ai nuk mund t'i kuptojë. Një sjellje e tillë mund të shkaktojë te nxënësi humbje të

---

<sup>127</sup> Shënon Ibn Maxhe me zingjir të dobët të transmetuesve.

dëshirës për diturinë tashmë të ofruar, ta shqetësojë zemrën e tij edhe më shumë, dhe të nxisë mendime në kokën e nxënësit se si mësuesi është dorështrënguar për dituri, sepse secili mendon që është i aftë për secilën hollësi të diturisë dhe secili është i kënaqur me përsosmërinë e mendjes që i është dhuruar. E më kokëtrashi, dhe me mendje më i dobëti është ai që më së shumti i gëzohet përsosshmërisë së mendjes së vet. Përshtatshëm kësaj, njeriu i rëndomtë (avam) që i përmbahet sheriatit dhe që në shpirt fuqishëm beson në parimet kryesore të fesë, ashtu siç kanë arritur ata nga gjenerata e parë, pa bërë krahasime dhe interpretime, e krahas kësaj është edhe me moral të bukur, kurse mendja e tij nuk është në gjendje të pranojë asgjë më shumë, besimin e tij nuk duhet trazuar, por duhet lënë në bindjen që e ka dhe në fenë që e ka mësuar. Nëse të tillit do t'i afrohej interpretimi i brendshëm i tekstit, ai del nga shtresa e rëndomtë, por meqë nuk mund të kuptojë, nuk do të hynte në mesin e të zgjedhurve (*havas*). Atëherë do të hiqej perdja mes tij dhe kundërshtimit, e edhe në qoftë njeri i mirë, do të bëhej shejtan inatçi, veten dhe të tjerët do t'i fuste në devijim.

Prandaj as nuk duhet filluar të flitet për të vërtetat e hollësive të diturisë para njerëzve të zakonshëm, por duhet kufizuar në mësimin e ibadeteve, në përmbajtjen e tyre, dhe si ta ruajnë atë amanet. Atëherë, zemrat e tyre mbushen me dëshirë për xhenet dhe frikë nga xhehenemi, ashtu siç e shpjegon Kur'ani, dhe nuk kthehen kah dyshimet. Nuk duhet të shpjegohet asgjë që mund të zgjojë dyshim te ata, e pastaj kërkesa për ta zgjedhur atë dyshim e lodh personin, e për këtë shkak bëhet i palumtur, dhe përfundon në shkatërrim.

Me një fjalë, dyert e hulumtimit nuk duhet hapur njerëzve të zakonshëm, sepse atëherë do të largohen nga profesionet e tyre me të cilat njerëzit jetojnë.

*Detyra e tetë: që mësuesi të veprojë sipas diturisë së tij, që të folurit e tij të përcillet me veprat e tij. Dituria shihet me shikim të zemrës (basiret), e veprat me shikimin e syve (besar), e pasi veprimi është gjendje që shihet me sy, tërheq më shumë vëmendjen e njerëzve. Sikur veprat të mos përcillnin diturinë, kjo do të ishte shkaktar i një papjekurie të madhe. Kushdo që angazhohet në diçka, e të tjerëve ju flet se si ajo punë nuk është e vlefshme, është duke pirë helm të rrezikshëm, bëhet shkaktar për akuzime dhe poshtërime të botës, e te vet ata ngjallë edhe më shumë dëshirën për të ndaluarën. Atëherë të tjerët do të thonë: “Po të mos ishte kjo diçka e mirë dhe e ëmbël, as ai nuk do ta praktikonte.”*

Murshidi është qëndistar, e nxënësi është vendi i qëndisjes. Pa qëndistarin nuk bëhet qëndisja. Dhe një ngjashmëri tjetër: mësuesi është si druri, e nxënësi hije. A mund të jetë hija e drejtë nëse druri është i shtrembër? Për këtë arsye është thënë:

*“Mos fol për pamoral, e shih si vet sillesh,  
Turpi mbi ty bjen, nëse kështu shtiresh.”*

Allahu Teala thotë:

**“A po i urdhëroni (thirrni) njerëzit për punë të mira, e veten tuaj po e harroni?”** 2-Bekare: 44

Prandaj dënimi për gabimin e dietarit është më i madh se sa dënimi për të paditurin (xhahil), sepse me rrëshqitjen e dietarit rrëshqasin edhe njerëzit. *‘Kush nis një praktikë të keqe, ai do të bartë gjynahin e vet, dhe të atyre që kanë vepruar sipas asaj praktike.’*

Për këtë, edhe thotë hazreti Alia r.a.:

*“Dy njerëz më thyen kurrizin – dietari gjynahqar dhe i padijshmi (xhahili) i përveshur në ibadet. I padijshmi huton të tjerët me ibadetin e tij, e dietari huton me gjynahet e tij.”*

E Allahu e di çdo gjë më së miri!



## KAPITULLI I GJASHTË

### DIJETARËT E KËQIJ

#### SQARIMI I SHENJAVE TË DIJETARËVE TË AHIRETIT DHE DIJETARËVE TË KËQIJ

Kemi përmendur disa ajete dhe hadithe që tregojnë faziletin e diturisë dhe dijetarëve, dhe që flasin për vuajtjen më të rëndë që do ta shijojnë dijetarët e këqij në ditën e kiametit. Një çështje tjetër e rëndësishme është dallimi mes dijetarëve materialistë, synimi i të cilëve është përfitimi i parasë, pasurisë, gradës dhe pozitës, prej dijetarëve të ahiretit. Fjalët e shenjta të Pejgamberit tonë kështu i ndajnë këta njerëz:

**“Në ditën e kiametit vuajtjen më të rëndë do ta shijojnë dijetarët që nuk kanë përfituar (për ahiretin e tyre) prej diturisë së Allahut Teala.”<sup>128</sup>**

Përsëri Pejgamberi ynë thotë:

**“Personi nuk mund të bëhet dijetar deri sa nuk vepron me atë që di.”<sup>129</sup>**

**“Janë dy dituri. Njëra është në gjuhë – që është një dëshmi e krijesave, e tjetra është në zemër; e kjo është dituria e dobishme.”<sup>130</sup>**

---

<sup>128</sup> Hadithi është cekur më lartë.

<sup>129</sup> Ibn Hibban, nga Ebu'd-Derda.

<sup>130</sup> Tirmidhi.

**“Në kohërat e fundit (ahir zaman) do të paraqiten abitët (ata që bëjnë shumë ibadet) pa dituri dhe dijetarët gjynahqarë.”<sup>131</sup>**

**“Mos mësoni të kacafyteni me të poshtrit, të paraqitni epërsi karshi dijetarëve dhe të përfitoni pëlqimin e njerëzve! Sepse, ata që mësojnë për këtë qëllim janë në xhehenem.”<sup>132</sup>**

**“Kush e fsheh diturinë, Allahu Teala atij do t’ia vendosë një fre nga zjarri.”<sup>133</sup>**

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**- Më shumë se nga Dexhalli, për juve frikësohem nga ata që nuk janë Dexhall! Pyetjes:**

**- ‘Kush janë ata? Për kë është fjala?’, Pejgamberi iu përgjigj:**

**- Janë imamët që devijojnë.<sup>134</sup>**

**“Nëse me shtimin e diturisë nuk përmirësohet edhe ahlaku (moral), asgjë tjetër pos largimit prej Allahut nuk mund të përfitohet.”<sup>135</sup>**

Isa alejhiselam, iu drejtua dijetarëve:

**- Si do t’u tregoni rrugën atyre që vrapojnë në këtë natë (që janë duke bërë ibadet), kur ju vet jeni ende në mesin të hutuarve?**

---

<sup>131</sup> Hakimi, nga Enesi.

<sup>132</sup> Ibn Maxhe nga Xhabiri.

<sup>133</sup> Hadithi është cekur më lartë.

<sup>134</sup> Ahmed, nga Ebu Dheri.

<sup>135</sup> Ebu Mansur nga ed-Dejlemiu.

Këto që treguam dhe thëniet që i cituam, shpjegojnë për rrezikun e madh të diturisë. Sepse dijetarët janë përballë shkatërrimit të përjetshëm, ose lumturisë së përjetshme. Nëse me dituri nuk gjejmë lumturi, atëherë nuk shpëtojmë.

Omeri r.a., ka thënë:

- *Për këtë ummet, më së shumti frikohem nga mynafiku (dyfytirësh) që posedon dituri. Pyetjes se si bëhet mynafiku i ditur, ai i është përgjigjur:*

- *Me gjuhë dijetar, me zemër dhe veprime i paditur.*

Hasan Basriu, Allahu qoftë i kënaqur me të, ka thënë:

- *Mos u bëj nga ata budallenj që mbledhin njohuritë e dijetarëve dhe fjalët e mençura – e fjalët nuk u përputhen me veprimin.*

Halil b. Ahmed thotë:

- *Njerëzit ndahen në katër pjesë:*

1. *Ata që kuptojnë, dhe veprojnë përshtatshëm me diturinë që kanë. Këta janë dijetarë, atyre përshtatuni.*

2. *Ata që kuptojnë, por nuk veprojnë përshtatshëm diturisë që kanë. Këta janë gafilët (të pavëmendshmit). Atyre tërhiqni vëmendjen.*

3. *Ata që nuk dinë por kuptojnë që nuk dinë. Këtyre u thuhet thjesht i paditur, këta janë në kërkim të rrugës, këtyre tregojni rrugën e drejtë.*

4. *Ata që nuk dinë, por nuk kuptojnë që nuk dinë (mendojnë që dinë). Këtij i thuhet i paditur i vërtetë, nga ai largohuni.*

Sufjan es-Sevri r.a., ka thënë:

- *Dituria e fton veprën. Nëse vepra nuk vjen, dituria largohet.*

Ibn Mubarek thotë:

- *Dijetari, deri sa vazhdon leximin është dijetar. Kur mendon se është dijetar dhe braktis shtimin e diturisë, atëherë bëhet i paditur.”*

Ndërsa Fudajl bin Ijad kështu thotë:

- Ndjej keqardhje për tre vetë:

1. *Për atë që, duke qenë i madhi i një populli, bie në poshtërim,*

2. *Për atë që, duke qenë i pasur bie në varfëri, dhe*

3. *Për dijetarin që është lodër në duart e botës.”*

Hasan Basriu ka thënë:

- *Vuajtja e dijetarëve është me vdekjen e zemrave të tyre. E vdekja e zemrave të tyre është kërkimi i kësaj bote me diturinë e ahiretit.”*

Në këtë çështje, një poet thotë:

- *Çuditë nga ai që jep udhëzimin e merr devijimin. Edhe më i çuditshëm është ai që jep fenë e merr këtë botë. E, edhe më i çuditshëm është ai që për pasurinë e tjetrit e shet fenë e vet.*

Resulallahu s.a.v.s., me një hadith thotë:

**“Dijetari (është fjala për dijetar gjynahqarë), aq shumë do të jetë kapur në vuajtje, sa që prej vuajtjes të fortë, banorët e xhehenemit i bëjnë vizitë.”**

Usame b. Zejd r.a. thotë se ka dëgjuar Resulallahun s.a.v.s., duke thënë:

- **Ditën e kiametit, dijetari dërgohet në xhehenem, zorrët dalin jashtë dhe ai sillet rreth si gomari që sillet rreth mullirit, banorët e xhehenemit u shkojnë në vizitë dhe i pyesin:**

- **Çka është kjo që vuani? Dijetari përgjigjet:**

- Urdhërova të mirën por vet nuk e bëra; ndalova të këqijat, por unë vet i bëra.<sup>136</sup> Arsyeja pse dijetari vuan edhe më shumë është se ai, duke ditur – është kryengritur. Për këtë arsye Allahu Teala thotë:

**“Pa dyshim që hipokritët do të jenë në thellësinë më të madhe të Xhehenemit.”** 4-Nisa: 145

Sepse ata, pasi mësuan – mohuan. Për këtë arsye çifutët njihen më të këqij se të krishterët. Por ata të gjithë nuk thanë që Allahu ka fëmijë. As nuk thanë të gjithë që Allahu është një trini (vet i treti). Por ata, edhe pse e njohën Pejgamberin tonë Muhammedin a.s., e mohuan. Ndërsa Kur’ani Kerim thotë:

**“Ata që u kemi dhënë Librin, e njohin atë (Pejgamberin a.s.), ashtu siç i njohin bijtë e tyre.”** 2-Bekare: 146

Dhe në ajetin tjetër:

**“Kur u erdhi ajo që e dinin se është e vërtetë, ata e mohuan atë! Prandaj mallkimi i Allahut qoftë mbi mohuesit!** 2-Bekare: 89

Në tregimin e Bal’am Ibn Ba’ura kështu thuhet:

**“Tregoju atyre (hebrenjëve) për njeriun, të cilit Ne i mësua shpalljet Tona, por ai u largua prej tyre. Kështu, shejtani e pushtoi atë dhe ai u bë nga të humburit.**

Sikur të donim, do ta ngritnim atë (me shpalljet Tona), por ai u mbërthye pas jetës tokësore dhe u dha pas dëshirave të veta. Shembulli i tij është si shembulli i qenit: nëse e ndjek, ai të nxjerr gjuhën, nëse largohesh, ai përsëri të nxjerr gjuhën. Ky është shembull i njerëzve, që mohojnë shpalljet Tona. Tregoju atyre këto ngjarje, në mënyrë që ata të mendojnë.” 7-A’raf : 175-176

---

<sup>136</sup> Buhari dhe Muslim.

Sipas shumë komentuesve të Kuranit, vargu aludon për një dijetar hebre, bashkëkohës të Musait a.s., që quhej Bal'am Ibn Bâ'ûra. Allahu i kishte mësuar atij emrin e Vet më të madh, nëpërmjet të cilit atij i plotësohej çdo lutje. Një herë, Musai e dërgoi Bal'amin tek mbreti i Medjenit, për ta ftuar në besimin tek Allahu. Mbreti nuk e pranoi këtë ftesë, por e joshi Bal'amin me pasuri dhe e ktheu në fenë vet. Kështu, ai hoqi dorë nga feja e Musait dhe u bë pagan.

I tillë është dijetari i keq. Bel'amit iu dha dituria nga libri i Allahut, por ai u zhyt në dëshirat e veta dhe i përngjau qenit. Pra, të tillëve, edhe po t'u jepet dituria, edhe mos t'u jepet – vazhdimisht janë të etur për dëshirat e veta.

Isa a.s. thotë:

*- Dijetari i keq është si një gur që ka rënë në burim; as që pi ujë vet e as që lë uji të shkojë e të ujitë kopshtet. Dijetari i keq është si bari që rritet mbi pleh. Dijetari i keq është si varri; nga jashtë mbuluar me lule, e përbrenda mbushur me eshtra.*

Nga të gjitha këto shpjegime është e qartë se ata që marrin dituri vetëm për përfitimet e kësaj bote do të kenë më shumë vuajtje se sa xhahili (i padituri).

Ndërsa dijetarët e ahiretit do të shpëtojnë dhe do të arrijnë në atë që besuan. Dijetarët e ahiretit kanë shenjat e veta:

1. Me diturinë e tij mos ta kërkojë këtë botë. Sepse shkalla më e ulët e dijetarëve është të dihet se kjo botë është e përbuzur dhe poshtëruar, që shijet janë kalimtare, si dhe të dihet (njihet) madhështia e ahiretit, që është i përjetshëm me mirësi të pastra. Gjithashtu, shkalla më e ultë e diturisë është të dihet që është e pamundur që këto dy kundërshti - bota dhe ahireti, të mblidhen me një vend. Kjo është si peshorja,

njëra anë rëndohet – tjera lehtësohet, si Lindja dhe Perëndimi – kur njërit i afrohesh, prej tjetrit largohesh. Janë si dy gota; njëra e plotë e tjetra zbrazët, kur derdhet njëra në tjetrën – njëra mbetet e zbraztë. Të gjitha këto duhet ditur.

Ai që nuk e di pa-vlefshmërinë e botës, shqetësimet dhe vuajtjet, kënaqësitë e përziera me pikëllim dhe mirësitë që shpejt humbasin, ai është budalla. Përvoja dhe vërtetimet tona tregojnë se ky është thelbi i kësaj çështje. Sigurisht, ai që nuk e kupton këtë është i pamend. A mund të jetë dijetari pa mend? Ndërsa ai që nuk beson se ahireti është i përjetshëm, është qafir.

Ai që nuk kupton se bota është e kundërta e ahiretit, dhe këto mundohet t'i bashkojë me një vend, është i paditur për të gjitha shariatet e Pejgamberëve, e ndoshta edhe për tërë urdhrat e Kur'anit, ai është qafir. Si mund t'i bashkohet kategorisë së dijetarëve dikush që gjendet në këtë shkallë të ulët? Ai që nuk preferon ahiretin duke i ditur të gjitha këto, është bërë peng i shejtanit dhe dëshirave që e shkatërrojnë; si mundet ai të hyjë në mesin e dijetarëve?

Sipas lajmeve, Davudi alejhiselam kështu urdhërohet nga Allahu Teala:

*- Dënimi më i vogël që do të jap për dijetarin i cili preferon dëshirat e veta mbi dashurinë Time, është që shija e lutjes së tij Mua, bëhet haram. O Davud, mos më pyet për dijetarin e dehur nga dashuria e kësaj bote; të tillët pengojnë dashurinë e njerëzve ndaj Meje, i ndërprejnë rrugët që qojnë në kënaqësinë Time. O Davud, në qoftë se gjen njërin që më kërkon Mua, bëhu shërbëtori i tij. O Davud, personi i cili një të arratisur e kthen kah Unë, atë e shënoj si mendjemprenjtë dhe të kuptueshëm. Këdo që e shënoj të kuptueshëm, atë assesi nuk e dënoj.*

Për këtë arsye Jahja b. Muadhi ka thënë:

- *Të kërkosh pasurinë e kësaj bote me dituri dhe mençuri, e humbet nurin (dritën) e diturisë dhe mençurisë.*

Sad b. Musejeb r.a. ka thënë:

- *Dijetari që shoqërohet me njerëzit e pushtetit, është hajdut.*

Omer r.a., ka thënë:

- *Në qoftë se e shih dijetarin duke iu përkulur kësaj bote, akuzojeni në emër të fesë. Sepse çdokush zhytet në atë që do.*

Malik b. Dinar ka thënë:

- *Lexova në një libër të vjetër që Allahu Teala urdhëron: 'Kur dijetari dashurohet në këtë botë, dënimi më i vogël që do t'i jap është që do ta humbas kënaqësinë e përuljes së tij ndaj Meje.*

Njëri i shkruante letër vëllait të vet:

- *Ti u bërë dijetar, mos e fik ndriçimin e diturisë me errësirën e gjynahut, se pastaj ngel në terr, e poseduesit e diturisë udhëtojnë me ndriçimin e diturisë.*

Jahja b. Muadh er-Radhi, për dijetarët që janë dashuruar pas kësaj bote, kishte thënë:

- *O dijetarë! Vilat e juaja si pallatet e mbretërve, shtëpitë e juaja si shtëpia e Kisrit (mbreti persian), veshja juaj si veshja e Vezir Tahirit, këpucët tuaja si të Xhalutit, kali juaj si kali i Karunit, shtroja juaj si ajo e Faraonit, ushqimi dhe pija si në kohën e xhahilijetit, rrugën që e ndiqni është rruga e shejtanit; ku mbeti sheriati i (rruga e) Muhammedit?!*

Poeti thotë:

- ***Nëse çobani që ruan delen prej ujkut bëhet vet ujk, si bëhet puna e deles?***

Edhe një poet kështu thotë:

*- Hej dijetarë të qytetit, ju demek jeni si kripa e gjellës. Kripa e ruan çdo gjë prej prishjes, e kur prishet vet kripa, çka mund të ruaj?*

Disa evlia kanë pyetur:

*- A mund të thoni që personi i cili merr kënaqësi prej gjynaheve e njeh Allahun? Ata thanë:*

*- Assesi nuk dyshojmë që ata të cilët preferojnë këtë botë më shumë se ahiretin nuk e njohin Allahun.*

Por preferimi i kësaj bote është më keq se sa të merret shije prej gjynahit.

Mos mendo që, për të hyrë në mesin e dijetarëve të ahiretit mjafton vetëm të braktiset pasuria. Sepse dëshirimi i postit është më i keq se pasuria.

Bishri ka thënë:

*- Kur dikush thotë 'na trego një hadith', kupto që ai dëshiron të thotë 'na trego lehtësi'.*

Bishri ka groposur më shumë se dhjetë zymbyle me libra. Gjithashtu ka thënë:

*- Nefsi (im) dëshiron të flasë, nëse mund ta mposht nefsin, atëherë flas.*

Bishri, por edhe të tjerët, kështu thonë:

*- Kur ke dëshirë të flasësh, mos fol; e kur je pa dëshirë për të folur, atëherë fol. Sepse kënaqësia që fitohet prej postit të udhëzuesit (irshad) dhe shprehjes me ndikim, është më e lartë se të gjitha kënaqësitë në këtë botë. Ata që u përshtaten epshit (në këtë çështje) janë materialistë.*

Për këtë arsye, Sevriu ka thënë:

- *Fitna (ngatërresa) e të folurit është më e madhe se sa fitna e pasurisë dhe familjes. Çfarë guximi është ky që nuk tërhiqesh prej fitnes së të folurit?*

Ndërsa Zotërisë së Pejgamberëve, kështu i është thënë:

**“Dhe sikur mos të të kishim forcuar Ne, gati do të kishe anuar pak nga ata.”** 17-Isra: 74

Shehli ka thënë:

- *Dituria për ahiretin është ajo dituri me të cilën veprohet. Të gjitha veprimet janë të kota, përpos veprimeve për rizanë e Allahut.*

Përsëri Shehli ka thënë:

- *Të gjithë njerëzit janë të vdekur, vetëm dijetarët nuk janë - ata janë të dehur, përpos atyre që edhe veprojnë me dituri. Edhe ata që veprojnë me dituri janë në mashtrim, përveç atyre që veprojnë edhe me sinqeritet. Edhe ata që veprojnë me sinqeritet janë në frikë, deri sa të njoftohen me përfundimin.*

Isa a.s., ka thënë:

- *Meqë ahireti është vendi i arritjes, si mund të bëhet dijetar ai që i është kthyer botës? Si mund të njihet si dijetar ai që mëson vetëm për t’ju treguar të tjerëve, e jo për të vepruar?*

Ebu Hurejre r.a., transmeton nga Resulallahu s.a.v.s.:

**“Ata të cilët, një dituri që është për të fituar kënaqësinë e Allahut Teala e kërkojnë për përfitime të kësaj bote, në kiamet nuk mund të nuhasin aromën e xhenetit.”**<sup>137</sup>

---

<sup>137</sup> Ebu Davudi nga Ibn Maxhe.

Allahu Teala i ka cilësuar si dijetarë të këqij ata që përfitojnë në këtë botë me dituri të ahiretit. Kurse dijetarët e ahiretit i ka cilësuar me përlujtje (hushu) dhe pa dëshira për këtë botë (zuhd).

Rreth dijetarëve të dynjallëkut është thënë:

**“Kujtoje kohën kur Allahu mori premtimin nga ata që u është dhënë Libri se do t’ua shpjegojnë atë njerëzve dhe nuk do të fshehin asgjë nga ai. Pastaj ata e hodhën pas shpine (premtimin) dhe e ndërruan atë me një vlerë të vogël.”** 3-Al’Imran: 187

Dhe për dijetarët e ahiretit, kështu thuhet:

**“Midis ithtarëve të Librit, me siguri ka të atillë që e besojnë Allahun dhe atë që ju është shpallur juve, si dhe atë që u është shpallur atyre, duke qenë të përlujtur para Allahut dhe pa i këmbyer shpalljet e Tij me ndonjë vlerë të paktë. Ata do të kenë shpërblimin e tyre te Rabbi i tyre.”**

3-Al’Imran: 199

Disa nga dijetarët e parë kanë thënë:

*- Dijetarët (e ahiretit) do të ringjallen në mesin e Pejgamberëve, ndërsa gratë dhe fakihët që me diturinë e tyre kërkojnë këtë botë do të ringjallen në mesin e sulltanëve ”*

Ebu’d- Derda r.a., thotë se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

**“Thuaju atyre që merren me dituri por jo për shkak të fesë, dituri fitojnë por nuk veprojnë me të, dynjallëkun e kërkojnë me veprime të ahiretit, para njerëzve janë si qengji, e ujëq përbrenda, në gjuhë janë më të ëmbël se mjalti, përderisa zemrat i kanë më të shtëna se bima e ithët e aloesë, Mua më mashtrojnë dhe me Mua tallen, të tillët do t’i sjellë në sprovë të tilla që, edhe i miri do të hutohet.”**

Dehhak-ju, duke transmetuar nga Ibn Abbasi r.a., thotë se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

**“Dijetarët e këtij ummeti janë dy lloj:**

**Njërit, Allahu Teala i jep dituri e ai ua shpërndanë këtë dituri njerëzve, e për këtë nuk merr ndonjë pasuri të kësaj bote; nuk e shet këtë dituri për gjëra të kësaj bote. Këtij personi i bëjnë dua shpendët në qiell, peshku në ujë, kafshët në tokë. Melaiket Kiramen Katibin e sjellin këtë person në ditën e kiametit në prani të Allahut Teala si një person të shenjtë dhe të ndershëm. Më në fund, duke marrë pjesë në mexhlisin e Pejgamberëve, bëhet mik me ta.**

**Ndërsa tjetrit Allahu Teala i jep dituri në botë, e ai me këtë dituri i devijon robërit e Allahut Teala. Për këtë dituri merr pasuritë e kësaj bote, këtë dituri e shet për pak send. Këtij personi, në ditën e kiametit i vendoset në gojë një fre prej zjarrit. Një tellall del përpara njerëzve duke thënë: *‘Ky është i biri i filanit. I ka dhënë Allahu Teala dituri, e ai me këtë dituri ka devijuar prej të vërtetës robërit e Allahut Teala, karshi kësaj diturie ka marrë mallin e dynjasë dhe ka shitur diturinë për pak send.’* Ky person vuan deri sa të përfundojë llogaria e njerëzve, pastaj e vuan dënimin e vërtetë.”<sup>138</sup>**

Edhe më keq se kjo është tregimi në vazhdim:

Një person, që ishte shërbëtori i Musasë a.s., vazhdimisht thoshte: *“Musa Safiullah kështu tha, Musa Naxhiijullah kështu foli, Musa Kelimullah kështu tregoi...”*, dhe me këtë përfitoi shumë pasuri. Për një kohë të shkurtër, ky person u humb. Musa a.s., e kërkoi shumë por nuk e gjeti. Një

---

<sup>138</sup> Taberani.

ditë, erdhi te Musa a.s., një njeri me një derr të zi lidhur me konop në qafë. Musa a.s., edhe këtë person e pyeti për shërbëtorin e tij, e personi i tha:

- *Ky derr është personi që ti kërkon.* Musa a.s., iu lut Allahut Teala, duke thënë:

- *Ja Rab, ktheje këtë person në formë të njeriut që ta pyes për shkakun e shndërrimit të tij në derr.* Në këtë dëshirë, Allahu Teala tha:

- **Ja Musa, nuk do të pranoj dëshirën tënde edhe nëse lutesh me lutjet e Ademit dhe prej Ademit deri te ti, por do të njoftoj pse e shndërrova në derr: Ai është kështu për shkak që ka ndërruar fenë me këtë botë.**

E edhe më e tmerrshme se kjo është transmetimi nga Muadh b. Xhebeli r.a., që Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

**“Njëra nga ngatërresat (fitne) të dijetarit është që më shumë e do bisedën se heshtjen. Ngase në fjalë ka gabime dhe zbulurime, si dhe shtesa në të folur për personin që nuk është i bindur, ndërsa në heshtje ka selamet dhe dituri. Nga dijetarët ka të tillë që xhelozojnë në diturinë e vet, nuk dëshirojnë që askush të jetë i ditur dhe askujt asgjë nuk i mësojnë. Dijetarët e tillë janë në shtresën e parë të xhehenemit. Disa dijetarë nervozohen si sulltanët nëse disa fjalë të tyre nuk dëgjohen ose nëse u humben disa të drejta. Këta janë në shtresën e dytë të xhehenemit. Ndërsa disa dijetarë u tregojnë të pasurve dhe njerëzve me popullaritet kuptimet më delikate dhe dituritë e përmbledhura, por këtu nuk ua tregojnë të varfërve që kanë nevojë për to, duke i poshtëruar ata. E këta janë në shtresën e tretë të xhehenemit. Disa dijetarë tjerë, duke e stolitur veten me emërtimin *myfti*, japin fetva të gabuara. Ndërsa Allahu Teala**

i urren fetvatë e shpikura. E vendi i këtyre është në shtresën e katërt të xhehenemit. Ndërsa disa dijetarë të tjerë, duke dëshiruar të shtojnë diturinë e tyre, shtojnë fjalët e çifutëve dhe të krishterëve në fjalët të veta. Këta janë në shtresën e pestë të xhehenemit. Ka edhe dijetarë të tillë që diturinë e tyre e llogarisin si një arsye për epërsi dhe famë mes njerëzve. Këta do të jenë në shtresën e gjashtë të xhehenemit. Disa dijetarë tjerë mbështillen në mendjemadhësi dhe egoizëm, në vaz janë të ashpër, dhe nuk dëgjojnë vazet e të tjerëve. Të këtillët janë në shtresën e shtatë të xhehenemit. Prandaj prefero heshtjen, që me heshtje ta mposhtësh shejtanin. Largohu nga çështjet boshe dhe mos shko në vende të panevojshme.”<sup>139</sup>

E me një hadith tjetër thuhet:

**“Lavdërimi i disa personave, edhe po të jetë nga lindja deri në perëndim, nuk ka vlerë tek Allahu Teala as sa krahu i mushkonjës.”<sup>140</sup>**

Tregohet se si një person, i cili kishte marrë pjesë në qarqet e Hasani Basriut, u kthye nga Horasani, duke ia sjellë një dhuratë prej 5000 dërrhemësh dhe dhjetë palë rroba nga materiali më i mirë, duke i thënë:

- *O Ebu Seid, kjo është nafakë e jotja.* Hasani iu përgjigj:

- *Allahu të mëshiroftë, mbaji ato për vete! Ne nuk kemi nevojë për to. Ai që ulet në një vend si ky i imi, e më pas nis të merr nga dynjaja këto që ti mi solle, në botën tjetër do ta takojë Allahun pa pasur aspak vlerë para Tij.*

---

<sup>139</sup> Ebu Nuajm dhe Ibn Xheviz e përmendin në **‘Mevzuat’**

<sup>140</sup> Nuk është gjetur burimi.

Xhabiri r.a., transmeton se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

**“Mos rrini në mexhlisin (tubimin) e çdo dijetari; dijetari në mexhlisin e të cilit do të uleni duhet të jetë i tillë që ju udhëzon nga pesë vese të këqija në pesë virtyte: nga dyshimi na bindje (jekin), nga dyfytirësia në sinqeritet, nga dëshira e kësaj bote në zuhd, nga egoja në nënshtrim, nga armiqësia në këshillë dhe në miqësi.”<sup>141</sup>**

Allahu Teala thotë:

**“Kur ai dilte para popullit të vet me stolitë e tij, ata që lakmonin jetën e kësaj bote thanë: ‘Ah! Sikur të na ishte dhënë edhe neve si Karunit! Vërtet që ai është njeri me fat.’**

**Ndërsa njerëzit e dijshtëm thoshin: ‘Të mjerët ju! Shpërblimi i Allahut është më i mirë për atë që beson dhe bën vepra të mira. Ai do t’u jepet vetëm të duruarve’.”**

28-Kasas: 79, 80

Allahu Teala na shpjegon që dijetarët e ahiretit e preferojnë ahiretin karshi kësaj bote. Një shenjë tjetër e dijetarëve të ahiretit është se fjala u përputhet me veprimin. Diçka që vet nuk e bëjnë, nuk i urdhërojnë as tjetrit.

**“Është shumë e urryer për Allahun të thoni atë që nuk e bëni!”** 61-Saff: 3

**“Vallë, a i urdhëroni njerëzit që të bëjnë të mira e veten po e harroni.”** 2-Bekare: 44

**“Unë nuk dëshiroj të bëj atë, që jua ndaloj juve.”**

11-Hud: 88

**“Prandaj ruajuni Allahut! Allahu ju mëson ju.”**

2-Bekare: 282

---

<sup>141</sup> Ebu Nuajm në veprën *‘Hilje’*.

**“Ta keni frikë Allahun dhe dijeni se...” 2-Bekare: 196**

**“Frikësojuni Allahut dhe dëgjojeni!” 5-Ma’ide: 108**

Allahu Teala i ka thënë Isasë alejhiselam:

**- *O i biri Mejremes, së pari foli vetes, nëse e bën atë që flet, atëherë folu njerëzve, përndryshe turpërohu prej Meje.***

Resulallahu s.a.v.s., me një hadidh kështu thotë:

**“Në natën e Israsë pashë njerëz me buzë të prera me gërshërë të zjarrita, e i pyeta *”Kush jeni ju”*, e ata u përgjigjën: *“Urdhëruam mirësinë – e vet nuk e bënim, ndaluam prej të këqijave – por ne vet i bënim.”*”<sup>142</sup>**

**“Shkatërrimi i ummetit tim vjen nga dijetarët e këqij dhe abidët xhahil (të paditur). Më i keqi nga më të këqijtë është dijetari i keq, e më i miri nga më të mirët është dijetari i mirë.”<sup>143</sup>**

Evzai, Allahu e mëshiroftë, tregon:

**- *Do të ankohen varrezat nga era e keqe që vjen nga e brendshmja e pabesimtarit, e Allahu do t’ju shpallë që era e të brendshmes së dijetarëve të këqij edhe më e neveritshme.***

Fudajl b. Ijadh r.a., ka thënë:

**- *Kam dëgjuar që në kiamet dijetarët e këqij do të japin llogari para idhujtarëve.***

Ebu ed-Derda r.a., ka thënë:

**- *Vaj halli për atë që nuk di, e shtatëdhjetë herë vaj halli për atë që di e nuk e bën.***

---

<sup>142</sup> Ibn Hibban nga Enesi.

<sup>143</sup> Darimi

Shabiu ka thënë:

- *Në kiamet disa xhenetli do t'i pyesin disa xhehenemli:*

- *'Për çka jeni ju në xhehenem, kur në saje të asaj që ju na mësuar dhe si na edukuat, Allahu Teala neve në solli në xhenet?', e ata thonë:*

- *'Ne urdhëruam të mirat, por vet nuk i bëmë; ndaluam të këqijat, por ne vet i bënim, dhe për këtë arsye jemi në xhehenem.'*

Hateme el-Asammi r.a. ka thënë:

- *Nuk do të ketë më të urryer në Ditën e Gjykimit se ai që i ka mësuar të tjerët dhe ata falë tij shpëtojnë; por ai vet nuk i është përmbajtur diturisë, e për këtë shkatërrohet.*

Malik b. Dinar r.a., ka thënë:

- *Kur dijetari nuk vepron me atë që di, këshillat e tij rrëshqasin dhe humbasin nga zemrat si pikat e shiut që rrëshqasin prej shkëmbit të zhveshur.*

Poeti thotë:

***O ti që njerëzit të respektojnë, kujdes se si vepron,  
Vet i bën gjithë ato gjëra, për çka të tjerët qorton.  
U jep këshilla e lavdërohesh,  
Pasha jetën, nga gjynahet e mëdha s'turpërohesh.***

***I thua tjetrit dynjanë ta urrejë, se e mashtron  
E je ti ai që dynjanë më së shumti dashuron!***

E një poet tjetër thotë:

***Mos i shtyj njerëzit nga e keqja, pastaj ti vet ta bësh,  
Është një turp i madh, nëse kështu do të veprosh.***

Ibrahim b. Ed'hem tregon:

- Në Mekë pash një gur mbi të cilin shkruante: 'më rrotullo, merr mësim nga unë'. E rrotullova gurin dhe nga mbrapa shkruante: 'ti nuk po vepron me atë që e di, e si mund të kërkosh nga unë atë që nuk e di?

Ibnu Semak ka thënë:

- Të shumtë janë ata që të tjerëve ju përkujtojnë Allahun Teala, e ata vet janë gafil (të pavëmendshëm); të shumtë janë ata që i frikësojnë njerëzit me Allahun, e ata vet nuk frikësohen; të shumtë janë ata që i afrojnë njerëzit te Allahu, e ata vet largohen, të shumtë janë ata që thërrasin te Allahu; e ata vet ikin; të shumtë janë ata që lexojnë Kur'anin, e vet nuk u përmbahen urdhrave të Kur'anit.

Përsëri Ibrahim b. Edhem ka thënë:

- Kur flasim, kujdesemi të mos bëjmë ndonjë gabim, e kur veprojmë – gabojmë, sepse nuk kujdesemi.

Evzai ka thënë:

- Kur vjen demonstrimi, përulja largohet.

Mekhuli transmeton nga Abdurrahman b. Ganemi: "Abdurrahmani tha: dymbëdhjetë vetë nga as'habët më treguan: - Ishim duke mësuar në mesxhidin (xhaminë) Kuba, na erdh Resulallahu s.a.v.s., dhe tha:

– Mësoni sa të doni, por nëse nuk veproni me atë që dini, Allahu Teala nuk ju jep shpërblim."<sup>144</sup>

---

<sup>144</sup> Ibn Adijj

Isa a.s. ka thënë:

- *Ai që nuk vepron me diturinë e vet, është si femra që bën ziná fshehtas, por lind haptas – dhe poshtërohet. Edhe ata që nuk veprojnë me diturinë e vet, Allahu Teala do t'i poshtërojë në ditën e kiametit, para të gjithë krijesave.*

Omeri r.a., ka thënë:

- *Kur dijetari gabon, bashkë me të gabon edhe një grup njerëzish. Përsëri Omeri:*

- *Ka tri shkaqe që e prishin rendin, e njëri shkak është gabimi i dijetarit.*

Muadh r.a. ka thënë:

- *Ruajuni nga rrëshqitja (e gjuhës) së dijetarit, sepse dijetari ka një pozitë shumë të lartë te njerëzit, dijetari merret si shembull, dhe kur ai gabon – njerëzit e ndjekin.*

Ibn Mesud r.a. ka thënë:

- *Do të vijë koha kur te njerëzit nuk do të ketë singëritet, imani që jep kënaqësi do të prishet, në atë kohë nuk do të kenë dobi as mësuesi e as nxënësi dhe zemrat e dijetarëve do të jenë të shkreta. Ashtu si nuk japin dobi pikat e shiut në shkretëtirë, as pikat e diturisë në zemrat e dijetarëve nuk sjellin kënaqësi. Kjo për shkak që zemrat e tyre anojnë kah dashuria e kësaj bote dhe kjo është koha kur kjo botë preferohet ndaj ahiretit. Në atë kohë, Allahu Teala e mbulon burimin e diturisë për ta dhe e fikë dritën e udhëzimit në zemrat e tyre. Në qoftë se takohesh me dijetarët e asaj kohe – ata me gjuhë shprehen se frikësohen prej Allahut, ndërsa në veprime u shihen përkeqësimet. Në ato ditë, gjuhët janë të pasura, por zemrat janë të varfra. Beto hem në Allahun, të Vetmit që i përket adhurimi, që shkak i kësaj është fakti se as mësuesi e as nxënësi nuk e kanë si qëllim kënaqësinë e Allahut Teala.*

Në Tëvrat dhe Inxhil shkruan: *“Deri sa nuk vepron me atë që tashmë e di, mos kërko dituri të reja.”*

Huzejfiu r.a., ka thënë:

*- Ju jeni në një kohë të tillë që, nëse nuk veproni në 9 nga 10 gjëra sipas asaj që e dini, shkatërroheni. E do të vijë një kohë e tillë që, kush vepron në 1 nga 10 gjëra sipas asaj që di - shpëton. Sepse në atë kohë do të ketë shumë pak nga ata që veprojnë.*

Duhet ta dini se dijetari është si kadiu (gjyqtari). Për kadiun, Resulallahu s.a.v.s. thotë:

**“Kaditë janë tre llojesh. I pari, duke ditur, gjykon me drejtësi. Ky kadi është në xhenet. I dyti, edhe duke ditur edhe duke mos ditur, gjykon me padrejtësi, kurse i treti nuk gjykon me urdhrat e Allahut fare. Këta të dy janë në xhehenem.”**<sup>145</sup>

Ka’b (Allahu qoftë i kënaqur me të) ka thënë:

*- Në kohët e fundit (ahir zaman) do të ketë dijetarë të tillë që i ftojnë njerëzit në zuhd, por ata në vete nuk do të kenë asgjë nga zuhd-i; njerëzit do t’i frikësojnë, por ata vet nuk do të kenë frikë; do t’i ndalojnë njerëzit nga lidhjet me të famshmit dhe udhëheqësinë, por vet nuk do të ndahen nga ta; me gjuhë do ta qortojnë dynjanë, e vet do t’u afrohen të pasurve, e do të ikin nga të varfrit; si femra që kundërshton mashkullin edhe ata do të kundërshtojnë ditoritë e të tjerëve; nëse i shohin miqtë e vet me të tjerët, do t’iu hidhërohen atyre. Këta janë mizorë dhe armiq të Allahut Teala.*

---

<sup>145</sup> As’habi Sunen nga Burejde.

Resulallahu s.a.v.s., tha:

**- Vërtet shejtani, duke ju angazhuar me dituri, shpesh ju pengon nga veprimi.**

E kur u pyet:

- *Si bëhet kjo?* Resulallahu s.a.v.s., u përgjigj:

**- Shejtani thotë: ‘mëso diturinë, nuk ke nevojë për veprim deri sa të marrësh dituri’. Kështu, ai vazhdimisht inkurajon diturinë duke ju bindur që veprimi vjen më pas, e kështu njeriu vdes pa vepruar.**

Serijus Sakati tregon:

*- Një person që ishte i pangopur për dituri, por e braktisi atë dhe u tërhoq në vetmi (uzlet) për të bërë ibadet, e pyeta për arsyen, e ai më tha:*

*- Njëri në ëndërr më tha: ‘Deri kur do të humbasësh këtë dituri?’, e unë e pyeta:*

*- ‘Si po e humbi? Pandërprerë po lexoj dhe po mësoj përmendësh!’ E kur personi më tha:*

*- ‘Dituria ruhet kur vepron me të’, e braktisa leximin dhe fillova me veprim.*

Ibn Mesud r.a. ka thënë:

*- Dituria nuk shërben për tu mbledhur dhe transmetuar, por për t’ju frikësuar Allahut. Përsëri Ibn Mesudi:*

*- Kur’ani ka zbritur për të vepruar me urdhrat e Tij, por ju leximin e kuptoni si veprim.*

Hasan Basriu ka thënë:

*- Mësoni sa të doni, se pasha Allahun, pa vepruar nuk ka shpërblim! Qëllimi i të paditurve është transmetimi i diturisë, ndërsa i dijetarëve – përshtatja asaj.*

Maliku r.a., ka thënë:

*- Në qoftë se qëllimi është mësimi me sinqeritet, atëherë mësimi është i bukur, e edhe veprimi është i bukur. Shiko çfarë të nevojitet në jetën e përditshme, dhe përtej kësaj mos prefero asgjë.*

Dijetari që nuk vepron me atë që di është si i sëmuri që i di emrat e ilaçeve e nuk i përdorë, ose si i urituri që flet për ëmbëlsinë e ushqimit, e ushqimi askund! Për të tillët, Allahu Teala thotë:

**“Dhe, mjerë për ju, për atë që i vishni.”** 21- Enbija: 18

Me një hadith është thënë:

**“Frikësohem për ummetin tim nga gabimi i dijetarit dhe polemika e hipokritit lidhur me Kur’anin.”<sup>146</sup>**

Edhe një cilësi e dijetarëve të ahiretit është që duke u larguar nga gjërat e padobishme, orientohen në mësimin dhe veprimet e gjërave që janë të dobishme për ahiretin e tyre. Largimi nga dituritë që inkurajojnë veprimin dhe angazhimi në debatimin e diturisë është e ngjashme me të sëmurin që e gjen mjekun dhe e pyet për hollësitë e mjekësisë, e sëmundjen e vet e harron. E kjo është plotësisht mungesë zgjuarsie.

Transmetohet se njëri erdh e tha:

*- O i Dërguari i Allahut, më mëso dituri të çuditshme.* Resulallahu s.a.v.s. e pyeti:

**- Çka di ti nga esencat e diturisë?**

---

<sup>146</sup> Teberani, nga Ebu ed-Derda.

- *Çka është esenca e diturisë?*, pyeti njeriu. Resulallahu e pyeti:

- **A ke njohuri për Allahun?** Njeriu pohoi. Resulallahu e pyeti:

- **Atëherë, çfarë robërie bëre ndaj Allahut?** Njeriu tha:

- *Ashtu, kërkesat e Allahut.* Resulallahu e pyeti:

- **A ke njohuri për vdekjen?** Njeriu tha:

- *Po. Kam njohuri.* Resulallahu e pyeti:

- **Çka përgatite për vdekjen?**

- *Ashtu, kërkesat e Allahut,* tha prapë njeriu. Resulallahu i tha:

- **Atëherë shko dhe përforcoi këto njohuri e pastaj eja, dhe unë ti mësoj pjesët e çuditshme të diturisë.**<sup>147</sup>

Nxënësi i dijes duhet të jetë si Hatem el-Asamm, nxënës i Shakiki Belhit. Shakiki e pyeti Hatemin:

– *Sa vite je me mua?*

– *33 vite,* tha Hatemi. Shakiki e pyeti:

– *Çka mësove nga unë për tërë këto vite?*

– *I mësova tetë gjëra.*

– *Inna li'llahi ve inna ilejhi haxhiun!*

*Jeta ime kaloi me ty, e ti vetëm tetë gjëra i mësove?*

– *Po hoxha im, unë nuk e dua gënjeshtërinë, vetëm tetë gjëra arrita t'i mësoj.* Shakiki tha:

– *Çka janë këto tetë gjëra që i ke mësuar? Trego të dëgjojmë.* Hatem filloi të tregojë:

(1) *E pashë që çdokush ka një shok. Por, me qenë se të gjithë shokët në fund kthehen prej varrit, nuk i besova askujt*

---

<sup>147</sup> Hadithin e shënojnë Ibn Sinni dhe Ebu Nuajm.

dhe zgjodha veprat e mira për varrin, i vetmi që do të bëhet shoku im.

– Shumë mirë. Po tjerat, trego çka janë, tha Shakiki.

(2) Mendova rreth ajetit: **“Kurse ai që i është frikësuar madhërisë së Rabbit të tij dhe e ka frenuar veten nga dëshirat, pa dyshim që do të ketë për strehë Xhenetin.”** (Nazi’at 79:40-41), e kuptova që është hak (e vërtetë), e frenova veten nga dëshirat, dhe vazhdova t’i përshtatem urdhreve të Allahut Teala.

(3) E pashë që secili po e ruan pasurinë e vlefshme, po e fshehin në arka, bëjnë gjithçka për mos ta humbur. Kurse Allahu Teala thotë: **“Gjithçka që keni ju, është kalimtare, ndërsa ajo që ndodhet tek Allahu, është e përhershme.”** (Nahl 16:96). Unë e mendova këtë ajet dhe për të mos humbur atë që e pashë të vlefshme, ekzistencën time ia bëra amanet Allahut dhe punova për përfitimin e kënaqësisë së Tij.

(4) E pashë që secili është duke kërkuar pasuri, famë, respekt dhe pasardhës. Kuptova që këto nuk janë asgjë, sepse Allahu Teala në këtë ajet urdhëron: **“Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij”** (Huxhuratë 49:13). E pashë që pasuria nuk qenka nder dhe zgjodha devotshmërinë.

(5) E pashë që njerëzit vazhdimisht sulmojnë njëri-tjetrin, mallkojnë. Shkakun e kësaj e gjeta në xhelozsi dhe mendova rreth ajetit: **“Jemi Ne ata që ua ndajmë njerëzve mjetet e jetesës në këtë botë.”** (Zuhruf 43:32) dhe e kuptova që kjo ndarje është ndarja e Allahut Teala, në këtë askush nuk mund të ndikojë. Iu dorëzova ndarjes së Allahut, sëmundjen e xhelozisë e hodha, dhe askujt nuk i bëra armiqësi.

(6) *E pashë që njerëzit janë bërë armiq të njëri-tjetrit, vrasin njëri-tjetrin. Allahu Teala në këtë ajet thotë: “Me të vërtetë, shejtani është armik për ju, andaj vështrojeni si armik!” (Fatir 35:6). Mendova, dhe kuptova që armiku i vërtetë është shejtani. Dhe unë vetëm shejtanin e konsiderova armik dhe askujt tjetër nuk i bëra armiqësi.*

(7) *E pashë që njerëzit për një kafshatë buke, pa u kujdesur se a është hallall a haram, durojnë çdo vështirësi. Allahu Teala thotë: “S’ka asnjë gjallesë në Tokë që të mos i ketë mjetet e jetesës prej Tij.” (Hud 11:6). Pasi që edhe unë jam njëra nga këto gjallesa, e kuptova që për rizkun (furnizimin) tim Allahu Teala është garantues. I braktisa dëshirat dhe u drejtova në obligimet ndaj Allahut.*

(8) *Pashë që një pjesë e njerëzve besojnë dhe mbështeten në pasurinë dhe tregtinë e tyre; Unë mendova rreth ajetit të Allahut Teala: “Allahu i mjafton kujtdo që mbështetet tek Ai.” (Talak 65:3) dhe vetëm Allahut iu mbështeta. Për mua, Allahu Teala është i mjaftueshëm.*

*Këto janë ajo çka mësova prej teje.” Shakiki tha:*

*– O Hatem, Allahu të shpërbleftë. Unë kam studiuar Tevratin, Inxhilin, Zeburin dhe Kur’anin, dhe po e shoh që të gjitha mirësitë janë të përmbledhura në këto tetë çështje. Kush i aplikon këto, ka aplikuar të katër Librat.*

Kush merret me këtë domethënie të diturisë dhe kupton, ai është dijetar i ahiretit. Ndërsa dijetarët e botës janë të zënë me gjithë fuqinë në përfitimin e pasurive dhe gradave, dhe i lënë pas dore dituritë e ahiretit për të cilat Allahu Teala na njoftoi përmes Pejgamberëve Tij.

Dehhak b. Mudhahim ka thënë:

*- Unë i mbërrita dijetarët e ahiretit. Ata nga njëri-tjetri mësonin vetëm devotshmërinë (takva) dhe shkallën më të lartë të devotshmërisë (vera). Ndërsa dijetarët e ditëve të sotme janë zënë me dituritë e shprehjeve dhe terminologjive.*

Edhe një dukuri e dijetarëve të ahiretit është që nuk e teprojnë në ushqim, veshje, strehim dhe nevoja të familjes (nuk shkojnë në ekstrem me harxhime koti). Për të gjitha këto dijetari duhet të kujdeset dhe të jetë modest, të përngjajë në të parët dhe të kënaqet me pak. Modestia e afron atë më shumë Allahut, dhe në mesin e dijetarëve të ahiretit i ngritët grada.

Tregimi në vazhdim, të cilin e transmeton Ebu Abdullah el-Havasi e dëshmon këtë:

“Ishim në një grup prej 320 personave, bashkë me Hatem el-Asamm-in, i cili ishte i veshur shumë modest, pa u ngarkuar me ushqim dhe pa çantë, dhe u nisëm për në Haxh. Erdhëm në qytetin Rej. Tregtari i këtij qyteti ishte bamirës, dhe na pranoi atë natë në konak. Në mëngjes, tregtari tha:

*– Në këtë qytet është një fakih i sëmurë, jam duke shkuar ta vizitoj. Në qoftë se dëshironi, mundeni edhe ju të vini. Hateme tha:*

*– Të vizitosh të sëmurin është sevap, të shikosh fytyrën e fakihut është ibadet – nëse pranoni, po vij edhe unë.*

I sëmuri ishte kadiu i qytetit Rej, Muhammed b. Mukatil. Kur mbërritëm, pamë një pallat të mrekullueshëm. Duke parë këtë, Hatemi me habi dhe në heshtje tha: “Dijetarit do t’i mjaftonte një shtëpi modeste.” Na pranuan brenda. Kur pa Hatemiu hollin e shtruar, të dekoruar me gjëra luksoze, u habit edhe më shumë. Më në fund na pranuan në dhomën e

fjetjes. Hatemi e pa të sëmurin e shtrirë në dyshek të butë dhe shërbëtori mbi kokë duke e freskuar. Tregtari u ul afër të sëmurit dhe e pyeti për shëndet. Hatemiu ishte ende në këmbë. I sëmuri i dha shenjë për t'u ulur, por Hatemiu nuk pranoi. Atëherë i sëmuri e pyeti: *"A keni ndonjë kërkesë."* Hatemiu tha:

– *Po, kam një pyetje për ju.*

– *Atëherë pyet. tha i sëmuri. Hatemiu tha:*

– *Ngrihu e ulu në shtrat, pastaj do të të pyes. I sëmuri u ul. Hatemiu e pyeti:*

– *Nga kush mësove ti?*

– *Nga dijetarët e mëdhenj, e ata mësuhan nga as'habët (shokët) e Resulallahut" tha i sëmuri.*

– *E as'habët nga kush mësuhan?*

– *Nga Resulallahu s.a.v.s.*

– *E Resulallahu?*

– *Nga Xhibrili, e Xhibrili nga Allahu Teala. Hatemi e pyeti:*

– *Në diturinë e cila prej Allahut Teala, nëpërmes Xhibrilit, mbërriti te pejgamberi, prej pejgamberit te as'habët, prej as'habëve te dijetarët e mëdhenj, e prej tyre te ti, a mos gjete në ato dituri që dikush është më i dashur për Allahun nëse posedon shtëpi më të madhe dhe më të zbukuruar?*

– *Jo, tha i sëmuri.*

– *Por si e mësove?*

– *Mësova se ai që ia kthen fytyrën kësaj bote, drejtohet kah ahireti, u ndihmon të varfërve dhe përgatitet për ahiret, është më i dashur për Allahun. Hatemiu i tha:*

– *Atëherë, kujt iu përshtate ti? Resulallahut s.a.v.s., as'habëve të tij, salihëve apo Faraonit dhe Nemrudit, i cili i pari e filloi ndërtimin me gëlqere e tullë? O dijetarët e këqij,*

*xhahilët e dhënë pas kësaj bote, kur ju shohin juve thonë: ‘Kur dijetarët janë kështu, pse ne të mos kërkojmë edhe më shumë’.*” Hatemiu ia shtoi sëmundjen Mukatilit, dhe doli nga dhoma. Populli i qytetit Rej, kur dëgjuan për këtë, i thanë: *“Kadiu i qytetit Kazvin, Muhammed Ahdeb et-Tanafis, jeton një jetë edhe më luksoze se kjo.”* Dhe Hatemiu doli në rrugë për Kazvin. U takua me Tanafisin dhe i tha: *“Unë jam fillestar, a mundesh të më mësosh se si duhet të marr abdes?”* Kadiu pranoi me kënaqësi dhe urdhëroi shërbëtorin të sjell ujë. Mori abdes duke larë pjesët e trupit nga tri herë, dhe tha:

– *Kështu merret abdesi.* Hatemiu i tha:

– *Më lejoni që edhe unë të marr abdes me shtambën tuaj.*

Tanafisi u ngrit dhe ia lëshoi vendin Hatemiut për të marrë abdes. Hatemiu u ul dhe duke marrë abdes, i lante pjesët nga katër herë, në vend që ti lajë nga tri herë. Tanafisi i tha:

– *E harxhove ujin kot.*

– *Pse?* e pyeti Hatemiu, e kadiu tha:

– *Në vend që t’i lashë pjesët nga tri herë, ti i laje nga katër herë.* Hatemiu ia drejtua:

– *Subhanallah, ti në gjithë këtë luks nuk po harxhon më shumë, e unë për një herë më tepër ujë – harxhova!* Tanafisi e kuptoi qëllimin e Hatemiut, dhe katërdhjetë ditë nuk doli para njerëzve.

Kur Hatemiu mbërriti në Bagdad, njerëzit u mbledhën rreth tij dhe i thanë:

– *O Eba Abdurrahman, ti nuk je arab, si dhe belbëzon. Si bëhet që çdo kush që bisedon me ty, ti e hesht?* Hatemiu u tha:

– Po, unë i kam këto tri veti, në saje të të cilave jam mbi kundërshtarët. Kur kundërshtari e gjen të drejtën – unë gëzohem, kur gabon – mërzitem, dhe – unë hezitoj që kundërshtarin ta paraqes si të paditur.

Kur e dëgjoi këtë, Ahmed b. Hanbeli tha: “Ky qenka njeri i mençur. Po shkoj ta vizitoj.” Kur u takuan, Ahmed b. Hambeli e pyeti: “O Eba Abdurrahman, si mund ta gjej shpëtim në këtë botë?” Hatemiu u përgjigj:

“Pa këto katër veti, nuk mund të gjesh rehati dhe shpëtim në këtë botë: (1) Të falësh mangësitë e njerëzve, (2) të mos u bësh njerëzve keq, (3) të gostitësh njerëzit aq sa ke mundësi; dhe (4) për të mirat e tua mos prit të njëjtën. Pra, kështu e gjen shpëtimin (selamet).”

Pastaj Hatemiu vazhdoi rrugën dhe mbërriti në Medinë. Populli i Medinës e priti, dhe Hatemiu i pyeti:

– Cili qytet është ky? Medinasit thanë:

– Ky është Medina, qyteti i Resulallahut s.a.v.s. Hatemiu tha:

– A më tregoni sarajin e Resulallahut, dëshiroj të fal namazin e lumturisë aty. Medinasit i thanë:

– Resulallahu nuk ka pasur saraj, ai kishte një shtëpi të thjeshtë, përdhese. Hatemiu tha:

– Atëherë, m’i tregoni sarajët e as’habëve. Medinasit i thanë:

– Edhe shtëpitë e tyre ishte të njëjta, ata nuk kishin saraj. Atëherë Hatemiu u tha:

– Atëherë ky nuk është qyteti i Resulallahut, thoni që është qyteti i Faraonit”. Medinasit u ofenduan, e dërguan Hatemiun te Valiu (guvernatori), u ankuan dhe i thanë Valiut:

- Ky axhem (jo-arab) e quajti Medinën qytet të Faraonit. Valiu pyeti për arsyen e kësaj, e Hatemiu tha:

– Mos u ngut. Unë jam një axhem (jo-arab) i huaj. Kur hyra në këtë qytet pyeta se cili qytet është ky, dhe ata thanë që është Medina – qyteti i Resulallahut. Dhe unë pyeta për sarajin e Resulallahut..., dhe pasi tregoi çdo gjë që është folur, e lexoi ajetin: **“Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e Allahut.”** (Ahzab 33:21) dhe iu tha:

– Kë e keni marrë shembull ju? Resulallahun, apo Faraonin? Ata heshtën dhe e liruan.

Pra, ky është tregimi i Hatemiut. E në vazhdim do të ketë më shumë shpjegime për ahlakun, modestinë dhe mënyrën se si e braktisën stolisjen dhe zbukurimin selefët (të parët).

**Për të mos u futur në gjëra të dyshimta, dhe për t’u tërhequr nga gjërat që janë mubah.**

Padyshim, zbukurimi me mubah (gjërat që nuk kanë as sevap e as gjynah) nuk është i ndaluar, por kur merresh shumë me mubah, ai bëhet i natyrshëm dhe ndarja prej tij bëhet shumë e vështirë. Ndërsa vazhdimi në zbukurime dhe stoli ndikojnë në bërjen e veprimeve të këqija, dhe kërkon kopjimin e adeteve dhe sjelljeve të gabuara të njerëzve. Më e drejtë është largimi nga kërkesat për zbukurime, që qojnë në gabime. Sepse, ai që angazhohet dhe mundohet me zbukurime dhe stoli, sigurisht është i kapur në kthetrat e kësaj bote. Po të ishte i mundur shpëtimi bashkë me dalldisjen në këtë botë, Resulallahu s.a.v.s., do ta kishte merituar këtë më shumti, e nuk do ta theksonte aq shumë braktisjen e dynjallëkut, aq sa edhe të hiqte xhyben e qëndisur dhe unazën e dukatit deri sa ishte në minber duke lexuar hutbe. Ka edhe më shumë, e këto do t’i tregojmë kur të vije radha.

## DREJTËSIA E DIJETARËVE TË VËRTETË

Transmetohet se Jahja b. Jezid en-Nevfeliu i shkroi një letër Malik b. Enesit r.a.:

*“Fillimisht - me Emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit. Së dyti i dërgoj salat dhe selam Muhammedit, zotërisë së pejgamberëve. Nga Jahja b. Jezid b. Abdi’l- Meliku, për Melik b. Enesin. Tani:*

*Dëgjova se po vijnë njerëzit nga çdo anë te ti, po të dëgjojnë, duke të pranuar si imam, e ti po vesh rroba të qëndisura, ushqehesh me gjella lloj-lloj, ulesh në shilte të butë, në derë ke roje dhe pa lejen tënde askënd nuk e pranon. O Malik, frikësoju Allahut, trego modesti. Këtë letër po ta shkruaj ty si një këshillë. Përveç Allahut askush nuk di për këtë. Selam për ty.”*

Maliku iu përgjigj:

*“Filloj me Emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit. Salat dhe selam i qoftë Muhammedit, ehli-bejtit dhe as’habëve të tij. Nga Malik b. Enesi, Jahja b. Jezidit. Tani:*

*E mora letrën tënde, e pranova këtë letër si një këshillë që është shkruar me mëshirë, për të qenë me edeb karshi Allahut Teala. Allahu ta shtoftë devotshmërinë, të shpërbleftë për këtë këshillë të hairit që më ke dhënë. Për të arrit rizanë e Allahut kërkoj ndihmë prej Tij. Sepse fuqia është vetëm e Allahut. Siç ke shkruar, po veshi rroba të qëndisura, po ha gjella të llojllojshme, po ulem në shilte të buta, dhe në derë kam vendosur roje; e për të gjitha këto bëj teube te Allahu Teala. Allahu Teala në Kur’an thotë:*

**“Thuaj: ‘Kush i ka penguar stolitë dhe ushqimet e këndshme, të cilat Ai i ka krijuar për robërit e Vet?’...”**

7-A’raf: 32

*E di mirë që këto janë mubah, dhe që braktisja e tyre është më e mirë se vazhdimësia në to. Mos na harro, e as ne nuk ju harrojmë. Selam.”*

Shih drejtësinë e Imam Malikut, kur tregon se këto (zbukurimet dhe pasuria) është më mirë të braktisen se sa t’u jepesh atyre, e gjithashtu tregon fetvanë për lejueshmërinë e përgjithshme të tyre, e në të dyja kishte të drejtë. Mendoni bujarinë e pranimit të këtyre këshillave nga Imam Maliku, kur ai ka aftësi të njohë çështje që nuk përbëjnë mekruh e që janë në kufi me mubah. E disa nuk kanë as aftësi të dallojnë mubah-un. Prandaj dhënia pas mubah-ut është rrezik i madh e dalldisja në mubah është largim nga frika. Frikë kanë dijetarët e ahiretit, e veçori e frikës është ruajtja nga rreziku.

Dukuri tjetër e dijetarëve të ahiretit është që jetojnë sa më larg pushtetarëve. Nëse ata afrohen – dijetari duhet të largohet. Sepse dynjaja është një gjelbërim i ëmbël, e frerët e saj janë në duart e pushtetarëve. Pushtetarët janë mizorë, e dijetari që takohet me ta, për t’u ofruar qetësi shpirtërore dhe për të fituar kënaqësinë e tyre, detyrohet të durojë padrejtësitë e tyre. Besimtari duhet t’i qortojë dhe të mos pranojë dhunën e tyre, duke e bërë publike tiraninë e tyre, t’ju bëj presion atyre që ta braktisin tiraninë dhe sjelljet tjera të ngjashme. Ai që shoqërohet me pushtetarin, ai ose i përçmon nimetet (mirësitë) që ia dhuroi Allahu Teala duke iu përkulur stolisjes së pushtetarit, ose bëhet dyfytirësh duke pranuar në heshtje dhe duke mos kundërshtuar tiraninë e tij. Apo, kërkon fjalë mashtruese për ta rehatuar shpirtin e udhëheqësit, dhe për të lavdëruar veprimet dhe gjendjen, e kësaj i thuhet shpifje. Ose dëshiron të përfitojë nga pasuria e pushtetarit, e kjo është kryekëput haram. Në librin për

hallallin dhe haramin do të shpjegohet çka është e lejuar (*xhaiz*) të pranohet nga pushtetarët, përfshirë dhuratat dhe pagat. Shkurt: shoqërimi me pushtetarët do të thotë hapje e derës së humbjes. Ndërsa rruga e dijetarëve të ahiretit është vetëpërmbytja.

Resulallahu thotë:

**“Ai që jeton në shkretëtirë bëhet i pagdhundur dhe i ashpër.”<sup>148</sup>**

Në një hadith tjetër thotë:

**“Në të ardhmen do të ju vijnë urdhërdhënës që disa urdhra të tyre do t’i pranoni e disa do t’i mohoni. Ata që mohojnë do të shfajësohen, ata që nuk i duan do të arrijnë lumturinë; por ata që i pranojnë dhe u përshtaten atyre, do të jen të privuar nga rahmeti i Allahut.”<sup>149</sup>**

Sufjan Sevri ka thënë:

*- Ka një luginë në xhehenem, aty do të vendosen vetëm ata lexues (të Kur’anit) që kanë vizituar sundimtarët.*

Huzejfiu tha:

*- Largohuni nga vendet e intrigës. U pyet:  
- Cilat janë ato vende? U tha:  
- Dyert e sundimtarëve. E në vazhdim tha:  
- Ndonjëri prej jush i viziton ata, i vërteton gënjeshttrat që i ata i falsin dhe për ta flet atë që nuk qëndron.*

---

<sup>148</sup> Ebu Davud dhe Tirmidhi, nga Abbasi.

<sup>149</sup> Muslimi nga Ummu Selem.

Sipas transmetimit të Enesit r.a., Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

- **“Dijetarët janë të besuarit e pejgamberëve mbi robët e Allahut. Kur dijetarët hyjnë në tubimet e pushtetarëve tradhtojnë pejgamberët. Largohuni nga ata.”**

Kur i thanë A’mesh-it:

- *Ti e ringjalle diturinë duke i mësuar shumë nxënës, A’meshiu tha:*

- *Mos u ngutni, sepse një e treta e nxënësve vdesin ende pa u bërë dijetarë të vërtetë, një e treta u sulen dyerve të sulltanëve - këta janë njerëz të këqij, e nga pjesa që mbetet, shumë pak janë ata që shpëtojnë veten.*

Për këtë arsye Sa’d b. Musejjebiu r.a., ka thënë:

- *Largohuni nga dijetari që shkon në derë të sulltanit çdo mëngjes e mbrëmje. I tilli është hajdut.*

Evzai ka thënë:

- *Allahu Teala më shumti e urren dijetarin që viziton valiun<sup>150</sup>.*

Edhe Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Më i keqi prej dijetarëve është ai që shkon te këmbët e sundimtarëve, e më i miri prej sundimtarëve është ai që viziton dijetarët.”**

Mekhul-i Dimeshki ka thënë:

- *Kur personi mëson Kur’anin dhe bëhet fakih, e më pas viziton tubimet e pushtetarëve me shpresë për ta përfutur diçka dhe fshehtas i ndihmon, çdo hap i tij është dalldisje në detin e zjarrtë të xhehenemit.*

---

<sup>150</sup> Vali: Qeveritari më i lartë, i emëruar nga sulltani.

Semnuni ka thënë:

- *Nuk ka më keq për dijetarin se kur ta kërkojë dikush në vendin e vet (në xhami), e përgjigja është: 'Ka shkuar te sulltani'. Dhe ka thënë:*

- *Kam dëgjuar që është thënë: 'Kur e shihni një dijetar që e do këtë dynja, fajësoni atë në emër të fesë tuaj.' Unë këtë edhe vet e përjetova. Siç e dini edhe ju, edhe pse isha vazhdimisht kundër sulltanit dhe kundërshtoja dëshirat e mia, çdoherë kur kam shkuar para sulltanit ndjeja ndaj tij një interesim, e jo vetëm ushqimin por edhe për një gllënjë ujë që e pija, thosha 'sikur të mos kisha ardhur.' Pastaj duke vazhduar tha:*

- *Dijetarët tanë tashmë janë më keq se dijetarët e beni Israelit. Japin fetva përshtatshëm dëshirës së sulltanit. Më mirë do të ishte mos të japin fetva. E nëse japin fetva në pamje të parë në favor të sulltanit, por në të vërtetë fetvaja ndihmon për shpëtim nga vuajtjet, sulltani zemërohet dhe nuk i pranon më, por tek Rabbi i tyre kjo bëhet shkak për shpëtim.*

Hasani Basriu ka thënë:

- *Në të kaluarën ishte një person nga myslimanët e parë i cili ka marrë pjesë në bisedat e Pejgamberit ( Abdullah b. Mubarek thotë se personi që përmend Hasani Basriu është Sa'd b. Ebi Vakkas i cili ishte njëri nga dhjetë xhenetitë). Ky person nuk u afrohej qeveritarëve dhe vazhdimisht ikte prej tyre. Djemtë e vet i thanë:*

- *Ata që nuk janë ne gradën e myslimanëve të parë dhe as'habëve marrin pjesë në tubimin e qeveritarëve, e ti përse nuk merr pjesë? Ai u tha:*

- *A dëshironi që edhe unë të ulem me një ngordhësirë të rrethuar nga njerëzit? Vallahi, nuk përzihem me ta. Djemtë i thanë:*

- *Por kështu ne vuajmë në varfëri! Personi u tha:*

- *O djemtë e mi, për mua më e pranueshme është të vdes si një besimtar i dobët se sa si një mynafik (përçarës) trashalug e i vjamosur.*

Hasani Basriu në vazhdim tha:

- *Vallahi, ai e dinte mirë që dheu e ha mishin dhe vajin, por imanin (besimin) nuk mund ta hajë.*

Kjo tregon se nuk munden ta shpëtojnë veten nga përçarja (nifak) ata të cilët vazhdojnë të marrin pjesë në bisedime me sulltanët. Ndërsa përçarja e dobëson imanin.

Ebu Dher i tha, Seleme-s:

- *Ja Seleme, mos shëtit nëpër dyert e sulltanëve, sepse dëmi i tyre në besimin tënd është më shumë se sa dobia materiale. Marrja pjesë në tubimet e sulltanëve, për dijetarët është intrigë e madhe dhe është një rrugë e tmerrshme që shejtani e hap kundër dijetarëve.*

Kjo është posaçërisht e rrezikshme për atë që ka shprehje të mirë e fjalë të ëmbla. Sepse shejtani i thotë: *‘Ti duhet t’ua shpjegosh fenë njerëzve, kjo i ruan ata nga errësira dhe vendos në zemrat e tyre kushtet e Islamit.’* Shejtani vazhdimisht të inkurajon, dhe kështu hyrjen tënde në mesin e njerëzve - predikimin tënd - e prezanton si detyrë fetare. Pasi të hysh në mesin e tyre, fillon të paraqitësh diturinë, dhe me lajka e lavdëron sulltanin. Ja, kështu prishet feja.

Është thënë:

- *Dijetari vepron kur mëson, dhe vepron për rizanë e Allahut, kur vepron për rizanë e Allahut çlirohet nga cilësitë e njeriut e mbështillet në cilësitë e melekut. Ata që ngritën në këtë gradë duhen dhe kërkohen, e kur kërkohen, ata largohen.*

Omer b. Abdi'l-Azizi r.a., me një letër i thotë Hasani Basriut:

- *Më njofto për ata që mund të më ndihmojnë në zbatimin e urdhrave të Allahut Teala.* Hasani Basriu iu përgjigj:

- *Njerëzit e fesë nuk vijnë tek ti, e njerëzit e dynjasë ti nuk i do. Kërko njerëz të ndershëm për t'u bërë miq me ty, sepse ata nuk ta njollosin nderin me tradhti e pislleqe.*

Bëhet fjalë për Omer b. Abdi'l- Azizin, që ishte kryetari i shtetit më të mirë të kohës, dhe zahid. E kur është kusht për dijetarët të largohen edhe nga njerëzit e këtillë, si mund të arsyetohet shoqërimi me sulltanët e tjerë? Ndërsa, dijetarët e përkryer si Hasani Basriu, Sevriu, Ibn Mubareki, Fudajli, Ibrahim b. Et'hemi, Yusuf b. Esbat kanë qortuar dijetarët në Mekke, Sham dhe qytete të tjera, të cilët i janë përlurur dynjasë dhe shoqëroheshin me sulltanët.

Edhe një çështje që kërkohet nga dijetari i ahiretit është që kur pyetet, mos të japë fetva me nguti, të mendojë dhe të jetë i kujdesshëm. Nëse përgjigjet e pyetjeve janë të qarta nga Kur'ani dhe hadithet, ose janë vërtetuar me konsensus, atëherë mund të japë përgjigje. Por, nëse është në dilemë dhe dyshime, duhet të tregojë që nuk di. Në një hadith, thuhet:

**“Janë tri dituri: libri që flet, sunneti i vendosur dhe të thuhet ‘nuk di’.”<sup>151</sup>**

---

<sup>151</sup> Ibnu Maxhe, nga Abdullah b. Omeri.

Esh-Shabi ka thënë:

*- Të thuash 'nuk e di' është gjysma e diturisë. Kur nuk di dhe heshtë, shpërblimi nuk është më pak se për atë që di, sepse për nefsin (veten) është e vështirë të pranojë paditurinë.*

Kështu kanë vepruar as'habët dhe dijetarët e parë.

Kur kanë kërkuar fetva nga Abdullah b. Omeri r.a., ai kishte thënë:

*- Këtë çështje shkoni e vareni në qafën e udhëheqësve që kanë marrë punët e njerëzve mbi vete.*

Ibn Mesudi r.a. ka thënë:

*"Ai që përgjigjet në çdo pyetje, është budalla", dhe: "Mbrotja e dijetarit është të thotë 'nuk e di'. Sa herë gabon në përdorimin e mbrojtjes, bëhet cak i sulmit së armikut."*

Ibrahim b. Et'hem ka thënë:

*- Ajo që më shumti e fyen shejtanin është dijetari i cili për disa çështje fol, e për disa heshtë. Shejtani thotë: 'Shikoni këtë, heshtja e tij është më e keqe për mua se sa të folurit e tij.*

Për abdallët (grupi i evliave; thonë që janë shtatë, katërdhjetë ose shtatëdhjetë) është thënë: *"Pa ndjerë urinë – nuk hanë, flenë vetëm kur i kaplon gjumi, nuk flasin pa u detyruar, dhe nuk përgjigjen pa u pyetur. Kur pyetën, nëse ka dikush tjetër që mund të përgjigjet – heshtin, nëse nuk ka – përgjigjen. Të flasin pa u pyetur e llogarisin si epsh të fshehtë."*

Hazreti Alia dhe Abdullah r.a., një ditë kaluan pranë njërit që po u ligjëronte njerëzve. Pasi e dëgjuan pak, thanë: *"Ky njeri po dëshiron ta bëjë vetën të njohur me fjalë."*

Disa kanë thënë: *"Dijetar është ai që, kur e pyet diçka – i duket sikur po ia hekë dhëmbin!"*

Për ata që kërkojnë fetva në favor të tyre, Omeri r.a. thoshte:

- *A dëshironi që neve të na bëni urë për të kaluar në xhehenem?*

Ebu Hafs en-Nisaburi ka thënë:

- *Dijetari i vërtetë, kur jep përgjigje i frikësohet ditës kur në kiamet do të pyetet ‘ku e gjete këtë përgjigje?’*

Ibrahim Tejmiu, kur është pyetur për një çështje, qau dhe tha:

- *A nuk gjetët tjetër kë, që u bëtë nevojtar për mua?*

Ebu’l-Aliu, er-Rijani, Ibrahim b. Et’hemi dhe Sufjani Sevriu bisedonin vetëm me dy apo tre persona, dhe kur shtoheshin më shumë njerëz, largoheshin.

Bile, “*Nuk e di*” ka thënë edhe Pejgamberi s.a.v.s.:

- **Nuk e di a është Uzejri pejgamber apo s’është. Nuk e di a është Tubbi i mallkuar apo s’është. Nuk e di a është Zul-Karnejn pejgamber apo s’është.**

Përsëri, ngjashëm me këtë, kur e kanë pyetur Resulallahun s.a.v.s.: “*Cilat vende janë më të mirat për qëndrim, e cilat më të këqija?*”, përgjigja e tij ishte:

“**Nuk e di, deri sa të vjen Xhebraili.**” Kur e pyetën Xhebrailin, edhe ai tha:

“**Nuk e di**”, deri sa Allahu Teala shpalli se:

“**Vendet më të mira për qëndrim janë xhamitë, e më të këqijat janë rrugët.**”<sup>152</sup>

---

<sup>152</sup> Ebu Davud dhe Hakim, nga Ebu Hurejre.

Ibn Omeri r.a., nëse pyetej për dhjetë çështje, për nëntë heshtte e vetëm për një përgjigje, deri sa Ibn Abbasi për nëntë çështje jepte përgjigje, e vetëm për një heshtte.

Më të shumtë ishin fakihët që kanë thënë ‘*nuk e di*’ se sa ‘*e di*’. Nga ata që kanë thënë ‘*nuk e di*’ ishin Sufjani Sevriu, Malik b. Enesi, Ahmed b. Hanbeli, Fudajl b. Ijazi dhe Beshr b. Harisi.

Abdurrahman b. Ebu Lejla ka thënë:

- *Në këtë mesxhid (xhamia në Medine) njoha 120 as’habë, dhe të gjithë ata drejtonin te të tjerët e nuk përgjigjeshin kur u pyeteshin për një çështje, ose kur u kërkonin fetva. Bile, kur njëri pyetej për diçka, e drejtonte personin te tjetri, tjetri e drejtonte te tjetri, e askush nuk dëshironte të jepte përgjigje, deri sa personi kthehej prapë te i pari që kishte pyetur.*

Transmetohet se njërit nga as’habi suff-ët<sup>153</sup> ia dhuruan një kokë deleje të pjekur. Ky, edhe pse ishte në gjendje shumë të vështirë, nuk hëngri dhe ia dërgoi shokut që njëjtë ishte i uritur, e ai tjetrit, ky tjetrit, dhe në fund koka e deles përsëri erdhi te ky i pari. Sepse ai ishte më i urituri. Kjo gradë e bujarisë quhet ‘*isar*’, që do të thotë: edhe pse vet nevojtar, preferon nevojtarin tjetër.

---

<sup>153</sup> *As’habi suff*: Ndonjëherë janë pak e ndonjëherë më shumë, dhe janë një xhemat që llogariten që kanë ndërprerë lidhjen me këtë botë (dynja) dhe nuk interesohen për këtë botë. Ata qëndronin para derës së mesxhidit, jetonin një lloj jete të medresesë, dhe mësonin hadithet nga Pejgamberi s.a.v.s.. Kur Pejgamberit s.a.v.s., i vinte sadaka, tërë sadakanë ua dërgonte atyre, dhe kur i vinin dhurata vetëm një pjesë e merrte, e të tjerat ua dërgonte atyre. Në kohën e hazreti Omerit, Omeri i shpërndau duke u thënë : ‘*Tashmë ka mbaruar detyra e juaj...*’.

E tani shiko dijetarët e sotëm, dhe shiko se si punët u kthehen mbrapsht. Tani po kërkohet ajo prej së cilës duhet ikur, kurse po iket nga ajo që duhet të kërkohet. Të mirën e largimit nga dhënia e fetvasë e dëshmon ky hadith i Pejgamberit:

**“Vetëm tre persona mund t’u japin fetva njerëzve: Emiri, me’muri dhe mutekellefi.”**

Disa thonë që as’habët kanë ikur nga katër gjëra:

1. Imamllëku (të qenit imam),
2. Kujdestaria,
3. Marrja e amanetit, dhe
4. Dhënia e fetvasë.

E disa të tjerë thanë: *“Ata që nguten në dhënien e fetvasë kanë pak dituri, e ata që ikin nga ajo, kanë më së shumti dituri – ata ikin nga dyshimet.”*

As’habët dhe Taibinët janë marrë me pesë gjëra: me lexim të Kur’anit, me qëndrim në xhami, me ndërtim të xhamive, me dhikrin e Allahut dhe me udhëzim në të mirën e largim prej të keqes. Për këtë, ata mbështeteshin në hadithin:

**“Çdo fjalë e birit të Ademit është kundër tij, përveç udhëzimit në të mira, largimi prej të këqijave (*emr-i bi'l ma'rûf ve neh-i anil münker*) dhe dhikri Allahun Teala.”**<sup>154</sup>

Ndërsa Allahu Teala thotë:

**“Në shumë biseda të fshehta nuk ka kurrfarë dobie, përveç (bisedës) kush këshillon për lëmoshë, për ndonjë të mirë ose pajtim mes njerëzve.”** 4-Nisa: 114

---

<sup>154</sup> Tirmidhi dhe Ibn Maxhe nga Ummu Habibe.

Një person (Nasr b. Ali el- Xhuhdhumi) nga Kufe e sheh në ëndërr Halil b. Ahmedin, i cili ishte njëri nga muxhtehidët në fetva dhe e pyeti:

- *Çfarë dobie pate nga ixhtihadi dhe fetvatë tua?*

Ky, me fytyrë të thartuar e ktheu shpinën dhe tha:

- *Ishin të padobishme. Prej tyre asgjë nuk përfitova.*

Ibn Hassini ka thënë:

- *Ju provoni të përgjigjeni edhe për çështje shumë të rëndësishme, për të cilat, po të pyetej Omer b. Hittabi r.a., nuk do të përgjigjej pa i mbledhë të gjithë luftëtarët nga Bedri.*

Heshtja është veçori e dijetarëve. Resulallahu s.a.v.s. thotë:

**“Kur e gjeni dikë në zuhd (vetmi) dhe heshtje – afrohuni, ai është njeri i diturisë (hikmetit).”<sup>155</sup>**

Është thënë që dijetarët janë dy lloje:

1) Dijetarët e njerëzve të rëndomtë (*avam*), të cilët kujdesen për ndarjen e hallallit nga harami. Këta janë dijetarët e sulltanit (në një kopje në vend të ‘*Salatin*’ shkruan ‘*Esatin*’, e që janë dijetarët e foltores).

2) Dijetarët e të zgjedhurve (*havas*), të cilët e njohin tehvidin dhe punët e zemrës. E këta janë larguar nga njerëzit, pra janë dijetarë të teqesë.

Është thënë: *Dijetarët si Ahmed b. Hanbeli janë të ngjashëm me lumin Tigër. Secili mund të merr me bollëk nga ai. E dijetarët si Bishr b. Haris, që është i mbyllur, i përngajnë ujit të ëmbël të pusit; nga aty ujë mund të marrë vetëm njëri pas tjetrit.*

---

<sup>155</sup> Ibn Maxhe

Duke i klasifikuar dijetarët, është thënë:

- *Filani është dijetar, filani folës i mirë, filani shumë flet e filani shumë vepron.*

Kurse Ebu Sulejman Darani ka thënë:

- *Më shumë ka marifet në heshtje se sa në të folur.*

Dhe është thënë:

- *Kur shumohet dituria pakësohen fjalët, e kur shumohen fjalët pakësohet dituria.*

Selmani, në letër që i shkroi Ebu'd Derdasë, me të cilin e kishte vëllazëruar Pejgamberi s.a.v.s., i tha:

- *Dëgjova që ke filluar të merresh me mjekësi për të shëruar njerëzit. Nëse je vërtet mjek - vazhdo në këshillë, sepse fjala jote është shërim. Por nëse je mjek i rremë, frikësoju Allahut Teala, mos vrajë myslimanët! Pas kësaj letre, Ebu'd-Derda është larguar nga dhënia përgjigje pyetjeve që i janë shtruar.*

Enesi r.a., kur është pyetur për një çështje, kishte thënë:

- *Pyeteni të nderuarin tonë, Hasani Basriun.*

Kur pyetej Ibn Abassi, ai i drejtonte njerëzit te Zejd b. Harisi, ndërsa Ibn Omeri r.a., i dërgonte te Sa'd b. Musejjebiu. Transmetohet se në një mexhlis, njëri nga as'habët lexoi njëzet hadithe. Kur kërkuan prej tij shpjegimin e haditheve, tha:

- *Unë vetëm lexoj, tjetër gjë nuk kuptoj. Në këtë, Hasani Basriu i shpjegoi njëzet hadithet veç-e-veç. Të gjithë u mahnitën nga ky shpjegim, e as'habi që foli në fillim mori një grusht dhé, ua hodhi atyre që ishin prezent, dhe u tha:*

- *Keni një të tillë në mesin tuaj, e mua më pyetni?*

Edhe një dukuri e dijetarëve të ahiretit është që i kanë dhënë shumë rëndësi diturisë batin – marifetit. Pra, për kontrollimin e zemrës, për të qenë në rrugë të ahiretit dhe për tu bërë udhëtar i kësaj rruge, duhet angazhuar shumë, duhet shqyrtuar dituritë, dhe duhet zhvilluar ato dituri që janë të nevojshme.

Sepse me angazhim mbërrihet në soditje shpirtërore dhe hollësitë e diturisë rrjedhin në zemër. Marifeti nuk arrihet me libra e lexim. Dera e hikmetit (diturisë) në zemër çelet me luftë, kontroll, duke bërë ibadete zahir dhe batin, duke bërë dhikër Allahun me mendime të mira e me zemër të qetë, dhe me këputjen e interesimit për këtë botë duke u lidhur me tërë qenien për Allahun. Ky është buimi i keshfit dhe çelësi i ilhamit (frymëzimit). Resulallahu s.a.v.s. thotë:

**“Ai që punon me atë që di, Allahu Teala ia mëson atij edhe atë që nuk e di.”<sup>156</sup>**

Në librat që u kanë zbritur pejgamberëve të mëparshëm shkruan: *“Mos thoni ‘Dituria është në qiell – kush do ta zbresë? Dituria është nën tokë – kush do ta nxjerrë? Ajo është pas detit – na thoni kush do ta sjellë?’ , sepse dituria është në zemrat tuaja. Bëhuni edhe ju të edukuar si melaiket dhe të moralshëm si të devotshmit (sidikët), që dituria të ndriçojë në zemrat tuaja.”*

Abdullah Tusteriu ka thënë:

*“Dijetarët, abidët dhe zahidët e braktisin këtë botë me zemra të mbyllura, vetëm sidikët (të devotshmit) dhe shehidët (dëshmorët) i kanë zemrat e hapura”; dhe lexoi ajetin:*

**“Ai i ka çelësat e të padukshmes (gajbit) dhe vetëm Ai i njeh ato.”** 6-En’am: 59

---

<sup>156</sup> Ebu Nuajm, në veprën *‘Hilje’*

Po qe se një zemër e ndriçuar me dituri batin nuk përmban edhe dituri zahir, Pejgamberi ynë nuk do të thoshte:

**“Ti pyete (konsulto) zemrën tënde, sado që të tjerët thonë, dhe përsëri thonë dhe përsëri thonë!”**

Dhe me një hadith kuds:

**“Robi Im vazhdimisht më afrohet me ibadete nafile. Në fund, atë e dua. Kur e dua robin, atëherë bëhem syri me të cilin sheh...”**<sup>157</sup>

As librat e tefsirit e as komentuesit nuk mund t’i kapin ato kuptime të holla, që lindin vetëm në zemrat e atyre që merren me dhikër dhe meditim. Muridi që e kontrollon veten frymëzohet nga këto kuptime. Kur u tregojnë komentuesve (mufesirëve), mufesirët që kuptojnë e pranojnë këtë, dhe ata e dinë se kjo është një mirësi e Allahut si shpërblim për mendimet e zemrës së pastër të tyre, si dhe për mundimet e tyre për Allahun Teala. Edhe dituritë zahir edhe ato batin janë një det në thellësi të të cilit nuk mund të arrihet. Secili mund të futet vetëm aq sa i takon dhe sa i dhuron Rahmani në krahasim me veprat e tija të mira.

Duke komentuar dituritë e ahiretit, Hazreti Alia, me një thënie të gjatë thotë:

*- Zemrat janë enë, e më e mira e enëve është ajo e cila bartë më së shumti hair, dhe vazhdoi:*

*- Njerëzit ndahen në tri grupe: ata që e njohin Allahun, ata që mësojnë për shpëtim dhe grupi i tretë – i pa vlerë, që shkojnë pas çdo fjale, që shtrembërohen me çdo erë, me nurin e diturisë nuk ndriçohen, në degë të sigurt nuk kapen. Dituria*

---

<sup>157</sup> Buhari dhe Muslim, nga Ebu Hurejre.

është më me vlerë se pasuria. Sepse dituria të ruan ty, kurse pasurinë e ruan ti; dituria e përdorur shtohet, e pasuria e përdorur harxhohet. Ashtu si përfitohen me dituri vepra të mira në këtë jetë, edhe pas vdekjes është e mundur mirëqenia në sajë të diturisë. Dituria është gjykatës, e pasuria është e detyruar në fajësi. Me vdekjen e të pasurit, interesi për pasurinë e tij shtohet. Thesari vdes, e pasuria mbetet në shesh. Por dijetarët jetojnë përderisa është bota.

Pastaj, mori frymë thellë dhe tha:

- Ah, këtu në gjoksin tim ka dituri të madhe! Sikur të gjeja dikë që mund ta bartë. Fatkeqësisht, ata që e dëshirojnë këtë, janë të pabesueshëm. Ata fenë e përdorin për përfitimet e kësaj bote dhe me mirësitë hyjnore, me dëshmitë që mësojnë, miqëve të Allahut dëshirojnë t'u tregojnë epërsi. Ose u përshtaten njerëzve të drejtë, por pasi që janë të dobët, nuk mund të përcaktojnë të drejtën menjëherë, në zemër u mbillet fara e dyshimit; pasi që nuk kanë zgjuarsin se në cilën anë duhet të jenë, zhyten në kënaqësitë e kësaj bote, ndjekin epshin, u përshtaten dëshirave për të grumbulluar pasuri. Këta më shumë u përngjajnë kafshëve në kullosa. Allahu im, ja – me vdekjen e bartësve të tillë, edhe dituria do të fiket. Prapë, sipërfaqja e tokës nuk mbetet e zbrazët prej atyre që i ruajnë urdhrat hyjnorë. Këta, ose janë haptas që çdokush mund t'i shohë, ose preferojnë të mbesin në fshehtësi për të ruajtur dëshmitë e Allahut Teala. Sepse, ata në numër janë pak por janë me vlera shumë të larta. Ata vetë janë të fshehur, por në zemra janë të çmuar. Me ta, Allahu Teala i ruan dëshmitë e Tij. Bile, këto dëshmi ata ua lënë amanet pasardhësve të tyre, dhe ua vendosin në zemra. Tërë dituria u kalon atyre. Shpirti arrin në jakin, ajo që është e fortë për të tjerët – për ta është e butë. Me shpirt janë lidhur në gradat e

*larta, me trup i dalin zot botës. Këta janë miqtë e Allahut në sipërfaqen e tokës dhe janë bërë punëtorët e Tij, kanë përfituar besueshmërinë e Tij, ftojnë në fe. Pastaj, duke qarë – tha:*

*- Kjo është ajo për çka unë kam zell.” Këto të fundit janë cilësi të dijetarëve të ahiretit. Kjo gjendje përfitohet me veprim dhe përpjekje.*

Dukuri tjetër e dijetarëve të ahiretit është që i japin rëndësi forcimit të *jekînit* (bindjes). Jekîn është kapitali i fesë. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Jekîn-i është tërësisht iman.”<sup>158</sup>**

Duhet të mësohet fillimi i diturisë së jekîn, që pastaj të hapet rruga e jekînit. Për këtë arsye Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Mësojeni jekînin.”<sup>159</sup>**

Pra, takohuni me poseduesit e jekînit dhe mësoni jekînin prej tyre, që t’u përshtateni gjendjeve dhe rrugës së tyre për të forcuar jekînin. Pak jekîn (bindje) është më e mirë se shumë veprim. Kur e pyetën Resulallahun s.a.v.s., për personin që posedon bindje të fortë por me shumë gjynahe dhe për atë që posedon bindje të dobët por me shumë vepra të mira, ai tha:

**“Nuk ka njeri pa gjynah.”**

Por, gjynahu nuk e dëmton personin e mençur i cili posedon jekîn që nga lindja. Sepse, pas çdo gjynahu, ai bën teube dhe istigfar, gjynahet zhduken dhe i mbesin veprat e mira që e qojnë në xhenet.

---

<sup>158</sup> Bejhaki nga Ibn Mesudi.

<sup>159</sup> Ebu Nuajm

Për këtë, Resulallahu s.a.v.s. thotë:

**“Më së paku u është dhënë jekîn dhe sabër. E kujt i jepet pak nga këto të dyja, nuk ka brengosje për agjërimet e kaluara dhe për netët që nuk është ngritur për t’u falur.”**

Llokmani kështu e këshillonte të birin:

*- O biri im, veprimi bëhet vetëm me bindje (jekîn), çdokush sipas bindjes vepron. Mangësia në veprim buron nga mangësia në bindje.*

Jahja b. Muadh er-Radhiu ka thënë:

*- Nuri i tevhidit është më i fortë se sa zjarri i mushrikëve që i ndez veprat e tyre të mira.*

Me këtë ‘nur’, Muadh nënkuptonte jekînin. Sidomos që në disa ajete Kur’anore përmenden poseduesit e jekînit, dhe që jekîni është mjet që shpie në lumturi të përhershme.

## KUPTIMI I JEKËNIT

Nëse thua që nuk është e mundur të kërkohet diçka që nuk kuptohet dhe nuk njihet, prandaj, në fillim na njofto kuptimin, forcën dhe mungesën e fuqisë së jekinit, pastaj merrem me kërkim; dije se:

Jekin është shprehje që ka dy vlera; dy grupe të ndryshme e përdorin në kuptime të ndryshme: Teoricienët dhe kelamistët me *jekin* nënkuptojnë mos-ekzistencën e dyshimit. Sepse prirja e nefsit (vetes) për të besuar diçka, i ka katër gradë.

### SHPJEGIMI I JEKINIT SIPAS TEORICIENTËVE DHE KELAMISTËVE

1– Vërtetimi me përgënjeshttrimin duhet të jenë në ekuilibër (drejtpeshim). Kësaj i thuhet '*Shek*'. Shembull: nëse ti pyetesh për një person a do të dënohet apo jo, e ti nuk je i informuar për gjendjen, ti nuk do të mundesh të japësh vendim për asnjërin anë, për ty është i mundshëm edhe dënimi edhe mos-dënimi. E meqë nuk ka parapëlqim, kësaj i thuhet '*dyshim*'.

2- Edhe pse i vlerëson të dy opsionet si të mundshme, ti anon në një anë. Shembull: pyetesh për një person të cilit ia njeh gjendjet shumë mirë, nëse ai person vdes me këto gjendje, a dënohet. Meqenëse ti ke parë te ai shenja të mirësisë, ti anon më shumë nga besimi që ai person nuk do të dënohet. Por bashkë me këtë, ti mendon që ai mund të dënohet për ndonjë faj të fshehur. Ky mendim i yti, është njëjtë i mundshëm si edhe animi yt, por nuk ka epërsi mbi të. E kësaj i thuhet '*supozim*' (*zann*).

3- Që në kujtesë nuk vjen e kundërta e asaj që besohet, e edhe nëse vjen, nuk pranohet; ky është animi i personit për të miratuar diçka dhe fitore e anës së miratimit. Por, një mendim i tillë, nuk mbështetet në njohje të sigurt. Por nëse ky person mendon mirë anën e dyshimit me anën e lejes, anon kah leja dhe e pranon atë. Kësaj i thuhet *‘besim i afërt me jekin (bindje)’*, e i këtillë është besimi i njerëzve të rëndomtë, të cilët vetëm përmes të dëgjuarit vendosin në koka parimet e shariatit. Ky besim është aq fuqishëm i vendosur në çdo pjesëtar të medh’hebeve, të cilët besojnë në mënyrë kategorike drejtësinë e medh’hebit të tyre dhe që imamët e tyre kanë gjetur të vërtetën (hakikatin), dhe nëse ndonjërit i thuhet: *‘është e mundur që imami juaj të ketë gabuar’*, nuk e pranon kurrë.

4- Njohja e vërtetë e cila arrihet me dëshmi në të cilën nuk ka aspak dyshim dhe ku dyshimi as që mund të paramendohet, e që është marifet. Besimin në të cilin nuk ka mundësi të përzihet dyshimi, dijetarët e kelamit dhe teoricienët e emërtojnë *‘jekin’*.

Një shembull i kësaj: kur i thuhet një personi të mençur: *‘A ka në mesin e krijesave të tilla që janë të përjetshme, që nuk kanë as fillim e as mbarim në kohë?’*, ai këtë menjëherë e refuzon dhe nuk mund ta pranojë. Sepse përjetësia nuk shihet me sy, ajo nuk është si dielli e hëna - krijesa që shihen. Të dihet për ekzistimin e përjetësisë nuk është e domosdoshme siç është që të dihet se dy është më shumë se një, pra nuk është si ato dituri që dihen në shikim të parë fare pa kërkuar dëshmi, dhe nuk është sikur dituria që diçka fillimisht është krijuar, e më pas ajo nuk mund të krijohet vetvetiu/pa shkak, sepse edhe kjo është e

domosdoshme. Pra, çdo i mençur e kupton menjëherë, pa i ekspozuar dëshmi, se diçka që ka dalë në shesh nuk mundet vetvetiu të krijohet, dhe që ekziston një Krijues i saj. Në pranimin e menjëhershëm të një ekzistence të përjetshme, ngurrimi i mendjes është i natyrshëm. Pastaj, një pjesë e njerëzve duke dëgjuar e një pjesë duke lexuar prej librave – për ekzistencën e përjetshme (që nuk ka fillim as fund), e pranojnë këtë në mënyrë absolute dhe vazhdojnë në besim. Ky besim është besimi i njerëzve të rëndomtë (avam). E disa njerëz e vërtetojnë praninë e ekzistencës së përjetshme me anë të dëshmisë. Kështu, nëse nuk do të ishte e pranishme një ekzistencë e përjetshme, të gjitha ekzistencat tjera do të ishin të krijuara pa shkak, e kjo është e pamundur. Diçka e tillë nuk mund të bëhet. E çdo gjë që drejton në të pamundurën është edhe vet e pamundur. Atëherë është e domosdoshme që mendja të pranojë një ekzistencë të përjetshme. Kjo çështje mund të studiohet në tri alternativa:

1. E gjithë ekzistenca është e përjetshme;
2. E gjithë ekzistenca është e krijuar;
3. Një pjesë është e përjetshme e një pjesë është paraqitur më vonë.

Nëse thua se e gjithë ekzistenca është e përjetshme, atëherë është gjetur ajo që kërkohej. Sepse e përjetshmja ekziston. Por, prej zhdukjes së disa prej tyre, po kuptojmë që ato janë paraqitur më vonë, janë krijuar. Nëse thua që gjithçka është paraqitur më vonë, kjo është e pamundur, siç është cekur më lartë. Atëherë, mbetet alternativa e tretë ose alternativa e parë. Përfitimit të njohurisë në këtë mënyrë i thonë *'jekin'*, edhe nëse përfitohet me dëshmi, siç është përmendur në shembullin më lartë, edhe nëse kuptohet me

shqisa, siç e shohim diellin dhe hënën. Ose kuptohet me mend, për shembull se pa shkak nuk do të mund të ekzistojë asgjë. Ose prej fjalëve, për shembull se ekziston Mekka. Ose kuptohet me përvojë, për shembull se *'sekomonja'* është ilaç kundër kapsllëkut. Ose me dëshmi, siç e shpjeguam më lartë.

Sipas dijetarëve të kelamit dhe teoricienëve, kushti për emërtimin *'jekin'* është mos-përzierja e dyshimit, prandaj çdo dituri që nuk është e përzier me dyshim, emërtohet *'jekin'*. Sipas kësaj, shpjegimi *'jekin'* nuk mundet të cilësohet me dobësi. Sepse nuk ka dallim mes dyshimit dhe dobësisë.

#### JEKINI SIPAS FAKIHËVE DHE SUFIVE

Shpjegimi i dytë është shpjegimi i fakihëve, sufive dhe disa dijetarëve. Edhe sipas këtyre, në jekin, siç është treguar më lartë, në asnjë mënyrë nuk pranohet mundësia e dyshimit. Në mendje duhet të gjendet vetëm jekini (bindje), dhe asgjë tjetër nuk duhet të vjen në kujtesë. Bile, sipas këtyre, edhe pse vdekja është ngjarje që patjetër do të ndodh, për dikë mund të thuhet *'filani e ka jekinin për vdekje të dobët'*, ose *'filani e ka jekinin për vdekje të fortë'*, (pra – jekini këtu cilësohet edhe si dobësi edhe si forcë). Kur zemra anon që të vërtetojë diçka, dhe ky anim fuqizohet në zemër duke hedhur anash mendimet tjera, dhe nëse kjo e mbulon zemrën plotësisht, atëherë kjo e merr *emrin 'jekin'*. Nuk ka dyshim që vdekja patjetër do të vjen dhe njerëzit janë me të njëjtin mendim - se assesi nuk ka dyshim. Por dikush nuk përgatitet për të (vdekjen), dhe bëhet kinse këtë nuk e beson. E dikujt ky

besim ia mbështjell zemrën, me tërë vullnetin fillon të përgatitet për vdekje dhe nuk harxhon kohë në punët tjera. E kësaj i thuhet *‘jekin i fuqishëm’*. Për këtë arsye disa dijetarë kanë thënë:

*“Vdekja është më së shumti e ngjashme me dyshimin pa bindje (jekin), dhe me bindjen (jekin) pa dyshim.”* (pra, mospërgatitja e njerëzve për vdekje, që është ngjarje e patjetër dhe absolute, e shfaqë vdekjen si të dyshimtë dhe e përngjanë me gjëra të dyshimta.)

E sipas kësaj shpjegimi, *‘jekini’* (bindje) mund të cilësohet si i dobët dhe i fortë.

Kur themi: *“Shenjë e dijetarëve të ahiretit është vullneti i tyre për ta forcuar jekinin e tyre”,* synojmë kuptimin e një jekini të përfituar duke braktisur dyshimin qysh në fillim, e që pastaj ky jekin, duke e mbushur zemrën, e mbizotëron atë plotësisht.

Nëse këtë e ke kuptuar, atëherë e ke të qartë kur themi se *jekin*-i mund të karakterizohet në tri mënyra: i fortë - i dobët, më shumë – më pak, dhe me të fshehtë - me të dukshmen. Sa i përket forcës (së bindjes) dhe dobësisë e fuqisë së jekinit, kjo ka të bëjë me shpjegimin e dytë (jekini si besim), që shihet në dominimin e tij (jekinit) dhe në vendosjen e kontrollit të tij mbi zemër, derisa për gradat e kuptimeve të jekinit sipas fuqisë dhe dobësisë, nuk ka fund. Dallimet mes njerëzve në lidhje me përgatitjen për vdekje rreshtohen përshtatshëm niveleve të ndryshme të jekinit në kuptimet e treguara (forcë bindëse dhe dobësia).

Sa u përket gradave përmes të fshehtës dhe të dukshmes përbrenda përdorimit të parë terminologjik të termit *‘jekin’* (jekin si bindje), as ajo nuk mund të hidhet poshtë. Ato ekzistojnë edhe në rastin e parë (si dyshim), edhe

në rastin e dytë (si supozim). As në rastin e parë e as në të dytin, ekzistenca e tyre nuk mund të hidhet poshtë, njëjtë si me ekzistimin e gradave të ndryshme të së fshehtës dhe të dukshmes, edhe sikur të gjitha dyshimet të evitohen. Shembull, ti bën dallim të qartë në mes të bindjes tënde për ekzistimin e Mekke-s, dhe bindjes për ekzistimin e *Fedek*-ut (fshat dhe oazë e vogël në veri të Medinës), ose në mes të ekzistimit të Musait dhe Jusha a.s., ani pse ti nuk dyshon në asnjërin nga ata të dy, e ku informatat për të dy lidhen me transmetim të besueshëm. Por megjithatë, njëra është më e dukshme dhe më e qartë në zemrën tënde se sa tjera, sepse shkaku te njëri është më i fortë, e kjo si pasojë e transmetuesve të shumtë. I njëjtë është rasti edhe me filozofin, i cili teoritë e veta i parashton përmes dëshmive. Nuk e ka njëjtë të qartë atë që i tregohet vetëm përmes një dëshmie, me atë të cilën e vërtetojnë shumë dëshmi, të gjitha të fuqishme në largimin e dyshimit. Diçka të këtillë mund të mohojë studiuesi i cili diturinë e merr nga librat dhe me të dëgjuar, duke mos i kushtuar vëmendje shpirtit të vet dhe asaj që shpirti e mëson (njeh) përmes gjendjeve të ndryshme.

Kur flasim për më shumë dhe më pak jekin, ajo qëndron në lidhje me përkatësinë e jekinit, sikur kur thuhet *filani ka më shumë dituri se ky tjetri*, që d.m.th. ka më shumë të dhëna faktike. Prandaj dijetari mund të jetë me jekin të fuqishëm sa i përket të gjithave që i ka sjellë sheriatit, por edhe mund të jetë me jekin të fuqishëm në vetëm një pjesë të sheriatit.

Nëse thua: *“E kam kuptuar jekin-in dhe cilësitë e tij të forcës dhe dobësisë, më shumë dhe më pak, të dukshmes dhe të fshehurës, në kuptim të mohimit të dyshimit, si edhe në kuptim të dominimit mbi zemrën, çka është atëherë qëllimi i jekinit dhe rrjedhave të tij, dhe në çka duhet kërkuar jekinin?*

*Nëse nuk e di se në çka të kërkoj jekinin, nuk mund të jem në gjendje as ta kërkoj”;*

Dije se e gjithë ajo me çka kanë ardhur pejgamberët a.s., nga fillimi deri në fund, përbëhet nga rrjedhat e jekinit. Sepse jekini (që nga personi e zhduk supozimin dhe dyshimin) është një dituri e veçantë dhe interesimi është për dituritë e sheriatit, e që këtu nuk ka mundësi t’i numëroj të gjitha, por vetëm t’i përmend disa nga kryesoret prej tyre.

Njëra nga to është *tevhid*: domethënë të njihet çdo gjë prej Allahut, duke mos u dhënë rëndësi ndërmjetësuesve tjerë (shkaktarëve dytësorë), gjithçka e sheh si të shfuqizuar dhe të nënshtruar urdhrit të Allahut Teala. Ai që beson në diçka të këtillë, posedon jekin.

Nëse përmes imanit, nga zemra largon të gjitha dyshimet, atëherë ai posedon jekin në njërin nga kuptimet e tij (bindje). Nëse në zemër, bashkë me iman, i dominon forca që largon urrejtjen ndaj shkaktarëve dytësorë, ose edhe kënaqësinë dhe lavdërimin për to, e shkaktarët dytësorë i bëhen në zemër si lapsi në dorën e mirëbërësit teksa shkruan, ai nuk do t’i falënderohet lapsit ose dorës, e as nuk do të zemërohet në to, por do t’i shohë si vegla të nënshtruara, si një lloj ndërmjetësuesi (shkaktarë dytësorë). Në këtë rast ai përfiton jekin në kuptimin e tij të dytë (besimi), i cili edhe është më i ndershëm. Ai është fryt i jekinit të parë, është shpirti dhe vlera e tij.

Sa herë që njeriu seriozisht pranon (kupton) që dielli, hëna, yjet, mineralet, bimët dhe kafshët janë të krijuara dhe të nënshtruara urdhrit të Allahut Teala, njëjtë si nënshtrimi i lapsit në dorën e shkruarit, dhe që fuqia e pafund e Allahut Teala është shkaktar për gjithçka, atëherë në zemrën e tij

mbizotëron *tevekkul*<sup>160</sup>, *riza* (kënaqësi) dhe *teslim* (dorëzim), dhe ai pastrohet nga zemërimi, urrejtja, xhelozia dhe ahlaku i keq. Kjo është njëra nga rrugët e jekinit.

Një nga këto rrugë është edhe bindja në garancinë e furnizimit nga Allahu. Allahu Teala thotë:

**“Nuk ka asnjë gjallesë në tokë që Allahu të mos ia ketë garantuar furnizimin e saj.”** 11-Hud: 6

Jekini përbëhet nga besimi se furnizimi vjen, edhe se ajo që i është caktuar do t'i vije. Sa herë që një bindje e këtillë t'i dominojë në zemër, njeriu aq do të kërkojë furnizimin në rrugë të mirë, deri sa zvogëlohet pangopësia, dëshira e pamasë dhe nuk brengoset për atë që i ka ikur. Një jekin i këtillë gjithashtu siguron qëndrueshmëri në nënshttrim Allahut dhe sjellje të lavdërueshme.

Një nga shenjat e këso jekini është edhe vendosja në zemër e ajetit ***‘kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë.’*** (99/7-8). Ky është jekini në shpërblim dhe dënim, përderisa lidhjen e

---

<sup>160</sup> Fjala *tevekkul*, në gjuhësi ka kuptimin të dorëzosh një punë dikujt tjetër, të kalosh një punë në përgjegjësi të dikujt tjetër, të porositësh dikë tjetër për një punë, puna të lihet në dorë të dikujt tjetër. Ndërsa, në terminologjinë Islame *tevekkul* ka kuptimin: pas marrjes së masave të sebebepit (shkakut) – përfundimi t'i lihet Allahut; të jesh i kënaqur (*razi*) me atë që vjen prej Allahut; duke u angazhuar me shkaqet, pas mobilizimit të mundësive, merr masa dhe i bën detyrat që i takojnë, dhe pastaj përfundimin ia lë Allahut Teala.

Tevekkul është një përfundim i natyrshëm i besimit që Allahu posedon cilësitë e diturisë, dëshirës, fuqisë dhe krijimit. Edhe besimi në kader dhe kaza përforcon *tevekkulin*. Tevekkul është kur njeriu plotësisht beson në premtimet e Allahut Teala.

Në gjuhën shqipe, *tevekkul* është përkthyer si *mbështetje*.

nënshtrimit me shpërblimin e sheh si lidhjen e bukës me ngopjen, kurse lidhjen e mosdëgjimit me dënimin si lidhjen e helmit me shkatërrimin (vdekjen). Ashtu siç punohet për bukë, qoftë shumë ose pak, me qëllim që të largohet uria, ashtu duhet synuar nënshtrimin ndaj Allahut Teala, qoftë shumë ose pak. Jekini në kuptimin e parë është prezent te të gjithë besimtarët, deri sa në kuptimin e dytë është posaçërisht për miqtë e Allahut. Fryt i një jekini të këtillë është vështrimi i sinqertë në lëvizje, në qetësi dhe në atë që vjen në mendime (*kujtesë*), si edhe takvallëku i fortë dhe ruajtja nga veprat e këqija. Sa më i fortë të bëhet jekini aq më shumë bëhet largimi nga e keqja dhe aq bëhet angazhim në të mirë.

Nga jekini është të kuptohet që Allahu Teala ka dijeni të plotë për çdo gjendje tënden, atë që kalon në zemrën tënde, të fshehtat e saj dhe mendimet tua. Këtë e posedon secili besimtar që e ka jekinin në kuptimin e tij të parë, pra jekin pa dyshim. Sa i përket kuptimit të dytë, i cili edhe është kuptimi që po kërkohet, që është i lartësuar dhe i takon sidikëve, fryt i tij është që njeriu, edhe kur është në vetmi (*halvet*), është i kujdesshëm për të gjitha gjendjet e tij, njëjtë si ai që qëndron para një sundimtari të ndershëm, nën vrojtimin e tij. I tilli do të jetë me shikim të lëshuar poshtë, do të ketë kujdes për secilën lëvizje të tij, dhe do të kujdeset të mos bëj ndonjë veprim jo të mirë. Njeriu i tillë, në mendimet e tij të fshehta duhet të jetë sikur në veprimet e tij të jashtme, sepse e ka kuptuar që Allahu i di të gjitha të fshehtat e tij, njëjtë siç i dinë njerëzit veprimet e tij të jashtme. Atëherë ai, me ndihmën e Allahut Teala, më shumë kujdes i kushton zhvillimit të së brendshmes së tij, pastrimit dhe zbukurimit të saj, se sa zbukurimit të së jashtmes së tij për njerëzit e tjerë.

Kjo gradë e jekinit lind turpërim, frikë, brishtësi, përulësi, nënshtrim, pendim, dhe virtyte të larta morale. Këto virtyte të larta morale sigurojnë zbatimin e plotë të urdhërave të Allahut Teala. Jekini, në secilin nga këto kuptime është si druri, cilësitë e mira të përmendura janë si degët e atij druri, kurse veprat dhe nënshtrimi që dalin nga ai ahlak janë si frutat dhe drita që shpërndahen nëpër ato degë. Jekini është baza dhe themeli. Ai ka porta dhe rrjedha më shumë se që ne kemi përmendur. Për këtë, inshallah do të flitet posaçërisht në vëllimin e katërt [RUB’U’L- MUNXHIJAT], derisa tash kjo që thamë, mjafton.

Një nga cilësitë e lavdërueshme morale është edhe që njeriu të jetë i pikëlluar, i butë, me shikim të lëshuar poshtë dhe i heshtur, që frika nga Allahu (*hashjet*), t’i lexohet në paraqitjen e tij, në mënyrën si vishet, në ecjen e tij, në heshtjen dhe në të folurit e tij, çdokush që e shikon atë ta përkujojë Allahun Teala. që e jashtëmja e tij të dëshmojë diturinë e tij dhe që syrin ta ketë pasqyrë të shpirtit të vet. Dijetarët e ahiretit njihen me shenjat në fytyrat e tyre, me dinjitet, me përulje dhe modesti. Thuhet: *“Allahu Teala nuk e ka veshur robin e Vet me rroba më të bukura se sa serioziteti në modesti. Kjo është rroba e pejegambereve, e të mirëve, të sinqertëve, dijetarëve.*

Sa i përket të folurit për t’u lavdëruar, dhënies së tepërt pas të qeshurave, ashpërsisë në lëvizje dhe në të folur, të gjitha këto janë pasoja të paturpësisë, mendjemadhësisë, mos-brengës dhe moskujdesit ndaj dënimit të Allahut Teala. Kështu veprojnë dijetarët e dynjallëkut, të pakujdesshëm ndaj Allahut Teala, që është e kundërt me ata që e njohin Allahun.

Kjo është në përputhje me ndarjen në tri pjesë të dijetarëve, për të cilën flet edhe Sehl Tusteri, Allahu e mëshiroftë:

*‘...Dijetarët e urdhrin të Allahut Teala, e jo të ditëve (ejjam) të Allahut Teala. Këta janë hoxhallarët që gjykojnë për hallallin dhe haramin. Nga ky lloj i diturisë nuk lind frika nga Allahu.*

*Në grupin e dytë bëjnë pjesë dijetarët të cilët e njohin Allahun Teala, por jo edhe urdhrin, e as ditët e Tij. Në këtë kategori bëjnë pjesë shumica e myslimanve.*

*Më në fund, grupit të tretë i takojnë dijetarët që njohin Allahun Teala, urdhrat e Tij dhe ditët e Tij. Këta janë të singertët, tek të cilët shfaqet frika nga Allahu Teala dhe përlulja.’*

Me ‘ditët e Tij’ (ejjam), Sehl-i ka menduar në lloje të ndryshme të dënimeve të fshehta dhe nimeteve të fshehta të Tij, të cilat Allahu i ka lëshuar mbi gjeneratat më të hershme, si dhe në ato që ende do të vijnë. Ai që gjithë këtë e kupton me diturinë e vet, të tillit frika nga Allahu dhe përlulja vetëm i forcohen.

Omeri r.a. thotë:

*- Përfitoni dituri, dhe përmes saj mësoni përluljen, dinjitetin dhe butësinë! Bëhuni të përlulur karshi atij nga i cili mësoni dituri, dhe ai nga ju që fiton dituri le të jetë i përlulur. Mos u bëni dijetarë mendjemëdhenj, e që dituria të ju kalojë në mos-dituri!” Gjithashtu thuhet:*

*- Allahu Teala nuk i ka dhënë robit të Vet dituri, e që bashkë me këtë të mos i ketë dhënë edhe butësi, përlulje, ahlak të bukur dhe dhembshuri.” Kjo është dituri e dobishme. Në një transmetim thuhet: “Kujt Allahu t’i japë dituri, zuhd, përlulje dhe ahlak të bukur, i tilli bëhet udhëheqës i muttekijëve (atyre që kanë frikë Allahun).*

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Ndër më të mirët e ummetit tim janë ata që haptas i gëzohen rahmetit të Allahut, e fshehtas qajnë nga frika prej dënimit të Allahut. Trupat e tyre janë në tokë, e zemrat në qiell, shpirtrat në dynja e mendjet në ahiret. Ata ecin me maturi ndërsa takimi i tyre është me sebebe.”<sup>161</sup>**

Hasani thotë: *“Dinjiteti është vezir i diturisë, butësia babai i saj, e modestia rroba e saj.”*

Bishr ibn Haris thotë:

*- Ai që me dituri synon pushtet, dhe kështu i afrohet Allahu Teala me armiqësi, i tilli është i urryer edhe në qiell edhe në tokë.*

Në një *israilijat* tregohet se si një i urtë shkroi 360 vepra për urtësinë, deri sa nuk e quajtën të urtë, e Allahu Teala peygamberit të atij populli i shpalli: *“Thuaj filanit: ‘Tokën e ke mbushur me fjalë boshe, e nuk më ke përmendur Mua në asnjë fjalë. Asgjë nga llomotitjet tua nuk do t’i pranoj.’* Personi u pendua, u largua nga ajo me çka merrej, shkoi në mesin e njerëzve të zakonshëm, filloi të sillej nëpër tregje, fitoi besimin e njerëzve, e në shpirt u bë modest. Allahu Teala atëherë i shpalli peygamberit të tyre: *‘Eh, tash Jam i kënaqur me të!’”*

Evzai, Allahu e mëshiroftë, transmeton nga Bilal ibn Sa’d, të ketë thënë: *“Ju e shihni policin, dhe kërkon strehim te Allahu Teala, e kur e shihni dijetarin e dynjallëkut, që lavdërohet para njerëzve e nxiton pas pushtetit, nuk ndjeni kurrfarë neverie, e ky meriton më shumë neveri se sa ai polici.”*

---

<sup>161</sup> Shënojnë Hakimi dhe Bejhekiu.

Transmetohet se e kanë pyetur Resulallahun s.a.v.s., cilat janë veprat më të vlefshme, në çka ai është përgjigjur:

**- Ruajtja nga harami, dhe duke u larguar nga harami e gjen shijen e përmendjes (zikrullah) në gjuhë. Allahu shumë përmend.** Më pas e pyetën:

- *Cili është shoku më i mirë?*, e Resulallahu s.a.v.s., tha:

**- Shoku i cili, kur ti e përmend Allahun, ai të ndihmon, e kur e harron Allahun, ai të përkujton.** Prapë e pyetën:

- *E cili është shoku më i keq?*, e Resulallahu a.s., tha:

**- Ai që, kur ti e harron Allahun, nuk të përkujton, e kur ti e kujton Allahun, ai nuk të ndihmon.** Gjithashtu e pyetën:

- *Cilët janë më të diturit?* Tha:

**- Ata që më së shumti i frikësohen Allahut.** Dhe thanë:

**- Na njofto për më të mirët në mes nesh, që të jemi në shoqërinë e tyre!** U tha:

**- Janë ata që, kur të shikohen, përmendet Allahu.** E pyetën:

- *E cilët janë njerëzit më të këqij?* Tha:

**- Allah, fali!** Thanë:

- *Na njofto, ja Resulallah!* U tha:

**- Dijetarët që ju prishen sjelljet.**<sup>162</sup>

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu na tregon:

**“Njerëzit më të sigurt në ditën e Kiametit do të jenë ata që në dynja më së shumti kanë menduar. Më të buzëqeshurit në ahiret do të jenë ata që në dynja më së shumti kanë qarë, e më të lumturit do të jenë ata që në dynja më së gjati kanë qenë në pikëllim.”**<sup>163</sup>

---

<sup>162</sup> Hadith me kuptim të ngjashëm shënojnë Ibnul-Mubarek dhe ed-Darimi.

<sup>163</sup> Burimin e këtij hadithi nuk e kemi gjetur në përmbledhjet kryesore të haditheve.

Në një nga hutbet e tij, hazreti Alia r.a., ka thënë:

- Edhe pse jam udhëheqës, ndërgjegjja ime është e lidhur me Allahun. Nuk ka kurrfarë dyshimi, asnjë e mbjellë nuk do të thahet, nëse është mbjellë me frikë ndaj Allahut, e rrënja e asnjë druri nuk do të thahet nëse është mirëmbajtur me drejtësi. Më i padijshmi është ai i cili rrugës ka mbledhur copëza të diturisë, të cilat e qojnë në errësirën e gjynahut, por, përkundër kësaj dhe përkundër faktit që nuk e ka kaluar as edhe një ditë në mësim, njeriu i keq dhe me reputacion të prishtë e quan dijetar. Ai do të shkojë pas sasisë, duke mos e ditur që sasia e vogël e diturisë së drejtë është më e mirë se sasia e madhe e diturisë e cila njeriun e largon nga Allahu. Ashtu siç ndodhë, ai do të pijë ujë që nuk lëvizë dhe do të hidhet në punë të ndryshme, por më kot. Më pas do të ulet që t'i mësojë njerëzit dhe të ju shpjegojë të pakuptueshmet. E nëse përballet me ndonjë problem të komplikuar, do të gjykojë gjerësisht, duke shprehur mendime të panevojshme, me të cilat në vend që të largojë dyshimet, edhe më shumë do të mjegullojë pamjen në detin e hutimit mu si rrjeta e merimangës, me çka do të hutojë njerëzit dhe do t'ua bëjë të pamundur vlerësimin se a ka ky të drejtë apo jo. Ai ka lëshuar rrënjë në mos-dituri dhe është viktimë e çmendurisë së shejtanit. Ai nuk heziton të përgjigjet në atë që nuk e di, dhe kështu t'i ikë gabimit, e as nuk do të mundohet të fitojë bazë të fuqishme të diturisë me zotërimin e së cilës do të shërbejë. Për shkak të mos-diturisë së tij, derdhet gjaku, e për shkak të vendimeve të tij ligjore, veprat e palejuara paraqiten si të lejuara. Ai nuk është në gjendje të përballet me problemet që i paraqiten, dhe nuk është i denjë për detyrën që i jepet. Të këtillët duhet dënuar me dënimin më të rëndë. Fatin e tyre duhet qarë sa janë ende gjallë.

Hazreti Alia gjithashtu ka thënë:

*- Mbahu fuqishëm për diturinë kur ta dëgjosh, dhe mos e përziej atë me tallje, që të mos bëhet dituri që humb vlerën.*

Njëri nga të parët e ndershëm thotë: *“Kur dijetari qeshet një herë, largohet një hap nga dituria.”*

Thuhet: *“Kur te mësuesi mbledhen tri cilësi: durimi, modestia dhe ahlaku i bukur, mirësia mbi nxënësin kompletohet. E kur te nxënësi gjenden tri cilësi: zgjuarësia, edukimi, dhe aftësia e të kuptuarit, atëherë kompletohet mirësia mbi mësuesin.”*

Shkurtimisht: Dijetarët e ahiretit nuk ndahen prej ahlakut që mëson Kur’ani. Sepse ata nuk lexojnë Kur’anin për të përfituar ndonjë pozitë, ata lexojnë Kur’anin për të vepruar me urdhrat e tij. Ibn Omer ka thënë:

*- Ne jetuam në një kohë kur disa prej neve besuan para se të zbresë Kur’ani. Pastaj zbritën ajetet, dhe na e mësuan hallallin dhe haramin, urdhrat dhe ndalesat. Nuk ka pasur asgjë që ne nuk kemi mundur të kuptojmë. Ndërsa kam parë edhe disa njerëz që pa besuar e lexojnë Kur’anin - prej sures Fatiha deri në fund, por nuk kuptojnë urdhrat dhe ndalesat, nuk mendojnë e nuk analizojnë, dhe i përziejnë gjërat si hurmat e mira me ato të këqija.*

Në një transmetim tjetër me të njëjtin kuptim, thuhet:

*- Ne i besuam Pejgamberit para se të zbresë Kur’ani. Do të vijnë disa njerëz të cilëve Kur’ani do t’u jepet pa besuar ata. Ata do ta respektojnë çdo shkronjë, por do ta tejkalojnë kontekstin, do të shpërfillin urdhrat, dhe do të thonë: ‘Ne jemi lexues, kush është që lexon më mirë se ne? Ne jemi dijetarë, kush është më dijetarë se ne?’ Ja që kjo është hisja e vetme që mund të marrin nga Kur’ani.*

Ndërsa një transmetim tjetër:

*“Pra, këta janë të këqijtë e këtij ummeti.”*

Është thënë:

*‘Sjellja dhe qëndrimi moral i dijetarëve të ahiretit përbëhet prej pesë veçorive që janë marrë prej pesë ajeteve Kur’anore, dhe ato janë: **Hashjet** (frika), **Hushu** (përulja), **Tevazu** (modestia), **Ahlaki i mirë** dhe **Zuhd** (parapëlqimi i ahiretit ndaj kësaj bote)’.*

Ajeti që është marrë për *hashjet*:

**“Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët.”** 35-Fatir: 28

Ajeti që është marr për *hushu*:

**“...duke qenë të përulur para Allahut dhe pa i këmbyer shpalljet e Tij me ndonjë vlerë të paktë.”** 3-Al’Imran: 199

Ajeti që është marr për *tevazu*:

**“Me besimtarët sillu butë!”** 15-Hixher: 88

Ahlaku i mirë:

**“Ti ishe i butë ndaj tyre, ngase Allahu të dhuroi mëshirë.”** 3-Al’Imran: 159

Ajeti që tregon *zuhd*-in:

**“Ndërsa njerëzit e dijshtëm thoshin: ‘Të mjerët ju! Shpërblimi i Allahut është më i mirë për atë që beson dhe bën vepra të mira’.”** 28-Kasas: 80

Kur Resulallahu s.a.v.s. lexoi ajetin:

**“Atë që Allahu dëshiron ta udhëzojë, ia zgjeron zemrën për (të pranuar) Islamin.”** [6/125], e pyetën:

– *Çka është ky ‘sherh-i sadr’ (zgjerimi i gjoksit)?* Resulallahu s.a.v.s. tha:

– **Kur rrjedh nur në zemër, gjoksi hapet dhe zgjerohet.**

E pyetën përsëri nëse kjo ka ndonjë shenjë, e Resulallahu s.a.v.s. tha:

**– Po ka, dhe ajo është largimi prej kësaj bote të rrejtshme, drejtimi kah ahireti i përhershëm dhe përgatitja për vdekje para se të arrijë vdekja.**

Edhe një dukuri e dijetarëve të ahiretit është studimi me kujdes i gjërave që i prishin veprat, që largojnë qetësinë e zemrës, që përgatitin vesvesen, si dhe që nxisin në veprim të keq. Sepse esenca e fesë është ruajtja prej të këqijave. Prandaj është thënë: *“E mësova të keqën, jo për të bërë keq, por për t’u mbrojtur prej saj. Shumica që nuk e njohin të keqen, zhyten në të pa e ditur”*.

Gjithashtu për shkak që veprat praktike përfitohen lehtë, e më e larta ndër to është përmendja e Allahut me zemër dhe me gjuhë. Pra, është aftësi e vërtetë të njihen gjërat që i pengojnë këto vepra, dhe të iket nga to. Këto që i treguam kanë shumë degë, dhe të gjithave duhet dhënë rëndësi, sepse secili ndeshet me to gjatë rrugëtimit të ahiretit.

Ndërsa dijetarët e dynjallëkut harxhojnë kohën duke kërkuar vendime dhe gjëra të çuditshme e të panevojshme për fetvatë të tyre, që as nuk ju nevojiten, ose ndoshta do t’ju nevojiten gjeneratave të më vonshme. E edhe nëse diçka e tillë ju nevojitet, ka shumë persona tjerë që mund ta zgjedhin atë çështje. Është e çuditshme që ata ditë e netë i kalojnë në kujtimet e tyre, në vesvese, dhe i lënë pas dore veprimet të rëndësishme që u nevojiten atyre. Ata preferojnë lavdërimin e njerëzve më shumë se rizanë së Allahut, preferojnë që të mëdhenjtë e dynjasë të thonë se ata janë hulumtues e studiues. E çka mund të jetë më larg nga lumturia se sa kur

ndërron një gjë të rëndësishme për vete me diçka që shumë rrallë i nevojitet tjetrit? Dënimi i dijetarëve të tillë është mospranimi i tyre me dëshirë nga njerëzit, pikëllimi me shqetësimet që vijnë një pas një. Ndërsa në ahiret do të kenë mall kur të shohin veten të shkatërruar, e dijetarët e vërtetë marrin shpërblime të shumta; nuk ka humbje më të madhe se kjo!

Është pranuar nga të gjithë dijetarët që fjalët e Hasani Basriut, Allahu qoftë i kënaqur me të, u ngjajnë më së shumti fjalëve të Pejgamberëve, udhëzimi i tij – udhëzimit të as’habëve. Shpjegimet e tij ishin më shumë rreth arritjes së vesveses në zemër, dëmtimit të veprave, vesveset e nefsit dhe anët e fshehta dhe të mbyllura të dëshirave dhe epshit. Një herë e pyetën:

– *O Ebu Said, ne nuk po dëgjojmë prej askujt këto që ti je duke i thënë, nga i mësove këto?*”, ai iu përgjigj:

– *Prej Huzejfe ibnul-Jeman.*” Edhe Huzejfe-n e kanë pyetur:

– *Prej teje po dëgjojmë ato që nuk dëgjuam prej asnjë as’habi, ku i mësove këto?* Huzejfe u tha:

- *I mësova prej Resulallahut s.a.v.s., dhe vazhdoi:*

- *Njerëzit vazhdimisht pyetnin për vlerat dhe shpërblimet që kanë për veprat dhe të mirat e tyre, e meqenëse e dija që unë nuk jam i pari që e mësoj mirësinë - unë pyeta për të këqijat për të mos u zhytur në vepra të këqija. Sepse e di se ai që nuk e njeh të keqen, as të mirën nuk e njeh. Për këtë arsye edhe Pejgamberi më nderoi duke m’i mësuar këto mua.*

Huzejfe ishte ai që më së miri e dinte shkakun e grindjes, diturinë për dyfytërsinë dhe hollësitë e ngatërresës. Bile Omeri, Osmani dhe as’habët e tjerë të mëdhenj, Huzejfin e pyesnin për ngatërresat, e dëshironin të mësonin nga ai

edhe për ngatërrestarët, por ai vetëm thoshte ‘vetëm edhe kaq kanë mbetur’, pa dhënë emra. Omeri e pyeste se a ka shenja dyfytërsie te ai, e Huzejfe e siguronte që në fytirën e Omerit nuk ka shenja dyfytërsie. Për Huzejfiun kishin thënë se është ‘Personi i fshehtësisë’.

Shkurtimisht: Kujdesi për gradat dhe gjendjet e zemrës, dhe përmirësimi, janë dukuri të dijetarëve të ahiretit. Sepse është zemra ajo që ngritët në afërsi hyjnore. Kjo dituri e zemrës mbeti e huaj, dhe bile u humb. Nëse një dijetar flet nga dituria e zemrës, dëgjuesit do të thoshin:

*“Sa gjëra të pakuptueshme dhe të çuditshme që tregon ky!”*

Habiten, dhe për atë (dijetarin) thonë:

*“Ja, ky po flet fjalë të zbukuruara dhe po i shet ato, ku janë ata dijetarë që përpiqen të tregojnë hollësitë.”* Sa mirë ka thënë Abdulvahid b. Zejd në këtë vjershë:

***“Rruga e vërtetë është një,  
ani pse rrugët janë shumë  
Ata që hyjnë në këtë rrugë janë pak,  
e nga ta - shumica në gjumë.”***

Shkurtimisht: Shumica e njerëzve u përshtaten natyrave të tyre dhe anojnë kah e lehta. E vërteta është e hidhët, të qëndrosh në të është e vështirë. Veçanërisht është e vështirë të njihen cilësitë e zemrës dhe të pastrohet ajo nga veset e këqija. Sepse ka mundësi që ato vese vazhdimisht të tërheqin shpirtin. Ndërsa personi, i cili me shpresën e shërimit duron shijen e ithët të ilaçit që e pi, është sikur ai që kalon gjithë jetën në agjërim, dhe në vdekje të bëjë iftar me myzhdënë e melekut. Për këtë arsye është thënë se nga 120 ligjërues që

kishte Basra, vetëm tre prej tyre flisnin për imanin jekin, gjendjet e zemrës dhe cilësitë e brendshme. Këta janë: Abdullah Tusteri, Subajhi dhe Abdurrahimi. Në ligjëratat e të tjerëve shkonin shumë xhemat, kurse në ligjëratat e këtyre të treve vinin pak njerëz – jo më shumë se dhjetë. Sepse diçkaje me vlerë vetëm njerëzit e caktuar ia dinë vlerën, diçkaje të vlefshme vetëm njerëzit e caktuar i përshtaten. Dhe ata të cilëve u janë dhënë gjëra të vlefshme janë pak.

Edhe një dukuri e dijetarëve të ahiretit është që, duke mësuar *tevvекul* (mbështetje) dhe duke hulumtuar e kuptuar me zemër të hapur hakkikatin e çdo gjëje, nuk imitojnë qorrazi të tjerët. Në urdhra dhe në ndalesa, i vetmi që duhet të imitohet është Zotëruesi i Sheriatit, Pejgamberi ynë Muhammedi a.s. Ndërsa imitimi i as'habëve në fjalët dhe punët e tyre që i mësuan prej Pejgamberit është udhërrëfyes. Kur imitojmë Pejgamberin duke pranuar fjalët dhe punët e tij, nevojitet përkushtim për të mësuar hollësitë në fjalët dhe punët të tij. Imituesi bën atë që e bëri Pejgamberi. Padyshim, në çdo fjalë dhe punë të Pejgamberit ka një hikmet (dituri). Andaj duhet edhe të hulumtohet fshehtësia (siri) dhe hikmeti në fjalët dhe punët të tij. Ai të cilit i mjaftojnë thëniet dhe shembujt, ai është vetëm enë e diturisë, por jo edhe dijetar. Për këtë arsye, ai që nuk kupton fshehtësinë dhe hikmetin dhe mëson përmendësh – nuk është dijetar: atij i thuhet '*enë e diturisë*'. Kujt i hiqet perdja nga syri i zemrës dhe ndriçohet me nurin hyjnor, nuk i imiton të tjerët, ai vetë imitohet dhe të tjerët i përshtaten atij. Për këtë arsye Ibn Abbas r.a., ka thënë:

- *Përveç Resulallahut, prej diturisë së çdokujt mund të merret dhe mund të refuzohet.*

Ibn Abbas ka marrë nga Zejd b. Sabit diturinë e fikhut, dhe nga Ubej b. Ka'b diturinë *kiraat* (leximin). Pastaj u është kundërshtuar atyre në disa çështje. Ndërsa disa dijetarë të mëparshëm kanë thënë:

*- Çka vjen nga Resulallahu s.a.v.s. e pranojmë mbi sy e kokë. Ajo që vjen nga as'habët, mund të ndodh ta pranojmë, por mund të ndodh edhe të mos e pranojmë. Kurse nga Tabijinët – edhe ata janë njerëz, edhe ne jemi njerëz.*

Vlera e lartë (*fazilet*) e as'habëve qëndron në atë që kanë parë veprat dhe gjendjet e Resulallahut s.a.v.s., dhe përmes dëshmisë në zemrat e tyre që kanë përfituar nga Resulallahu s.a.v.s., kanë mundur të kuptojnë atë që kanë synuar. Këto gjendje as'habët i arritën me drejtësi të cilën nuk ka mënyrë për ta shprehur dhe përshkruar. Sepse ata i mbrojti nuri i nubevvetit nga disa gabime, dhe ia arritën qëllimit.

Pasi që mbështetja gjërave që dëgjohen prej të tjerëve njihet si imitim i papëlqyeshëm, edhe mbështetja në shkrime dhe libra është shumë larg prej të qenit e pëlqyeshme. Sepse në kohën e as'habëve dhe tabijinëve nuk ka pasur libra. Librat filluan të shkruhen në vitin 120 H, pas vdekjes së tërë as'habëve dhe me vdekjen e Tabijinëve të mëdhenj si Said b. Musejjeb, Hasani Basriu dhe të tjerë. Të parët nuk e kanë parë të pëlqyeshme të shkruhen libra, bile as edhe të shkruhen hadithet, me frikën që kjo pengon në leximin e Kur'anit, në mendimin për kuptimet, në meditim dhe përkujtim. Dhe thoshin: *"Si ne që mësuam përmendësh edhe ju mësoni përmendësh."* Për këtë arsye Ebu Bekri r.a. dhe një pjesë e as'habëve, me frikë që njerëzit nuk do ta mësojnë Kur'anin përmendësh, nuk e panë të përshtatshme që Kur'ani

Kerim të mblidhet në një vend (lidhja në një libër të vetme - musaf), dhe thanë: *“Atë që nuk e ka bërë Resulallahu s.a.v.s, nuk e bëjmë as ne; ta lëmë Kur’anin si është, dhe ta transmetojmë duke e mësuar prej gojës në gojë.”* Mirëpo, Omeri r.a. dhe as’habët e tjerë, duke u brengosur që njerëzit do të bëhen dembelë në leximin e ajeteve të ngjashëm Kur’anorë, ose që mund të ketë mosmarrëveshje për ndonjë fjalë, e nuk ka ku të kërkohet përgjigje pasi që nuk gjendet origjinali, dhanë shenjë që Kur’ani duhet të shkruhet, edhe me pranimin e Ebu Bekrit, ajetet e Kur’anit janë mbledhur në një Musaf. Edhe Ahmed b. Hanbeli nuk e gjente të pëlqyeshëm librin ‘Muvatta’ të Malikut, dhe i thoshte: *“E bëre atë që as’habët nuk e bënë.”*

Është thënë që Ibn Xhurejh (vdiq 146 H) ka shkruar librin e parë në Islam; libri i tij është në lidhje me hadithet, dhe në Meke, nga transmetimet e Muxhahidit, Atta-së dhe shokëve të Ibn Abbasit, ka shkruar vepër në temën e komentimit. Ndërsa në Jemen, Mamer b. Rashid San’ani ka shkruar libër rreth sunnetit të Pejgamberit. Më vonë, në Medine, Malik b. Enesi shkroi librin ‘Muvatta’, dhe Sufjan Sevri veprën ‘Xhami’.

Në shekullin e katërt filluan të shkruhen libra rreth kelamit. Në artikujt e tyre u zhytën në gjëra bosh, pa themel, dhe thashetheme. Njerëzve filluan t’u pëlqejnë tregimet dhe ligjëratat e tyre. Dituria jekîn filloi të humbet. Mbetën dituritë e pabesueshme të zemrës, cilësitë e nefsit, kërkimi i diturive për rrugët e mashtrimit të shejtanit. Prapë, përveç pak njerëzve, shumica ia kthyen shpinën këtyre diturive. Kelami filloi të quhet ‘dituri’, e ‘dijetarë’ - ata që flisnin me fjalë të

rimuara dhe të zbukuruara. Shkaku i parë i kësaj është se xhemati që dëgjonte këto nuk posedonte aftësinë për të zgjedhur të vërtetën, nuk mund të kuptonte dallimin mes këtyre dhe diturisë e ahlakut të as'habëve. Në këtë mënyrë, 'dijetarë' u quajtën të tillët, dhe ky emër kaloi nga gjenerata në gjeneratë. Dituria e ahiretit u harrua. Nuk mbeti dallim mes diturisë dhe fjalëve të kota. Përveç të zgjedhurve (*havas*), të tjerët erdhën në gjendje të mos mund të dallojnë shitjen e fjalës prej diturisë. Përveç që të zgjedhurit, kur janë pyetur se kush është dijetar, mund të thoshin '*Filani është dijetar, e filani është llafazan*', dhe mundën të ndajnë diturinë prej fjalëve të kota. Ja kështu, në shekujt e kaluar feja filloi të dobësohet. Në qoftë se ti pyet "*Çka është mendimi yt për këtë kohë?*" them se puna mbërriti në një shkallë të tillë që, ai që dëshiron të përmirësojë këto gabime, mund të quhet *mexhnun* (i çmendur). Në kohëra të këtilla, më e drejtë është që njeriu të merret me veten, në qetësi.

Edhe një dukuri e dijetarëve të ahiretit është largimi nga gjërat që populli i shpifë, duke mos u dhënë atyre kurrfarë vlere. Gjendja, ahlaku (moral) dhe dituria duhet të jenë si të as'habëve. A ishte tërë qëllimi i as'habëve të ligjërojnë, të shkruajnë libra, të shqyrtojnë, të jenë gjykatës, guvernatorë, drejtues të fondacionit të jetimëve, të merren me mallin e jetimit, të përzihen me udhëheqësit (padishahët) e shtetit dhe t'u vardisen atyre? Apo qëllimi ishte të kërkohet dituria batin (e brendshme) duke u frikuar nga Allahu Teala, të mendohen mirësitë e Allahut, të luftohet nefsi, të kontrollohet e brendshmja dhe e jashtmjja, të largohet prej gjynaheve të vogla e të mëdha dhe prej dëshirave të fshehta eposhore, prej mashtrimit të shejtanit, dhe të ngjashme? Pra,

detyrë e myslimanit të vërtetë është të posedojë ato gjendje që kishin as'habët dhe të jetë mirë i informuar për punët e tyre.

Të vërtetën dije mirë: dijetari më i madh i kohës është ai që është më afër Allahut Teala, që me çdo gjendje më së shumti i përngjanë as'habit, që e di më së miri rrugën e paraardhësit (selefit) dhe që ka marrë urdhrat e fesë prej tyre. Për këtë arsye, kur i është thënë Alisë r.a.:

- *Filanin e kundërshtove, ka thënë:*

- *Më i hairit prej juve është ai që në këtë fe na përshtatet neve.*

Prandaj nuk duhet preokupuar me rrugën e gabuar të njerëzve të kohës tonë në vend të gjeneratës së Resulallahut s.a.v.s.; fatëkeqësisht natyra e njeriut anon kah ata dhe faziletin e shohin në kohën e vet duke mos pranuar që sjelljet e veta largojnë prej xhenetit, dhe kundërshtarëve u thonë: *'kjo është rruga që qon në xhenet.'*

Hasani Basriu ka thënë:

- *Dy lloj njerëzish janë risi në Islam:*

1. *Ai që ka mendime të këqija, dhe për ata që mendojnë si ai beson që do të hyjnë në xhenet; dhe*

2. *Ai që ka arritur famë dhe dobi në dynja, e adhuron dynjanë, është i kënaqur nga kjo dynja dhe dynjaja është ajo që kërkon.*

*Që të dytë kundërshtoni, sepse vendi i tyre është xhehenemi. Besimtari në këtë dynja qëndron në mes të luksit që e thërret në dynjallëk, dhe ftesës për epsh. Kur e mbron nga sherri i të dyjave, Allahu Teala e bën të anojë ka ata mirët e parë, të studiojë veprat e tyre dhe t'ju përshtatet atyre. E ky njeri është përgatitur për shpërblim të madh!"*

Nga Ibn Mesud transmetohet se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

**“Ato (gjërat më të mira) janë vetëm dy: të folurit dhe rruga. Të folurit më të mirë është të folurit e Allahut Teala, e rruga më e mirë është rruga e Resulallahut s.a.v.s.. Aman, mos u afroni gjërave që paraqiten më vonë. Ato me të vërtetë janë gjëra të këqija. E gjithçka që është paraqitur më vonë është bidat, e secili bidat është devijim. Mos t’ju mashtrojnë jetët e gjata - mos shpresoni se nuk vjen vdekja, e t’ju forcohen zemrat. Gjithçka që vjen është afër, e larg është ajo që nuk do të vijë fare.”**

Resulallahu s.a.v.s., në një hutbe, kështu thotë:

**“Lum ai që merret me mangësitë e veta dhe që mangësitë e të tjerëve nuk i hulumton, që jep prej fitimit hallall, që takohet me njerëzit e hikmetit (diturisë) dhe fikhut edhe që largohet nga kryengritësi dhe keqbërësi. I gëzuar qoftë ai që është i përlur me ahlak/moral të mirë, që është shpirtmirë dhe nuk u bën keq njerëzve. I gëzuar qoftë ai që me dituri vepron, që jep tepricën prej pasurisë, që e fsheh tepricën e fjalëve, që mbështetet në sunnet dhe largohet nga bidatat (risitë).”<sup>164</sup>**

Ibn Mesudi r.a. thoshte:

**- Në ahir zaman (kohët e fundit), gjendja e mirë dhe ahlaku i bukur do të jenë më të mira se veprat e mira.”** Gjithashtu thoshte: **“Më i hairit nga ju është ai që me bindje i përvishet punës. Do të vije koha kur më të hairit do të jenë ata që ndalen kur shumohen gjërat e dyshimta, duke mos preferuar asnjë anë.”**

---

<sup>164</sup> Ebu Nuajm, nga Husejn b. Ali.

Ibn Mesudi ka pasur plotësisht të drejtë. Sepse në këtë kohë, vërtet është më mirë të ndalesh se sa të dalldisesh, siç është dalldisur shumica, që janë zhytur në humnerë e shkojnë në shkatërrim.

Huzejfe r.a., ka thënë:

*- Më e çuditshme se kjo është që ju keni pranuar atë që kanë mohuar selefët, kurse atë që ju e refuzoni, sepse e kuptoni që është e keqe, gjeneratat e ardhshme do ta pranojnë si të mirë. Do të jeni në hair, përderisa e njihni të vërtetën, e nuk talleni me dijetarët."*

Huzejfiu e ka thënë të vërtetën. Shumë gjëra që në kohën e sotme llogariten si të mira e të pëlqyeshme, në kohën e as'habëve janë refuzuar. Për shembull, në kohën tonë, një pëlqim i qartë është zbukurimi i xhamive, në ndërtim, me qëndisje e me shtroja, për kupolën e xhamisë harxhohet sa për ndërtimin e gjithë kompleksit të xhamisë (përfshirë medresenë, bibliotekën etj.) Kjo është shpikje e Haxhaxhi Zalim-it. Myslimanët e parë, në namaz kishin shumë pak ndarje mes vete dhe dheut. Tutje – angazhimi në hollësitë e diturisë së diskutimit sot pranohet si një nga dituritë më të larta, si mjet që më së shumti siguron afërsi Allahut Teala, e në kohën e tyre (as'habëve) kjo ishte nga dituritë e ndaluara. Tjetër shembull është edhe lakimi i zërit në ezan dhe në leximin e Kur'an-it. Edhe një shembull është tejkalimi i masës së pastrimit dhe vesveset në pastrim pas kryerjes së nevojës; nuk ka kujdes për kafshatën që hahet se a është hallall apo haram, por sillet ujë nga njëmijë burime, për të pastruar rrobat. Shumë mirë ka thënë Ibn Mesudi r.a.:

*- Ju gjendeni në një kohë kur dëshirat e juaja u janë përshtatur diturisë. Do të vije një kohë kur dituria do t'i përshtatet dëshirave.*

Ahmed b. Hanbel ka thënë:

*- E lanë diturinë dhe kërkuan gjëra të çuditshme. Për të këtillët, dituria është pakësuar shumë. Allahu na ndihmoftë.*

Malik b. Enes ka thënë:

*- Në të kaluarën, njerëzit nuk kanë pasur nevojë të pyesin për gjëra për të cilat pyesin sot. Edhe dijetarët nuk kanë thënë: 'Kjo është hallall e kjo është haram', ndoshta thoshin: 'Kjo është mustehab e kjo është mekruh'. Do të thotë, hallallin dhe haramin e dinte çdokush dhe kanë bërë atë çka duhet, është kërkuar të mësohet çka janë mustehab (të preferuarat) dhe kerahat (neveria).*

Hisham b. Urve ka thënë:

*- Këta mos i pyetni për shpikjet e tyre, sepse këta edhe përgjigjet i kanë përgatitur. Pyetni për sunnetin, fatkeqësisht – asgjë nuk dinë.*

Sulejman Darani r.a., ka thënë:

*- Personit që i lind vullneti për të bërë një mirësi, mos ta bëjë menjëherë. Le ta shikojë a është e përshtatshme ajo vepër, apo nuk është e sheriatit. Në qoftë se është e përshtatshme – le ta bëjë duke falënderuar Allahun Teala.*

Kështu ka thënë për shkak se bidatet ishin shumë për sërë tepërmi. Përveç zemrat e atyre që ishin nën mbrojtjen e Allahut Teala, të gjitha zemrat tjera ishin përfshirë. Kështu, çdo vullnet i lindur në zemër për të bërë mirësi e turbullon qartësinë e zemrës dhe për këtë shkak, e padrejta mund të kuptohet si e drejtë. Prandaj duhet të kërkohen dëshmi për njoftimet e reja, dhe të veprohet me kujdes. Për këtë arsye, kur Mervani e ndërtoi mimberin në vend ku është falur namazi i Bajramit, Ebu Said Hudri e pyeti:

*- Çka është ky bidat?, e Mervani tha:*

- *Kjo nuk është bidat. Kjo është më e hairit nga ato që i di ti. Këtë e bëra për shkak që u shumuan njerëzit për të dëgjuar zërin tim.* Ebu Said Hudri tha:

- *I betohem Allahut, këtë që e ke bërë ti nuk është më e hairit nga dituria ime. Vallahi, pas teje kurrë nuk do të fali namazin.*

Shkak për mospranim në këtë rast është kjo:

Resulallahu s.a.v.s., nuk është ngritur në mimber, në hudbet e namazit të Bajramit dhe në duanë e shiut (*istiska*) është mbështetur në një hark ose në shkop.

Me një hadith të mirënjohur thuhet:

**“Ai që shpik një gjë që nuk është në fenë tonë është *merdud* (i refuzuar).”<sup>165</sup>**

Do të thotë, diçka që nuk ekziston në fe, e që është shpikur më vonë në emër të fesë, refuzohet. Edhe me një hadith është thënë:

**“Mallkimi i Allahut, i Melaikeve dhe i të gjithë njerëzve qoftë mbi ata që ummetit tim i bëjnë *gashje*.”**

Ata e pyetën “Çka është *gashje* ummetit tuaj”, e Resulallahu s.a.v.s. u përgjigj:

**“Zvarritja e njerëzve në diçka të shpikur, që nuk ekziston në fe.”<sup>166</sup>**

Dhe në një hadith tjetër:

- **Një melek që është krijuar nga Allahu Teala çdo ditë bën këtë thirrje: ‘Nuk i arrin shefati i Resulallahut (s.a.v.s.) atij që ndahet nga sunneti i tij’<sup>167</sup>**

---

<sup>165</sup> Buhari dhe Muslimi nga Ajshe.

<sup>166</sup> Darekutni nga Enesi.

<sup>167</sup> Burimi nuk është gjetur.

Kushdo që bën një gabim në përshtatje sunnetit, është si ai që nuk përshtatet në disa vendime të sulltanit, e kushdo që shpik një gjë që nuk përputhet me sunnetin, duke sulmuar kështu fenë, është si ai që dëshiron të bëjë grushtshtet. Padyshim që i falet atij që bën gabim, por nuk i falet atij që ka dëshiruar grushtshtet.

Disa dijetarë kanë thënë:

- *Padrejtësi është të heshtet për tregimet e selefëve, e për ato që kanë heshtur selefët, është e kotë të flitet.*

Një tjetër ka thënë:

- *E Vërteta (hak) është e rëndë. Ai që e tejkalon është mizor, ai që nuk mund t'i afrohet është i paafte, e ai që i përshtatet (të vërtetës), kjo i mjafton.*

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Bëni përpjekje gjithmonë të gjendeni në shkallën e mesme, edhe ata që janë përpara do të kthehen aty, dhe ata që janë prapa aty do të ngritën.”<sup>168</sup>**

Ibn Abbasi ka thënë:

- *Edhe në zemrat e atyre që ka parregullsi, sipas tyre ka një shije. Ndërsa Allahu Teala thotë:*

**“Largohuni nga ata që fenë e tyre e marrin si lojë dhe dëfrim.”** 6-En’am: 70

Dhe me një ajet tjetër:

**“A është ai, që veprat e veta të këqija i duken të mira (si ai që është i udhëzuar në rrugën e drejtë)?”**

35-Fatir: 8

Pas epokës e as’habëve, çdo shpikje që kalon të domosdoshmen dhe nevojën, është lojë dhe dëfrim.

---

<sup>168</sup> Ebu Ubejd nga Ali b. Ebu Talib.

Transmetohet se Iblisi i mallkuar e shpërndau ushtrinë e tij në kohën e as'habëve për të mashtruar njerëzit. Ata u kthyen pa bërë asgjë.

– Kur i pyeti “Çka u bë?”, ata thanë:

– *Nuk kemi parë kësë njerëz të çuditshëm. Sado që u munduam, nuk mundëm t'i mashtrojmë. Vetëm mbetëm shumë të lodhur.* Iblisi tha:

– *Ju nuk mund t'i mashtroni ata, assesi. Sepse ata janë takuar me Pejgamberin dhe janë bërë dëshmitarë në zbritjen e Kur'anit. Por pas tyre do të vijnë njerëz të cilët mund t'i ndikoni.*

Në kohën e Taibinëve, Iblisi përsëri shpërndau ushtrinë e tij, me të njëjtin qëllim; edhe ata u kthyen me kokë të ulur, dhe thanë:

– *Nuk kemi parë kësë njerëz të çuditshëm. Edhe në raste kur mashtroheshin, me një teube në mbrëmje, Allahu ua kthente në mirësi.* Iblisi tha:

– *As prej këtyre ju nuk keni dobi. Sepse këta u janë nënshtruar sunnetit të Pejgamberit. Këta janë njerëz që vërtetë posedojnë tehvidin. Por, pas tyre do të vijnë njerëz me të cilët ju do të jeni të kënaqur. Ata do të bëhen lodër në duart tua. Me egërsimin e tyre epshor, ju mund t'i tërhiqni kah të doni. Ata nuk bëjnë teube, e edhe nëse bëjnë (pasi që nuk i përshtaten sheriatit, dhe për këtë arsye nuk bëjnë teube të sigurtë), teubeja e tyre nuk do të pranohet që të kthehet në mirësi.*

Dhe vërtetë, pas epokës së Taibinëve erdhën njerëz të mbuluar me epsh; atyre bidatet iu prezantuan si hallall, dhe ata i pranuan si pjesë të fesë. Ata nuk bënë teube, duke mos kërkuar falje nga Allahu. Edhe Allahu ua nxiti armiqtë atyre. Armiqtë i kthyen ata kah dëshiruan.

Nëse thua: *“Ai që e solli këtë tregim, as nuk e ka parë Iblisin, e as nuk ka folur me të. Nga e di ai këtë tregim?”*

Duhet ta dini që poseduesit e *keshf*-it (vështrim i syrit të zemrës) mund t’i shohin fshehtësitë e padukshme. Ky vështrim ndonjëherë bëhet me *ilham* (frymëzimin që vjen në zemër prej Allahut Teala) që është një degë e shpalljes (*vahj*), ndonjëherë me një ëndërr të vërtetë, dhe ndonjëherë në zhgëndërr. Njeriu shpirtërisht ngritët në një botë, aty e sheh të vërtetën e gjërave dhe ua merr vesh kuptimet. Ëndrra e vërtetë është një prej 46 pjesëve të nubuvvetit (pejgamberllëkut), e kjo gradë nga pjesët e nubuvvetit është grada më e lartë.

Mos! Mos e moho këtë dituri vetëm pse ti nuk e kupton! Këtu është pika e shkatërrimit të dijetarëve që menduan se kanë kuptuar dituritë mendore, duke dalë nga kapacitetet e veta. Për atë që mohon këto gjendje të miqve të Allahut Teala (evlia), xhehaleti (padituria) është më e mirë se dituria. Sepse xhahilët që e dinë që nuk kuptojnë, punët ia lënë Allahut. Meqë janë nga burimi i njëjtë, të mohosh evliatë dhe kerametet është njëjtë sikur të mohosh pejgamberët dhe muxhizet. Ndërsa mohimi i pejgamberëve është dalje e plotë nga feja. Disa arifë kanë thënë:

*- Fshehja e njerëzve të mirë në kohët e fundit është prej mos-durimit të tyre për të parë dijetarët e kësaj bote. Sepse ata që njihen si dijetarë në sytë e xhahilëve dhe që e llogarisin veten si dijetarë, në sytë e arifëve janë xhahil.*

Gjynahu më i madh është të mos njihet xhahilijeti, të shikohen mangësitë të tjerëve, të dëgjohen fjalët e gafilëve, dhe dijetarëve të cilët janë dalldisur pas kësaj bote. Nuk është e drejtë të dëgjohen dijetarët të cilët janë dalldisur pas

kësaj bote. Ndoshta, gjithçka që flasin nuk duhet të refuzohet. Sepse secili dalldiset pas asaj që do, dhe refuzon atë që nuk e do. Ndërsa Allahu Teala thotë:

**“Mos dëgjo atë, zemrën e të cilit ia kemi lënë mospërfillëse ndaj përmendjes Sonë, e që shkon pas dëshirave të veta, duke shkelur çdo kufi në veprimet e veta.”** 18-Kehf: 28

Xhahilët me të meta janë shumë më mirë se ata dijetarë që mendojnë se janë të dijshëm. Sepse njerëzit e rëndomtë i pranojnë mangësitë e veta, bëjnë teube dhe i kërkojnë falje Allahut Teala. Por, xhahilët të cilët mendojnë se janë dijetarë, që merrem me dituri për të përfituar këtë botë, duke u ndarë kështu prej rrugës së fesë, këmbëngulin në veprimet e tyre, nuk bëjnë teube dhe në këtë gjendje vdesin.

Kur kjo gjendje bëhet gjithëpërfshirëse, përveç atyre që Allahu Teala i mbron, dhe kur hiqet shpresa nga përmirësimi, për fetarët është shpëtim dhe mbrojtje largimi nga këto duke u tërhequr në vetmi. Inshallah, në kapitullin ‘Uzlet’ (Vetmia) do ta shpjegojmë këtë. Për këtë arsye, me shumë të drejtë, në një letër shkruar Huzejfetu’l-Mer’ashit, Jusuf b. Esbat ka thënë:

*- Çka thua për njeriun, kur nuk gjen asnjë person që përmend Allahun pa hyrë në gjynah, ose të bisedojë për dituri pa kryengritje?*

Shumë drejtë ka thënë: nuk po gjej person. Kjo sepse, me përzierje në rrethin e njerëzve, ose do të bëjë thashetheme, ose do t’i dëgjojë njerëzit, ose do të hesht për një të keqe që e sheh. Nga pikëpamja e fesë, të gjitha këto

janë të këqija. Po, gjendja më e mirë e njeriut është të mësuarit dhe mësimi i të tjerëve. Por, nëse ai që i mëson të tjerët lavdërohet, kërkon të jetë në krye, kërkon të përfitojë pasuri dhe kupton se prej kësaj dëshire veten nuk mund ta shpëtojë, duhet të kuptojë se edhe nxënësit e tij do ta përdorin diturinë për përfitim dhe në sherr; ai vetë është bërë ndihmës në përgatitje të shkaqeve të këqija; është bërë si ai që u shet armë grabitësve. Dituria, vërtet është armë. Hizmeti në mirësi, është si arma në luftë. Ashtu siç nuk është e lejuar t’u shiten armë atyre që do të bëjnë të këqija, edhe dhënia e diturisë personave me nijet (qëllim) të keq nuk është e përshtatshme.

Ja kështu, këto që përshkruam deri këtu janë dymbëdhjetë dukuritë e dijetarëve të ahiretit, duke përfshirë veprimet dhe gjendjet e tyre. E ti, zgjidh njëren nga këto dy rrugë:

1. Të mbledhësh të gjitha këto veti në një vend, ose
2. Duke i pranuar këto, të tregosh të vërtetën që je me të meta.

Mos e zgjedh rrugën e 3-të: mos e ndërro fenë me gjëra të kësaj bote dhe mos i njih si dijetarë të vërtetë ata të cilët në vepra të mira janë dembelë; dhe duke parë diturinë dhe mohimin tënd – mos u bëj nga ata që janë të varfër nga mëshira e Allahut dhe që janë në rrugën e shkatërrimit.

Dëshirat tona ndaj Allahut janë që të jemi prej robërve të cilët shejtani dhe stolitë e kësaj bote nuk mund t’i mashtrojnë.



## KAPITULLI I SHTATË

### NDERI I MENDJES

Kuptoje – meqë epërsia e mendjes është evidente, nuk ka nevojë të kërkohen dëshmi për nderin e saj. Meqenëse kuptuam që mendja është burimi, vendlindja dhe rrënja e diturisë, edhe nderi i saj del haptas. Mendja është në lidhje me diturinë si pema me frytin, si dielli me dritën, si syri me shikimin.

E si mos të jetë e ndershme mendja, kur ajo është mjet i lumturisë në këtë botë dhe në ahiret (botën e përherëshme)? Si mund të dyshohet në nderin e mendjes? Bile edhe kafshët më të mëdha, grabitqare dhe të tmerrshme, duke e ditur se me mendje njeriu është fitues karshi tyre, e shohin atë madhështor, i frikësohen dhe i përshtaten atij.

Pejgamberi ynë thotë:

**“Shejhu (dijetari) për popullin e vet është si pejgamberi për ummetin e tij.”<sup>169</sup>**

---

<sup>169</sup> Ibn Hibban nga Omeri.

Kjo nuk është nga pasuria, mosha dhe fuqia e tij, por nga përvoja (në të shumtën e rasteve), dhe është fryt i mendjes. Për këtë arsye shtresat e ulëta të popullsisë Arabe, Turke, Kurdë dhe fise tjera, edhe pse të varfër nga dituria dhe njohuria për shkak të xhahilijetit të tyre, instinktivisht i respektojnë të mëdhenjtë e tyre. Është pikërisht nga vlerat e epërsisë së mendjes që, kur keqdashësit i dolën në rrugë për atentat Muhammedit s.a.v.s., duke parë fytyrën e tij të ndritshme, panë nurin e nubuvetit dhe mendjes, prandaj i mbështolli frika prej madhërisë së tij, dhe hoqën dorë nga qëllimi.

Nderi i mendjes është i qartë dhe për këtë nuk nevojiten dëshmi. Por ne do të përmendim ajetet dhe hadidhet në lidhje me këtë. Allahu Teala mendjes i jep emrin *nur* (dritë).

**“Allahu është nur i qiejve e tokës. Shembulli i nurit të Tij i gjason kandilit të vendosur në një zgavër të errët.”**

24-Nur: 35

Ndërsa diturisë që përfitohet prej mendjes, Allahu i ka dhënë emrin *ruh* (shpirt) *vahj* (shpallje) dhe *hajat* (jetë):

**“Po kështu nga urdhri jonë Ne të shpallëm edhe ty shpirtin (ruh).”** 42-Shura: 52

**“A barazohet i vdekuri që Ne e ngjallëm dhe i dhamë nur me të cilin ecën midis njerëzve...”** 6-En’amë: 122

Allahu Teala, duke përmendur nurin bashkë me errësirën (zulmin), ndriçimin me terrin – qëllimi është të tregohet se nga ndriçimi vjen dituria, e nga errësira – xhahilijeti (padituria). Kështu, Allahu Teala na njofton:

**“Ai i nxjerr ata nga errësira në dritë.”** 2-Bekare: 157

E nga ana tjetër, Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Kujtoni Allahun, dhe nxiteni njëri-tjetrin në mendime, do ta dini se çka u është urdhëruar, e çka ndaluar! Dijeni se mendja do t’ju shpëtojë te Rabbi juaj. Dijeni se i mençur është ai që bëhet i dëgjueshëm ndaj Allahut, qoftë ai edhe me pamje të shëmtuar, status pa vlerë, gjendje të keqe e dukje të grisur, derisa xhahil i vërtetë është ai që është i padëgjueshëm ndaj Allahut Teala, qoftë ai edhe me pamje të bukur, status të lartë, pozitë të nderuar, të jashtme të këndshme, dhe folës i mirë e i shkathët. Kafshët e egra janë më të mençura tek Allahu Teala sesa ai që është i padëgjueshëm ndaj Tij. Mos u jep vlerë njerëzve që të shfaqin respekt (ty, e jo Allahut), sepse ata vërtetë janë nga të dështuarit.”<sup>170</sup>

Me një hadith tjetër të Resulallahut s.a.v.s, thuhet:

“Mendja është e para që Allahu Teala krijoi. Allahu i urdhëroi mendjes: ‘Ktheu në këtë anë’ dhe mendja u kthye. Urdhëroi ‘Ktheu në këtë anë’, mendja përsëri u kthye. U përul në çdo urdhër të Allahut Teala. Pastaj Allahu Teala tha: ‘Për hakun e lartësisë dhe madhërisë Time, nuk kam krijuar asgjë më të vlefshme se ti. Me ty jap, me ty marr. Me ty shpërblej, me ty dënoj’.”<sup>171</sup>

Nëse ti pyet: *‘Në qoftë se mendja është cilësi që nuk mund të qëndrojë vetvetiu, por duhet të mbështetet në diçka, si u bë që ajo u krijua para materies? Në qoftë se mendja është esencë, si mundet të qëndrojë vetvetiu, pa*

---

<sup>170</sup> Shënon Davud Ibnul-Muhbir, e gjendet edhe në **Musned**-in e Haris ibn Ebu Usame.

<sup>171</sup> Taberani, nga Uname.

*vendqëndrim?’*, duhet ta dish se kjo është dituria *mukashefe* (dituria që zbulon të fshehtë). Si e tillë, nuk është e përshtatshme të tregohet në diturinë *muamele* (praktike). Ndërsa ne jemi duke treguar diturinë praktike.

Sipas transmetimit nga Enesi r.a., disa njerëz ia lavdëruan shumë një person Resulallahut s.a.v.s., e Resulallahu s.a.v.s., i pyeti:

- **Si e ka mendjen ky person?** Ata thanë:

- *Ja Resulallah, ne po ju tregojmë për punët e hairit dhe ibadetin, ju po pyetni për mendjen e tij?* Resulallahu s.a.v.s., tha:

- **Me injorancë, njeriu hyn në gabime edhe më të mëdha se gjynahet. Ngritja e njeriut në gradat e larta nesër tek Allahu është në raport me mendjen.**

Nga transmetimi i Omerit r.a., Resulallahu s.a.v.s. tha:

**“Nuk ka fitim më të lartë për njeriun se sa mendja. Mendja e dërgon poseduesin e saj në mirësi, e tërheq prej të këqijave. Njeriut nuk i bëhet feja e drejtë dhe imani i plotë përderisa mendja nuk i arrin përkryerje.”**<sup>172</sup>

Përsëri Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Me ahlak të bukur (moral të bukur), njeriu arrin në nivelin e atyre që ditën agjërojnë e natën bëjnë ibadet. Por, ahlaku nuk zbukurohet pa u plotësuar mendja. Duke u pjekur mendja, edhe imani arrin në përkryerje; Rabbit të vet i përulet dhe shejtanin e kundërshton.”**<sup>173</sup>

---

<sup>172</sup> Ibnu’l-Muhber.

<sup>173</sup> Ibnu’l-Muhber.

Sipas transmetimit të Ebu Said Hudriut, Resulallahu s.a.v.s. ka thënë:

**“Çdo gjë ka një shtyllë, e shtylla e muminit (besimtarit) është mendja – zotëria e tij. Edhe ibadeti i tij është në raport me mendjen. A nuk dëgjuat thëniet në xhehenem:**

**“Sikur të kishim dëgjuar ose menduar, nuk do të ishim midis banorëve të Zjarrit Flakërues! (67:10)”**

Temim ed-Dari, i tha Omerit r.a.:

- *Sipas neve, zotëria është mendja. Omeri e vërtetoi, dhe tha:*

- *Unë pata pyetur Resulallahun s.a.v.s., e edhe Resulallahu njëjtë u përgjigj. Pastaj vazhdoi:*

- *Resulallahu pat thënë: ‘Edhe unë e pyeta Xhebrailin a.s. se çka është zotëria e ai tha:*

*- Mendja.’*

Bera b. Azib ka treguar:

- Një ditë e pyetën Resulallahun s.a.v.s., për shumë gjëra. Resulallahu s.a.v.s.,tha.:

**- O njerëz, çdo gjë ka një mbartës (një mjet udhëtimi), e mbartësi i njeriut është mendja e tij. Ai prej jush që arrit në dituri me dëshmi dhe në rrugë të drejtë, është poseduesi i mendjes më të lartë.**

Sipas transmetimit të Ebu Hurejres r.a., Resulallahu s.a.v.s., duke u kthyer nga beteja e Uhudit, dëgjoi bisdat e disa njerëzve se *‘filani prej filanit ishte më trim, filani përballoi fatkeqësi’,* e të ngjashme.

Në këtë Resulallahu s.a.v.s, ju tha:

- **Ju nuk mund të dini gjendjet e tyre.** As'habët e pyetën:

- *Ja Resulallah, pse nuk mund t'i dimë?* Resulallahu s.a.v.s., u përgjigj:

- **Lufta e tyre është në raport me mendjen që Allahu Teala ua ka ndarë atyre. Edhe fitorja edhe nijeti i tyre është në gradën e mendjes së tyre. Çdokush sipas këtyre gradave fiton pozitë, dhe në ditën e kiametit fitojnë pozitën sipas nijetit dhe nivelit të mendjes.**

Sipas transmetimit të Bera b. Azib-it Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

- **Melekët duruan me mendje në nënshtrim Allahut Teala. Bijtë e Ademit që janë besimtarë tregojnë durim në raport me mendjen të tyre. Më të mençurit janë ata që më së shumti veprojnë për rizanë e Allahut Teala.**

Sipas transmetimit, Aisha r.a. kishte pyetur Resulallahun s.a.v.s.,:

- *Ja Resulallah, me çka fitojnë epërsi njerëzit në botë?* Resulallahu tha:

- **Me mendje.** Aisha tha:

- *A nuk i peshohet vlera çdokujt me vepra?* Resulallahu tha:

- **O Aisha, a mund ata të bëjnë diçka më shumë se mendja e tyre? Ata veprojnë sipas mendjes që u ka dhënë Allahu Teala. Pastaj, sipas veprimit shpërblehen.**

Sipas transmetimit të Ibn Abbasit r.a., Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Çdo gjë ka një vegël, një përgatitje dhe aftësi: vegla e besimtarit është mendja. Çdo gjë ka një mjet për ngritje: mjeti i ngritjes së njeriut është mendja. Çdo gjë ka një shtyllë: shtylla e fesë është mendja. Çdo komb ka një mbështetje: mbështetja e ibadetit është mendja. Çdo komb ka një ftues: ftuesi i abidëve në ibadet është mendja. Çdo tregtar ka një kapital: kapitali i muxhtehidëve është mendja. Çdo familje ka një drejtues: kujdestari i shtëpisë së sidikëve (sinqertëve) është mendja. Çdo rrënojë ka një ndërtues: ahiretin e ndërton mendja. Çdokush ka një pasardhës që do ta përkujtojë: Sidikun do ta përkujtojë mendja e vet. Çdo udhëtar ka një çadër: çadra e besimtarit është mendja.”<sup>174</sup>**

Përsëri Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Tek Allahu Teala besimtari më i vlefshëm është ai që në ibadet veten ia ka nënshtuar Allahut Teala, që u jep këshilla robërve të Tij, mendja që i ka arrit në përkryerje; ai i jep këshilla vetes kur sheh të metat e tij, dhe me këto vepron tërë jetën. E ky gjen shpëtim dhe arrin fitoren.”<sup>175</sup>**

Me një hadith tjetër:

**“Më i mençuri është ai që më së shumti i frikësohet Allahut. Më i bukuri është ai që i përshtatet urdhrave dhe ndalesave të Allahut Teala. Bile, edhe nëse ai është dikush që bën më pak ibadete nafie.”<sup>176</sup>**

---

<sup>174</sup> Ibnul-Muhber.

<sup>175</sup> Ibnu’l-Muhber dhe er-Dejlemi.

<sup>176</sup> Ibnu’l-Muhber nga Ebu Katade.

## PJESËT DHE HAKIKATI I MENDJES

Dije se në shpjegimin e mendjes dhe hakikatit të saj, njerëzit janë në mosmarrëveshje dhe shumica e harruan që fjala *mendje* përfshin disa kuptime.

Ruga më e drejtë që do të ngritë perden në këtë çështje është:

Fjala *Akl* (mendja/arsyeja) është shprehje me të cilën tregohen katër kuptime, njëjtë si fjala '*ajn*' që ka disa kuptime (sy, burim, esencë, thelb, etj), ose si shumë fjalë të tjera me disa kuptime. Prandaj nuk është e nevojshme të kërkohet një definicion i posaçëm që përfshinë të gjitha kuptimet, por ndoshta duhet njohur shpjegimin për secilin kuptim, veç-e-veç. T'i shpjegojmë këto kuptime:

1. Tiparit që krijon ndarjen e njerëzve nga gjallesat tjera (kafshët), i thonë '*mendje*'. Që nga krijimi, njerëzit me këtë mendje përfitojnë aftësi të mësojnë dituritë racionale si dhe fitojnë shkathtësi e përvojë në profesion.

Edhe Haris b. Esed Muhasibiu këtë e thotë:

*"Mendja është një instinkt natyror përmes së cilit kuptohen dituritë racionale. Ajo është një nur që Allahu Teala e ka vendosur në zemër, njeriu me të përfiton aftësi për të kuptuar sendet."*

Ai që mohon këtë shpjegim të Muhasibiut e thotë që mendja përbën vetëm dituritë e domosdoshme, nuk ka të drejtë. Sepse, edhe ata që janë të shkujdesur ndaj diturive të domosdoshme, ose nuk i posedojnë ato për shkak që janë në

gjumë, prapë janë të mençur, sepse posedojnë këtë instinkt natyror. Njëjtë si jeta, që në mënyrë instinktive mundëson lëvizjet e lira të trupit dhe ndjesitë e shqisave, edhe mendja si instinkt natyror i përgatit disa kafshë për dituri praktike. Nëse ti thua që, sipas kësaj shpjegimi, nuk do të duhet të ketë dallim mes njeriut dhe gomarit, dije se; edhe mund të thuhet që nuk ka dallim në mendje mes njeriut dhe gomarit. Vetëm se sipas zakonit hyjnor (adet-i ilahijje), te njeriu krijohen dituri të cilat nuk krijohen te gomari dhe te kafshët tjera. Njëjtë nëse pohohet që nga pikëpamja e jetës edhe gomari me bimën janë baraz, mund të thuhet: po, nuk kanë dallim mes tyre. Ka vetëm aq dallim që Allahu Teala, sipas zakonit të Tij, krijon te gomari lëvizje të veçanta, dhe kështu atë e ndanë. Siç është e domosdoshme të thuhet që dallimi mes gomarit dhe gurit përmes lëvizjeve nuk është asgjë tjetër pos pasojë e natyrës së gomarit që ne e quajmë jetë, njëjtë edhe dallimi i njeriut nga kafshët në njohjen e diturive praktike është pasojë e natyrës së njeriut, të cilën e quajmë mendje.

Mendja është si pasqyra, e cila nga objektet tjera dallohet për nga natyra e saj e lëmuar, me çka edhe i pasqyron format dhe ngjyrat e jashtme. Edhe syri është kështu. Tipari i aftësisë së shikimit është i ndarë nga balli.

Kështu raporti i kësaj natyre ndaj diturive është si raporti i syrit me shikimin, kurse raporti i Kur'anit dhe Ligjit/sheriatit ndaj kësaj natyre në zbulimin e gjërave është si raporti i diellit ndaj shikimit të syrit. Ja, kështu duhet kuptuar këtë natyrë.

2. Pranimi nga ana e fëmiut që të pranueshmet janë të pranueshme (*xhaiz*), dhe që të pamundurat janë të pamundura: dhe njohja që dy është më shumë se një, që një

person nuk mund të gjendet në të njëjtën kohë në dy vende; këto janë dituri të domosdoshme. Edhe në shpjegimin e mendjes nga disa kelamistë synimi është kjo. Ata thonë: *'kuptimi që sendet e mundshme ka mundësi të bëhen, sendet e pamundura s'ka mundësi të bëhen, është dituri e domosdoshme.'* Edhe ky shpjegim është i drejtë, sepse këto dituri ekzistojnë te njerëzit. Dhënia e emërimit *'mendje'* këtyre është e kuptueshme, deri sa nuk është e drejtë që të mohohet instinkti natyror, e të pranohen vetëm këto dituri.

3. Dituria e përfituar nga përvoja është mendje: ai që kupton nga përvoja dhe që ato e bëjnë të matur, atij i thonë *i mençur*. Ai që nga përvojat nuk kupton asgjë, atij i thonë budalla dhe xhahil. Kjo është një lloj tjetër i diturisë, të cilës i është dhënë emërtimi *mendje*, e kësaj i thonë përvojë. Ky është një lloj tjetër i diturisë, të cilës njëjtë i është dhënë emërtimi *mendje*.

4. Ngritja e atij instinkti natyror në një gradë kur njeriu kupton tërë përfundimin e këtyre punëve, dhe kupton përfundimet e rrezikshme, si dhe e mposhtë epshin që fton në kënaqësi kalimtare. Personi te kush gjendet kjo forcë, përmes së cilës ai nuk përshtatet në ndjekje të dëshirave të epshit, por vepron duke menduar përfundimin, thuhet që merr cilësinë *'i mençur'*. Edhe kjo është një veçori që ndanë njeriun nga kafshët.

Nga këto katër kuptime të mendjes, e para është esenciale dhe është rrënja. E dyta është një degë e tij më e afërt. E treta është vetë kuptimi, e para dhe e dyta janë degët e kuptimit. Kjo sepse dituritë e përvojës përfitohen me forcën

e instinktit natyror. Nga mendja e katërt pritet rezultat, prandaj është si *fryti i fundit i mendjes*. E para dhe e dyta janë natyrore, ndërsa e treta dhe e katërta janë të fituara.

Për këtë arsye Alia r.a. thotë:

*- E pashë mendjen dy llojesh; njëra natyrore (e lindur-fitri), dhe tjetra e fituar. Pa ekzistuar mendja natyrore (e lindur), mendja e fituar nuk siguron dobi, siç nuk kanë dobi nga dielli ata që kanë syrin e verbër.*

Resulallahu s.a.v.s thotë:

**“Allahu Teala nuk ka krijuar asgjë më të vlefshme se mendja,”** e në këtë hadith të Resulallahut s.a.v.s, qëllim është e para, pra mendja (e lindur) natyrore - *fitri*.

Kurse në hadithin ku Resulallahu s.a.v.s., i drejtohet Alisë r.a.:

**“Siç i afrohen njerëzit Allahut Teala me mirësi të shumëllojshme, edhe ti afrohu me mendje,”** qëllimi është mendja e katërt, d.m.th. mendja e fituar.

Edhe nga kjo bisedë e Pejgamberit a.s., qëllimi është i njëjtë:

Sipas transmetimit, Resulallahu s.a.v.s., i tha Ebu’d-Derdas:

**- Shtoj mendjen, që t’i afrosh Allahut Teala.**

Ebu’d-Derda e pyeti:

*- Ja Resulallah, nëna e babai im ju qofshin kurban, si mundem të shtoj mendjen?, e Resulallahu s.a.v.s., u përgjigj:*

**- Largohu nga haramet dhe zbato farzet që të bëhesh i mençur, bëj vepra të mira që të arrish gradat e larta në dynja, dhe në afrimin Allahut Teala në ahiret – do të gjesh lartësi.**

Sipas transmetimit nga Sa'id b. Musejebi, Hazreti Omeri, Ubej b. Ka'b dhe Ebu Hurejre e pyetën Resulallahun s.a.v.s.:

- *Ja Resulallah, kush është më dijetari prej njerëzve?*

Resulallahu s.a.v.s., u përgjigj:

- **Ai që është më i mençur.** Ata e pyetën:

- *Kush është që më së shumti bën ibadet?* Resulallahu s.a.v.s., tha:

- **Ai që është më i mençur.** Ata pyetën:

- *Kush është nga njerëzit me vlerën më të lartë (fazilet)?*

Resulallahu s.a.v.s., u përgjigj:

- **Ai që është më i mençur.** Ata pyetën:

- *Ja Resulallah, a nuk është njeri i mençur mirëbërësi, i xhymerti, ai që di çka flet dhe që është i respektuar?* Resulallahu s.a.v.s., tha:

- **Të gjitha këto që i përmendët janë dynjallëk dhe gjëra që i takojnë dynjasë. Ndërsa ahireti është i të devotshmëve.**

Me një hadith Resulallahu s.a.s.v.s., thotë:

- **I mençur është ai që beson Allahun Teala, beson Pejgamberin (e Tij), dhe zbaton urdhrat.**<sup>177</sup>

Fjala 'mendje' është emërtimi i këtij instinkti natyror, si në fjalor ashtu edhe nga pikëpamja e përdorimit. Kurse dituritë e domosdoshme quhen 'mendje' bazuar në përfundimin e tyre. Sepse diçka njihet me përfundimin e vet. Prandaj thuhet se dituria është frikë (*hashjet*), e dijetari është ai që më së shumti i frikësohet Allahut. Por, frika nuk është shpjegim i diturisë, ndoshta është fryti dhe përfundimi i diturisë. Nga kjo pikëpamje është bërë metaforë e esencës Por ne nuk kemi për qëllim këtu kuptimin e fjalorit, qëllimi është të tregojmë në ekzistimin e këtyre katër pjesëve, dhe

---

<sup>177</sup> Inbu'l- Muhber.

që fjala ‘mendje’, përpos kuptimit të parë, përfshinë edhe të tjerat. Edhe tri pjesët tjera janë esencë, dhe janë brenda pjesës së parë - instinktit natyror. Kur gjendet shkaku që e bën të nevojshme për t’u shfaqur jashtë këto dituri, ato dalin në ekzistencë; ato janë si të fshehura brenda vetes e nga jashtë nuk merr pjesë diçka për t’i nxjerrë në ekzistencë. Shembull i kësaj është uji nën tokë, i cili del jashtë me një gërmim të vogël, dhe uji tubohet aty, pa iu bashkangjitur asgjë nga jashtë. Njëjtë është edhe vaji në bajame, dhe uji i trëndafililit. Për këtë arsye, Allahu Teala thotë:

**“Përkujto kur Rabbi yt nxori nga kurrizi i bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri dëshmues të vetes së tyre, u tha: ‘A nuk jam Unë Rabbi juaj?’ Ata u përgjigjën: ‘Po, dëshmojmë se Ti je’.”** 7- A’raf: 172

Kjo është deklaratë e shpirtave (të zhveshur nga trupi), e jo deklaratë e gjuhës, mirëpo në këtë botë, përmes deklaratës së gjuhës u ndanë në dy pjesë. Një pjesë deklaroi të njëjtën edhe me gjuhë, e një pjesë e mohoi. Për këtë arsye Allahu Teala tha:

**“Nëse i pyet ata se kush i ka krijuar, me siguri që ata do të thonë: ‘Allahu!’”** 43-Zuhruf: 78

Pra, gjendet e tyre të brendshme dhe mendja e tyre e dëshmojnë këtë. Duke treguar në këtë, Allahu Teala thotë:

**“Natyrën fillestare (fitrat), në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit.”** 30-Rum: 30

Pra, çdo njeri është krijuar në natyrën fillestare (të lindur), me besim në Allahun Teala dhe me aftësi natyrore për të kuptuar çdo gjë siç është. Meqenëse është afër aftësisë së kuptimit, kjo gjendje është sikur të jetë brenda personit.

Edhe pas njohjes se imani është një natyrë e vendosur te njerëzit qysh në krijim, një pjesë e njerëzve e ndryshuan qëndrimin dhe harruan këtë natyrë (fitrat). Një pjesë tjetër, duke u bërë dëshmitarë të ndonjë ndodhie, pasi kanë harruar, përsëri, duke u kujtuar, u vijnë mendtë e kokës, drejtohen andej dhe përkujtojnë natyrën fillestare. Për këtë Allahu Teala thotë:

**“Ashtu, që ata të përkujtojnë.”** 2-Bekare: 221

E në ajete tjera:

**“...që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend.”**

38-Sad: 29

**“Kujtoni dhuntinë e Allahut dhe besëlidhjen.”**

5-Ma’ide: 7

**“Vërtet, Ne e kemi bërë Kuranin të lehtë për t’u kuptuar dhe kujtuar, prandaj, a ka ndonjë që të marrë këshillë?!”** 54-Kamer: 17

Kujtimi është dy lloj:

1) Kujton diçka, pasi ta ketë harruar atë, e që më parë e ka pasur në kujtesë.

2) Kujton diçka që gjendet në vete që nga krijimi.

Për ata që shohin këto me syrin e zemrës (nurin e basiretit<sup>178</sup>), e vërteta është e qartë. Për ata që janë të privuar nga *keshf*-i dhe *mushahede*, kjo është e rëndë të kuptohet me anë të dëgjimit dhe imitimit. Për këtë arsye, duke u futur në ajete të këtilla me keqinterpretime të deklaratës së nefsit dhe kujtimit, devijuan nga rruga e drejtë, u mbërthyen në mendime kontradiktore, dhe në ajete e hadithe panë

---

<sup>178</sup> **Basiret:** syri i zemrës; të hetohet dhe kuptohet hakikati me zemër; të dihet hakikati i një sendi me zemër.

imagjinatën e vet. Shumë shpesh kjo gjendje te ata bëhet e natyrshme, ajetet dhe hadithet i përbuznin dhe besojnë që në këto ajete dhe hadithe vërtetë ka kundërshti, e kështu hutohen, dhe ndahen prej imanit, sikur qimja prej vajit. I tilli, nga paaftësia e vet, mendon që në fe ka kundërshti. Kjo gjendje i përngjanë të verbrit, i cili duke hyrë në shtëpinë e tjetrit, pengohet me karrige dhe tavolina, dhe i thotë të zotit të shtëpisë: *“Pse nuk i keni vendosur këto mobile në vende të veta?!”. Nuk është në dijeni, nga verbëria e vet, që mobilet janë në vend. Përgjigja që mund t’i jepet këtij personi është: “Turpërohu, nuk po e mendon verbërinë tënde, e po kërkon të meta te tjetri.” Ata që e kanë të mbyllur syrin e zemrës (basiret) janë si të verbrit, ndoshta edhe më keq, sepse basireti është si kalorës, e trupi si kali. Padyshim, verbëria e të parit (kalorësit) është shumë më e rrezikshme se verbëria e të dytit (kalit).*

Meqenëse syri i zemrës përngjanë me sytë në ballë, Allahu Teala tha:

**“Zemra nuk e mohoi atë që e pa.”** 53-Nexhm: 11,  
do të thotë: punët e shenjta shihen së pari me zemër, pastaj me syrin.

Prapë Allahu Teala thotë:

**“...Ibrahimit ia mundësuam t’i shohë madhësitë e qiejve e të tokës...”** 6-En’amë: 75

Ashtu siç i është dhënë emri *shikim* (ru’jet) kuptimit të zemrës, edhe të kundërtës së saj i është dhënë emri *verbëri*, pra *verbëria* është e kundërta e të kuptuarit, siç na njofton ky ajet:

**“Në të vërtetë sytë nuk verbërohen, por verbërohen zemrat në kraharor.”** 22-Haxh: 46, dhe me nje ajet tjetër:

**“Ai, që në këtë botë ka qenë i verbër, do të jetë i verbër edhe në botën tjetër dhe më i humbur nga rruga e drejtë.” 17-Isra: 72**

Nga këto gjëra që u janë treguar Pejgamberëve, disa i kanë parë me sytë e ballit, e disa me syrin e zemrës, dhe të gjithave së bashku u është dhënë emërtimi *shikim* (ru’jet).

Përmbledhje: Kujt nuk i është çelur syri i zemrës, nuk mund të arrijë në të vërtetën e fesë, por vetëm në lëvozhgën e saj.

Këto që i treguam janë pjesët e mendjes.

## DALLIMI I NJERËZVE NË MENDJE

Njerëzit janë në mosmarrëveshje rreth dallimit në mendje mes tyre. Të mundohemi duke cituar fjalët e atyre që janë privuar nga dituritë shpirtërore këtu, nuk ka asnjë kuptim. Më e drejtë është të mundohemi menjëherë ta shpjegojmë rrugën e vërtetë. Në këtë çështje e vërteta e qartë është kjo:

Nga katër pjesët e mendjes që treguam më lartë, përveç pjesës së dytë që përbën dituritë e domosdoshme, në të tri pjesët tjera ka dallime mes njerëzve. Shprehja: *‘sendet e mundura ka mundësi të ndodhin, sendet e pamundura s’ka mundësi të ndodhin’* në kuptimin e dytë, është shpjegues i diturisë së domosdoshme. Ai që e di se dy është më shumë se një, se një ekzistencë nuk mund të gjendet në të njëjtën kohë në dy vende, se një send nuk mund të bëhet edhe i krijuar edhe i përjetshëm, ai i di në mënyrë të prerë edhe gjërat tjera të ngjashme si këto, që mendja mund t’i dijë. Në këtë nuk ekziston ndarje. Por ndarje ka në tri pjesët tjera.

Në pjesën e katërt, në mposhtjen e epshit dhe në përfitimin e njohurisë, njerëzit nuk janë të njëjtë; bile duket ashikare që edhe një njeri i vetëm nuk është në të njëjtën gradë në çdo gjendje të tij. Ky dallim nganjëherë përbën paraqitjen e lloj-lloj epsheve. Shembull: njeriu është i aftë të largojë disa epshe me mendje, e disa nuk mundet t’i largojë. Edhe kjo nuk bëhet në një mënyrë të vazhdueshme. Kështu, në kohën e rinisë nuk mund të mbizotërojnë epshet. Por, duke u moshuar dhe menduar, e mposht epshin, por si

kundërveprim i forcohet dëshira për demonstrim dhe pozitë. Këtë radhë nuk mund t'i parandalojë këto. Kjo nganjëherë bëhet në mungesë të diturive që shpjegojnë dëmet e atyre epsheve. Për këtë arsye, mjeku e ruan veten nga shumë materie të dëmshme, por kur mjeku nuk ruhet nga to, as pacienti nuk do të mund të ruhet. Duke u shumuar dituria, shumohet edhe frika, e në këtë mënyrë frika bëhet ndihmës i mendjes në mbizotërimin e dëshirave. Siç është kështu gjendja në jetën materie, edhe në anën shpirtërore njëjtë është. Një dijetar që e di mirë dëmin e gabimeve, më mirë e ruan vetën se sa një i paditur (xhahil). Por, *dijetar* nuk është ai që ka mësuar për përfitim material, ka veshur xhybe dhe është grindavec, ne po flasim për atë që ka mësuar për rizanë e Allahut Teala - ai është dijetar i vërtetë.

Nëse dallimet lajmërohen te epshi, kjo nuk ndikon në dallime në mendje, do të thotë nuk është veçori e ndasive të mendjeve. Nëse dallimet janë për shkak të diturisë, ne edhe kësaj pjese të diturisë i dhamë emërtimin mendje. Sepse këtu dituria është nga fuqia e natyrës së lindur (*garizes*). Këtu ndarja bëhet në kuptimin e emërtimit. Kjo ndarje nganjëherë bëhet në krijim. Atij që në krijim i është dhënë mendje e fuqishme, ai e mbron veten më mirë nga dëshirat e nefsit.

Sa i përket pjesës së tretë, që është dituria e përvojës: ndarjen këtu nuk mund ta mohojë askush. Këto nganjëherë ndahen rastësisht, e nganjëherë nga lëvizjet e ndryshimeve të shpejta. Edhe shkak i kësaj ndarje është ndarja në krijim, si dhe niveli i përvojës.

Sa i përket pjesës së parë që është e vërtetë, pra mendja nga krijimi; ndarjen në këtë nuk ka rrugë për të mohuar, sepse ajo është një nur që shkëlqen mbi shpirtin dhe një diell që lind në mëngjesin e tij. Koha e shkëlqimit është në moshën e pjekurisë. Kjo mendje shtohet dhe pjekët pa ndalë, deri në moshën katërdhjetë vjeçare. Kjo i përngjanë diellit të mëngjesit: në fillim është goxha i lehtë, pastaj kur arrin në zenit, shtohet dhe pjekët. Më e shumta dhe më e pakta e nurit të basiretit është si më e shumta dhe më e pakta e dritës së syrit në ballë. Është i qartë dallimi mes syrit të sëmurë që vazhdimisht loton dhe syrit të shëndoshë. Ndoshta është sunneti (ligji) i Allahut Teala në zbatim, që çdo gjë gradualisht arrin në përsosmëri. Bile, epshi nuk i ngarkohet me tërë peshën mbi supet e të riut, deri sa arrin moshën e pjekurisë. Kështu janë edhe forcat tjera si ngrënia, ndjenjat, imagjinata dhe të menduarit. Dyshohet në mendjen e atyre që deklarojnë se nuk ka ndarje në krijim. Kush e konsideron të njëjtë mendjen e Pejgamberit me mendjen e një beduini, ai është edhe më i ulët se beduini.

Si mund të mohohet ekzistimi i dallimit në krijim mes mendjeve? Nëse nuk do të kishte dallim mes njerëzve në perceptimin e diturive, ata nuk do të ishin ndarë në tre: një pjesë që quhen *‘të zgjuar’*, të cilët, pas një mundimi të gjatë arrijnë të mësojnë diçka, ata që nuk arrijnë të mësojnë e që quhen *‘budalla’*, dhe një pjesë, të cilët pa shkollë dhe pa përgatitje, e dinë hakikatin dhe bukurinë e të gjitha gjërave, e që quhen *‘kamil’* (të përkryer), për të cilët Allahu Teala thotë;

**“E vaji i tij ndriçon pothuajse edhe pa e prekur zjarri. Dritë sipër dritës.”** 24-Nur: 35

Këta janë Pejgamberët. Edhe pa shpallje (vahj) dhe melekë, atyre u shfaqen në zemra gjëra të fshehta dhe që nuk dihen, e kësaj i thonë *ilham*.<sup>179</sup> Si shembulli i kësaj, në një hadith Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Xhebraili, ose Allahu Teala (drejtpërdrejtë), e vendosi këtë në zemrën time: dashuro çka të duash, në fund do të ndahesh. Jeto sa të duash, në fund do të vdesësh. Vepro si të duash, në fund do të përgjigjesh.”**<sup>180</sup>

Kjo rrugë e njoftimit të pejgamberëve nga melekët është një rrugë tjetër nga shpallja e qartë që dëgjohet me vesh. Për këtë, Pejgamberi ynë këto i ka shprehë me fjalët ‘*nefes*’ dhe ‘*ruh*’, në kuptimin *fryrje* dhe *frymë*.

Rrugët e shpalljes janë të shumta, por meqë kjo i takon diturisë *mukashefe*, në diturinë *muamele* (praktike) mbi këtë nuk duhet ta zgjasim më shumë.

Për të njohur gradat e shpalljes (*vahj*), mos mendo që ajo duhet të shfaqet edhe te ti. Sepse një mjek i cili nuk është shëndosh mund t’i tregojë gradat e sëmundjes të sëmurit, e edhe dijetari i cili nuk vepron me atë që thotë, mund t’i tregojë drejtësinë dhe gradat e mirësisë një personi të keq. Ngjashëm kësaj, nuk është kusht t’i shfaqet shpallja personit, për të treguar gradat e shpalljes. Dituria është tjetër, e ekzistenca e asaj që dihet diçka tjetër. Ai që e di çka është pejgamberllëku dhe evliallëku, nuk do të thotë që edhe ai duhet të jetë pejgamber ose evlia, ose ai që e di devotshmërinë dhe zuhd-in, nuk do të thotë se edhe vet është i devotshëm.

---

<sup>179</sup> **Ilham:** kuptimi që bëhet i dukshëm në zemër prej Allahut Teala; frymëzim.

<sup>180</sup> Shirazi Sehl nga Sa’d.

Nga pikëpamja e kuptimit, në njohje të vetes dhe në mësimin me udhëzim e edukim, njerëzit janë si sipërfaqja e tokës. Një pjesë e tokës buron ujë nga vetja, e uji rrjedhë, një pjesë e tokës e nxjerrë ujin pasi të gërmohet, dhe një pjesë është e thatë, sado që të gërmosh - nuk ka ujë, dhe krejt kjo ndodh si pasojë e dallimeve në esencën e tokës. I njëjtë është dallimi mes njerëzve sipas natyrës së mendjes së tyre.

Për shpjegimin që mendjet nuk janë të njëjta, njëra nga dëshmitë është edhe fundi i hadithit të gjatë të transmetuar nga Abdullah b. Selami. Në këtë hadith, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“...Melekët thanë:**

**- *Ja Rabb, a krijove diçka më të madhe se Arshi? Allahu***

**Teala tha:**

**- *Po, e krijova mendjen. Melekët thanë:***

**- *Ja Rab sa është e madhe mendja? Allahu Teala tha:***

**- *A dini numrin e kokrave të zallit? Melekët thanë:***

**- *Jo, nuk e dimë, ja Rabb. Allahu Teala tha:***

**- *(pra) as madhësinë e mendjes nuk mund ta dini. Unë e ndava mendjen në klasa, siç i ndava kokrrat e zallit. Dikujt i është dhënë një kokërr, dikujt dy kokrra, dikujt tri a katër kokrra, dikujt një kaci, dikujt një ngarkesë, e dikujt edhe më shumë.***<sup>181</sup>

Nëse ti pyet se çka është shkaku që disa sufi e qortuan mendjen dhe dituritë racionale, dije se shkaku i kësaj është që njerëzit përpiqen të përdorin mendjen dhe dituritë racionale për ta heshtur njëri-tjetrin, mendjen dhe emërtime të

---

<sup>181</sup> Inbu'l Muhber nga Enesi.

përshtatshme mendjes i përdorin në përplasje dhe debatim. Ndërsa debatimi është arti i fjalës. Sufitë duke i thënë atyre: “*Ju në këtë fjalim keni gabuar, arti i fjalës është tjetër e dituria racionale tjetër*”, nuk patën fuqi ta shpjegojnë këtë çështje. E është e pamundur të nxirret kjo nga zemrat e tyre, ngase ata këtë e kanë trashëguar nga mësuesit e tyre. Prandaj sufitë u detyruan të qortojnë emërtime të përshtatshme mendjes dhe diturive racionale. E assesi nuk mund të mendohet qortimi i nurit të mendjes që është vendosur në zemër dhe që është i dobishëm për të njohur Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Nëse qortohet kjo mendje të cilën Vet Allahu Teala e ka lavdëruar, çka mbetet tjetër për t’u lavdëruar? Nëse sheriat i që e solli Pejgamberi s.a.v.s. është i lavdërueshëm, drejtësia e kësaj me çka është ditur? Nëse njohja përfitohet përmes mendjes qortuese, edhe ajo njohje është qortuese.

Nuk ka vlerë ai që thotë se drejtësia e sheriatit nuk njihet me mendje, por kuptohet me nurin e imanit dhe me jekin. Sepse ne me emërtimin *mendje* synojmë pikërisht atë që ata e emërtojnë *nuri i imanit* dhe *jekin*. Kjo është një veti e brendshme për të kuptuar hakikatin e gjërave, e që e ndanë njeriun prej gjallesave tjera. Shumica e këtyre rrëshqitjeve është prej paditurisë së njerëzve, që kërkojnë hakikatin në fjalë, e kur njerëzit u ngatërruan në fjalë, u ngatërruan edhe në gjërat që ato fjalë shpjegojnë.

Në shpjegimin e *nderit të mendjes*, kaq është e mjaftueshme. Vetëm Allahu Teala e di çdo gjë ashtu siç është.